



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE**

**DISERTACION**

**ÇËSHTJE TË SEMIOLOGJISË DHE SEMANTIKËS NË  
PLANIN KRAHASUES MIDIS SHQIPES DHE  
ANGLISHTES**

**Punoi  
Ma. SUELA MANGELLI**

**Udhëheqës shkencor  
Prof. dr. ALI JASHARI**

**TIRANË, 2015**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

DISERTACION

Përgatitur nga: SUELA MANGELLI  
Për marrjen e gradës shkencore: “DOKTOR”

ÇËSHTJE TË SEMIOLOGJISË DHE SEMANTIKËS NË PLANIN  
KRAHASUES MIDIS SHQIPES DHE ANGLISHTES

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Ali JASHARI  
Mbrohët në dt. \_\_. \_\_. 2015 përpara jurisë së përbërë nga:

1. \_\_\_\_\_ Kryetar
2. \_\_\_\_\_ Anëtar
3. \_\_\_\_\_ Anëtar (oponent)
4. \_\_\_\_\_ Anëtar (oponent)
5. \_\_\_\_\_ Anëtar

TIRANË, 2015

## PASQYRA E LËNDËS

|                    |           |
|--------------------|-----------|
| <b>HYRJE</b> ..... | <b>IX</b> |
|--------------------|-----------|

|   |             |
|---|-------------|
| Përligjja e temës.....                        | <b>IX</b>   |
| Objekti, karakteri dhe synimet e punimit..... | <b>XII</b>  |
| Metodologjia dhe struktura e punimit.....     | <b>XIII</b> |

|   |          |
|---|----------|
| <b>PJESA E PARË ÇËSHTJE TË SEMIOLOGJISË</b> ..... | <b>1</b> |
|---|----------|

### **KAPITULLI I**

|                                      |          |
|--------------------------------------|----------|
| <b>ÇËSHTJE TË SEMIOLOGJISË</b> ..... | <b>2</b> |
|--------------------------------------|----------|

|   |           |
|---|-----------|
| 1.1.Ç'është semiologjia? .....  | <b>2</b>  |
| 1.2.Semiologjia dhe gjuhësia.....   | <b>3</b>  |
| 1.3.Shenja gjuhësore.....   | <b>4</b>  |
| 1.4.Modeli i shenjës gjuhësore sipas Ferdinand de Sossyr-it (Ferdinand de Saussure).5   |           |
| 1.4.1. Shenjuesi dhe i shenjuari.....   | <b>5</b>  |
| 1.4.2. Koncepti dhe forma (përbërja) tingullore.....                                    | <b>7</b>  |
| 1.4.3. Marrëdhënia (relata) dhe vlera.....  | <b>8</b>  |
| 1.4.4. Arbitrariteti dhe marrëveshja.....   | <b>9</b>  |
| 1.5. Modeli i shenjës gjuhësore sipas Çarls Sandërs Pirs-it (Charles Sanders Pierce).11 |           |
| 1.5.1. Modeli trianësh I: përfaqësimi, interpretimi, objekti.....                       | <b>11</b> |
| 1.5.2. Modeli trianësh II: mjeti shenJOR, kuptimi, referenti.....                       | <b>13</b> |
| 1.5.3. Ikona, simboli, treguesi (indeksi).....  | <b>13</b> |
| 1.6. Roman Jakobson-i (Roman Jakobson) për modelin shenJOR Sossyrian dhe Pirsian.....   | <b>14</b> |
| 1.7. Modeli i shenjës gjuhësore sipas Karl Buhler-it (Karl Bühler).....                 | <b>15</b> |
| 1.8. Një vështrim kritik mbi modelet e shenjës gjuhësore.....                           | <b>17</b> |
| 1.9. Arbitrariteti i shenjës gjuhësore .....  | <b>20</b> |
| 1.10. Asimetria e shenjës gjuhësore .....   | <b>22</b> |

### **KAPITULLI II**

|   |           |
|---|-----------|
| <b>LIDHJA MIDIS SEMANTIKËS DHE SEMIOLOGJISË</b> ..... | <b>27</b> |
|---|-----------|

|   |           |
|---|-----------|
| 2.1. Lidhja midis semantikës dhe semiologjisë në komunikimin e kuptimit ..... | <b>27</b> |
| 2.2. Semantika dhe komunikimi i kuptimit .....                                | <b>27</b> |
| 2.3. Semiologjia dhe konteksti i kuptimit .....                               | <b>28</b> |
| 2.4. Semantika dhe semiologjia si mjete analitike .....                       | <b>28</b> |

|  |           |
|--|-----------|
| <b>PJESA E DYTË ÇËSHTJE TË SEMANTIKËS NË PLANIN KRAHASUES<br/>MIDIS SHQIPES DHE ANGLISHTES .....</b> | <b>30</b> |
|--|-----------|

### **KAPITULLI III**

#### **SFOND HISTORIK RRETH DUKURISË GJUHËSORE TË HOMONIMISË.31**

|  |    |
|--|----|
| 3.1. Prejardhja e fjalës “homonimi” .....  | 31 |
| 3.2. Ç’janë homonimet? .....   | 31 |
| 3.3. Shkaqet dhe rrugët e lindjes së homonimeve në gjuhën shqipe dhe angleze .....                           | 34 |
| 3.3.1. Rrugët e lindjes së homonimeve në gjuhën shqipe .....   | 36 |
| 3.3.1.1. Përputhja fonetike e fjalëve krejt të ndryshme .....  | 36 |
| 3.3.1.2. Shpërbërja e polisemisë .....   | 37 |
| 3.3.1.3. Formimi i fjalëve të reja .....   | 38 |
| 3.3.2. Lindja e homonimeve në gjuhën angleze.....  | 38 |
| 3.3.3. Rrugët e lindjes së homonimeve në gjuhën angleze .....  | 39 |
| 3.3.3.1. Homonimi nëpërmjet zhvillimit konvergjent të tingujve .....   | 40 |
| 3.3.3.2. Homonimi e zhvilluar nga polisemia nëpërmjet zhvillimit divergjent të kuptimeve .....               | 41 |
| 3.3.3.3. Fjalëformimi .....  | 43 |
| 3.4. Ndikimi i homonimisë në gjuhë .....   | 45 |
| 3.4.1. Bie nga përdorimi një homonim dhe zëvendësohet me një fjalë tjetër.....                               | 45 |
| 3.4.2. Shfrytëzimi i trajtave gramatikore sjell ndryshim të pjesshëm të njërës prej fjalëve homonimike ..... | 46 |

### **KAPITULLI IV**

#### **POLISEMIA DHE HOMONIMIA NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE ...47**

|  |    |
|--|----|
| 4.1. Shkallëzimi i prejardhjes semantike .....   | 47 |
| 4.2. Polisemia dhe homonimia një labirint konceptual .....   | 49 |
| 4.2.1. Lidhja polisemi / homonimi .....  | 51 |
| 4.2.2. Polisemi që formohet nga homonimia (Kontaminimi homonimik) .....                                | 54 |
| 4.3. Kriteret e dallimit polisemi / homonimi .....   | 57 |
| 4.3.1. Kriteri i prejardhjes etimologjike .....  | 58 |
| 4.3.2. Kriteri i lidhjes kuptimore .....   | 60 |
| 4.3.3. Kriteri i ngjashmërisë ose dallimit formal .....  | 62 |
| 4.3.4. Kriteri mbi baza referenciale .....   | 64 |
| 4.4. Parametra të dallimit polisemi / homonimi sipas Najlëdi Sikar Dash-it (Niladri Sekhar Dash) ..... | 71 |
| 4.5. Polisemia dhe homonimia nga këndvështrimi leksikografik .....                                     | 73 |
| 4.6. Polisemia dhe homonimia në leksikografinë kompjuterike .....                                      | 75 |

## KAPITULLI V

### KLASIFIKIMI I HOMONIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE...80

|  |    |
|--|----|
| 5.1. Klasifikimi i homonimeve në gjuhën shqipe .....                             | 80 |
| 5.1.1. Klasifikim i homonimeve sipas Jani Thomait .....                          | 80 |
| 5.1.2. Klasifikim i homonimeve sipas Xhevat Lloshit .....                        | 84 |
| 5.1.3. Klasifikim i homonimeve sipas Rami Memushajt .....                        | 86 |
| 5.2. Klasifikimi i homonimeve në gjuhën angleze .....                            | 87 |
| 5.2.1. Klasifikim i homonimeve sipas Uolter Skit-it (Walter Skeat) .....         | 87 |
| 5.2.2. Klasifikim i homonimeve sipas A. I. Smirnitski-t (A. I. Smirnitsky) ..... | 89 |
| 5.2.3. Klasifikim i homonimeve sipas I. V. Arnold-it (I. V. Arnold) .....        | 91 |
| 5.2.4. Klasifikim i homonimeve sipas Ilo Stefanllarit .....                      | 92 |
| 5.2.5. Klasifikim i homonimeve sipas Xhon Lajëns-it (John Lyons) .....           | 93 |
| 5.3. Krahasim midis klasave të homonimeve në të dyja gjuhët .....                | 96 |
| 5.4. Klasifikim i homonimeve sipas Aristotelit .....                             | 96 |

## KAPITULLI VI

### TRAJTIMI LEKSIKOGRAFIK I HOMONIMEVE NË GJUHËSINË SHQIPTARE DHE ANGLEZE .....98

|   |     |
|---|-----|
| 6.1. Homonimia në leksikografinë shqiptare .....  | 99  |
| 6.1.1. Vështrim deri në <i>Fjalorin e Gjuhës Shqipe</i> (1954) .....  | 99  |
| 6.1.2. Paraqitja e homonimeve në <i>Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe</i> (1980)...101  |     |
| 6.1.3. Paraqitja e homonimeve në <i>Fjalorin e Shqipes së Sotme</i> (2002) .....  | 104 |
| 6.1.4. Krahasim i pasqyrimet të homonimeve në fjalorët shpjegues të shqipes:<br><i>Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe</i> (1980) dhe <i>Fjalori i Shqipes së Sotme</i> (2002).105                             |     |
| 6.1.5. Homonimet në <i>FGJSSH</i> (1980) nga sipas Agim Spahiut .....   | 109 |
| 6.1.6. <i>Fjalori i homonimeve të gjuhës shqipe</i> nga Bahtijar Kryeziu dhe Ali<br>Jashari .....   | 111 |
| 6.2. Homonimia në leksikografinë angleze .....  | 112 |
| 6.2.1. Paraqitja e homonimeve tek <i>Oxford Advanced Learner's Dictionary</i> (2000)<br>nga A. S. Hornbi (A. S. Hornby) .....   | 119 |
| 6.2.2. <i>A dictionary of English homonyms: pronouncing and explanatory</i> (1899) -<br><i>Një fjalor i homonimeve të gjuhës angleze: shqiptues dhe shpjegues</i> nga A. F.<br>Inglot-i (A.F. Inglot) ..... | 121 |
| 6.2.3. <i>The encyclopedia of homonyms 'sound-alikes'</i> (1977) - <i>Enciklopedia e<br/>    homonimeve 'që tingëllojnë njësoj'</i> nga Dora Njuhaus-i (Dora Newhouse) .....                                | 122 |
| 6.2.4. <i>A dictionary of homophones</i> (1997) - <i>Një fjalor homofonesh</i> nga Lesli<br>Presën-i (Leslie Presson) .....   | 123 |
| 6.2.5. <i>Dictionary of Homonyms</i> (2007) - <i>Fjalori i homonimeve</i> nga Deivid<br>Rothuell-i (David Rothwell) .....   | 125 |
| 6.2.6. <i>Homonyms. When you need to write the right words</i> (2011) - <i>Homonimet.<br/>    Kur ju duhet të shkruani fjalën e duhur</i> nga Kethi Zengolux-i (Kethy<br>Zengolewicz) .....                 | 127 |

|  |     |
|--|-----|
| 6.2.7. An <i>English homophone dictionary</i> - Një fjalor homofon i gjuhës angleze nga Sabër-i dhe Thorp-i (Suber dhe Thorpe) ..... | 128 |
| 6.2.8. Alan Cooper's <i>Homonyms list</i> - Lista e homofoneve nga Alan Kupër-i (Alan Cooper) .....                                  | 129 |

## KAPITULLI VII

|   |     |
|---|-----|
| <b>HOMONIMET SI MJETE STILISTIKORE</b> .....  | 131 |
| 7.1. Një vështrim i përgjithshëm mbi kalamburin (lojë fjalësh) .....                    | 131 |
| 7.2. Përkufizime të ndryshme të termit 'kalambur' .....                                 | 132 |
| 7.3. Histori .....  | 134 |
| 7.4. Autorë të ndryshëm për kalamburin .....  | 135 |
| 7.4.1. Kalamburet: forma më e ulët e mençurisë .....                                    | 136 |
| 7.4.2. Të lehta për t'u krijuar .....   | 137 |
| 7.4.3. Jezusi përdori një lojë fjalësh .....  | 138 |
| 7.4.4. Poetë dhe dramaturgë mbi lojën e fjalëve .....                                   | 138 |
| 7.4.5. Lojë fjalësh, por jo për të qeshur .....   | 138 |
| 7.4.6. Krijimi dhe përdorimi i kalambureve është i justifikuar .....                    | 139 |
| 7.5. Homonimet si mjete stilistikore në gjuhën shqipe dhe angleze .....                 | 139 |
| 7.6. Llojet e kalambureve (Tipologji) .....   | 149 |
| 7.6.1. Kalamburi homografik .....   | 149 |
| 7.6.2. Kalamburi homofonik .....  | 149 |
| 7.6.3. Kalamburi homonimik .....  | 151 |
| 7.6.4. Kalambur i përbërë .....   | 152 |
| 7.6.5. Kalambur i përsëritur .....  | 153 |
| 7.6.6. Kalamburet vizuale .....   | 153 |
| 7.6.7. Kalamburet humoristike .....   | 153 |
| 7.6.8. Kalamburet serioze .....   | 154 |
| 7.7. Përdorimi i kalamburit .....   | 155 |
| 7.7.1. Në komedi dhe në shaka .....   | 155 |
| 7.7.2. Në letërsi .....   | 155 |
| 7.7.3. Në retorikë .....  | 157 |
| 7.7.4. Në emërtime .....  | 157 |
| 7.7.5. Përdorime konfuze dhe alternative .....  | 159 |
| 7.8. Lloje të ndryshme lojërash ndërtuar mbi kalambure homonimike .....                 | 159 |
| 7.9. Paronomasia dhe përdorimi i saj stilistikor .....                                  | 160 |
| 7.10. Shembuj homonimesh në vepra të letërsisë shqipe .....                             | 162 |
| 7.11. Shembuj homonimesh në vepra të letërsisë së huaj të përkthyer në shqip ....       | 185 |
| 7.12. Shembuj homonimesh në vepra të letërsisë angleze .....                            | 193 |
| 7.12.1. Shembuj homonimesh në veprën "Romeo dhe Zhulieta" nga Uilliam Shekspir-i .....  | 193 |
| 7.12.2. Shembuj homonimesh në veprën "Hamleti" nga Uilliam Shekspir-i ...               | 196 |
| 7.12.3. Shembuj homonimesh në veprën "Liza në botën e çudirave" nga Luis Kerëll-i ..... | 199 |
| <b>PËRFUNDIME</b> .....   | 204 |

|  |     |
|--|-----|
| <b>REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA</b> .....   | 211 |
| Literatura shkencore (artikuj dhe libra të botuar) .....   | 211 |
| Literatura shkencore (artikuj dhe libra të paraqitur në internet) .....                                    | 215 |
| Vepra leksikografike (fjalorë shpjegues të gjuhës shqipe dhe asaj angleze, lista<br>homonimesh etj.) ..... | 217 |
| Literatura artistike .....   | 219 |
| <b>SHKURTIME</b> .....   | 221 |

## FALENDERIME

Në rrugëtimin e gjatë të përfundimit të studimeve të mia të doktoraturës kam pasur fatin të kem në krah shumë persona që më kanë ndihmuar, mbështetur dhe këshilluar. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë e njëkohësisht të falenderoj të gjithë ata që ndikuan në ecurinë e mbarë të këtij procesi studimor, të gjithë ata që me mendimet apo sugjerimet e tyre më ndihmuan e më mbështetën për ta çuar deri në fund këtë nismë të rëndësishme për profesionin tim.

Së pari, dëshiroj të falënderoj udhëheqësin shkencor të këtij studimi, Prof. Dr. Ali Jashari, i cili drejtoi çdo hap të punimit me kërkesë shkencore dhe metodologjike. Mendimet dhe sugjerimet e tij kanë qenë shumë të dobishme dhe ndihmuese për mua gjatë kryerjes së këtij procesi kërkimor.

Së dyti, një ndihmesë e çmuar kanë qenë edhe debatet profesionale me kolegët e mi, mbi problemet e hasura në hapa të caktuar të studimit dhe këtu dëshiroj të cilësoj në veçanti ish-kolegjet e mia: Lindita Kaçani, Armela Panajoti, Marsela Prifti dhe Magdalini Gaqollari.

Po ashtu, dëshiroj të falënderoj për ndihmën dhe mbështetjen profesionale profesor Ilo Stefanllari.

Një falënderim i veçantë i takon edhe një grupi studentësh të Masterit Profesional, Dega Gjuhë – Letërsi të Universitetit të Korçës, viti akademik 2011-2012, të cilët ndihmuan në mbledhjen e burimeve stilistikore të përdorimit të homonimisë për të dyja gjuhët, shqipe dhe angleze.

Së fundi, shpreh falenderime pa fund për familjen time të shtrenjtë, e cila më krijoi mundësinë e një pune të qetë, justifikoi mungesën e pranisë sime dhe të vëmendjes sime duke më dhënë gjithë tolerancën e duhur për të cilën kisha nevojë.



## HYRJE

### *Përligjja e temës*

Përzgjedhja e temës u bë në varësi të interesave tona studimore dhe profesionale. Duke qënë lektore e lëndëve të “Semiologjisë” dhe “Leksikologjisë angleze” si edhe duke pasur parasysh lidhjen e dy shkencave me njëra-tjetrën gjatë zhvillimit të tyre, u nxita për t’i ndërthurur ato në punimin tim të doktoraturës. Si rrjedhim ai ndahet në dy pjesë.

**Pjesa e parë** e punimit është një studim teorik në fushën e Semiologjisë e ndërthurur me Gjuhësinë. Semiologjia është studimi i “mbartjes së kuptimit”, teoria filozofike e shenjave dhe simboleve. Ajo përfshin studimin e shenjave dhe proceseve shenjore (semiozave). Njeriu duket të jetë një specie, që priret nga “dëshira për të mbartur kuptime”<sup>1</sup> duke krijuar dhe interpretuar shenjat. Në të vërtetë është fakt që “ne mendojmë vetëm me anë të shenjave”.<sup>2</sup> Këto shenja mund të kenë formën e fjalëve, tingujve, imazheve, objekteve, veprimeve, bisedave, teksteve ose aromave. Duke qënë se sendet nuk kanë një kuptim të brendshëm, ne duhet t’u japim atyre një kuptim në mënyrë që të bëhen shenja. Çarls Sandërs Pirs-i pohon se “Asgjë nuk është shenjë nëse nuk interpretohet si e tillë.”<sup>3</sup> Kjo do të thotë se çdo gjë mund të bëhet një shenjë për aq kohë sa ajo shenjon diçka – i referohet ose qëndron për diçka.<sup>4</sup>

Semiologjia lidhet ngushtë me gjuhësinë, e cila, nga ana e saj, studion strukturën dhe kuptimin e gjuhës në mënyrë më specifike. Ndryshe nga gjuhësia, semiologjia studion edhe sistemet shenjore jogjuhësore. Raporti midis semiologjisë dhe gjuhësisë argumentohet nga Ferdinand de Sossyr-i dhe Roland Barths-i (Roland Barthes).

Në këtë pjesë të parë të punimit do të përqendrohemi edhe te shenja gjuhësore dhe tri modelet kryesore të saj, të cilat realizojnë një shpjegim të hollësishëm të formimit të një shenje. Këto janë modelet e Ferdinand De Sossyr-it, Çarls Sandërs Pirs-it dhe Karl Buhler-it. Ferdinand de Sossyr-i na paraqet një model dyanësh të shenjës gjuhësore, ndërsa modeli Pirsian është trianësh dhe ai konceptohet si një logjikë filozofike e studiuar në lidhje me shenjat, të cilat nuk janë gjithmonë gjuhësore ose artificiale. Modeli Pirsian i drejtohet jo vetëm mekanizmit të jashtëm të komunikimit siç bëri Sossyr-i, por mekanizmit të brendshëm të përfaqësimit, i cili studion jo vetëm proceset shenjore, por të gjithë procesin hetimor në përgjithësi. Edhe psikologu gjerman Karl Buhler vjen me modelin “Organon” të shenjës gjuhësore, i cili përkufizon funksionet komunikuese sipas të cilave mund të përshkruhet komunikimi gjuhësor.

*Semiologjia shpesh ndahet në tri degë:*

<sup>1</sup> Chandler, D. *Semiotics for Beginners*, London, Routledge, 2002, f. 43

<sup>2</sup> Peirce, Ch. S. *Collected Writings* (Vëllimi II), Cambridge, MA, Harvard University Press, 1931, f. 301.

<sup>3</sup> Po aty, f. 172.

<sup>4</sup> Chandler, D. *Semiotics for Beginners*, London, Routledge, 2002, f.43.

*semantika: lidhja midis shenjave dhe asaj që shenja i referohet, kuptimit denotativ (kuptimi i parë / tregues);*

*sintaksa: lidhja midis shenjave në strukturat formale;*

*pragmatika: lidhja midis shenjave dhe agjentëve që i përdorin ato.*

*Në temën tonë sjellim edhe një trajtim teorik të lidhjes midis semantikës dhe semiologjisë në komunikimin e kuptimit. Pasi shqyrtohet rëndësia e gjuhës në shkencat moderne, ndalemi në veçanti te gjuhësia dhe jepet një shpjegim më i hollësishëm i semantikës dhe semiologjisë.*

*Duke ndjekur rrjedhën logjike të trajtimit të temës duke u nisur nga lidhja e semiologjisë me gjuhësinë dhe më konkretisht me semantikën, vazhdojmë me pjesën e dytë të punimit, i cili është konceptuar si një studim teorik dhe praktik në fushën e gjuhësisë, me drejtim semantik (leksikologjik). Tashmë përqendrohemi te një dukuri (shenjë) e veçantë gjuhësore, siç është homonimia.*

*Studimi i thelluar i materialit gjuhësor (leksikor), gjithnjë e më të madh, që po grumbullohet nga gjuhëtarët për të dyja gjuhët, shqipe dhe angleze, shtron nevojën e trajtimit të çështjeve të veçanta gjuhësore, siç është dukuria e homonimisë. Në këtë pjesë të dytë homonimia hulumtohet për të nxjerrë në pah universalitetin e saj në të dyja gjuhët, shqipe dhe angleze.*

*Homonimet, fjalë me formë të njëjtë dhe përmbajtje të ndryshme, janë zhvilluar intensivisht në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Ato formojnë një klasë më vete leksikore dhe zënë një vend të rëndësishëm në të dyja gjuhët.*

*Në gjuhën e sotme shqipe ka rreth 500 vargje homonimike me rreth 1050 fjalë<sup>5</sup>, ndërsa në anglishten moderne numërohen rreth 6139 homonime të llojeve të ndryshme<sup>6</sup>. Ky numër i përgjithshëm nuk është i vogël, veçanërisht për anglishten, ku dukuria gjuhësore sot ka marrë zhvillim dhe përmasa të gjera. Anglishtja moderne është veçanërisht e pasur me fjalë dhe forma fjalësh homonimike. Thuhet se gjuhët, ku fjalët njërrrokëshe mbizotërojnë (si anglishtja) kanë më shumë homonime se gjuhët ku fjalët shumërrrokëshe përbëjnë shumicën.*

*Jo vetëm fjalët, por edhe njësi të tjera gjuhësore mund të jenë homonimike. Megjithatë, ne jemi përqendruar vetëm te homonimia e fjalëve dhe formave të fjalëve, kështu që nuk do të prekim problemin e ndajshesave homonimike ose shprehjeve homonimike.*

*Në këtë pjesë do të përqendrohemi te dy gjuhë të cilat kanë karakter të ndryshëm morfologjik, shqipja më flektive dhe anglishtja më analitike. Kjo gjë ka ndikuar edhe në çështje të tilla si ajo e homonimisë. Në gjuhën shqipe, e cila karakterizohet nga një natyrë mjaft flektive, ku tema e fjalës dhe tema fjalëformuese nuk përputhen gjithmonë me njëra-tjetrën, ku fjalët kanë një strukturë të gjerë kuptimore, ku zhvillimet e fundit historiko-shoqërore kanë pasur ndikimin e tyre në*

---

<sup>5</sup> Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1989, f. 177.

<sup>6</sup> Burke, R. R. *Dictionary of Homonyms and Homophones*, Rogers Reference. Australia, 2000.  
<http://rogersreference.com/>

gjuhë, e gjejmë si domosdoshmëri hulumentimin e çështjeve të tilla, siç është ajo e homonimisë. Në gjuhën angleze, e cila ka një natyrë të theksuar analitike dhe karakterizohet nga një shkallë shumë e lartë polisemantizmi, me strukturë njërrrokjesore të fjalëve më të përdorura, gjithashtu, i kushtohet vëmendje e veçantë çështjes së homonimisë.

Mjaft punime në të dyja gjuhët e kanë parë të domosdoshme trajtimin e dukurisë leksikore të homonimisë. Përpyekjet e para në gjuhën shqipe për studimin e saj gjenden në vepra leksikografike, ku hasim një zgjidhje praktike të çështjes sipas autorëve, por pa një përgjithësim të saj në parathëniet e fjalorëve ose në diskutimet e zhvilluara më pas rreth tyre. Për herë të parë homonimet përmenden te Fjalori i shkurtër shqip-rusisht (1951)<sup>7</sup>. Në shënimet mbi përdorimin te Fjalori i Gjuhës Shqipe (1954)<sup>8</sup> kemi edhe një përpyetje për të dhënë përkufizimin e homonimeve në gjuhën shqipe: “Fjalët që ngjajnë në shqiptim, por ndryshojnë shumë nga kuptimi (homonimet) janë vënë si fjalë të veçanta”. Një formulim më të përpiktë kemi po në këtë fjalor, kur shpjegohet fjala ‘homonim’: “thuhet për një fjalë që ka të njëjtën trajtë fonetike me një tjetër, po kuptimet janë të ndryshme”<sup>9</sup>.

Studiues të gjuhës shqipe e kanë hulumtuar homoniminë për t’i dhënë një zgjidhje sa më të drejtë trajtimit të saj në çdo nivel të gjuhës. Profesor Eqrem Çabej te “Studime etimologjike në fushë të shqipes”<sup>10</sup> prek çështjen e homonimisë për të parë ndikimin që ajo ka pasur në zhvillimin historik të disa fjalëve. Edhe Androkli Kostallari në artikullin e tij “Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme”<sup>11</sup> e përmend homoniminë me qëllim që të përcaktohet drejt nocioni i saj në gjuhën shqipe, të bëhet klasifikimi dhe të përcaktohen prirjet e zhvillimit të saj për të pasur një pasqyrim sa më të drejtë në praktikën leksikografike.

Gjithashtu, Xhevat Lloshi trajton çështje të rëndësishme të homonimisë në gjuhën shqipe, si klasifikimi i tyre, rrugët e lindjes së homonimeve dhe kontaminimi homonimik. Një studim të hollësishëm mbi homoniminë në gjuhën shqipe bën edhe Jani Thomai te “Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe”<sup>12</sup>, sidomos për çështje të tilla si karakteri i lidhjes polisemi – homonimi, dallimi ndërmjet polisemisë dhe homonimisë, si edhe tipet e homonimeve në gjuhën shqipe.

Për sa i përket gjuhës angleze, termi ‘homonim’ u huazua nga greqishtja e vjetër ὁμός “homos” (e njëjtë) dhe ὄνομα “onomos” (emër), bashkë me shumë terma të tjerë të greqishtes që hynë në fjalorin e anglishtes nëpërmjet latinishtes dhe frëngjishtes. Në gjuhën angleze gjejmë edhe studimin e Aristotelit për homoniminë, dallimin që ai bën midis dy termave teknikë ‘sinonimi’ (‘univocity’) dhe ‘homonimi’ (‘multivocity’). Ja si shprehet Aristoteli te hyrja e punimit “Kategoritë”: “Kur gjërat kanë vetëm një emërtim të përbashkët dhe përkufizimet që i përkasin këtij emërtimi

<sup>7</sup> Kostallari, A.; Koci, R.; Skendi, Dh. *Fjalor i shkurtër shqip – rusisht*, Shtëpia botonjësore shtetërore e fjalorëve të huaj dhe nacionalë, Moskë, 1951.

<sup>8</sup> *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954, f.15.

<sup>9</sup> Lloshi, Xh. “Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe”, *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vëllimi I, Tiranë, 1972, f. 203.

<sup>10</sup> Çabej, E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, II, Tiranë, 1982, f. 385.

<sup>11</sup> Kostallari, A. “Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme”, *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vëllimi II, Tiranë, 1972, f. 81 – 115.

<sup>12</sup> Thomai, J. *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Botimet EDFA, 2009.

janë të ndryshme, ato quhen homonime” ose siç shprehej shpesh ai “pollochôs legomenos” (kuptime të shumëfishta)<sup>13</sup>.

Në pjesën e dytë të temës do të trajtohen gjerësisht dy aspekte: teorik dhe praktik. Kjo do të bëjë që fusha e studimit të punimit të jetë më e gjerë, përfshi ndërthurjen e aspektit teorik me atë praktik, si dhe përdorimin e vazhdueshëm të komenteve krahasuese për të dyja gjuhët mbi dukurinë e homonimisë.

### **Objekti, karakteri dhe synimet e punimit**

Siç u theksua parapraakisht, punimi ka dy pjesë kryesore përbërëse. Për këtë arsye edhe qëllimi i tij varion nga njëra pjesë te tjetra.

Pjesa e parë e punimit i përket fushës së semiologjisë e ndërthurur me atë të gjuhësisë. Me anë të trajtimit teorik synohet të vihet në dukje rëndësia e semiologjisë në jetën tonë të përditshme. Ajo mund të aplikohet në të gjitha llojet e aktiviteteve të njeriut, përfshi kinemanë, teatrin, vallëzimin, arkitekturën, pikturën, politikën, mjekësinë, historinë, besimin fetar etj. Ne përdorim lloje të ndryshme shenjash në jetën e përditshme për të mbartur mesazhe dhe kuptime te njerëzit që na rrethojnë.

Çështja e shenjës gjuhësore i përket së bashku semiologjisë dhe gjuhësisë. Përpunimi i materialeve të kohëve të ndryshme, vjelja e të dhënave, krahasimi i tyre dhe nxjerrja e përfundimeve etj. vënë në dukje se dy modelet më të përhapura mbi shenjat gjuhësore janë ato të gjuhëtarit zviceran Ferdinand de Saussure dhe filozofit amerikan Çarls Sandërs Pirs. Të dy kanë koncepte shumë të ndryshme mbi atë se çfarë tregon një shenjë.

Ndërthurja e dy disiplinave, semiologjisë dhe gjuhësisë, synon të nxjerrë në pah lidhjet e ndërsjellëta midis tyre. Koncepti i gjuhës si sistem shenjash ndërlidhet me konceptin e semiologjisë apo studimit të shenjave. Sipas Saussure-it, gjuhësia është një nga pjesët e semiologjisë, e cila merret me shenjat e të gjitha llojeve dhe jo vetëm të gjuhës. Roland Barthes-i semiologjinë e sheh si pjesë të gjuhësisë, por më pas edhe ai del te mendimi se “Gjuhësia është degë e semiotikës dhe shkencë fjinje e saj. ...”.

Një tjetër çështje e pjesës së parë është edhe lidhja midis semantikës dhe semiologjisë. Kjo shërben si një pikë tjetër lidhëse logjike e pjesës së parë me të dytën dhe, njëkohësisht, synon të tregojë se sa e rëndësishme është lidhja e dy fushave në çështjen e realizimit të komunikimit ndërnjerëzor.

Pjesa e dytë e punimit i përket fushës së studimeve gjuhësore krahasuese dhe, përmes përjasjes, hulumtohet një dukuri (shenjë) e veçantë gjuhësore siç është homonimia. Përjasja synon të nxjerrë në pah karakteristika themelore të homonimisë në dy gjuhë, shqipe dhe angleze.

Qëllimi i pjesës së dytë të temës është, gjithashtu, përjasja e studimeve të kohëve të ndryshme, deri në ato më të fundit mbi homoniminë në të dyja gjuhët.

Çështja e homonimisë në gjuhë vlen të studiohet, pasi ka rëndësi si për marrëveshjen gjuhësore në variantet e saj, ashtu edhe për kuptimin teorik dhe praktik të kësaj dukurie leksikologjike (semantike).

<sup>13</sup> Shields, Ch. “Aristotle”, *The Stanford Encyclopedia of Philosophy*, Edward N. Zalta (ed.), 2012  
<http://plato.stanford.edu/archives/sum2012/entries/aristotle>

*Trajtimi teorik synon të nxjerrë në pah prejardhjen e termit leksikor “homonim”, shkaqet dhe burimet e lindjes së homonimeve në të dyja gjuhët, klasifikimi tyre dhe ndikimi i homonimisë në gjuhë. Ndërsa qëllimi i trajtimit praktik është ta njohim homoniminë jo thjesht si një dukuri teorike.*

*Një nga pikat kryesore të punimit është analiza e çështjeve më të rëndësishme të homonimisë dhe polisemisë në të dyja gjuhët në rrafshin leksikor, semantik, paradigmatic, sintagmatik dhe atë stilistikor. Çështje të tilla kanë të bëjnë me kufijtë e polisemisë dhe homonimisë, me dykuptimshmërinë që vjen prej homonimisë dhe polisemisë, pasqyrimi sa më i saktë në fjalorë dhe përdorimi sa më i drejtë në gjuhën e folur ose atë të shkruar.*

*Hulumtimi i homonimeve në të dyja gjuhët dhe dallimet e tyre nga fjalët polisemantike, ende nuk janë studiuar në shkallën e duhur për të dyja gjuhët. Një nga qëllimet kryesore të kësaj teme kërkimore është pikërisht përpjekja për të hulumtuar këtë problem.*

*Çështje që trajtohen përgjatë këtij punimi gjejnë zbatim të gjerë në hartimin e fjalorëve shpjgues, pasqyrimin e homonimeve në fjalorë homonimikë, si edhe në përdorimin stilistikor të tyre në të dyja gjuhët. Punimi ka vlerë dhe mund të gjejë aplikim edhe në mësimdhënie, si të gjuhës amtare, ashtu edhe asaj të huaj, në rastin tonë gjuha angleze.*

*Duke u bazuar në përmbajtjen e pjesës së dytë të temës mund të formulojmë edhe disa synime të tjera të punës tonë kërkimore:*

- *Studimi i fjalëve homonimike është një çështje në zhvillim e leksikologjisë në ditët tona. Punimi synon të studiojë, të analizojë dhe të përmbledhë të gjitha ndryshimet e mundshme që kanë ndodhur mbi këtë dukuri gjuhësore gjatë viteve të fundit.*
- *Të paraqitë çështjen e homonimisë në të gjitha këndvështrimet e saj për të dyja gjuhët, shqipe dhe angleze.*
- *Të demonstrojë domethënien e kësaj çështjeje për ata që janë më të interesuar në studimet krahasuese.*
- *Të përmendë të gjitha opinionet e gjuhëtarëve në lidhje me temën në fjalë.*
- *Të evidentojë faktin që kuptimet homonimike të fjalëve janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e teknologjive moderne të informacionit.*

### **Metodologjia dhe struktura e punimit**

*Metodat e përdorura për realizimin e pjesës së parë të studimit janë ato analitike dhe interpretuese. Për këtë arsye janë mbledhur dhe përpunuar materiale me punime të mirëfillta mbi semiologjinë, gjuhësinë, shenjën gjuhësore, semantikën etj. Ndërthurja i dy metodave bën të mundur vjeljen e të dhënave, krahasimin i tyre dhe nxjerrjen e përfundimeve mbi çështjet e lartpërmendura.*

*Metoda themelore e përzgjedhur për pjesën e dytë të studimit është ajo krahasuese, e cila na krijon mundësinë e përqaqjes apo pranëvënies së çështjes së homonimisë në leksikologji dhe veçorive të shumta të saj në të dyja gjuhët, shqipe dhe angleze. Përparësi i jepet gjuhës shqipe dhe përqaqja me anglishten ndihmon në një studim më të thelluar të materialit, çka e bën atë më të kuptueshëm dhe më interesant.*

*Përveç metodës krahasuese (përqasëse), kjo pjesë e punimit realizohet duke zbatuar edhe një sërë metodash të tjera, si: metoda statistikore, e cila përdoret po në rrafshin gjuhësor; metoda interpretuese në rrafshin letrar gjatë argumentimit stilistikor të homonimisë; si dhe metodat përshkruese dhe analitike. Në rrafshin gjuhësor, merren fjalorë, në shqip dhe në anglisht, nga të cilët janë vjelë homonimet përkatëse dhe janë dhënë karakteristika dhe veçori të tyre në secilën gjuhë. Në rrafshin letrar janë marrë vepra nga të cilat nxirren homonimet dhe diskutohet shumëkuptimësia e tyre me vlerë stilistikore.*

*Për të realizuar qëllimin e konceptuar studimi është ndarë në shtatë kapituj.*

*Në kapitullin e parë studimi shtjellon çështje të tilla, si: ç'është semiologjia; semiologjia dhe gjuhësia; shenja gjuhësore; modeli i shenjës gjuhësore sipas Ferdinand de Sossyr-it; modeli i shenjës gjuhësore sipas Çarls Sandërs Pirs-it; Roman Jakobson-i mbi modelin shenjor Sossyrian dhe Pirsian; modeli i shenjës gjuhësore sipas Karl Buhler-it; një vështrim kritik mbi modelet e shenjës gjuhësore; spontaniteti / arbitrariteti i shenjës gjuhësore; asimetria e një shenje gjuhësore etj.*

*Kapitulli fillon me një paraqitje të shkurtër të shkencës së semiologjisë dhe më pas analizohet raporti i saj me gjuhësinë sipas pikëpamjeve të studiuesve të ndryshëm, si: Ferdinand de Sossyr-i, Roland Barths-i, etj. Analiza e shenjës gjuhësore dhe modeleve kryesore të saj janë çështjet në vijim. Shenjë në gjuhësi është çdo njësi gjuhësore (morfemë, fjalë, shprehje ose fjali) e përdorur për të përcaktuar objekte ose dukuri të realitetit. Shenjat gjuhësore janë të dyanshme. Ato konsistojnë në një shenjues, i përbërë nga tinguj të të folurit (më saktësisht fonema) dhe një i shenjuar, i krijuar nga përmbajtja kuptimore e shenjës gjuhësore. Marrëdhënia midis aspekteve të një shenje është arbitrare për arsye se zgjedhja e formës tingullore përgjithësisht nuk varet nga cilësi të objektit të përcaktuar. E veçanta e shenjës gjuhësore është asimetria e saj, që do të thotë aftësia e një shenjuesi për të mbartur kuptime të ndryshme (p.sh. homonimia ose polisemia) dhe prirja e të shenjuarit për t'u shprehur nga shenjues të ndryshëm (p.sh. sinonimia). Asimetria e strukturës së shenjës gjuhësore përcakton aftësinë e gjuhës për zhvillim.*

*Kapitulli i dytë nxjerr në pah lidhjen midis semantikës dhe semiologjisë në komunikimin e kuptimit, duke pasur parasysh që të dyja fushat kanë një interes të përbashkët në lidhje me kuptimin e shenjave. Nga këndvështrimi semantik, qëllimi kryesor është elementi më i vogël përbërës i një fjalie, që është fjala. Si rrjedhim, një fjali e saktë duhet të ketë përshtatjen kryefjalë – kallëzues, përdorimin e duhur të gjinisë, ose çfarë quhet një ndërtim sintaksor i një fjalie dhe, së bashku, përbërësit duhet të komunikojnë një ide të kuptimtë. Në kontrast me këtë, semiologjia u adresohet elementëve të tillë, si: kodet, shenjuesi, i shenjuari, ikonat dhe simbolet. Kapitulli i dytë trajton çështje të tilla, si: lidhja midis semantikës dhe semiologjisë në komunikimin e kuptimit; semantika dhe interpretimi i kuptimit; semiologjia dhe konteksti i kuptimit; semantika e semiologjia si mjete analitike.*

*Përtej kapitullit të tretë, i cili shërben për të dhënë një paraqitje të termit dhe një panoramë të përgjithshme diakronike të çështjes së homonimisë në të dyja gjuhët, kapitujt e tjerë sjellin një analizë më të hollësishme të aspekteve të ndryshme të dukurisë me karakter teorik e praktik. Punimi është plotësuar me përfundimet dhe bibliografinë e specifikuar për secilin autor dhe referim të shfrytëzuar.*

Në kapitullin e tretë jepet një bazë teorike e nevojshme për ecurinë e përjasjes, duke trajtuar aspektet më të rëndësishme të studimit të homonimisë, siç janë ato për prejardhjen e fjalës 'homonim' dhe përkufizimet gjuhësore të termit në fjalorë e prej autorësh të ndryshëm në të dyja gjuhët. Duke identifikuar tipare dalluese të dukurisë është më të lehtë të jepet një përkufizim më i qartë i saj.

Në këtë kapitull studimi përqëndrohet kryesisht tek shkaqet dhe rrugët e lindjes së homonimeve përkatësisht në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Në gjuhën shqipe homonimet kanë lindur si rezultat i: përpunimit fonetike të fjalëve krejt të ndryshme, shpërbërjes së polisemisë dhe formimit të fjalëve të reja. Ndërsa në gjuhën angleze homonimet janë krijuar nëpërmjet: zhvillimit konvergjent të tingujve, polisemisë nga zhvillimit divergjent të kuptimeve dhe fjalëformimit.

Po në këtë kapitull preket edhe çështja e ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe dhe angleze. Raste të ndryshme tregojnë kur homonima shihet si një pengesë gjuhësore, ndryshe nga polisemia që trajtohet si një tipar i qenësishëm gjuhësor dhe se si gjuha reagon me mjetet e saj.

Kapitulli i katërt synon një analizë më të detajuar drejt argumentimit të tezës. Në bazë të përkufizimit të homonimisë nga kapitulli pararendës, jepet një klasifikim (tipologji) e homonimeve, me veçantitë dhe ngjashmëritë e të dyja gjuhëve. Kjo tipologji prezantohet sipas autorëve të ndryshëm duke u bazuar në tri kritere, të cilat qartësojnë të gjitha aspektet e homonimisë: formën e shkruar (ortografia), formën e folur (shqiptimi) dhe dallimet kuptimore.

Në gjuhën shqipe trajtohen klasifikimet e homonimeve sipas Jani Thomait, Xhevat Lloshit dhe Rami Memushajt. Në gjuhën angleze klasifikimet e homonimeve vijnë sipas: filologut Uolter Skit, A. I. Smirnitshi, I. V. Arnold-it, Ilo Stefanllari dhe Xhon Lajëns-it. Klasifikimi i homonimeve sipas Aristotelit, në homonime rastësore dhe jorastësore, është një tjetër pikë me interes në këtë kapitull.

Në kapitullin e pestë vazhdohet me të njëjtën metodë pune dhe me të njëjtën strukturë përmbajtësore si në dy kapitujt e mëparshëm. Kapitulli fillon me çështjen e shkallëzimit të prejardhjes semantike, e cila shërben si parantezë për t'u përqëndruar më tej te homonimia dhe polisemia në gjuhën shqipe dhe angleze. Në analizën semantike, dallimi teorik midis homonimisë dhe polisemisë krijon një problem që ka tërhequr vëmendjen e shumë gjuhëtarëve. Nuk është gjithmonë e mundur të dallohen njësitë leksikore homonimike nga ato polisemantike. Edhe nëse ky dallim bëhet, subjektivizmi mbizotëron. Kritere të dallimit polisemi / homonimi janë: kriteri i prejardhjes etimologjike, kriteri i lidhjes kuptimore, kriteri i ngjashmërisë ose dallimit formal dhe kriteri mbi baza referenciale. Parametra të dallimit polisemi / homonimi analizohen edhe nga studiuesi indian Najlëdi Sikar Dash-i.

Një rëndësi të veçantë ka edhe polisemia dhe homonimia të trajtuara nga këndvështrimi leksikografik . Në fakt leksikografi e bën dallimin duke i paraqitur homonimet ndaras në fjalor, dmth, si dy ose më shumë njësi leksikore pavarësisht se këto kanë të njëjtën ortografi dhe/ose shqiptim, ndërsa një njësi leksikore polisemantike jepet si një njësi më vete, duke renditur të gjitha kuptimet, dmth dy ose më shumë kuptime që i përkasin kësaj fjale. Polisemia dhe homonimia janë çështje leksikore që lidhen ngushtë me çdo aspekt të përdorimit të leksikut të një gjuhe. Ato gjejnë një përdorim të gjerë jo vetëm si figura gjuhësore, por edhe si figura stilistikore. Paraqitja e tyre në fjalor, gjithashtu, kërkon një studim të thelluar të

strukturës semantike të fjalës. Kur kjo strukturë interpretohet saktë, atëherë kemi edhe një ndarje të saktë të kuptimeve polisemantike nga ato homonimike.

Ndërsa te çështja “Polisemia dhe homonimia në leksikografinë kompjuterike” trajtohet problemi i dykuptimisë gjatë përpunimit kompjuterik të materialit gjuhësor.

Aspekte praktike të homonimisë trajtohen në kapitujt e katërt dhe të pestë. Qëllimi i trajtimit praktik është ta njohim homoniminë jo thjesht si një dukuri teorike.

Kapitulli i gjashtë i kushtohet trajtimit leksikografik të homonimeve. Shqyrtimi i anëve të ndryshme të tyre në leksikologjinë e të dyja gjuhëve, sjell me vete edhe një mënyrë të caktuar të paraqitjes së tyre në veprat leksikografike. Puna me fjalorë bashkëkohorë të të dyja gjuhëve argumenton trajtimin e homonimeve në praktikën leksikografike dhe parimet që duhet të ndjekë një leksikograf në paraqitjen e tyre. Dihet që të gjitha vlerat e mundshme të një shenje gjuhësore listohen në fjalor. Është detyra e leksikografit të përcaktojë kufijtë e çdo fjale, dmth, të diferencojë homonimet dhe të vendosë në çdo rast, nëse kuptimet e ndryshme i përkasin të njëjtës fjalë polisemantike apo duhen trajtuar si fjalë të veçanta, identike në formë.

Në veçanti jemi ndalur në paraqitjen e homonimeve në fjalorë shpjegues të gjuhës shqipe, që u përkasin periudhave të ndryshme të botimit, si: “Fjalori i Gjuhës Shqipe” (1954), “Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe” (1980), “Fjalori i Shqipes së Sotme” (2002), “FGJSSH” (1980) nga Agim Spahiu dhe “Fjalori i homonimeve të gjuhës shqipe” (2008) nga Bahtijar Kryeziu dhe Ali Jashari.

Në leksikografinë e gjuhës angleze është trajtuar paraqitja e homonimeve te: “Oxford Advanced Learner’s Dictionary” nga A. S. Hornbi (2000), “A dictionary of English homonyms: pronouncing and explanatory” (Një fjalor i homonimeve të gjuhës angleze: shqiptues dhe shpjegues) nga A. F. Inglot-i (1899), “The encyclopedia of homonyms ‘sound-alikes’” (Enciklopedia e homonimeve ‘që tingëllojnë njësoj’) nga Dora Njuhaus-i (1977), “A dictionary of homophones” (Një fjalor homofonësh) nga Lesli Presën (1997), “Dictionary of Homonyms” (Fjalor i homonimeve) nga Deivid Rothuell-i (2007), “Homonyms. When you need to write the right words” (Homonimet. Kur ju, duhet të shkruani fjalët e duhura) nga Kethi Zengolux-i (2011), “An English homophone dictionary” (Një fjalor homofon i gjuhës angleze) nga Subër-i dhe Thorp-i dhe “Homonyms list” (Lista e homofoneve) nga Alan Kupër-i.

Përdorimi stilistikor i homonimeve në të dyja gjuhët trajtohet në kapitullin e shtatë. Ato bëhen shpesh shkak paqartësie dhe nuk mund të kuptohen pa kontekstin ku përdoren. Pikërisht ky tipar i homonimeve është shfrytëzuar për të krijuar lojëra fjalësh ose kalambure, të cilat e bëjnë një gjuhë të tingëllojë këndshëm dhe të ngjallë interes te përdoruesit e saj. Jepen përkufizime të ndryshme të termit ‘kalambur’ dhe paraqitet një tipologji e tyre, ku ato klasifikohen në: kalamburë homografikë, homofonikë, homonimikë, të përbërë, të përsëritur, vizualë, humoristikë dhe seriozë.

Studiues të ndryshëm janë shprehur pozitivisht ose negativisht për kalamburin (lojën e fjalëve). Në këtë kapitull janë sjellë opinione dhe mendime të tyre. Kalamburet përdoren gjerësisht: në komedi dhe shaka, në letërsi, në retorikë, në emërtime, në fushën shkencore dhe kompjuterike, për të ndërtuar lojra të ndryshme etj.

Numri i madh i homonimeve në një gjuhë krijon paqartësi në ligjërim. Megjithatë, rrallë ndodh që paqartësi të kësaj natyre të ndikojnë te kuptimi, sepse në



*dinamikën e gjuhës së gjallë dhe veçanërisht në ligjërimin letrar, homonimia merr vlera shprehëse stilistikore. Prania e tyre në një titull gazete, reklamë, prozë, poezi, fjalëkryq etj. tërheq vëmendjen dhe ngjall interes te lexuesi dhe dëgjuesi. Pra, homonimet nuk janë vetëm figura gjuhësore, por edhe përftesa stilistikore që shfrytëzohen mjeshtërisht nga autorë të ndryshëm në vepra letrare. Duke u përqendruar në vepra të letërsisë shqipe dhe asaj të huaj, kryesisht angleze, është bërë një analizë e hollësishme e lojërave të fjalëve, që ndërtohen mbi bazën e homonimisë, për efekte humori apo thjesht si figura stilistikore.*

*Nga letërsia shqipe janë sjellë shembuj të përdorimit të homonimeve në vepra të Pashko Vasës, Naim Frashërit, Mit'hat Frashërit, Faik Konicës, Fan Nolit, Ali Asllanit, Lasgush Poradecit, Petro Markos, Fatos Arapit, Ismail Kadaresë, Sotir Lashovës, Rexhep Qoses, Musa Vyshkës, Skënder Rusit, Ferit Lamajt dhe Ilir Belliut, kurse në letërsinë e huaj janë vjelë shembuj nga Xhakomo Leopardi, Henrik Hajne, Aleksandër Pushkini, Nikolas Sparks, Honore de Balzak, Frederik Stendali, Gustav Floberi, Leon Tolstoi, Xhani Rodari dhe Xhon Luka Karaxhale.*

*Veprave të letërsisë së huaj “Romeo dhe Zhulieta”, “Hamleti” nga Uilliam Shekspir-i dhe “Liza në botën e çudirave” nga Luis Kerëll-i, u është bërë një analizë më e hollësishme lidhur me përdorimin e lojërave të fjalëve, që ndërtohen mbi bazën e homonimeve.*

*Në kuadrin e kësaj analize, si një rrjedhim logjik dhe i natyrshëm, arrihet në formulimin e përfundimeve të studimit.*

*Bibliografia e përzgjedhur është një mbështetje e vazhdueshme teorike dhe praktike për përgatitjen e këtij studimi, madje, shpeshherë, edhe nxitje për verifikime të vazhdueshme e kërkime më të hollësishme, që ndihmojnë në përgatitjen e një punimi me baza sa më të thella shkencore dhe në nxjerrjen e përfundimeve sa më të argumentuara. Ajo, gjithashtu, ndihmon që lexuesi të orientohet më lehtë në trajtimin e temës.*

*Referencat dhe bibliografia e shfrytëzuar ndahet në: literaturë shkencore I (artikuj dhe libra të botuar); literaturë shkencore II (artikuj dhe libra të paraqitura në internet); vepra leksikografike (fjalorë shpjegues të gjuhës shqipe dhe asaj angleze, lista homonimesh etj.) dhe literaturë artistike për të nxjerrë në pah vlerat e pasura stilistikore të homonimisë.*

*"Asgjë nuk është shenjë nëse ajo nuk interpretohet si e tillë."*<sup>1</sup>

*Çarls Sandërs Pirs*

*Pjesa e parë*  
*Çështje të semiologjisë*

---

<sup>1</sup> Peirce, Ch. S. *Collected Writings* (Vëllimi II), Cambridge, MA, Harvard University Press, 1831, f. 172.

## KAPITULLI I ÇËSHTJE TË SEMIOLOGJISË

### 1.1. Ç'është semiologjia?

Semiologjia është teoria filozofike e hulumtimit të shenjave të ndryshme. Për emërtimin e saj gjatë zhvillimit historik janë përdorur disa terma: *semiologji*, *teori e shenjave*, *semiotikë*, *shkencë e shenjave* etj. Fjala semiologji (semiotikë) vjen nga fjala greke *semeion* “shenjë” dhe *semeiotikos* “që lidhet me shenjat”. Fjala mori kuptimin që ka sot në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX në punime të gjuhëtarit zviceran Ferdinand de Saussure dhe filozofit pragmatist amerikan Çarls Sandërs Pirs. Por rrënjët e semiologjisë shkojnë thellë në antikitetin grek, veçanërisht në njohuritë mjekësore. Termat “semiologji” dhe “semiotikë” nënkuptojnë të njëjtën gjë. Saussure-i si themelues i linguistikës moderne evropiane ka përdorur termin “**semiologji**” kurse përfaqësuesi i shkollës linguistike amerikane Pirs-i ka përdorur termin “**semiotikë**”. Pirs shikonte te semiotika një teori të njohjes njerëzore, të përqëndruar në aftësinë për të interpretuar përvojën dhe çdo shfaqje të saj empirike. Nga ky këndvështrim, fjalë, mendime, ndjenja, mund të quhen “interpretues” të ndryshëm të të njëjtit objekt, në një proces të ndërtimit të kuptimit, i cili virtualisht nuk reshtet kurrë. Saussure-i, i cili parapëlqente të fliste për semiologji (jo semiotikë), mendonte më shumë për një disiplinë-kuadër, që të përvijonte një territor të përbashkët për të gjitha dukuritë e komunikimit (gjuhët, para së gjithash, por edhe gjuhët e shurdhmemecëve, formulat e mirësjelljes, sjelljet njerëzore të riteve etj.) dhe nga e cila mund të lëvizet për të studiuar çka është e veçantë për çdo mënyrë komunikimi.

Semiologjia mund të aplikohet në të gjitha llojet e aktiviteteve të njeriut, përfshi kinemanë, teatrin, vallëzimin, arkitekturën, pikturën, politikën, mjekësinë, historinë, besimin fetar etj. Ne përdorim një shumëllojshmëri shenjash në jetën e përditshme për të sjellë mesazh të njerëzit që na rrethojnë. Ne duhet të mendojmë për mesazhet ose tekstet si sisteme të shenjave, për shembull, leksikore, grafike etj., të cilat ushtrojnë ndikimin e tyre me anë të përplasjeve konstante midis këtyre sistemeve. Për shembull, menyja që ne lexojmë në një restorant është krijuar duke iu referuar një strukture, por kjo strukturë mund të plotësohet në mënyra të ndryshme, sipas kohës dhe vendit, për shembull, mëngjes ose drekë.<sup>2</sup>

Më konkretisht, semiologjia studion kuptimin e shenjave (shqip. *Shenjë*, ang. *Sign*, frëngj. *Signe*, ital. *Segno*) dhe se si kuptimet ndërtohen me anë të sistemit shenjor dhe përdorimit të tyre. Semiologjia na lejon të kuptojmë që realiteti nuk është objektiv, por i ndërtuar mbi kuptimet që krijohen me anë të kodeve, bisedave, praktikave dhe konteksteve.

Nëse me shenjë kuptojmë diçka që shpreh ose na sjell ndërmend diçka tjetër, atëherë mund të themi se e gjithë jeta jonë lëviz brenda shenjave. Shenjat i japin formë jetëve tona: ne jemi të rrethuar prej tyre dhe, përgjithësisht, jemi të pavetëdijshëm për këtë fakt.

Vetitë e shenjës mund të cilësojnë një klasë ngjarjesh të prodhuara nga qeniet e gjalla, njerëzore ose lloje të tjera gjallesash duke i shtuar, të gjitha sistemet e krijuara nga njeriu me qëllim që të përmbushet funksioni komunikativ (sinjalistika e tipeve të ndryshme, sistemet e alarmit, programet e shkrimit në kompjuter etj.). Është e zakonshme të përdoret termi *qëllimshmëri* për të karakterizuar shenjat e mirëfillta

<sup>2</sup> [Barthes, R. *The Structuralist Activity, Essais Critiques*, 1964, Partisa Review 34: (Winter) 82-88] shih te <http://people.ucalgary.ca/~rseiler/semiolog.htm>

dhe të vërteta, të realizuara sipas rregullave të parashikuara nga një *kod* në bazë të korrespondencave të qartësuar mes shprehjes dhe përmbajtjes. Nga kjo pikëpamje, të gjitha gjuhët dhe dialektet e tyre, të gjitha sistemet e shkrimit, të gjitha artet, format e llogaritjes, gjuhët gjestuale që shoqërojnë fjalët ose gjuhët e posaçme dhe të vërteta që përdorin shurdhmemecët, gjuhët e fishkëlluara dhe ato të daulles të disa popujve ekzotike, të gjitha format e komunikimit të gjallesave (jo të njerëzve), nga shimpazetë te milingonat që shkëmbejnë sinjale kimike: e gjitha kjo hyn me të drejta të plota në hapësirën e zbatimit të konceptit të *shenjës* (*së mirëfilltë*).

Njeriu duket të jetë një specie që priret nga “dëshira për të mbartur kuptime”<sup>3</sup> duke krijuar dhe interpretuar shenjat. Në të vërtetë, është fakt që “ne mendojmë vetëm me anë të shenjave”.<sup>4</sup> Këto shenja mund të kenë formën e fjalëve, tingujve, imazheve, objekteve, veprimeve, bisedave, teksteve ose aromave. Duke qenë se sendet nuk kanë një kuptim të brendshëm, ne duhet t’u japim atyre një kuptim në mënyrë që të bëhen shenja. Pirs-i pohon se “Asgjë nuk është shenjë nëse nuk interpretohet si e tillë.”<sup>5</sup> Kjo do të thotë se çdo gjë mund të bëhet një shenjë për aq kohë sa ajo shenjon diçka – i referohet ose qëndron për diçka.<sup>6</sup> Interpretimi ynë mbi shenjat është një proces i pavetëdijshëm në mendjet tona, ndërsa në mënyrë konstante ne lidhim shenjat me të cilat përballemi në një sistem marrëveshjesh të njohur për ne. Ky sistem marrëveshjesh dhe përdorimi i shenjave, në përgjithësi, është qëllimi i semiotikës.

Ka tri modele kryesore, të cilat japin një shpjegim të hollësishëm të formimit të një shenje. Këto janë modelet e Ferdinand De Sossyr-it, Çarls Sandërs Pirs-it dhe Karl Buhler-it.

Semiologjia është teoria e *shenjave gjuhësore* dhe *jogjuhësore*, si dhe e proceseve shenjuese. Në këtë mënyrë ajo është e interesuar mbi:

- a. lidhjen midis shenjave të ndryshme (*sintaksë*);
- b. lidhjen midis shenjës dhe kuptimit të saj (*semantikë*);
- c. lidhjen midis shenjës dhe përdoruesit të saj (*pragmatikë*).

Të gjitha gjuhët njerëzore mund të përkufizohen si sisteme shenjash arbitrare. Këto tri nëndisiplina i përkasin, gjithashtu, edhe fushave të ndryshme të gjuhësisë.

Shenjat gjuhësore shfaqen, funksionojnë dhe zhvillohen në procesin e përhershëm të ndryshimit të gjuhës.

## 1.2. Semiologjia dhe gjuhësia

Duke u nisur nga ato që u pohuan më sipër bëjmë pyetjen: cili është raporti mes semiologjisë dhe gjuhësisë? Dihet që mjeti kryesor i komunikimit ndërnjerëzor është gjuha. Përdorimi në praktikë dhe aplikimi i gjuhës janë objekt studimi i gjuhësisë së aplikuar. Gjatë studimit të gjuhës mund të lindin pyetje të tilla, si: cila është forma e fjalëve të përdorura? si ndryshojnë fjalët në trajta të ndryshme gramatikore? Nëse këto pyetje i shohim me syrin e një semiologu, duhet të shprehemi se flasim për një proces të vazhdueshëm komunikimi ose siç shkruan Sossyr-i:

<sup>3</sup> Chandler, D. 2002, *Semiotics for Beginners*, London, Routledge, 2002, f. 43

<sup>4</sup> Peirce, Ch. S. *Collected Writings* (Vëllimi II), Cambridge, MA, Harvard University Press, 1931, f. 301.

<sup>5</sup> Po aty, f. 172.

<sup>6</sup> Chandler, D. 2002, *Semiotics for Beginners*, London, Routledge, f.43.

“Gjuha është vetëm një ndër sistemet semiotike.”<sup>7</sup> Në fillimet e punës së tij, Sossyr-i u shpreh: “Gjuha është një sistem shenjash që shpreh ide që mund të jenë të krahasueshme me alfabetin e shurdhmemecëve, principet simbolike, etj... gjuha është vetëm një sistem në sajë të sistemeve të tilla.”<sup>8</sup> Por, më vonë, edhe Sossyr-i e quan gjuhën shkencë të shenjave në sajë të jetës shoqërore dhe pjesë të psikologjisë sociale dhe të psikologjisë së përgjithshme.

Siç shihet nga pohimi i mësipërm, *linguistika ose shkenca mbi gjuhën shihet si pjesë përbërëse e shkencës mbi shenjat*. Nëse këtë tezë e marrim në kuptimin më të gjerë arrijmë në përfundimin se semiologjia i zgjeron kompetencat e saj shkencore dhe metodologjike dhe se gjuhësia dhe aplikimi i saj është pjesë e semiologjisë. Por çfarë përfshin semiologjia përveç shkencës mbi gjuhën? Përgjigjja do të jetë: shenjat joverbale. Përkufizimi i Sossyr-it në lidhje me kompetencën gjuhësore e argumenton një hipotezë të tillë.

Pra, koncepti i gjuhës si sistem shenjash ndërlidhet me konceptin e semiologjisë apo studimit të shenjave. Sipas Sossyr-it, gjuhësia është një nga pjesët e semiologjisë, e cila merret me shenjat e të gjitha llojeve dhe jo vetëm të gjuhës.

Gjuhëtari dhe semiologu francez Roland Barths ndjek një tjetër mënyrë arsyetimi: “Kështu edhe pse duke punuar në fillim me lëndë jogjuhësore, semiologjisë iu desh, më shpejt ose më vonë, të gjente gjuhën (në kuptimin më të gjerë të fjalës) në rrugën e saj, jo vetëm si një model, por edhe si një komponent. Kur flasim për gjuhë në këtë kontekst, nuk nënkuptohet gjuha e gjuhëtarit. Kjo është gjuhë e një rendi të dytë, jo me njësitë e saj morfema ose fonema, por fragmente më të mëdha të ligjërit, që i referohen objekteve dhe episodeve, kuptimi i të cilave motivon gjuhën. Këto nuk mund të ekzistojnë asnjëherë të pavarura prej saj. Semiologjia ndoshta është e destinuar të absorbohet nga një ndërgjuhësi, lëndë e së cilës janë mitet, krijimet e stilit tregimtar, gazetaria ose, nga ana tjetër, objekte të qytetërimit tonë të shprehura me anë të të folurit (shtypit, intervistave, bashkëbisedimeve, ndoshta edhe gjuhës së brendshme, e cila drejtohet nga ligje të imagjinatës). Në këtë pikë përballemi me mundësinë e përmbysjes së pohimit të Sossyr-it: “Linguistika nuk është një pjesë e shkencës së përgjithshme të shenjave, madje një pjesë e privilegjuar e saj, por semiologjia është pjesë e linguistikës, dhe për të qenë më të saktë, është kjo pjesë që mbulon njësitë e mëdha të kuptimshme të ligjërit.”<sup>9</sup>

Roland Barths-i, semiotikën e sheh si pjesë të linguistikës por, më pas, edhe ai del te mendimi se “Linguistika është degë e semiotikës dhe shkencë fqinje e saj. ...”. Në punime të tij ai ka shpjeguar edhe lidhjet e ndërsjellta të këtyre dy disiplinave.<sup>10</sup>

### 1.3. Shenja gjuhësore

Shenjë në Gjuhësi është çdo njësi gjuhësore (morfemë, fjalë, shprehje ose fjali) e përdorur për të përcaktuar objekte ose dukuri të realitetit. Shenjat gjuhësore janë të dyanshme. Ato konsistojnë në një *shenjues*, i përbërë nga tinguj të të folurit (më saktësisht fonema) dhe një *shenjuar*, i krijuar nga përmbajtja kuptimore e

<sup>7</sup> Saussure, F. de. *Kursi i Gjuhësisë së Përgjithshme*, Prishtinë: Rilindja, Redaksija e Botimeve, 1977, f. 50.

<sup>8</sup> Po aty, f. 53 - 54.

<sup>9</sup> Barthes, R. *Elements of Semiology*, 1964.

<https://www.marxists.org/reference/subject/philosophy/works/fr/barthes.htm>

<sup>10</sup> Po aty.

shenjës gjuhësore. Marrëdhënia midis aspekteve të një shenje është arbitrare për arsye se zgjedhja e formës tingullore, përgjithësisht, nuk varet nga cilësi të objektit të përcaktuar. E veçanta e shenjës gjuhësore është asimetria e saj, që do të thotë aftësia e një *shenjuesi* për të mbartur kuptime të ndryshme (p.sh. homonimia ose polisemia) dhe prirja e të *shenjuarit* për t'u shprehur nga *shenjues* të ndryshëm (p.sh. sinonimia). Asimetria e strukturës së shenjës gjuhësore përcakton aftësinë e gjuhës për zhvillim.

Shenjat gjuhësore ndahen në të *plota* dhe të *pjesshme*. Një shenjë e *plotë* përfshin të folurit (të shprehurit), zakonisht një fjali, të lidhur drejtpërdrejt me situatën e përcaktuar (referenti i shenjës gjuhësore). Një shenjë gjuhësore e *pjesshme* është një fjalë ose morfemë që është aktualizuar vetëm si pjesë e një shenje të plotë. Ekzistenca në një gjuhë e shenjave të *pjesshme* të shkallëve të ndryshme të kompleksitetit, po ashtu edhe përpjesëtueshmëria e *shenjuesit* dhe të *shenjuarit* të shenjës më të thjeshtë në njësi të njëanshme (joshenjore) të përmbajtjes (përbërës të kuptimit) dhe shprehjes (fonemat), siguron ekonominë e sistemit gjuhësor dhe lejon krijimin e një numri të madh e të pafund komunikimesh nga një numër i caktuar njësisht të thjeshta.<sup>11</sup>

Dy modelet më të përhapura mbi shenjat gjuhësore janë ato të gjuhëtarit Ferdinand de Saussure dhe filozofit amerikan Çarls Sandërs Pirs. Të dy kanë koncepte shumë të ndryshme mbi atë se çfarë tregon një shenjë. Saussure-i beson se shenja gjuhësore nuk është shoqërimi midis një objekti dhe një emri, por lidhja midis një koncepti dhe një strukture tingujsh, ku struktura e tingujve nuk është një tingull aktual dhe as fizik. Ai beson se struktura tingullore është përshtypja psikologjike e dëgjuesit për një tingull dhe si ai perceptohet nga shqisat. Saussure-i beson se natyra arbitrare e shenjës bën të qartë parimin e parë të gjuhës.<sup>12</sup> Më pas, Çarls Hokit (Charles Hockett) e klasifikoi arbitraritetin si çelës të *tiparit të projektimit* të gjuhës.<sup>13</sup> Në kundërshtim me këtë, Pirs besonte se shenjat janë mjete ynë i vetëm i të menduarit. Shenjat mund të marrin formën e imazheve, fjalëve, aromave, objekteve ose veprimeve, por, në fakt, atyre u mungon kuptimi i trashëguar dhe ato bëhen shenja vetëm kur pajisen me një kuptim. Pirs-i pohon se asgjë nuk përbën një shenjë nëse nuk interpretohet si e tillë dhe nuk shenjon diçka.<sup>14</sup> Arsyeja pse një shenjë ekziston është të mbartë një kuptim.

Të dyja modelet e shenjës gjuhësore janë mjaft të dallueshme nga njëra-tjetra.

## 1.4. Modeli i shenjës gjuhësore sipas Ferdinand de Saussure-it (Ferdinand de Saussure)

### 1.4.1. Shenjuesi dhe i shenjuari

Saussure-i ofron një model dyanësh të shenjës gjuhësore,<sup>15</sup> i cili pasqyrohet në diagramin e mëposhtëm.

---

<sup>11</sup>Po aty. f. 60.

<sup>12</sup>Po aty. f. 59.

<sup>13</sup>Hockett, Ch. F. *Animal "Languages" and Human Languages*, te Spuhler, J. N. *The Evolution of Man's Capacity for Culture*, Detroit, MI, Wayne State University press, 1965, f. 32 – 39.

<sup>14</sup>Peirce, Ch. S. *Collected Writings* (Vëllimi II), Cambridge, MA, Harvard University Press, 1931, f. 58.

<sup>15</sup>Saussure, F. de. *Course in General Linguistics*, London, Duckworth, 1983, f. 66.




Fig. 1.1. Modeli dyanësh i shenjës gjuhësore sipas Ferdinand de Sossyr-it<sup>16</sup>

Sipas këtij diagrami, shenja gjuhësore përbëhet nga një *shenjues* dhe një *shenjuar*. Ndërsa *shenjuesi* përfaqëson *formën* që merr shenja, *i shenjuari* përfaqëson *konceptin* e shenjës. Marrëdhënia midis të dyjave, *shenjues – i shenjuar*, quhet *kuptueshmëri* dhe tregohet me dy shigjetat që ndodhen në të djathtë dhe në të majtë të diagramit. Siç vihet re, këto shigjeta kanë drejtime të kundërta dhe kjo tregon që elementët e shenjës janë shumë të lidhur dhe ato shkaktojnë njëri-tjetrin. Në diagram vihet re një vijë horizontale midis *shenjuesit* dhe *të shenjuarit*.

Një shembull është fjala “libër”. Kjo është një shenjë, e cila përbëhet nga *shenjuesi* - fjala “libër” dhe *i shenjuari* - koncepti që ne kemi në mendje kur dëgjojmë ose lexojmë fjalën “libër”. Ky shembull tregon se nuk është e mjaftueshme të kemi vetëm një *shenjues* dhe një *të shenjuar*. Ose fjala “hap” (në rastin e qepenave të një dyqani) është një shenjë, e cila përfshin fjalën ‘hap’ (*shenjuesin*) dhe *të shenjuarin*, i cili është koncepti që dyqani është i hapur për biznes.

Sipas Sossyr-it, është një kusht i domosdoshëm që një shenjë të përmbajë së bashku *shenjuesin* dhe *të shenjuarin*. Një shenjë gjuhësore është shenjë vetëm nëse përmban kombinimin e këtyre dy elementëve. Është e pamundur të kemi një *shenjues* pa kuptim dhe një *të shenjuar* pa formë.<sup>17</sup> Prandaj në kontekstin e gjuhës së folur një shenjë nuk mund të përmbajë një tingëllim pa kuptim ose një kuptim pa tingëllim. Megjithatë, i njëjti *shenjues* mund t’i referohet një numri të ndryshëm *të shenjuarish* (në rastin e homonimeve: *fole*, *zë*, *bar*, *ah* etj. në gjuhën shqipe dhe *miss* “*më mungon/më le/zonjushë*”; *bear* “*mbart/ari*”; *lie* “*shtrihem/gënjej*” etj. në gjuhën angleze, pra në përgjithësi kur krijohen lojëra fjalësh) dhe *shenjues* të ndryshëm mund t’i referohen të njëjtit *të shenjuar* (në rastin e sinonimeve: *speak* “*flas*”; *talk* “*bidesoj*”; *utter* “*artikuloj*”; *say* “*them*”; *verbalize* “*verbalizoj*” etj.).

Kohët e fundit modeli Sossyrian është interpretuar në një mënyrë më materiale, i cili nuk ishte në fakt qëllimi i tij. Tashmë *shenjuesi* interpretohet gjerësisht si forma materiale ose fizike e shenjës dhe diçka e qartë (e prekshme), e cila mund të perceptohet fizikisht nga shqisat. Megjithatë, për Sossyr-in, *shenjuesi* dhe *i shenjuari*, së bashku ishin koncepte të pastra psikologjike dhe për këtë arsye përbënin *formë* më tepër sesa *substancë*.<sup>18</sup>

Sossyr-i pretendon që shenjat mbartin kuptim vetëm si përbërës të një sistemi formal, të përgjithshëm dhe abstrakt. Nocioni i tij për kuptimin është plotësisht *strukturor* dhe *relativ*, me tepër sesa *referencial*. Sossyr-i pohon që shenjat parimisht i referohen njëra-tjetrës më tepër sesa përmbajnë një kuptim të brendshëm dhe se së bashku *shenjuesi* dhe *i shenjuari* janë subjekte relative.<sup>19</sup> Prandaj, kuptimi i një fjale

<sup>16</sup> Chandler, D. 2002, *Semiotics for beginners*, London, Routledge, 2002, f. 43.

<sup>17</sup> Saussure, F. de. *Course in General Linguistics*, London, Duckworth. 1983, f. 67.

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Po aty.

varet nga konteksti, dmth, nga fjalët e tjera me të cilat ajo është përdorur. Koncepti i Sossyr-it për kuptimin ishte, gjithashtu, *diferencues*. Ai pohon se “ajo që e dallon një shenjë është ajo çfarë e përbën atë”.<sup>20</sup> Sossyr-i thekson se nuk ka një lidhje të detyruar, të trashëguar ose të drejtpërdrejtë midis *shenjuesit* dhe *të shenjuarit*. Sipas tij kjo lidhje është arbitrare dhe e tillë është edhe natyra e shenjës.

#### 1.4.2. Koncepti dhe forma (përbërja) tingullore

Për Sossyr-in shenja me dy komponentët e saj përbërës – *shenjuesi* dhe *shenjuari* – është diçka psikologjike më tepër se materiale (substanciale). Ai pohon se “një shenjë gjuhësore nuk është një lidhje midis një sendi dhe një emri, por midis një *koncepti* dhe një *forme tingullore*. Forma tingullore nuk është një tingull, sepse një tingull është diçka fizike. Një formë tingullore është përshtypja psikologjike e një tingulli të dëgjuesi, siç i jepet atij nga evidenca e shqisave të tij. Kjo formë tingullore mund të quhet një element “material” sepse ajo është përfaqësimi i përshtypjeve shqisore. Në këtë mënyrë forma tingullore dallohet nga elementi tjetër, i cili e shoqëron atë në formimin e shenjës gjuhësore. Elementi tjetër është përgjithësisht i një lloji më abstrakt: *koncepti*. Ky shpjegim ilustron me anën e një diagram që krahasohet me diagramin që përmendëm më lart.




Fig. 1.2.<sup>21</sup>

Sossyr-i parapëlqen fjalën *e folur* më tepër se atë *të shkruar*. Ai përdor termat “imazh akustik” ose “formë tingullore” për të. Sipas teorisë së tij, shkrimi është një sistem shenjor gjuhësor “i ndarë”, sepse “ai është në vetvete jo pjesë e një sistemi të brendshëm të gjuhës”.<sup>22</sup> Megjithatë, është e pamundur të injorohet kjo mënyrë e paraqitjes së gjuhës. Shkrimi me të vërtetë është i rëndësishëm për Sossyr-in për faktin se disa gjuhë tani kanë vdekur, por ato njihen sot vetëm sepse kanë qenë të shkruara. Megjithatë, është fjala e folur ajo që ka rëndësi për semiologjinë dhe jo ajo e shkruar. Sigurisht që ka një lidhje të rëndësishme midis fjalës së folur dhe asaj të shkruar, por ne përqendrohemi tek e para për të studiuar shenjen gjuhësore. Sossyr-i e krahason këtë fakt me një person dhe fotografinë e tij dhe pohon se: “Është njësoj si në rastin kur njerëzit besojnë se në mënyrë që të gjejnë se si ngjan një person është më mirë të studiohet fotografia e tij, sesa fytyra e tij”.<sup>23</sup>

Duke u përqëndruar tek *i shenjuari* në modelin Sossyrian, del se ky përbën një koncept në mendjen e folësit, “nuk është një send, por nocioni i këtij sendi”.<sup>24</sup> Për të bërë të qartë se çfarë nënkuptohet me këtë, po sjellim një shembull nga Sjuzën

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> Po aty, f. 67.

<sup>22</sup> Po aty, f. 24.

<sup>23</sup> Po aty, f. 25.

<sup>24</sup> Chandler, D. 2002, *Semiotics for beginners*, London, Routledge, f. 45.



Langër-i (Susanne Langer). Ajo pohon se *simbolet* – është fjala që ajo përdor në vend të termit *shenjë gjuhësore* – “nuk përfaqësojnë objektet e tyre, por janë mjete për konceptimin e objekteve. Duke folur për sendet, ne bëjmë konceptim të tyre dhe jo të vetë sendeve. Janë konceptimet e jo sendet ato që *simboli (shenja gjuhësore)* nënkupton drejtpërdrejt”.<sup>25</sup> Ajo thotë se “Nëse unë them ‘Napolon’, ju nuk do të përkuleni ndaj pushtuesit të Evropës sikur unë t’ua kisha prezantuar atë, por thjesht do të mendoni për të”.

Megjithatë, Sossyr-i vendosi të përdorte termat *shenjues* dhe *i shenjuar* për të treguar “atë çka dallon njërën nga tjetra”.<sup>26</sup> Ai e krahason këtë me një fije letër: *shenjuesi* (tingulli) është nga njëra anë dhe *i shenjuari* (mendimi) është në anën tjetër. Është e pamundur të grisësh njërën anë të letrës pa grisur edhe tjetrën, pra është e pamundur të ndahet mendimi nga tingulli.<sup>27</sup>

### 1.4.3. Marrëdhënia (relata) dhe vlera

Në një sistem gjuhësor “çdo gjë varet nga marrëdhëniet (relatat)”.<sup>28</sup> Kjo do të thotë që asnjë shenjë nuk mbart kuptim nëse ajo nuk lidhet me shenja të tjera. Po marrim si shembull fjalën “pemë” (shembull gjuhësor). Ajo mbart për ne kuptim, por vetëm në një kontekst të caktuar dhe duke u përdorur në lidhje me fjalë të tjera. Një tjetër shembull është forma bazë e foljes “leh”. Nëse marrim dy fjali: “qeni leh” dhe “macja leh”, sigurisht që fjalia e parë ka më tepër kuptim se e dyta, ashtu si vetë forma bazë e foljes “leh” na kujton neve një qen dhe aspak një mace. Ne e dimë që macet nuk lehin. Kjo është arsyeja pse fjala “leh” ka kuptim kur përdoret në kontekst me fjalën “qen” dhe jo me fjalën “mace”.

Sossyr-i e përdor termin “*vlerë*” për shenjat që janë në lidhje me shenja të tjera. Ai shprehet se shenjat nuk kanë të njëjtën vlerë në kontekste të ndryshme dhe e krahason mendimin e tij me një lojë shahu, ndërsa “një gjendje mbi fushën e shahut i korrespondon saktësisht një gjendjeje të gjuhës”.<sup>29</sup> Së pari, çdo gur shahu ka një pozicion të caktuar në fushën e shahut, nga e cila varet vlera e tyre. Së dyti, vlera nuk është e fiksuar, sepse ajo ndryshon nga një pozicion te tjetri. Së treti, ka rregulla të fiksuara për një lojë shahu dhe ato nuk mund të ndryshohen. Lojtarët duhet t’i respektojnë ato. Së fundi, vetëm një pjesë nevojitet për të ndryshuar gjendjen e lojës së shahut. Sossyr-i e përmbledh këtë krahasim me pak fjalë dhe pohon se në një lojë shahu “çdo pozicion mbi fushën e shahut varet plotësisht nga pozicione të mëparshme”. Nuk ka rëndësi nëse pozicioni në fjalë është arritur me një sekuencë lëvizjesh ose një tjetër. Ai që ka ndjekur gjithë lojën nuk ka as avantazhin më të vogël ndaj dikujt që rastësisht po e sheh atë. E gjithë kjo përdoret në mënyrë të njëjtë në gjuhë. E folura funksionon vetëm mbi një gjendje të caktuar gjuhësore dhe ndryshimet që ndodhin nga një gjendje në një tjetër nuk lidhen me njëra-tjetrën. Krahasimi i mësipërm ka një pikë të dobët: në fushën e shahut lojtari ka një qëllim – ai dëshiron të bëjë lëvizje dhe të ndryshojë diçka në fushë – ndërsa në sistemin gjuhësor “nuk ka paramendim”.

Ka edhe mjaft shembuj të tjerë që provojnë ekzistencën e *vlerës* në gjuhë. Një tjetër shembull bazohet në monedhat e çdo vendi, si për shembull, monedha evropiane

<sup>25</sup> Langer, S. *Philosophy in a New Key*, Harvard University Press, 1951, f.61.

<sup>26</sup> Saussure, F. de. *Course in General Linguistics*, London, Duckworth, 1983, f. 67.

<sup>27</sup> <http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

<sup>28</sup> Saussure, F. de. *Course in General Linguistics*, London, Duckworth, 1983, f. 121.

<sup>29</sup> Po aty, f. 88.

dy-euro. Së pari, dihet që monedha mund të shkëmbehet me gjëra/sende të tjera, për shembull, një kafe, një libër etj. Së dyti, ajo mund të krahasohet me monedha të tjera, me vlera të tjera të:

a) të njëjtit vend, i cili ka të njëjtin sistem, si për shembull, një monedhë një-euro me një monedhë pesëdhjetë-cent

b) një shteti tjetër, i cili ka një sistem tjetër monetar, për shembull, dollarin.

Një shembull tjetër që provon se kuptimi i një shenje ndryshon nga vlera e një shenje është fjala e gjuhës frënge “mouton” (dhen). Megjithëse kjo ka të njëjtin kuptim si fjala e gjuhës angleze “sheep” (dhen), ajo jo domosdoshmërisht ka të njëjtën vlerë, sepse kuptimi në gjuhën angleze “mishi i kësaj kafshe, i përgatitur dhe i shërbyer si ushqim” nuk është “sheep” (dele) por “mutton” (mish deleje).<sup>30</sup> Duke u nisur nga fakti se anglishtja përdor fjalën “mutton” për mishin e deles, ka një dallim midis “mouton” dhe “sheep”, sepse “mouton” kuptimisht përmbledh kafshën dhe mishin e saj.

#### 1.4.4. Arbitrariteti dhe marrëveshja

Megjithëse më sipër u përmend se *shenjuesi* i referohet të *shenjuarit*, por “nuk ka një lidhje të brendshme”<sup>31</sup> midis një tingulli dhe idesë që fshihet mbrapa tij; nuk ka arsye pse tingujt të tregojnë idenë e “tavolinës”(si send); nuk ka arsye pse “pema” duhet të quhet “pemë” sepse fjala vetë nuk tregon se ka diçka “pemërore” në lidhje me këtë fjalë. Dhe, mbi të gjitha, nuk ka arsye pse shkronja “t” shqiptohet [t] dhe jo [b]. Kjo është arsyeja pse Sossyr-i thekson arbitraritetin e shenjave. Arbitraritet thjesht do të thotë, që shenjat janë të pamotivueshme. Sossyr-i argumenton se “një gjuhë nuk është në asnjë mënyrë e kufizuar në zgjedhjen e mjeteve të saj. Kjo për faktin se nuk ka diçka në përgjithësi për të parandaluar shoqërimin e një ideje çfarëdo me një sekuencë tingujsh çfarëdo.”<sup>32</sup>

Koncepti se shenja gjuhësore ka karakter arbitrar nuk është original. Aristoteli është shprehur se nuk ka një lidhje natyrore midis tingujve të një gjuhe dhe asaj çfarë ajo shenjon.<sup>33</sup> Shekspir-i shkruan: “Trëndafili do të ishte po aq erëmirë edhe nëse do të kishte një emër tjetër”. Sossyr-i, gjithashtu, theksoi faktin që shenjat në formën e tyre të shkruar janë po ashtu arbitrare. Shkronja ‘s’, për shembull, nuk ka një lidhje me tingullin korrespondues që e tregon atë.<sup>34</sup> Sossyr-i pohon se gjuha nuk është tërësisht arbitrare dhe se sistemi karakterizohet nga racionaliteti (normaliteti). Ndërsa shenja nuk diktohet nga *faktorë jashtëgjuhësorë*, ajo është pronë e *përcaktimit të brendshëm gjuhësor*. Për shembull, *shenjuesit* mund të përmbajnë tinguj të përshtatshëm për strukturën ekzistuese dhe rregullat e kombinimit brenda një gjuhe të veçantë.<sup>35</sup> Për më tepër, emrat e përbërë si, për shembull, “zemërgjerë, erëmirë” nuk janë plotësisht arbitrare. Ato janë një grupim i kuptueshëm i dy shenjave ekzistuese. Sossyr-i shpjegoi konceptin e shkallëve të arbitraritetit. Gjithashtu, marrëdhëniet midis *shenjuesve* dhe të *shenjuarve* janë arbitrare, por jo në aspektin social dhe historik. Levi-Straus-i (Lèvi-Strauss) pohon se paraprakisht shenja është arbitrare, por

<sup>30</sup> Po aty, f.114.

<sup>31</sup> Po aty, f. 67.

<sup>32</sup> Po aty, f. 76.

<sup>33</sup> Richards, I. A. *The Philosophy of Rhetoric*, London, Oxford University Press, 1932, f. 49.

<sup>34</sup> Saussure, F. d. *Course in General Linguistics*, London, Duckworth. 1983, f.96.

<sup>35</sup> Chandler, D. *Semiotics for beginners*, London, Routledge, 2002, f. 49.

ajo ndaloi së qeni e tillë si rezultat i pasojave.<sup>36</sup> Çdo shenjë kërkon një histori, tone kulturore dhe nuanca të ndryshme në kohë.

Edhe Platon-i ishte i vetëdijshëm për arbitraritetin e shenjave dhe deklaroi se “çdo emër që mund t’i vini një sendi, ai është emri i duhur; dhe nëse ju hiqni dorë nga ky emërtim dhe e ndryshoni atë me një tjetër, emri i dytë nuk është me i saktë se i pari, në të njëjtën mënyrë si ne ndryshojmë emrat e shërbëtorëve tanë; sepse unë mendoj se asnjë emër nuk i përket diçkaje të caktuar për nga natyra e saj”.<sup>37</sup>

Pohimi i Platon-it nxjerr në dritë një nga problemet me arbitraritetin, të cilat ishin vënë në dukje edhe nga Sossyr-i. Përsa i takon parimit Sossyrian të arbitraritetit ai pohon se nuk mund të ketë arbitraritet të plotë, sepse kjo do të çonte në një kaos në shoqëri dhe komunikimi nuk do të ishte më i mundur. Një gjuhë “nuk është plotësisht arbitrare, sepse sistemi ka një argumentim të caktuar.”<sup>38</sup> Megjithëse duket sikur çdo shenjues është i lirë të zgjidhet nga çdo komunitet gjuhësor, kjo nuk përbën fakt. Duke u bazuar në faktin se “një gjuhë është gjithmonë trashëgimi e së kaluarës, shoqëria nuk vendos një kontratë midis koncepteve dhe formave tingullore”. Kjo i përket së kaluarës, kështu që kjo kontratë midis të dyjave vjen nga e kaluara. Megjithëse shoqëria është e vetëdijshme për parimet e arbitraritetit të një shenje gjuhësore, gjuha e çdo shoqërie është e trashëguar dhe shoqëria nuk mund të bëjë asgjë veçse “të pranojë”. Gjithashtu, është e vërtetë se nëse një shqiptar përdor fjalën “libër” dhe “pemë”, ai e bën këtë vetëm sepse babai, gjyshi i tij e me rradhë, e kanë bërë këtë para tij. Kjo na çon në përfundimin e mëposhtëm: “Shenja gjuhësore është arbitrare dhe ajo nuk njih ligje të tjera veç traditës. Ajo është krijuar mbi traditë, e cila mund të jetë arbitrare”.<sup>39</sup>

Në lidhjen *shenjues - i shenjuar* marrëveshja luan një rol të rëndësishëm sepse ajo është e bazuar në mjedisin shoqëror dhe kulturor. Rrjedhimisht, themi se “një fjalë nënkupton çfarë ajo na shkakton neve sepse ne kolektivisht biem dakord për ta lenë atë të bëjë kështu.”<sup>40</sup>

Së fundi, po sjellim një shembull, i cili del kundër natyrës arbitrare të shenjave.

*Fjalët onomatopeike* (fjalë tingullimituese ose përshkrim i dukurive a i sendeve duke shfrytëzuar imitimim e zhurmave e të zërave.) Ato nuk janë “elementë organike të një sistemi gjuhësor”<sup>41</sup>, por janë vetëm imitime të tingujve të caktuar. Këto imitime pjesërisht janë konvencionalizuar, çfarë është e dukshme kur ne mendojmë për fjalë, si: mjau, mjau (si macja); kikiriki (si gjeli); paf-puf (duhanin); bam-bum (si daullja) etj. në gjuhën shqipe; baa (si delja); buzz (si bleta); bang, bang (si daullja) etj. në gjuhën angleze.

Megjithatë, edhe këto shenja, që rëndom i perceptojmë si të motivuara, janë të ndryshme në gjuhë të ndryshme. Për shembull, gjeli bën “kikiriki” në shqip dhe “coockadoodleoo” në anglisht.

Për Sossyr-in parimi i arbitraritetit ishte më i rëndësishmi dhe më i domosdoshmi kur flitet për shenjat gjuhësore. Ai madje deklaroi se “shenjat, të cilat janë plotësisht arbitrare, sjellin më mirë se të tjerat procesin semiologjik ideal. Kjo ndodh sepse më kompleksi dhe më i përhapuri nga të gjitha sistemet e të shprehurit, i cili është ai që ne gjejmë në gjuhët njerëzore, është, gjithashtu, më karakteristik i të

<sup>36</sup> Lévi-Strauss, C., *Structural Anthropology*, Harmondsworth, Penguin, 1972, f.34.

<sup>37</sup> Harris, R. *The language machine*, Duckworth, London, 1987, f.67.

<sup>38</sup> Saussure, F. de. *Course in General Linguistics*, London, Duckworth, 1983, f. 73.

<sup>39</sup> Po aty, f. 74.

<sup>40</sup> Chandler, D. *Semiotics for beginners*, London, Routledge, 2002, f.50.

<sup>41</sup> Saussure, F. de, *Course in General Linguistics*, London, Duckworth, 1983, f. 69.

gjithëve. Në këtë kuptim, *gjuhësia shërben si një model për gjithë semiologjinë, megjithëse gjuhët paraqitin vetëm një lloj sistemi semiologjik.*<sup>42</sup>

Arbitrariteti i shenjës gjuhësore do të trajtohet më gjerësisht në një pjesë të veçantë në vazhdim.

## 1.5. Modeli i shenjës gjuhësore sipas Çarls Sandërs Pirs-it (Charles Sanders Peirce)

### 1.5.1. Modeli trianësh I: përfaqësimi, interpretimi, objekti

Ndërkohë që Sossyr-i krijoi modelin e tij dyanësh, Çarls Sandërs Pirs-i ofroi një model trianësh. Ai “lidhte proceset shenjore me proceset që bënin ndërmjetësim.”<sup>43</sup> Kjo do të thotë që duhet të jetë edhe një pjesë e tretë në modelin e tij. Sipas Pirs-it nuk ka mundësi për një shenjë të përbëhet vetëm nga dy pjesë. “*Semioza*” e tij është “një veprim ose ndikim, i cili përfshin një bashkëpunim të tri subjekteve.”<sup>44</sup> Këto tri subjekte janë *shenja*, *objekti* dhe *interpretimi*. Rrjedhimisht, është e pamundur t’i përmbledhësh ato në një paradigmë dyanëshe.

Një shembull i kësaj lidhjeje dyanëshe mund të jetë “t’i japësh dikujt një libër”. Ky proces, së pari, përfshin ndërmjetësimin dhe një kombinim të një lidhjeje dyanëshe. Ch. W. Morris e shpjegon këtë duke pohuar se “këtu nuk përfshihet ‘dhënie’ nëse objekti në dorën e shtrirë të një personi thjesht merret nga një person tjetër.”<sup>45</sup> Një arsye tjetër pse një model dyanësh nuk është i mjaftueshëm për Pirs-in, është fakti që ai gjithmonë “lidh procese të ndërmjetësimit, procese shenjore dhe procese mendore.” Edhe disa teori bihevioriste argumentojnë që Pirs-i kishte të drejtë me modelin e tij për arsye se çdo përgjigje kushtore përfshin një tjetër përgjigje. Përgjigja tjetër është një ndërmjetësim që vjen nga një faktor i tretë, i cili quhet “gjendje përforcuese”. Sipas Morris-it, përgjigja kushtore – “është trianëshe dhe gjendja përforcuese e punëve është faktor ndërmjetësimi”.

Modeli i Pirs-it duket të jetë shumë logjik. Ai nënkupton që çdo kusht është një ndërmjetësim për shkak të “gjendjes përforcuese të çështjeve” dhe kjo do të thotë që çdo kusht është një shenjë. Kjo është e vërtetë dhe sipas Morris-it tregon “syri”. “Syri”, në shikim, është një element i rëndësishëm ndërmjetësimi në lidhjen e përgjigjeve të caktuara ndaj objekteve të caktuara dhe “syri” mund të quhet shenjë në raste të tilla. Kjo është edhe arsyeja pse Pirs-i jep një përkufizim të fjalës “përfaqëson”: “të qëndrosh për diçka, domethënë të jesh në marrëdhënie me diçka tjetër që, për qëllime të caktuara, trajtohet sikur të jetë e njëjta gjë.”<sup>46</sup> Pirs-i vazhdon duke thënë: “Ndërsa përfaqësimi është karakteristikë e diçkaje, me anë të së cilës, për krijimin e një efekti të caktuar mendor, ajo mund të qëndrojë në vend të diçkaje tjetër. Ajo gjë, e cila ka këtë karakteristikë quhet *përfaqësim*, efekti mendor ose mendimi është *interpretimi* i saj dhe objekti/sendit, për të cilin ajo qëndron, përbën *objektin* e saj.”<sup>47</sup>

<sup>42</sup>Po aty, f. 68.

<sup>43</sup>Morris, Ch. W. *Writings on the general theory of signs*, The Hague, Mouton, 1971, f. 287.

<sup>44</sup>Peirce, Ch. S. *Collected Writings*, (Vëllimi V), Cambridge, MA, Harvard University Press, 1931, f. 484.

<sup>45</sup>Morris, Ch. W. *Writings on the general theory of signs*, The Hague, Mouton, 1971, f. 288.

<sup>46</sup>Peirce, Ch. S. *Collected Writings*, Cambridge, MA, Harvard University Press, (Vëllimi II), 1931, f.273.

<sup>47</sup>Po aty, f. 273.

Pra, me fjalë të tjera, modeli Pirsian për shenjën është trianësh. Ky model përbëhet nga *përfaqësimi*, *interpretimi* dhe *objekti*.

Ndryshe, modeli Pirsian njihet si “trekëndëshi semiotik”. Ai paraqitet në figurën e mëposhtme:




Fig. 1.3. Trekëndëshi semiotik i Pirs-it<sup>48</sup>

*Përfaqësimi* është forma që shenja merr, e cila nuk është domosdoshmërisht fizike. *Interpretimi* është kuptimi i shenjës dhe *objekti* është ai, të cilit shenja i referohet.<sup>49</sup> Pirs-i e përkufizon marrëdhënien midis të trijave si *semiozë*. Për shembull, shenja e dritave të trafikut për “kalo” do të ishte një dritë jeshile në kryqëzim. Kjo përbën *përfaqësimin*, automjetet që lëvizin përbëjnë *objektin*, ndërsa koncepti që drita jeshile nënkupton, domethënë që automjetet lejohen të kalojnë, përbën *interpretimin*. *Përfaqësimi* i Pirs-it është analog me *shenjuesin* e Sossyr-it, ndërsa *interpretimi* është paralel me kuptimin e *të shenjuarit*.<sup>50</sup> Megjithatë, *i shenjuari* i Sossyr-it nuk është një referent i jashtëm, por një prezantim abstrakt mendor dhe *objekti* i Pirs-it nuk është i lidhur me objekte të sendëzuara dhe mund të përmbajë koncepte abstrakte ose subjekte të trilluara. Modeli i Pirs-it lë gjerësisht vend për materializëm, çka nuk karakterizon modelin Sossyrian. Sipas modelit Pirsian, kuptimi përfshin, së bashku, referencën dhe kuptimin ose, në një kuptim më të gjerë *përfaqësimin* dhe *interpretimin*. Baza trianëshe e modelit e lehtëson atë për të funksionuar si një model më i përgjithshëm i shenjës në krahasim me ç’mund të bëjë një model dyanësh (si ai i Sossyr-it).<sup>51</sup> Megjithatë, vetë *interpretimi* është një shenjë në mendjen e *interpretuesit*, aspak si *i shenjuari* i Sossyr-it. Kush përdor një fjalor dhe shkon përtej përkufizimit të fjalës, njihet me nocionin e *të shenjuarit*, i cili, gjithashtu, funksionon si *shenjues*. Modeli Pirsian paraqet konceptin e mendimit dialogues, i cili mungon në modelin Sossyrian. Ai buron pjesërisht nga theksi që Pirs-i vë mbi *semiozën* si një proces, i cili vë përballë theksimin sinkronik të Sossyr-it mbi strukturën.<sup>52</sup> Pirs-i duke qenë një taksonomist i bindur, ofroi tipologji logjike të shumta, ndryshe nga Sossyr-i.<sup>53</sup>

<sup>48</sup> <http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

<sup>49</sup> [Peirce, Ch. S. *Collected Writings*, (Vëllimi II), Cambridge, MA, Harvard University Press, 1931, f. 58.] shih te <http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

<sup>50</sup> [Silverman, K. *The Subject of Semiotics*, New York, Oxford University Press, 1983, f. 34.] shih te <http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

<sup>51</sup> [Chandler, D. *Semiotics for beginners*, London, Routledge, 2002, f. 52.] shih te <http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

<sup>52</sup> [Peirce, Ch. S. *Collected Writings* (Vëllimi II), Cambridge, MA, Harvard University Press, 1931, f. 58.] shih te <http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

<sup>53</sup> <http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

### 1.5.2. Modeli trianësh II: mjeti shenjor, kuptimi, referenti

Modeli trekëndor Pirsian siguroi bazën për teoricienë të tjerë të zhvillonin variante ose sisteme më të thjeshta semiotike të bazuar në elementë me tri pjesë. Modeli i mëposhtëm është një prej varianteve të modelit trianësh të Pirs-it dhe ndeshet shpesh në literaturën semiotike. Autori i tij nuk bën gjë tjetër, vetëm se ndryshon termat Pirsianë.

*mjeti shenjor* / shenjuesi / përfaqësimi

*kuptimi* / i shenjuari / interpretimi

*referenti* / objekti, ndonjëherë i lidhur me shenjuesin.

Ky model paraqitet në figurën e mëposhtme, i cili quhet, gjithashtu, “trekëndësh semiotik”.




Fig.1.4. Trekëndësh semiotik<sup>54</sup>

Ai tregon qartë tri marrëdhëniet e një shenje sipas renditjes: 1. mjeti shenjor 2. kuptimi 3. referenti. Vija që lidh *mjetin shenjor* me *referentin* është e ndërprerë, sepse tregon natyrën indirekte të marrëdhënies midis këtyre dy elementeve dhe rrugën e ndërmjetësimit nga (1) në (3). Megjithatë, renditja e relatave në procesin trianësh të ndërmjetësimit është interpretuar në mënyra të ndryshme. Edhe përkufizimi i Aristotelit mbi fjalët si shenja jepet me të njëjtën mënyrë dhe renditje elementësh përbërës të shenjës.

Natyra e çdo përbërësi në modelin trianësh shpesh ka qenë e debatueshme.

### 1.5.3. Ikona, simboli, treguesi (indeksi)

Ndërsa Sossyr-i nuk ofroi një tipologji shenjash, Pirs-i dha disa të tilla.<sup>55</sup> Çfarë ai vëzhgoi si ndarjen më thelbësore të shenjave është cituar gjerësisht në studime të ndryshme për semiotikën. Megjithëse ky është parë si klasifikim i llojeve të dallueshme të shenjave, më tepër është interpretuar si mënyra të ndryshme marrëdhëniesh midis mjeteve shenjore dhe çfarë është shenjuar.<sup>56</sup> Në terminologjinë Pirsiane ato përbëjnë marrëdhëniet midis *përfaqësimit* dhe *objektit* të tij ose

<sup>54</sup>[Nöth, W. *Handbook of Semiotics*, Indiana University Press, 1990, f. 89] shih te [http://www.semioticsigns.com/articlesofinterest/2007\\_09\\_20/handbook.pdf](http://www.semioticsigns.com/articlesofinterest/2007_09_20/handbook.pdf)

<sup>55</sup>[Peirce, Ch. S. *Collected Writings*, Cambridge, MA, Harvard University Press, 1931, Vëllimi I, f. 281., Vëllimi II, 243.] shih te <http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

<sup>56</sup>[Hawkes, T. *Structuralism and Semiotics*, University of California Press, 1977, f. 129.] shih te [http://www.indiana.edu/~slavicgf/e103/assignments/Chandler\\_ch1\\_pt2.pdf](http://www.indiana.edu/~slavicgf/e103/assignments/Chandler_ch1_pt2.pdf)

*interpretimit* të tij. Siç vihet re, shpesh, përdoren edhe terma të Sossyr-it: *shenjues* dhe *i shenjuar*.<sup>57</sup> Po shtjellojmë këto tri mjete:

**Simboli**, një mjet në të cilin shenjuesi nuk i përngjan të shenjuarit, por është shumë arbitrar dhe konvencional. Për shembull, gjuha në përgjithësi (plus gjuhë të veçanta, shkronjat alfabetike, shenjat e pikësimit, fjalët, shprehjet dhe fjalitë, numrat, kodi Mors, dritat e trafikut, flamujt kombëtarë etj.) Pra, një shenjë është një simbol kur ajo i referohet objektit të saj në bazë të një ligji ose rregulle.

**Ikona**, një mjet në të cilën shenjuesi është pranuar si i ngjashëm ose imitues i të shenjuarit (në mënyrë të arsyeshme, të dukshme, tingëlluese, të shijueshme ose të nuhatshme si ai) – duke qenë i ngjashëm në zotërimin e disa prej cilësive të tij. Për shembull, një portret, një fotografi, një vizatim, onomatopetë, metaforat, efektet tingullore në drama radiofonike, veprime imituese, një film i dubluar etj.) Pra, një ikonë paraqet fizikisht atë që ajo tregon.

**Treguesi (indeksi)**, një mjet në të cilin shenjuesi nuk është arbitrar, por është drejtpërdrejt i lidhur në një farë mënyre (fizikisht ose rastësisht) me të shenjuarin (pavarësisht qëllimit) – kjo lidhje mund të shihet ose të dëshmohet. Për shembull, shenjat natyrale (tymi, vetëtima, shenjat e gishtave, jehonat, aromat natyrale), simptomat mjekësore (dhembje, skuqje, ritmi i pulsit), instrumentat matës (termometri, ora), sinjalet (një e trokitur në derë, një zile telefoni), treguesit (gishti tregues, një shenje që tregon drejtim), regjistrimet (një fotografi, një film, një zë i regjistruar), shenja personale (shkrimi, thënie të famshme), fjalë të tilla treguese (si *ky*, *kjo*, *atje*, *këtu*) etj. Pra, një tregues është një shenjë që ka një lidhje direkte midis shenjës dhe sendit.<sup>58</sup>

Megjithatë, këto kategori nuk janë përjashtuese. Një shenjë mund të jetë një *ikonë*, një *simbol*, një *tregues* ose çdo kombinim i të trijave. Modeli Pirsian shoqëroi edhe shenjat jogjuhësore, çka nuk e bëri Sossyr-i me modelin e tij. Por ashtu si Sossyr-i, Pirs-i u dha mjaft rëndësi shenjave simbolike.<sup>59</sup>

## 1.6. Roman Jakobson-i për modelin shenjor Sossyrian dhe Pirsian

Strukturalizmi i Roman Jakobson-it ndikoi gjerësisht në zhvillimin e semiotikës evropiane. Jakobson-i adoptoi shenjë e Sossyr-it dhe ishte interpretues i strukturave binare në gjuhë, pavarësisht kritikës së tij ndaj punës së Sossyr-it. Sipas Jakobson-it “çdo njësi gjuhësore është dypalëshe”.<sup>60</sup> Ai përdori termat “*signans*”, e cila i referohet *shenjuesit* dhe “*signatum*”, e cila i referohet *të shenjuarit*. Në fillim të viteve 1950, kur Jakobson-i u njoh me punën e Pirs-it, ai u bë përkrahës i koncepteve të tij. Megjithatë, *i shenjuari* i Jakobson-it duket shumë i ngjashëm me atë të Sossyr-it. Në punimet e tij të mëvonshme, Jakobson-i pranon që termi *referent* është i përzier.<sup>61</sup> Më vonë ai e gjeti *referentin* më tepër brenda gjuhësisë në formën e

<sup>57</sup>[Jakobson, R. *Selected Writings of Roman Jakobson*, The Hague, Mouton, 1966] Po aty.

<sup>58</sup>Po aty.

<sup>59</sup>Po aty.

<sup>60</sup>[Jakobson, R. 1949, *The phonetic and grammatical aspects of language and their interrelation*, *Proceedings of the Fifth International Congress of Linguistics*, Paris, Klincksieck, 1949.] Po aty.

<sup>61</sup>[Jakobson, R. *Linguistics and Poetics: Closing Statement to Style in Language*, Cambridge MITI Press, 1960, f. 350-377.] Po aty.

kuptimit situacional dhe kontekstual. Megjithatë, modeli i tij mbi shenjën formalisht mbetet dyanësh. Ai vendoste paralelisht të shenjuarin me interpretimin e Pirs-it. Jakobson-i vazhdoi të integronte tipare të interpretimit të Pirs-it, që i referoheshin të shenjuarit si pjesa e interpretueshme e shenjës brenda një sistemi dyanësh. “Në nivelin bazë, semiotika e Jakobson-it është më tepër Sossyriane se Pirsiane, e përkushtuar ndaj natyrës shenjore të çdo aspekti dhe çdo shembulli të shenjës”.<sup>62</sup> Jakobson-i ishte një nga përkrahësit e koncepteve të Pirs-it në traditën semiologjike evropiane. Strukturalizmi i tij dallonte dukshëm nga ai i Sossyr-it. Qëndrimi i tij ndaj modelit të shenjës ndikoi gjerësisht semiologjinë evropiane duke ekspozuar ndikimin Pirsian mbi modelin dyanësh, pa e ndryshuar atë në thelb.

Si përfundim, modeli i shenjës gjuhësore sipas Sossyr-it rezulton shumë i ndryshëm nga ai i paraqitur prej Pirs-it. Modeli Pirsian i shenjës duket më elastik dhe funksionon edhe për shenjat jogjuhësore. Jakobson-i, i cili u ndikua shumë nga puna e Pirs-it u përpoq të ndërthurte modelin trianësh në një model dyanësh dhe kjo pati ndikimin e saj në semiologjinë evropiane. Sossyr-i beson se shenjat gjuhësore lidhen me objektet (sendet) në botë në një nivel shumë arbitrar dhe se shenjuesi dhe i shenjuari nuk kanë sendësi fizike, por janë plotësisht psikologjike. Nga ana tjetër, modeli Pirsian lë vend për një marrëdhënie më fizike dhe të prekshme midis shenjave dhe sendeve në botë.

### 1.7. Modeli i shenjës gjuhësore sipas Karl Buhler-it (Karl Bühler)

Ideja bazë e modelit Organon është marrë nga dialogu i Platon-it “*Cratylus*”<sup>63</sup>.

Modeli Organon i gjuhës (sipas greqishtes *organon* “vegël”) i formuluar nga psikologu gjerman Karl Buhler-i përkufizon funksionet komunikuese sipas të cilave mund të përshkruhet komunikimi gjuhësor. Gjuha është marrë si një vegël/instrument (Organon) me anë të së cilës folësi/dërguesi përcjell mendimet e tij te dëgjuesi / marrësi i mesazhit. Pra, një shenjë gjuhësore shërben si një vegël me anën e së cilës një person komunikon me një tjetër rreth botës. Në këtë mënyrë, Buhler-i dallon tri funksione të shenjës gjuhësore: ajo është një *simptomë* që e lejon personin që e dërgon të shprehë mendimet dhe ndjenjat e tij (funksion ekspresiv); ajo është një *sinjal* që apelon te personi që e merr mesazhin (funksion apelues); ajo është një *simbol*, që i referohet objekteve dhe gjendjeve të çështjeve në botën reale (funksion i përfaqësimit).<sup>64</sup>

Pra, tri funksionet bazë të komunikimit janë:

*Shprehja*: Gjuha përdoret për të shprehur gjendje mendore të dërguesit ose folësit.

*Përfaqësimi*: Ky funksion gjuhësor përdoret për të nënkuptuar objektet dhe gjendjet e çështjeve, të cilave iu referohet komunikimi gjuhësor.

<sup>62</sup>[Chandler, D. 2002, *Semiotics for beginners*, London, Routledge, 2002.] shih te <http://www.ello.uos.de/field.php/Semantics/TheLinguisticsign>

<sup>63</sup>*Cratylus* ([krəˈtailəs] greq. vjet. Kratylos) është emri i një dialogu nga Platoni. Në dialog Sokrati pyetet nga dy burra, Kratylos dhe Hermogeni, për t’u treguar atyre nëse emrat janë “konvencionalë” apo “natyralë”, dmt. nëse gjuha është një sistem shenjash arbitrare apo nëse fjalët kanë një lidhje të brendshme me sendet/objektet që ato nënkuptojnë..

<sup>64</sup><http://www.ello.uos.de/field.php/Semantics/TheLinguisticsign>



*Apelimi*: Gjuha përdoret për t'iu drejtuar marrësit ose dëgjuesit. Pra, në këtë rast, fokusi bie mbi *marrësin*. *Dërguesi* përdor një shenjë për të komunikuar. Kjo mund të jetë një lutje ose një kërkesë. Nëpërmjet kësaj lutjeje ose kërkesë ai dëshiron të marrë një reagim të caktuar nga dëgjuesi i tij. *Apelimi* është rreth marrëdhënies midis shenjës dhe marrësit të saj, si edhe ndikimi që ajo ka mbi të. Për shembull: “Jepi makinës”.<sup>65</sup>

Modeli i shenjës gjuhësore sipas Bühler-it paraqitet në figurën e mëposhtme:




Fig. 1.5. Modeli i shenjës gjuhësore sipas Bühler-it<sup>66</sup>

Në figurë, përveç tri funksioneve të gjuhës nga të cilat një shenjë përbëhet gjithmonë (*shprehja*, *përfaqësimi*, *apelimi*), përfshihen edhe termat: një *dërgues* ose *folës*, një *marrës* ose *dëgjues* si edhe *objektet dhe gjendjet e çështjeve*, të cilave iu referohet mesazhi. Sipas Bühler-it tri elementet ose funksionet e gjuhës janë të lidhura pandashmërisht nga njëri-tjetri.

Karl Bühler-i shkruan: “Nuk është e vërtetë që grupi i fjalëve “*objektet dhe gjendjet e çështjeve*” mbulon çdo gjë për të cilën tingulli është një fenomen ndërmjetësues midis dërguesit/folësit dhe marrësit/dëgjuesit. Në fakt, secili prej dy pjesëmarrësve ka pozicionin e tij në krijimin e situatës, përkatësisht dërguesi si subjekt i ligjerimit, nga njëra anë, dhe marrësi si personi, të cilit ai i drejtohet, i adresuari i aktit të ligjerimit, nga ana tjetër. Ata nuk janë thjesht një pjesë e asaj rreth së cilës vërtitet mesazhi, por partnerë në një shkëmbim dhe kjo është edhe arsyeja pse është e mundur që tingulli, si një produkt ndërmjetësues, ka një marrëdhënie specifike kuptimplotë me secilin.”<sup>67</sup>

<sup>65</sup> <http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

<sup>66</sup> <http://sharedsymbolicstorage.blogspot.com/2008/06/karl-bhlerbuhlerbuehler-on-evolution-of.html>

<sup>67</sup> [Bühler, K. *Theory of Language*, John Benjamin's Publishing Company, 1990, f.37.] shih te [http://www.atilf.fr/IMG/pdf/verbum/Verbum\\_XXXI\\_1-2\\_1\\_4\\_Halawa.pdf](http://www.atilf.fr/IMG/pdf/verbum/Verbum_XXXI_1-2_1_4_Halawa.pdf)

Shenja paraqitet strukturalisht nga një *rreth* dhe një *trekëndësh*. Rrethi qëndron për fenomenin e tingullit, e cila është fjala aktuale e folur dhe trekëndëshi – siç u pohua më parë – përfaqëson shenjen gjuhësore dhe ndan të njëjtën hapësirë me rrethin në disa zona. Në zona të tjera ka mbivendosje. Nëse rrethi mbivendoset mbi trekëndëshin, marrësi i shenjës merr informacion më tepër sesa atij aktualisht i nevojitet të kuptojë (në lidhje me çfarë dërguesi dëshiron t’i dërgojë atij). Pra, ka më tepër informacion akustik. Megjithatë, marrësi është në gjendje të ndajë informacionin e rëndësishëm nga ai i parëndësishëm, siç mund të jetë, për shembull, pasthirrma “ahh”. Në qoftë se trekëndëshi mbivendoset në rreth, informacioni që nevojitet për të kuptuar funksionin e shenjës nuk është i mjaftueshëm. Një nga arsyet e kësaj mund të jetë se dërguesi bën gabime në të folur, humbet informacionin, i keqgërmëzon fjalët, harron informacion të rëndësishëm ose është shumë i zhurmshëm. Marrësit i duhet të mbushë hapësirat bosh për të patur një mesazh të kuptimshëm.<sup>68</sup>

Nëse të gjitha këto realizohen në mënyrën e duhur midis dërguesit dhe marrësit, komunikimi është i suksesshëm.

Modeli Oragon i shenjës gjuhësore nga Karl Buhler-i ndikoi te Roman Jakobson-i në punën e tij mbi funksionet gjuhësore dhe modelin e komunikimit. Ai u shtoi tri funksioneve që përcaktoi Buhler-i edhe atë poetik, fatik dhe metagjuhësor.

## 1.8. Një vështrim kritik mbi modelet e shenjës gjuhësore

Siç vihet re nga ato që u parashtruan më lart, është e vështirë të përcaktohet se cila nga teoritë është më e sakta. Ndodh që një teori të duket mjaft logjike për dikë, ndërsa për dikë tjetër ajo është jo shumë e qartë në disa pika.

Në lidhje me modelin Sossyrian, vlen të përmendet edhe një herë *parimi i arbitraritetit*. Për sa i përket lidhjes arbitrare midis *shenjuesit* dhe *të shenjuarit* mund të debatohet më tej. A është bindëse që *i shenjuari* mund të përcaktohet nga *shenjuesi* në vend që të ndodhë ndryshe? Kjo, sigurisht, do të çonte në një model në të cilin pozicioni i të dy elementeve ndryshon. Zhak Lakan-i (Jacques Lacan) ishte i të njëjtit mendim. Kjo është edhe arsyeja pse ai e rishikoi teorinë Sossyriane. Në këtë model *shenjuesi* paraqitet me shkronjën e madhe “S”, ndërsa *i shenjuari* jepet me “s” të vogël. Pozicionet e tyre në model ndryshojnë: *shenjuesi* qëndron sipër *të shenjuarit*. Një vijë horizontale i ndan të dy elementet.



Fig. 1.6.<sup>69</sup>

Ka edhe një aspekt tjetër që mund të përmendet ndërsa flasim për arbitraritetin e një shenje: nuk ka gjithmonë një lidhje të qartë midis *shenjuesit* dhe *të shenjuarit*, sepse shenjat gjuhësore ndonjëherë kanë më shumë se një kuptim. Kjo do të thotë se një *shenjues* është i aftë t’u referohet shumë *të shenjuarve* në një gjuhë. Në këtë rast ne flasim për homonimi. Gjithashtu, është e mundur që një *i shenjuar* t’u referohet shumë *shenjuesve*. Këtu ne flasim për sinonimi, si, për shembull, foljet në gjuhën

<sup>68</sup><http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

<sup>69</sup>Po aty.

angleze dhe përkatësisht, në shqipe, *go* “shkoj” dhe *walk* “ec”, të cilat, së bashku, i referohen veprimit të lëvizjes.

Një tjetër pikë e diskutuar është nëse përdorimi i fjalës “arbitrar” është i saktë. Megjithëse Sossyr-i deklaroi se marrëdhënia midis dy elementëve të tij është arbitrare, dikush mund të pyesë nëse është e vërtetë kjo apo jo. Mënyra si ne flasim nuk është arbitrare në përgjithësi, ndërsa gjuha që ne mësuam në fëmijëri ishte e trashëguar nga brezat e mëparshëm. Gjuha na u “dha” dhe ne nuk ishim në gjendje të ndryshonim kuptimet e fjalëve, pavarësisht dëshirës sonë. Kjo do të thotë se gjuha që ne flasim nuk është arbitrare dhe kjo është edhe arsyeja pse ne nuk mund të flasim qartë për një parim arbitrariteti kur i referohemi marrëdhënies midis *shenjuesit* dhe *të shenjuarit*. Teorikisht kjo është arbitrare – nuk ka një arsye të dukshme për një tavolinë të emërtohet me fjalën “tavolinë”, sigurisht – por kjo më shumë ose më pak ka të bëjë me marrëdhënien midis dy elementëve, pikërisht në fillimet dhe krijimin e gjuhës. Dhe ndërsa kjo ka ndodhur kohë më parë se periudha Sossyriane, është e vështirë të mos jesh kritik me teorinë e tij.

Ndërsa Pirs-i përfshinte një *referent* në modelet e tij dhe është e dyshimtë nëse modeli i tij është me të vërtetë më i mirë se ai i Sossyr-it. Kjo për arsye se ka një efekt çorientues në lidhje me elementët – *mjet shenjor*, *kuptim* dhe *referent* – që përdor Pirs-i. Xhon Lajëns-i, për shembull, bëri shumë pyetje në lidhje me përdorimin e këtyre elementëve. Ai pyeste nëse *mjeti shenjor* duhet të përkufizohet si “një entitet fizik apo mendor”<sup>70</sup>, nëse *kuptimi* ka status psikologjik apo ontologjik dhe, gjithashtu, ai dëshironte të dinte nëse *referenti* është diçka “që i referohemi në një rast të veçantë”. Ai, po ashtu, pyeste nëse “mund të jetë kompleksiteti i gjërave ai që duhet t’i referohemi kur artikulojmë shenjën”.

Një tjetër pikë që vihet re është se ka një paqartësi në terma të Sossyr-it dhe Pirs-it në lidhje me vetë *shenjën* dhe *mjetin shenjor*. Ndërsa vetë shenja është më shumë se kaq dhe nuk është gjithmonë e qartë, atëherë cilit i referohen Pirs-i dhe Sossyr-i kur flasin për shenjë. Ka raste kur Sossyr-i e përdor fjalën *shenjë* për t’iu referuar *shenjuesit*, ndërsa Pirs-i e përdor fjalën *shenjë* edhe kur i drejtohet *përfaqësimit*. Pavarësisht këtyre, duhet të jetë e qartë se kur Pirs-i dhe Sossyr-i përdorin fjalët *përfaqësim* dhe *shenjues*, ata duan t’i referohen *formës* që shenja merr dhe jo vetë shenjës.

Tri llojet e një shenje të Pirs-it: *indeksi (tregues)*, *ikona* dhe *simboli*, gjithashtu, krijojnë probleme. Së pari, nuk ka shenja që të jenë 100% ikonike, sepse të gjitha ato kanë një lloj kuptimi konvencional dhe kulturor në vetvete. Pirs-i pohon se edhe “një imazh material”, që e bën të qartë mënyrën si ai paraqet diçka, është “shumë konvencional në mënyrën e tij të paraqitjes”<sup>71</sup>. Ai sjell shembullin e portretit të një personi dhe argumenton: “Ne themi se portreti i një personi që nuk e kemi parë është bindës. Thjesht nga çfarë ne shohim në të na bind të formojmë një ide mbi personin që ajo përfaqëson. Kjo është një *ikonë*. Por në fakt kjo nuk është një ikonë e pastër, sepse dihet që portretet përmbajnë ngjashmërinë më të vogël me origjinalin, përveçse në raste të caktuar dhe pas një shkalle konvencionale vlerash.”

Në lidhje me këto tri lloje shenjash, ka mundësi të çorientohemi nëse një shenjë mund të jetë një *indeks (tregues)*, një *ikonë* apo një *simbol*. Një hartë, për shembull, do të ishte një *indeks* sepse ajo tregon vendndodhjen e qyteteve, maleve etj. Ajo, gjithashtu, është një *ikonë* për shkak të distancave që ajo tregon. Dhe së fundi,

<sup>70</sup>Lyons, J. *Semantics 2*, Cambridge University Press, 1977, f.99.

<sup>71</sup>Peirce, Ch. S. *Collected Writings*, (Vëllimi II), Cambridge, MA, Harvard University Press, 1931, f.276.

ajo është një *simbol* për shkak të përdorimit të saj të simboleve, si për shembull, simboli i pikës së karburanteve përgjatë autostradës. Kuptimi i simboleve të përdorura thjesht duhet të mësohet.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është se shenjat mund të ndryshojnë karakterin e tyre në kohë. Kjo do të thotë që një shenjë dikur ka qenë një *ikonë*, ndërsa sot është një *simbol*. Kjo vihet re në hieroglifet egjiptiane.

Buhler-i e zhvilloi në mënyrë konstante krijimin e modelit të shenjave gjuhësore. Kjo solli një lloj përmirësimi. Modeli i tij i ligjërimit, i quajtur Organon, ende nuk mbulon çdo mundësi të ligjërimit dhe ka mangësi në plotësimin e tij, ashtu si modelet e Sossyr-it dhe Pirs-it.

Së pari, mund të debatohet mbi faktin nëse modeli i Buhler-it me të vërtetë mbulon aspekte të një “teorie të shenjës gjuhësore”. Disa studiues janë të mendimit se modeli nuk është në të vërtetë rreth vetë shenjave gjuhësore dhe funksionit të tyre, por vetëm rreth përdorimit të shenjave gjuhësore dhe funksionit të ligjërimit. Për më tepër, këto dy aspekte të përmendura më parë nuk arrijnë të mbulojnë të tri elementet e modelit të tij. Përdorimi dhe funksioni mund të jenë të mundshëm me elementët *apelim* dhe *shprehje*, por, sigurisht, jo për elementin e fundit *përfaqësim*.

Dy elementet e parë mund të krahasohen me *simptomën* dhe *sinjalin*, siç u pohua më lart. *Simptoma* dhe *sinjali* shkojnë së bashku me ligjërimin, çka do të thotë që ato funksionojnë vetëm kur akti i ligjërimit është në proces. Ky nuk është rasti që ka lidhje me *përfaqësimin*. Ky element mund të krahasohet me *simbolin*. Ai nuk krijohet në momentin e ligjërimit, por para tij. Ai duhet të ndodhet atje, kështu që akti i ligjërimit është në gjendje të krijohet.

Modeli i Buhler-it shihet si shumë statik. Po të marrim parasysh çfarë u tha për *përfaqësimin* më lart, del se edhe një mendim është një *përfaqësim*. Kjo nuk tingëllon logjike ndërsa nuk është e sigurt nëse mendimi është pjesë e ligjërimit.

Shumë gjuhëtarë e zgjeruan më tej modelin e Buhler-it duke i dhënë më shumë funksione në mënyrë që të mbulonin të gjitha mundësitë e ligjërimit.

Po rimarrim edhe një herë konceptin “*lidhje/relatë*”. Ky element jep informacion për lidhjen midis *dërguesit* të mesazhit dhe *marrësit*, ndërsa ligjërimi shpesh varet nga kjo. Në rastin kur burri flet me gruan e tij përballë dritave të trafikut, fjalia e mëposhtme mund të jetë një shembull i mirë për të konkretizuar “*lidhjen/relatën*”: - “Ti po reagon më ngadalë se unë”.

Informacioni i mësipërm për teorinë e shenjave gjuhësore e bëri të qartë se edhe nëse të gjitha modelet duken logjike dhe të plota, ato nuk mbulojnë të gjitha aspektet e shenjave gjuhësore. Megjithëse mungesa e këtyre aspekteve nuk është e qartë që nga fillimi, gjithsecili i kupton ato kur diskuton ose mendon rreth çdo modeli në një vëzhgim më të thellë. Thuhet që nuk ka një model të përsosur, kështu që është shumë e vështirë për të vendosur se cili prej tyre është më i miri. Rekomandohet që për çdo shenjë gjuhësore, funksionin e saj dhe madje dhe “aktin e të folurit”, fillimisht duhet menduar rreth çdo modeli në vetevete dhe pastaj të përpiqemi të gjejmë modelin që i përshtatet më mirë situatës së dhënë. Po të veprohej ndryshe, kjo do të çonte në një situatë kaotike, sepse çdo model ofron një shumëllojshmëri teorish dhe mundësish.

## 1.9. Arbitrariteti i shenjës gjuhësore

Çdo shenjë gjuhësore, nga natyra e saj, ka karakter spontan. Spontaniteti shpreh rastësi, arbitraritet dhe mungesë natyrshmërie/rregullsie në formim. Gjuha dhe shenjat janë formuar pikërisht në këtë mënyrë. Askush nuk i ka shpikur shenjat gjuhësore dhe askush nuk ka rënë dakord mbi kuptimin e fjalëve të formuara.

Kjo ide reflekton plotësisht mendimet e mëposhtme për sa i përket karakterit të një shenje gjuhësore. Aristoteli ka vënë në dukje se “nuk ka një lidhje natyrore midis tingujve të çdo gjuhe dhe çfarë ato nënkuptojnë.”<sup>72</sup>

Siç u përmend edhe më parë, e njëjta pikë interpretohet nga Platon-i në dialogun e tij “*Cratylus*” ku ai e nxiti Sokrat-in të pranonte që “çfarëdo emërtimi që i bëjmë diçkaje, ky është emërtimi i duhur, dhe nëse e heqim këtë emër dhe përdorim një tjetër, emri i dytë nuk do të jetë më i saktë se i pari; ashtu siç mund të ndryshojmë emrat e shërbëtorëve tanë; sepse unë mendoj që asnjë emër nuk i përket diçkaje të veçantë për nga natyra.”

Kjo çështje, e cila ka krijuar dilema në semantikë dhe në filozofinë e gjuhës, lidhet me marrëdhënien midis *shenjuesit* dhe *të shenjuarit*. A është e kushtëzuar kjo lidhje? Ferdinand de Sossyr-i ka pohuar “Ajo çfarë lidh shenja gjuhësore nuk është sendi dhe emri i tij, por imazhi i konceptit me imazhin tingullor.” Sossyr-i, gjithashtu, shton idenë e arbitraritetit të një shenje, e cila i përngjan nocionit të Losev-it mbi karakterin spontan të saj. Ka qasje të ndryshme ndaj nocionit Sossyrian të shenjës, “Arbitrariteti i shenjës është një koncept radikal, sepse ai propozon autonominë e gjuhës në lidhje me realitetin”. Modeli Sossyrian, duke theksuar strukturat e brendshme të sistemit të një gjuhe, mund të interpretohet si mbështetje e nocionit që gjuha nuk “reflekton” realitetin, por e ndërton atë. Ne mund ta përdorim gjuhën “për të thënë se çfarë ka në botë, po ashtu si çfarë nuk ka aty.” Dhe atëherë kur ne arrijmë të njohim botën me anë të gjuhës, ne kemi lindur në mes të saj dhe është me vend të thuhet se gjuha jonë përcakton realitetin, më shumë sesa realiteti përcakton gjuhën.”<sup>73</sup>

Duke shqyrtuar këto ide mbi shenjat (fjalët) dhe referentin (sendet), Aristoteli komentoj se “Nuk ka një lidhje të natyrshme midis anës tingullore të çdo gjuhe dhe asaj çfarë është shenjuar.” Për ta bërë më të qartë: “fjalët nuk janë sende/objekte; sendet/objektet janë përtej gjuhësore dhe karakterizohen nga një ballafaqim me gjuhën”.<sup>74</sup> Ideja është shumë e thjeshtë dhe e thellë. Ky nocion u shqyrtua nga Agustin-i (Augustine) në punimin e tij “*De Doctrina Christiana*”. Modeli Sossyrian i një shenje na lejon të kuptojmë lehtësisht lidhjen *shenjues/i shenjuar*:

Nëse i referohemi nocionit Agustinian të një shenje, “Sendet/objektet janë ato, të cilat nuk përmenden për të shenjuar diçka, ndërsa shenjat janë ato sende/objekte që përdoren për të shenjuar diçka tjetër. Kështu që çdo shenjë është, gjithashtu, një send/objekt, sepse, në qoftë se ajo nuk përbën një send/objekt, atëherë ajo është asgjë”.<sup>75</sup> Ky arsyetim çon drejt pyetjes se cili nga komponentët e kësaj lidhjeje është parësor, sendi/objekti apo shenja?

<sup>72</sup>[Chandler, D. *Semiotics for Beginners*, 25 Shtator 2011.] shih te <http://www.aber.ac.uk/media/Documents/S4B/sem02.html>

<sup>73</sup><file:///C:/Users/user/Downloads/301-1027-1-PB.pdf>

<sup>74</sup>[Smith, James K. A. *Between Predication and Silence, Augustine on How (Not) to Speak of God*, 2000.] shih te [http://www.calvin.edu/academic/philosophy/virtuallibrary/articles/smith\\_james/Betw072701.pdf](http://www.calvin.edu/academic/philosophy/virtuallibrary/articles/smith_james/Betw072701.pdf)

<sup>75</sup>[St. Augustine, *De Doctrina Christiana*, 1.2.2.] shih te <file:///C:/Users/user/Downloads/301-1027-1-PB.pdf>

<sup>75</sup><http://studopedia.org/6-11674.html>

Duke iu kthyer reflektimeve të Aleksei Losev-it (Alexei Losev) për shenjat gjuhësore, ai dallon tri lloj ekzistencash të shenjës gjuhësore. Së pari, sipas tij, ekziston një realitet objektiv në vetvete, i cili është i natyrës “korporale” (sendore) dhe që krijon çdo gjë brenda vetvetes. Kjo përmban në vetvete sende/objekte, të cilat ekzistojnë jashtë vetëdijes dhe në mënyrë të pavarur nga ajo, megjithëse ato mund të jenë shenjuar-caktuar nga ne brenda kornizës të perceptimit tonë. Së dyti, është e njëjta lloj ekzistence, por e reflektuar dhe e përfaqësuar në ndërgjegjen tonë. Ky është i njëjti realitet, dmth, të njëjtat sende/objekte dhe fenomene jo të ndërmarra në vetevete, por të marra në formën dhe idetë e tyre. Së treti, ka një lloj tjetër ekzistence, e cila gjendet midis realitetit objektiv dhe ekzistencës të ndërgjegjshme-semantike. Kjo lloj ekzistence ka karakter gjuhësor, e cila ndryshon nga lloji i ekzistencës së ndërgjegjshme-semantike për shkak të tiparit të mëposhtëm. Kjo nuk është një riprodhim, por është një lloj i veçantë transformimi i realitetit në mënyrë që ai të kuptohet dhe nuk është një riprodhim mekanik-direkt i këtij realiteti, por një mënyrë origjinale e perceptimit të tij. Kjo është një ekzistencë semantike<sup>76</sup>. Në konceptin e tij për shenjën gjuhësore, Losev-i supozon se lloji i tretë i ekzistencës (gjuhësori) krijon rregullat e saj, të cilat jo gjithmonë korrespondojnë me logjikën.<sup>77</sup>

Një tjetër koncept i rëndësishëm që lidhet me shenjën gjuhësore është ai i pohimit. Sipas nocionit të pohimit, çdo shenjë gjuhësore është një pohim i një lloji të caktuar, i një objektiviteti të përcaktuar. Ne gjithmonë pohojmë diçka me anë të një shenje gjuhësore dhe ky lloj pohimi realizohet për sende dhe fenomene konkrete. Pohimi është një nga kategoritë më të rëndësishme të të menduarit në përgjithësi. A. Losev-i thekson se procesi i pohimit realizohet me anën e vetëdijes dhe, gjithashtu, në mënyrë mbizotëruese nga procesi i të menduarit, megjithëse ai nuk është rezultat i një lidhjeje natyrore midis sendeve dhe tipareve të tyre. Dallimi midis objekteve fizike dhe ndërgjegjes njerëzore është shumë i qartë dhe i thellë. Sendi/objekti nuk është as ndërgjegje dhe as i menduar. Ai thjesht është i reflektuar (i përfaqësuar) brenda ndërgjegjes/të menduarit, megjithëse, duke u nisur nga ekzistenca e tij, nuk është as e para, as i dyti. Duke bërë dallimin midis objekteve materiale dhe ndërgjegjes njerëzore, autori është i interesuar rreth natyrës origjinale të fenomenit (ose të sendeve). Shkaku natyror dhe original i fenomenit nuk është shkaku i tyre logjik. Kjo nuk qëndron për koncepte dhe nocione, por vetëm për objekte/sendë dhe ndërlidhjen e tyre shkakore. Kur ne shprehim diçka rreth diçkaje (një sendi/objekti), kjo nuk do të thotë se ne natyrshëm ndikojmë mbi të. Rrjedhimisht, shenja, e cila është një lloj i caktuar i përcaktimit të objektivitetit, nuk është aspak rezultat i tij. Shenja gjuhësore e një objekti/sendi nuk është tipar i tij natyror/original.

Në lidhje me marrëdhënien send/objekt dhe kuptimin i tij, autori shprehet si më poshtë: së pari, me të vërtetë ekziston një objekt dhe pas kësaj ndodh emërtimi i tij. Nëse nuk ka një objekt, atëherë nuk do të ketë as fjalë për ta emërtuar atë. Pra, nëse një fjalë i korrespondon një objekti, ajo bëhet konkrete. Ajo përpiqet të ekzistojë dhe nuk është e prirur për të përcaktuar ato gjëra që kanë krijuar këtë fjalë dhe shprehjen e asaj që ajo përfaqëson.

Në këtë mënyrë, ne mësojmë se objekti është elementi parësor i marrëdhënies *shenjues - i shenjuar*. Ai, gjithashtu, i përngjan nocionit Agustinian mbi lidhjen send (objekt)/shenjë. Te “*De Doctrina Christiana*” ai shprehet “Kur më jepet një shenjë, unë nuk kuptoj asgjë nëse nuk kam njohuri për objektin që kjo shenjë përcakton; shenja nuk perceptohet si e tillë (si shenjë) derisa objekti që ajo nënkupton njihet, ose

<sup>76</sup> [Losev, A. F. *Sign, Symbol, Myth*, Moscow University Publishing. 1982, f. 89.] shih te <file:///C:/Users/user/Downloads/301-1027-1-PB.pdf>

<sup>77</sup> <file:///C:/Users/user/Downloads/301-1027-1-PB.pdf>

me fjalë të tjera, njohuria (përvoja) për sendin i paraprin njohjes së shenjës. Megjithatë, një shenjë kuptohet kur njihet objekti dhe aspak objekti të njihet kur jepet shenja (pra e kundërta)”<sup>78</sup>.

Duke përmbledhur arsyetimin e mësipërm mund të themi se: 1. nuk ka një lidhje të natyrshme midis shenjës gjuhësore dhe objektit që ajo nënkupton. (Aristotel-i) 2. shenja është arbitrare. (Sossyr-i) 3. shenja gjuhësore e një objekti nuk është veçori e tij natyrore/origjinale. (Losev-i) 4. njohuria (përvoja) për objektit/sendit paraprin njohurinë e shenjës. (Agustin-i)

### 1.10. Asimetria e një shenje gjuhësore

Me asimetri të shenjës gjuhësore kuptohet mungesa e një lidhjeje ndërmjet kuptimit dhe formës. Një formë mund të shprehë shumë kuptime dhe një kuptim mund të shprehet nga shumë forma. Kjo asimetri e lidhjeve midis formës dhe kuptimit shfaqet te polisemia, homonimia, dykuptimësia dhe ngatërime të ndryshme semantike në nivelin sintagmatik.<sup>79</sup>

*Polisemia*: Për shembull, në gjuhën shqipe: *shkon* – 1. “ecën” (treni); 2. “kalon” (koha); 3. “blihet” (malli); 4. “përshtatet nga ngjyra”, *shtroj* – 1. “ndeje perden, hap” (shtroj qilimin, petët në tepsin); 2. “e bëj gati për të ngrënë” (shtroj sofrën); 3. “jap një darkë” (shtroj sofrën); 4. “hëngrën e pinë mirë” (ia shtruan); 5. “e asfaltoj” (shtroj rrugën); 6. “bëj dysheme me dërrasa, me çimento” (shtroj dhomën); 7. “e vuri nën sundim, e detyroi të bindet” (shtroi vendin); 8. “nisi bisedën” (shtroi kuvend, bisedë); 9. “e vë në diskutim” (nis bisedën); 10. “i vë vezët për të çelur zogj” (shtroj kllonjë); 11. “e rrahu shumë” (shtroi në dru) etj.

Në gjuhën angleze: *to speculate* - 1. “të mendosh për një ide pa pasur fakte mbështetëse”; 2. “të shesësh diçka duke shpresuar të fitosh më tepër”, *bank* - 1. “një institucion financiar”; 2. “ndërtesa ku një institucion financiar ofron shërbime”; 3. “të mbështetesh tek” etj.

*Homonimia*: Për shembull, në gjuhën shqipe: *kisha<sub>I</sub>* - “objekt fetar”; *kisha<sub>II</sub>* - “e shkuara e foljes ‘kam’, *qepa<sub>I</sub>* - “perime”, *qepa<sub>II</sub>* - “e shkuara e foljes ‘qep’”, *përdhes<sub>I</sub>* - “emër sëmundjeje”; *përdhes<sub>II</sub>* - “mbiemër” etj.

Në gjuhën angleze: *Catholic<sub>I</sub>* – “i referohet kishës katolike”; *Catholic<sub>II</sub>* - “i mësuar; i ditur (me njohuri)”, *fell<sub>I</sub>* - “lëkura e kafshëve që ndërrohet”; *fell<sub>II</sub>* - “kodër”; *fell<sub>III</sub>* - “i rreptë, i egër”; *fell<sub>IV</sub>* - “pres pemë” dhe “grumbull pemësh të prera”; *fell<sub>V</sub>* - “koha e shkuar e foljes ‘fall’ bie, rrëzohem” etj.

*Dykuptimësia*: Për shembull, në gjuhën shqipe: *Agimi e piu verën në shishe*.<sup>80</sup> Kjo frazë është e dykuptimshme, të paktën në variantin e shkruar. Në ligjërim na vjen në ndihmë intonacioni, i cili na ndihmon të transmetojmë më lehtësisht informacionin që duam të përcjellim. Kështu, nëse theksi bie mbi grupin e fjalëve *në shishe*, do të thotë që Agimi në vend të gotës ka përdorur shishen për të pirë verë, por nuk mund të pohojmë se e piu të gjithën apo jo. Por, nëse theksi bie mbi foljen *pIU*, kjo do të thotë që Agimi e piu gjithë verën që ishte në shishe, por nuk jemi në gjendje të përcaktojmë si e piu atë, pra në shishe, gotë, etj.

Në gjuhën angleze: *He left the car with the girl*. (Ai e la makinën me vajzën.) Ne mund të bëjmë pyetje të ndryshme për pjesën e nënvizuar të fjalisë: *Me kë e la ai makinën?* ose *Si e la ai makinën?*

<sup>78</sup> [Augustine, De Doctrina Christiana, 1.2.2.] sipas <file:///C:/Users/user/Downloads/301-1027-1-PB.pdf>

<sup>79</sup> <http://studopedia.org/6-11674.html>

<sup>80</sup> Koleci, F. & Turano, G. *Hyrje në Sintaksën Gjenerative të Shqipes*, shblu, Tiranë, 2011, f. 31.

*Ngatërrimet semantike* shfaqen në aspektin sintagmatik gjatë ligjërimit. Duke u ndikuar nga konteksti, format gramatikore zhvillojnë kuptime të reja konotative (nuanca kuptimore të shprehtësisë, emocionale, intensive, pozitive ose negative). Për shembull, në gjuhën shqipe ngatërrime semantike ndodhin kur homonimet përdoren për të ndërtuar lojëra fjalësh. Këto njësi, duke pasur tingëllim të njëjtë, nganjëherë sjellin keqkuptime në ligjërimit dhe errësojnë qartësinë e fjalisë. Ja një shembull, ku fjala *verë* mund të merrej sipas rastit me dy kuptime:

“Deti shikon kodrat,  
Vreshtat që mbollëm dje,  
Së shpejti, verë do të kemi.  
E ç’verë!  
Në Kryekuq,  
Derë më derë,  
Në vend të ujit,  
Verë ...” (Letërsi artistike)<sup>81</sup>

Në gjuhën angleze: He disliked the *girls*. (Ai nuk i pëlqen vajzat.)  
He disliked the *enthusiasms* of American girls. (Ai nuk e pëlqen entuziazmin e vajzave amerikane). Numri shumë i emrit “*girls*” (*vajzat*) në fjalinë e parë është përdorim i zakonshëm. Numri shumë i emrit “*enthusiasms*” (*entuziazmin*) në fjalinë e dytë tregon qëndrimin negativ të personazhit ndaj vajzave.

Asimetria është një fenomen i gjerë që shfaqet në mënyra të ndryshme. Gjuhësia është një nga fushat e saj të shprehur.

Në vazhdim do të përqëndrohemi te teoria e shenjës gjuhësore dhe asimetria e saj nga këndvështrime të ndryshme. Një nga krijuesit e Shkollës Gjuhësore të Gjenezës, S.O.Kartzevski (S.O. Kartzevsky), ishte i pari që krijoi një teori të qëndrueshme të dualizmit asimetrik të shenjës gjuhësore. Në një prej artikujve të tij, autori shpalosi arsyet e krijimit të asimetrisë dhe krijimin e burimeve të pastra gjuhësore të prejardhjes së homonimisë dhe sinonimisë. Fjalët e tij të mëposhtme janë të rëndësishme në ditët e sotme: “Homofonia është një dukuri e zakonshme, ndërsa homonimia është shfaqja e saj e veçantë. Homonimia shfaqet zakonisht në aspektin konceptual të gjuhës. Në këtë aspekt, homonimia mund të kundërshtohet nga një tjetër fenomen – heterofonia, dmth, sinonimi e koncepteve. Megjithatë, kjo nuk është asgjë më tepër sesa dy anët e një parimi. Ky parim mund të përgjithësohet në thënien e mëposhtme: *çdo shenjë gjuhësore është një homonim potencial dhe një sinonim në njëjtën kohë* ... Ky përfundim logjik vjen nga tipari i dallueshëm i një shenje dhe çdo shenjë gjuhësore duhet të përmbajë një tipar të tillë. Përndryshe, ajo nuk do të ndryshonte nga sinjali.”<sup>82</sup>

Autori pohon se homonimet në karakter janë më tepër psikologjike sesa logjike. Dhe karakteri logjik është më i pandashëm nga sinonimet. Idetë e autorit në lidhje me zhvendosjet gramatikore dhe semantike kanë qenë shumë kuptimplota. Sipas opinionit të S.O. Kartzevski-t supozimet e mëposhtme çojnë drejt rritjes së asimetrisë së shenjës gjuhësore: shenjuesi ka prirjen të përmbushë funksione të tjera përveç atij parësorit. I shenjuari ka prirjen të shprehet nga mjete të ndryshme përveç shenjave të tij.

<sup>81</sup> Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë, 1999, f. 43.

<sup>82</sup> Karcevskiy, S. O. *On the asymmetric dualism of the linguistic sign*, “Travaux du Cercle linguistique de Prague”, I, 1929, f. 24 -25.



Konceptet e simetrisë dhe asimetrisë në fillimet e tyre kanë qenë kategori filozofike. Së pari, ato u vendosen në një sistem të caktuar në shekullin XIX, në një material kristalografik. Në të njëjtën fushë u përkufizuan llojet e asimetrisë. Më vonë ide të simetrisë dhe asimetrisë u gjendën edhe në shkenca të tjera si në gjeometri, në fizikë etj. Gjuhësia filloi t'i përdorte këto ide, siç e përmendëm edhe më lart, falë përpjekjeve të S.O. Kartzevski-t.

Një shenjë dhe një kuptim, një formë dhe një përmbajtje, nuk janë gjithmonë plotësisht të baraspeshuara. Kjo ndodh sepse në disa raste e njëjta shenjë ose formë përmbush funksione të ndryshme, dmth, ka kuptime të ndryshme dhe i njëjti kuptim ose përmbajtje mund të sillet me mjete të shenjave ose formave të ndryshme. Kjo dukuri është formuar si *teoria e asimetrisë gjuhësore*.

Autori V.G.Gek (V.G.Gak) shkruan se po të mos kishte një asimetri të shenjës gjuhësore, nuk do të kishte një gjuhësi teorike. Të gjitha argumentet dhe debatet për gjuhësinë do të reduktoheshin në maksimum. Simetria (termi vjen nga greqishtja *symmetria*) është përkufizuar si përshtatje, përputhje etj. Termi, gjithashtu, nënkupton pandryshueshmëri.<sup>83</sup> Duke thjeshtuar çfarë përmendëm më lart, mund të themi se simetria është manifestimi i rregullit, i sekuencave të sakta dhe i qëndrueshmërisë midis objekteve dhe dukurive të realitetit objektiv.

Sipas burimeve të ndryshme, asimetria përkufizohet si mungesë e simetrisë. Në këtë mënyrë asimetria mund të shihet si një shkelje e rregullit dhe qëndrueshmërisë.<sup>84, 85</sup> Sipas Gek-ut asimetria mund të shihet në dy rastet e mëposhtme: a) në ndarjen e qendrës (thelbit) nga periferia b) në dallimin e *shenjuesit* nga *i shenjuari*. Nga pikëpamja e strukturës gjuhësore, qendra (thelbi) përbëhet nga fonemat kryesore, modele të fjalëformimit, të kombinimit të fjalëve, të ndryshimit të fjalëve, të përdorura kryesisht në periudhën të cilës i përket zhvillimi i gjuhës. Periferia është shmangie nga këto modele. Asimetria e *shenjuesit* dhe të *shenjuarit* mund të shihet në nivelet e një sistemi, një strukture dhe një funksioni. Asimetria e sistemit shihet kryesisht në zhvillimin e çrregullt të lidhjeve gjuhësore dhe në anomalinë paradigmatiche të disa fjalëve.<sup>86</sup>

Në kapitullin IV të punimit “The Theoretical Grammar of the French Language” (Gramatika Teorike e Gjuhës Frënge), V.K.Gek-u ka analizuar problemin e asimetrisë në gramatikë. Ai pohon se çdo nivel dhe seksion i gjuhës duhet të ndahet në elemente qendrore, standarde, kryesore dhe periferike. Lidhja qendër - periferi mund të shihet në aspektet strukturore, semantike dhe funksionale të gjuhës. Sipas teorisë së Gek-ut, në aspektin strukturor qendra përbëhet nga modele parësore të formimit dhe të ndryshimit të fjalëve, ndërsa periferia është shmangie nga këto modele dhe standarde. Kjo ide ilustron me shembullin e mëposhtëm në formimin e formës së shumësit në gjuhën frënge: në qoftë se i shtohet mbaresa –s temës së fjalës, kjo është mënyra kryesore e formimit të shumësit, ndryshe nga mënyrat e tjera të formimit të shumësit (*œil – yeux, travail – travaux*), të cilat i përkasin shtresës periferike të gjuhës. Shembull i të njëjtit lloj nga gjuha angleze është: mënyra kryesore – *book-books, hand-hands*; mënyra dytësore – *foot-feet, ox-oxen, child-children* etj.<sup>87</sup>

<sup>83</sup> [Soviet Encyclopaedic Dictionary, M.:Soviet Encyclopaedia, 1980. f. 1219.] shih te [http://www.rusnauka.com/15\\_NPN\\_2013/Philologia/7\\_135961.doc.htm](http://www.rusnauka.com/15_NPN_2013/Philologia/7_135961.doc.htm)

<sup>84</sup> [Soviet Encyclopaedic Dictionary, M.:Soviet Encyclopaedia, 1980. f. 1219.] shih po aty.

<sup>85</sup> [V.G.Gak, *The theoretical grammar of the French language*, M.:Dobrosvet, 2000, f. 831. ] Po aty.

<sup>86</sup> [Linguistic Encyclopaedic Dictionary, M.: Soviet Encyclopaedia, 1990, f. 682.] Po aty.

<sup>87</sup> *On the linguistic sign asymmetry*

[http://www.rusnauka.com/15\\_NPN\\_2013/Philologia/7\\_135961.doc.htm](http://www.rusnauka.com/15_NPN_2013/Philologia/7_135961.doc.htm)

Sipas V. G. Gek-ut asimetria e një forme (F) dhe e një përmbajtjeje (P) mund të shihet në aspektin sintagmatik, paradigmatic dhe semiotik. Asimetria e një forme dhe e një përmbajtjeje ndodh kur elemente të formës dhe elemente të përmbajtjes nuk janë të barabartë në sasi të tyre. Në këtë rast, ose elementet e formës janë më shumë se elementet e përmbajtjes, ose e anasjellta. Sipas teorisë së Gek-ut në aspektin sintagmatik, një formë dhe një përmbajtje duhet të përputhen, ashtu siç e kërkon simetria. Ky aspekt përshkruhet si më poshtë:

|            |    |    |    |       |    |
|------------|----|----|----|-------|----|
| Përmbajtja | P1 | P2 | P3 | Forma | F1 |
|            |    |    |    |       | F2 |
|            |    |    |    |       | F3 |

Kjo konkretizohet edhe në shembujt e mëposhtëm, përkatësisht në gjuhën shqipe dhe angleze:

në gjuhën shqipe: kuptimi leksikor    mbiemri    gjinia (mashkullore)  
*punë-*                                    *-tor-*                                    *-i*

në gjuhën angleze: kuptimi leksikor    mbiemri    gjinia (femërore)    shumësi  
*nation-*                                    *-al-*                                    *-e-*                                    *-s*

Dëmtimi i paralelizmit në aspektin sintagmatik rezulton në asimetri të dy llojeve: a) sintetike; b) analitike.

|                 |                               |
|-----------------|-------------------------------|
| P1 + P2         | P3                            |
| F1              | F2 + F3                       |
| Formë sintetike | Formë analitike <sup>88</sup> |

Në aspektin paradigmatic lidhjet e njësisive të formës dhe planeve të përmbajtjes janë simetrike. Një formë i korrespondon një kuptimi. Kjo ilustron në mënyrën e mëposhtme.

|                |          |    |                     |
|----------------|----------|----|---------------------|
| Plani i formës | F1 _____ | P1 | Plani i përmbajtjes |
|                | F2 _____ | P2 |                     |

Nëse dëmtohet ky proporcionalitet, rezultojnë dy lloj asimetrish: polisemi/homonimi dhe sinonimi.

Lidhja e barabartë e një forme dhe një përmbajtjeje rezulton në simetri edhe në aspektin semiotik.

F ----- P

Por ndërprerja në njërin anë e këtij koncepti të simetrisë (F ose P), mund të shkaktojë dy lloj asimetrish.

Formë zero    Ø \_\_\_\_\_ P

<sup>88</sup> Po aty.

Formë bosh F \_\_\_\_\_ Ø

Një formë zero nuk ka shenjë ose tregues të një kuptimi.

Nëse një formë nuk i korrespondon ndonjë elementi në realitet, një formë bosh mund të ndodhë, dmth, forma humbet kuptimin dhe vlerën e saj semantike.<sup>89</sup>

Asimetria funksionale mund të shkaktohet duke shprehur një kuptim me ndihmën e formave të ndryshme dhe duke përdorur një formë për të shprehur kuptime të ndryshme. Për shembull, në sistemin kohor të gjuhës angleze, një veprim i së ardhmes dhe, rrjedhimisht, një kohë (moment kohor) e së ardhmes mund të shprehen me më shumë se një mënyrë.<sup>90</sup>

I will go there tomorrow. (Unë do të shkoj atje nesër) - vendimi merret në moment  
I'm going there tomorrow. (Unë do të shkoj atje nesër.) - vendimi është i parashikuar  
I'll be doing my work tomorrow. (Nesër do të jem duke bërë punën time/ Do të jem në punë nesër.)

I'm on the point of leaving. (Jam gati për t'u larguar.)

I'm about to leave. (Unë do të iki tani.) etj.

Dhe një formë mund të shprehë kuptime të ndryshme. Për shembull:

He can't see you tomorrow, he *is meeting* his parents. (Ai nuk mund t'ju presë ju nesër, ai do të *takojë* prindërit.) (Koha e ardhme e foljes që shpreh diçka të planifikuar për nesër "is meeting")

He *is meeting* his parents now at the aeroport. (Ai *është duke takuar* prindërit e tij në aeroport.) (Koha e tashme e vazhduar e foljes që shpreh një veprim që po ndodh në çastin që flasim "is meeting").

Duke përmledhur ato që pohuam më sipër, arrijmë në përfundimin se kategoritë filozofike të simetrisë dhe asimetrisë përbëjnë një njësi dialektike në bazë të së cilës në një shkencë gjuhësore ato shqyrtohen në pandashmëri dhe pavarësi. Vëzhgim i këtyre dy dukurive gjuhësore çon në një njohje më të thellë të strukturës gjuhësore dhe siguron një mundësi për të shpjeguar stabilitetin dinamik të strukturës së dhënë dhe gatishmërinë e saj për të ndryshuar.

---

<sup>89</sup> Po aty.

<sup>90</sup> Po aty.

## KAPITULLI II LIDHJA MIDIS SEMANTIKËS DHE SEMIOLOGJISË

### 2.1. Lidhja midis semantikës dhe semiologjisë në komunikimin e kuptimit

Kur ne hapim gojën për të folur, një rrymë ajri del si rezultat i artikulimit të fjalëve. Është për t'u çuditur që “një shpërthim akustik” mund të mbartë kuptim. Profesori i gjuhësisë Roi Harris (Roy Harris)<sup>91</sup> shpjegon rëndësinë e studimit të gjuhës: “Fjalët nuk janë etiketime të thjeshta vokale apo suplemente komunikimi të mbivendosura sipas një rendi të dhënë sendesh/objektsh/çështjesh. Ato janë produkte kolektive të ndërveprimit social, instrumente të rëndësishme me anë të cilave njeriu krijon dhe artikulon botën e tij. Kjo pikëpamje e shekullit XX për gjuhën ka ndikuar së tepërmi zhvillimet e të gjitha shkencave njerëzore.”

Natyrshëm lind pyetja: si është e mundur që një shpërthim akustik merr tipare semantike? ose, si e dëshifron (dekodon) mendja e njeriut kuptimin e synuar të një shpërthimi akustik? Shumë disiplina të shkencave njohëse (kognitive) japin kontributin e tyre në përgjigjen e këtyre pyetjeve. Sipas modelit të komunikimit gjuhësor të Roman Jakobson-it, ky mesazh tregon se çfarë folësi përpiqet t'i transmetojë dëgjuesit.<sup>92</sup> Megjithatë, gjuhëtari Çomski (Chomsky) shprehet si vijon: “shpesh e kam të vështirë të artikuloj atë që jam duke menduar. Është një përvojë shumë e zakonshme .... Të përpiqesh të shprehësh diçka, ta thuash dhe ta realizosh atë, nuk është ajo që synohet ... është shumë e vështirë t'i japësh kuptim kësaj përvoje pa supozuar që ju të mendoni pa gjuhën. Ju mendoheni dhe më pas përpiqeni të gjeni një mënyrë për të artikuluar çfarë ju mendoni dhe, ndonjëherë, ju nuk mund ta bëni atë; ... nëse ju jeni duke menduar, atëherë, mesa duket, ekziston një lloj strukture konceptuale.”<sup>93</sup>

Për të mbartur një mesazh gjuhësor ose për t'i dhënë kuptim një mesazhi të tillë, përdoren së bashku, semantika dhe semiologjia. Megjithatë, së pari, është e rëndësishme të kujtojmë që gjuhësisë i intereson gjuha. Në një kuptim të gjerë, mesazhi mund të marrë formën e një fotoje, muzike ose një gjesti trupor. Me fjalë të tjera, një formë jogjuhësore. Gjuha është përshkruar si një formë gjuhësore e komunikimit dhe mund të mbartë kuptim në mënyrë të pavarur ose në lidhje me forma jogjuhësore. Deniël Shandlë-ri (Daniel Chandler) e zhvillon më tej këtë ide duke u shprehur se “një tekst” mund të jetë verbal, joverbal ose në të dyja format, së bashku. Në këtë rast termi “tekst” zakonisht i referohet një mesazhi që është i pavarur fizikisht nga dërguesi ose marrësi i tij. Për të kuptuar më mirë semantikën dhe semiologjinë, si edhe rolet e tyre në dëshifrimin (dekodimin) e kuptimeve, le ta marrim secilën çështje në veçanti dhe më pas të shohim lidhjen mes tyre në dekodimin e kuptimit.

### 2.2. Semantika dhe interpretimi i kuptimit

Semantika njihet si dega e gjuhësisë, e cila lidhet me kuptimin e fjalës. Megjithatë, paqartësia e termi “kuptim” e bën këtë një çështje të vështirë për t'u

<sup>91</sup> Harris, R. *Language, Saussure and Wittgenstein: How to play games with words*, London: Routledge, 1988, f. 32.

<sup>92</sup> Jakobson, R. *Closing statement: linguistics and poetics*, te Sebeck, T. *Style in Language*, 1960.

<sup>93</sup> Chomsky, N; Mukherji, N; Patnaik, B; Agnihotri, R. *The architecture of language*, New Delhi: Oxford University Press, 2000.

vëzhguar. Paqartësia rrjedh nga ideja se kuptimi mund të përfshijë shumë elemente. Pra ai mund të gjendet kudo. Kuptimi i fjalëve vjen nga marrëdhënia midis fjalëve, koncepteve dhe objekteve në botën reale. Kuptimi i një fjalie në një gjuhë varet nga mënyrat me të cilat fjalët dhe shprehjet e fjalisë lidhen me situatat e botës reale.

Semantika ka ndihmuar shumë teori për të arritur në një përkufizim më të plotë të “kuptimit”. Një prej tyre është *teoria referenciale* e semantikës. Sipas saj, kuptimi duhet t’i referohet diçkaje në botën reale, abstrakte ose e prekshme. Një tjetër teori e rëndësishme është teoria e semantikës *e vërteta - kushtore*. Për shembull, nëse dikush thotë: “Andi është një student”, kjo fjali nuk do të përmbajë një tipar të së vërtetës, në qoftë se ne nuk mund të përcaktojmë kushte të mjaftueshme dhe të domosdoshme për të vërtetën e kësaj fjalie. Kjo teori semantike nuk përcakton nëse një teori e caktuar apo hipotezë është e saktë, megjithatë, ajo ofron informacion të plotë mbi kuptimin denotativ (kuptimi i parë / tregues) të një fjale. Këto teori dhe studimet e ndryshme janë përpjekje për të studiuar një koncept të ndërlikuar, siç është “kuptimi”.

### 2.3. Semiologjia dhe konteksti i kuptimit

Semiologjia është përkufizuar nga shumë gjuhëtarë dhe nga studiues të shkencave të tjera. Mjaft prej këtyre përkufizimeve janë të paqarta ose të vështira për t’u kuptuar. Më tepër se njëqind vjet më parë, Ferdinand de Saussure<sup>94</sup> theksoi se kjo paqartësi vjen nga fakti se shumë fusha studimi ndërthuren me semiologjinë. Duke studiuar shumë materiale mbi semiologjinë është arritur në një përkufizim të thjeshtë. Semiologjia mbulon jo vetëm çfarë njihet si një shenjë në një analizë gjuhësore të ligjëritimit të njeriut, por, gjithashtu, ajo merr në konsideratë gjithë kontekstin (situatën) në të cilën thuhet fjalët. Në të njëjtën mënyrë, shumë studiues theksojnë se çdo studim semiologjik i kuptimit synon të reduktojë kuptimin në një model kod të komunikimit. Ia vlen të përmendet se në semiologji shenjat mund të përfshijnë fjalë, imazhe, tinguj, gjeste dhe objekte. Në këtë kuptim, themi se semiologjia duhet të përfshijë semantikën, e cila ofron një këndvështrim më të gjerë sesa semantika për të kuptuar ligjërimin e njeriut. Por, si bashkëpunojnë semantika me semiologjinë për të dëshifruar (dekoduar) kuptimin e teksteve. Këtu edhe një herë theksojmë se një tekst mund të jetë verbal, joverbal ose të dyja së bashku.

### 2.4. Semantika dhe semiologjia si mjete analitike

Për të kuptuar lidhjen mes semantikës dhe semiologjisë në komunikimin e kuptimit, duhet të kemi parasysh që të dyja fushat ndajnë një interes të përbashkët në lidhje me kuptimin e shenjave. Xhon Sturrock-u (John Sturrock)<sup>95</sup> thekson se, ndërsa semantika fokusohet në dimensionet denotative (kuptimi i parë i fjalës) të kuptimit të fjalëve, semiologjia ofron një ide më të gjerë të kuptimit duke u fokusuar në dimensionet denotative dhe konotative (kuptimi figurativ) të shenjave. Noel Burton-Roberts-i (Noel Burton-Roberts)<sup>96</sup> beson se kuptimi nuk është një cilësi semantike

<sup>94</sup> Saussure de, F. *Course in general linguistics*, London, Duckworth, 1993. f. 47.

<sup>95</sup> Sturrock, J. *Structuralism and science: From Levi Strauss to Derrida*, Oxford University Press, 1979. f. 48.

<sup>96</sup> Burton-Roberts, N. *Meaning, semantics and semiotics*, te Capone, A. *Perspectives on Philosophy and Pragmatics*, Newcastle, UK: Newcastle University, 2011, f. 34.

por, një relatë semiologjike ndaj cilësive semantike. Në të njëjtën mënyrë, Patrik Zabalbosko (Patrick Zabalbeascoa)<sup>97</sup> shqyrtoi më tej rolin e semantikës dhe semiologjisë në interpretimin e kuptimit të një teksti: “asnjë tekst nuk mund të përbëhet plotësisht nga shenja verbale sepse shenja të tilla gjithmonë kanë nevojë për një lloj mbështetje fizike.” Pohimi i tij nënkupton që mbështetja fizike do të fitojë një kuptim semantik brenda një konteksti semiologjik. Le të shohim si funksionon një bashkëbisedim i thjeshtë midis dy njerëzve. Dihet që çdo bashkëbisedim përbëhet nga të paktën një dërgues dhe një marrës, ose, siç i quan Jakobson-i, adresuesi dhe i adresuari. Misioni kryesor i adresuesit është të mbartë një mesazh tek i adresuari. Mesazhi përfaqëson mendimet e atij që e dërgon atë. Bashkëbisedimi nuk do të ketë vlerë nëse adresuesi nuk komunikon suksesshëm mendimet e tij dhe i adresuari nuk e kupton mesazhin. Megjithatë, ky është një vështim sipërfaqësor i asaj se çfarë ndodh në një bashkëbisedim. Në një analizë më shkencore, mund të përdoren parime të semantikës dhe semiologjisë. Semantikisht, qëllimi kryesor është elementi më i vogël përbërës i një fjalie, e cila është fjala. Si rrjedhim, një fjali e saktë duhet të ketë përshtatjen kryefjalë – kallëzues, përdorimin e duhur të gjinisë, ose çfarë quhet një ndërtim sintaksor i një fjalie dhe, së bashku, përbërësit duhet të komunikojnë një ide të kuptimtë. Në kontrast me këtë, semiologjia iu adresohet elementeve të tilla si kodet, shenjuesi, i shenjuari, ikonat dhe simbolet.

---

<sup>97</sup> Zabalbeascoa, P. *Dubbing and the non-verbal dimension of translation*, te Poyatos, F. *Non-verbal communication and translation: New perspectives and challenges in literature, interpretation and the media*, Amsterdam, 1997, f.327.

*“Çdo shenjë (gjuhësore) është potencialisht “një homonim” dhe “një sinonim” në të njëjtën kohë - dmth, ajo përbëhet nga kryqëzimi i këtyre dy njësive konceptuale.”<sup>98</sup>*

*Sergej Karcevskij*

*Pjesa e dytë*

*Çështje të semantikës në planin krahasues midis shqipes dhe anglishtes*

---

<sup>98</sup> S.O.Karcevskiy, *On the asymmetric dualism of the linguistic sign*, “Travaux du Cercle linguistique de Prague”, I, 1929, f. 24 -25.

## KAPITULLI III

### SFOND HISTORIK RRETH DUKURISË GJUHËSORE TË HOMONIMISË

#### 3.1. Prejardhja e fjalës “homonim”

Termi “*homonimik*” e ka burimin në greqishten e vjetër ὁμόνυμος “homonymous” që do të thotë ‘kanë të njëjtin emër’ (ku ὁμός *homos* do të thotë “i njëjtë” dhe ὄνομα *onyma* do të thotë “emër”)<sup>99</sup>. Vetë origjina e fjalës shpreh qartë ngjashmërinë e emërtimit, të kombinuar me ndryshimin në kuptim. “Homonimia i referohet një situatë ku ndodhen dy ose më shumë fjalë me të njëjtën formë. Megjithatë kanë të njëjtën formë, homonimet janë konsideruar si leksema të veçanta, për arsye se kryesisht ato kanë kuptime të palidhura dhe etimologji të ndryshme.”<sup>100</sup>

#### 3.2. Ç’ janë homonimet

Në kuptimin e gjerë të fjalës, homonimia përfshin të gjitha llojet e tingëllimeve të njëjta; kështu flasim për homonimi gramatikore, kur përputhen në tingëllim format e ndryshme të po asaj fjale, kemi homonimi të morfemave, të togjeve të tërë etj. Pra jo vetëm fjalët, por edhe njësi të tjera leksikore mund të jenë homonimike.

Në këtë temë ndalemi vetëm tek homonimia e fjalëve dhe e formave të fjalëve, pra nuk preket problemi i ndajshesave homonimike ose shprehjeve homonimike.

Fillimisht i referohemi mënyrës se si shpjegohet fjala ‘*homonim*’ në fjalorë të gjuhës shqipe, të anglishtes britanike, të anglishtes amerikane, etj.

Në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1954) homonimet përkufizohen si: “Fjalët që ngjajnë në shqiptim, por ndryshojnë shumë nga kuptimi quhen homonime.”<sup>101</sup>

Në “Fjalorin e shqipes së sotme” (2002) termi përkufizohet: “Homonim – fjalë që tingëllon njësoj me një tjetër, por nga kuptimi ndryshon prej saj (p.sh. verë I dhe verë II); secila nga njësitë e ndryshme gjuhësore që përputhen nga ana tingullore.”<sup>102</sup>

Te “Fjalori e Gjuhës Shqipe” (2006) përkufizimi gjuhësor i fjalës është: “gjuh. fjalë që ka trajtë e tingëllim të njëllotë me një tjetër, por kuptim të ndryshëm (psh. verë <pije> dhe verë <stinë> : homonime leksikore.”<sup>103</sup>

Në fjalorin e gjuhës angleze “Oxford Advanced Learner’s Dictionary” (2000) homonimia përkufizohet si vijon: “Homonim – një fjalë që shkruhet njësoj si një fjalë

<sup>99</sup>Liddell, H. G.; Scott, R. *A Greek - English Lexicon*, Oxford University Press, 1819.

<sup>100</sup>Përkufizimi i dhënë nga Jackson, H. (Hauërd Xheksën) te *Words, Meaning and Vocabulary*, 1999 është marrë nga Stefanllari, I. *A Course in English Lexicology*, GEER, Tiranë, 2011, f. 93.

<sup>101</sup>*Fjalori i gjuhës shqipe*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954. f. v.

<sup>102</sup>*Fjalori i shqipes së sotme*, Botimi i dytë, TOENA, Tiranë, 2002. f. 486.

<sup>103</sup>*Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006. f.391.



tjetër, por ka një kuptim të ndryshëm nga ajo, dhe mund të ketë dhe një shqiptim të ndryshëm, gjithashtu.”<sup>104</sup>

Te “Thorndike Barnhart – Advanced Dictionary” (1973) fjala përkruhet: “Homonom – fjalë që ka të njëjtin shqiptim dhe gërmëzim me një fjalë tjetër, por kuptim dhe origjinë të ndryshme me të.”<sup>105</sup>

Te “Webster’s New College Dictionary” (1995) termi përkufizohet: “Homonom – një prej dy ose më shumë fjalëve që kanë të njëjtin shqiptim dhe shpesh të njëjtin gërmëzim, por që ndryshojnë në kuptim.”<sup>106</sup>

Ndërsa te “The American Heritage Dictionary of the English Language” (2000) homonimet përkufizohen: “Homonom – një prej dy ose më shumë fjalëve që kanë të njëjtin tingëllim dhe shpesh të njëjtën ortografi, por ndryshojnë në kuptim, si p.sh., bank (breg) dhe bank (bangë, institucion financiar.)”<sup>107</sup>

Në fjalorin “Collins English Dictionary” (1998) fjala përkufizohet nga ana gjuhësore: “(Gjuhësi) Një fjalë prej një grupi fjalësh e shqiptuar ose e shkruar në të njëjtën mënyrë me të tjerat, por që kanë kuptime të ndryshme.”<sup>108</sup>

Ndërsa sipas “Thesaurus” (2003 – 2012) homonimet janë: “Homonom – dy fjalë janë homonime në qoftë se ato janë shqiptuar ose shkruar në të njëjtën mënyrë por kanë kuptime të ndryshme.”<sup>109</sup>

Trajtimi teorik i konceptit homonimi dhe problemeve të saj në shkencën gjuhësore ka tërhequr vëmendjen e mjaft gjuhëtarëve.

Sipas Jani Thomait te “Leksikologjia e Gjuhës Shqipe” (1999): “Homonime quhen zakonisht fjalët ose shprehjet frazeologjike që kumbojnë njëllor, por kanë kuptime krejt të ndryshme.” “Homonimet janë fjalë me formë të njëjtë e me përmbajtje të ndryshme.”<sup>110</sup>

Ndërsa Xhevat Lloshi në studimin “Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe” (1972) shprehet se: “Homonomi do të quajmë përputhjen tingullore të njësisë leksikore të ndryshme. Pra, homonimet janë fjalë të ndryshme, por me të njëjtin tingëllim.”<sup>111</sup>

Përsëri Xhevat Lloshi te “Stilistika dhe Pragmatika” (1999) shkruan se: “Homonomia është një polisemi e rremë, domethënë kemi po atë kompleks tingullor, por jo me kuptime të ndryshme, sepse me të vërtetë janë leksema të ndryshme, që kanë përkuar fonetiki. Në ligjërimin e zakonshëm ajo nuk bie në sy, madje janë gjuhëtarët që e tregojnë si dukuri, përndryshe folësit nuk e njohin aspak.”<sup>112</sup>

---

<sup>104</sup>Hornby, A. S. *Oxford Advanced Learners Dictionary of Current English*, Oxford University Press, 2000, f. 632.

<sup>105</sup>Scott & Foresman, *Thorndike Barnhart - Advanced Dictionary*, Illinois, USA, 1973, fq. 486.

<sup>106</sup>*Webster’s New College Dictionary*, Houghton Mifflin Company, Boston -New York, 1995, f. 530.

<sup>107</sup>*The American Heritage Dictionary of the English Language*, 4<sup>th</sup> ed. Houghton Mifflin Company, 2000. <http://www.thefreedictionary.com/homonym>

<sup>108</sup>*Collins English Dictionary - Complete and Unabridged*, Harper Collins Publishers, 1998.

<http://www.thefreedictionary.com/homonym>

<sup>109</sup>WordNet 3.0, Koleksioni Farlex clipart, Princeton University, Farlex Inc. 2003-2012.

<http://www.thefreedictionary.com/homonym>

<sup>110</sup>Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë, 1999, f. 42.

<sup>111</sup>Lloshi, Xh. “Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe”, *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vëllimi I, Tiranë 1972, f. 204.

<sup>112</sup>Lloshi, Xh. *Stilistika dhe Pragmatika*, Botimet Toena, Tiranë, 1999, f. 130.

Rami Memushaj në librin “Hyrje në gjuhësi” (2004) shprehet se: “Homonymia (gr. vj. homos “i njëjtë” + onyma “emër”) është një dukuri që mund të ngatërrohet lehtë me poliseminë, pasi në të dyja kemi një shenjues të vetëm për dy a më shumë të shenjuar dhe të dyja shkoqiten nga lidhjet sintagmatike të shenjuesve. Dallimi midis tyre është se në rastin e polisemisë të shenjuarit e ndryshëm lidhen midis tyre me një shenjues të vetëm, që funksionon si një njësi e vetme gjuhësore, kurse te fjalët homonimike, të shenjuarit e ndryshëm janë pa lidhje midis tyre dhe lidhen secili veçmas me shenjuesin, duke formuar njësi të ndryshe.”<sup>113</sup>.

Xhon Lajens-i te “Semantics 1” i përkufizon fjalët homonimike si: “Dy ose më shumë fjalë identike në shqiptim ose në shkrim ose në të dyja së bashku, por të ndryshme në kuptime, shpërndarje dhe (në shumë raste) në origjinë, quhen homonime.”<sup>114</sup>

Sipas Dajan Nikolls-it (Diane Nicholls) në studimin “Watt is a homonym?” (2002): “Dy ose më shumë fjalë që shqiptohen njësoj ose gërmëzohen njësoj ose të dyja së bashku (shqiptohen dhe gërmëzohen) quhen homonime.”<sup>115</sup>

Antrishina (Antryshina) te “English Lexicology” përkufizon: “Homonimet janë fjalë identike në formën e tyre tingëllore dhe të shkruar ose të paktën në një nga këto aspekte, por të ndryshme në kuptim.”<sup>116</sup>

Sipas Sinsova-s (Synsova) te “English Lexicology” homonimet janë: “Fjalë identike në formën e tyre tingëllore dhe/ose grafemore, por të ndryshme në kuptim, tradicionalisht janë quajtur homonime.”<sup>117</sup>

Ndërsa Arnold-i (Arnold) te “The English Word” shkruan se: “Dy ose më shumë fjalë identike në tingëllim dhe drejtshkrim, por të ndryshme në kuptim, shpërndarje dhe në shumë raste në origjinë quhen homonime.”<sup>118</sup>

Edhe Lion D. Levëtiçi (Leon D. Levitichi) te “Lexicology of the English Language” përqëndrohet te homonymia dhe e përkufizon atë: “Homonimet janë njësi leksikore ose gramatikore që shkruhen dhe shqiptohen njësoj ose të paktën shqiptohen ose shkruhen njësoj; ndryshojnë në kuptim ose në funksionin semantiko-gramatikor.”<sup>119</sup>

Riçërds-i (Richards) dhe Shmit-i (Schmidt) te “Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics” (2002)<sup>120</sup> dhe Jull-i (Yule) (2006)<sup>121</sup> i përkufizojnë homonimet si një term i përdorur në semantikë për njësitë leksikore që janë identike në të shkruar dhe në shqiptim por kanë kuptime të ndryshme. Ky përkufizim nuk përfshin informacion rreth homofoneve dhe homografeve; por ai krijon një problem me poliseminë.

---

<sup>113</sup>Memushaj, R. *Hyrje në gjuhësi*, DITURIA, Tiranë, 2004, f. 171.

<sup>114</sup>Lyons, J. *Semantics 1*, Cambridge University Press, 1977, f. 209.

<sup>115</sup>Nichols, D. *Watt is a homonym*, MED Magazine, November 2<sup>nd</sup>, 2002.

<sup>116</sup>Përkufizimi i dhënë është marrë nga Stefanllari, I. *A Course in English Lexicology*, GEER, Tiranë, 2011, f. 93.

<sup>117</sup>Po aty f. 93.

<sup>118</sup>Po aty f. 93.

<sup>119</sup>Po aty f. 93.

<sup>120</sup>Richards, J.C.; Schmidt, R. *Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics*, Essex, England: Pearson Education Limited, 2002, f. 241.

<sup>121</sup>Yule, G. *The Study of Language*, 3<sup>rd</sup> ed. Cambridge: Cambridge University Press, 2006, f. 107.

Hartman-i (Hartmann) dhe Stork-u (Stork) te “*Dictionary of Language and Linguistics*” (1976)<sup>122</sup>; Atichison-i (Atičisën) te “*Teach Yourself Linguistics*” (1993)<sup>123</sup> dhe Fromkin-i (Frëmkin) te “*An Introduction to Language*” (2003)<sup>124</sup> bien dakord që homonimet janë fjalë të ndryshme me të njëjtin shqiptim (artikulim) që mund ose nuk mund të jenë identike në të shkruar. Kështu, ata krijojnë një përkufizim, i cili është pjesërisht i ngjashëm me atë të homofoneve. Nga ana tjetër, Wotkins-i (Watkins) te “*Practical English Handbook*” (2001)<sup>125</sup> i përkufizon homonimet njësoj sikur të përkufizonte homofonet, dmth, “fjalë që tingëllojnë ekzaktësisht njësoj me fjalë të tjera, por kanë ortografi të ndryshme” pavarësisht faktit që nuk i emërton ato ‘homofone’ por ‘homonime’, njësoj si vepron edhe Fromkin-i.

Gramli (Gramley) dhe Patzold-i (Pätzold) te “*A Survey of Modern English*” (1992)<sup>126</sup> dhe Wikipedia te “*Homonymy*” (2010)<sup>127</sup>, nga ana tjetër, i përkufizon homonimet si “ekzistenca e leksemave të ndryshme që tingëllojnë njësoj (homofonet, p.sh., days “ditë” / daze “çudi”) ose që shkruhen njësoj (homografe, p.sh., lead “prij, udhëheq” / lead “metal, plumb”) por kanë kuptime të ndryshme”. Në këtë mënyrë, ata i ndajnë ato në homofone dhe homografe.

Shihet qartë që përkufizimet e homonimeve, ndryshojnë në mënyrën e formulimit, nga fjalori në fjalor, nga autori në autor, nga gjuha në gjuhë e me sa duket edhe midis anglishtes britanike dhe asaj amerikane. Megjithatë, ideja që shprehet është pothuaj e njëjtë.

### 3.3. Shkaqet dhe rrugët e lindjes së homonimeve në gjuhën shqipe dhe angleze

Përgjigjet e shumë pyetjeve rreth homonimeve mund t’i gjejmë duke ndjekur shkaqet dhe rrugët e lindjes së tyre. Çështja kërkon një trajtim diakronik.

Arsyeja themelore që në gjuhë lind homonimia është fakti se *gjuha ndryshon, zhvillohet*. Kjo përbën përgjigjen e parë unike për të dyja gjuhët, shqipe dhe angleze.

Nga vëzhgimet e bëra, del se rrugët e lindjes së homonimeve në anglisht dhe shqip janë pothuaj të njëjta, ndërsa shkaqet që mund të çojnë tek to, lidhen me karakterin dhe evolucionin e secilës gjuhë.

Mundësia e lindjes së homonimeve varet kryesisht nga struktura rrokjesore e fjalëve. Gjuhët në të cilat mbizotërojnë fjalët njërrrokëshe, si anglishtja dhe kinezishtja, kanë më shumë homonime se ato në të cilat mbizotërojnë fjalët me dy a më shumë rrokje, si shqipja, gjermanishtja, italishtja etj.

<sup>122</sup>Hartmann, R.; Stork, F. C. *Dictionary of Language and Linguistics*, London: Applied Science Publishers Limited, 1976, f. 105.

<sup>123</sup>Atichison, J. *Teach Yourself Linguistics*, London: Hodder and Stoughton, 1993, f. 52.

<sup>124</sup>Fromkin, V.; Rodman, R.; Hyams, N. *An Introduction to Language*, 7<sup>th</sup> ed. USA: Heinle, a part of Thomson Corporation, 2003, f. 71.

<sup>125</sup>Watkins, F. C.; Dillingham, W. B.; Hiers, J. *Practical English Handbook*, 11<sup>th</sup> ed. Boston: Houghton, Mifflin Company, 2001, f. 269.

<sup>126</sup>Gramley, S.; Patzold, K. *A Survey of Modern English*, London: Routledge, 1992, f. 13.

<sup>127</sup>Wikipedia, Homonymy, 2010, f.2.  
[en.wikipedia.org/wiki/User:Homograph](http://en.wikipedia.org/wiki/User:Homograph)

Homonimet ekzistojnë në shumë gjuhë, por në gjuhën angleze kjo dukuri është në veçanti e shpeshtë, sidomos midis fjalëve njërrrokëshe. Në listën prej 2540 homonimeve që jepet tek Oxford English Dictionary (Fjalori Oksford i Anglishtes), 89% rezultojnë fjalë njërrrokëshe dhe 9.1% janë fjalë të ndërtuara nga dy rrokje. Nëse nisemi nga këndvështrimi i strukturës së tyre morfologjike, ato janë kryesisht fjalë me një morfemë.

Në **gjuhën shqipe** lindja e homonimeve është një proces i gjallë, gjithashtu, por jo aq intensiv sa në anglisht. Faktorët e brendshëm gjuhësorë që ndërthuren me njëri-tjetrin në lindjen e homonimeve janë:

- evolucioni fonetik i fjalëve;
- huazimet nga gjuhët e tjera;
- fjalëformimi;
- zbërthimi i polisemisë;
- lëvizjet dhe ndryshimet në gjuhë nga dialektet dhe gjuha e folur.

Krahas këtyre, luajnë rol të veçantë edhe disa faktorë jashtëgjuhësorë. Si rezultat, rrugët e lindjes së homonimeve në gjuhën shqipe janë:

1. përputhja fonetike e fjalëve krejt të ndryshme;
2. shpërbërja e polisemisë;
3. fjalëformimi (konversioni, prejardhja).

Zhvillimi intensiv i homonimisë **në gjuhën angleze** nuk është rezultat i një faktori të vetëm, por i disa faktorëve gjuhësorë, të ndërthurur me njëri-tjetrin në etapa të ndryshme të zhvillimit të saj, siç janë:

- karakteri njërrrokësh i anglishtes;
- struktura e saj analitike;
- identiteti fonetik i fjalës dhe rrënjës së saj;
- shpërbërja e polisemisë;
- formimi i fjalëve të reja me mjete të ndryshme, si konversioni dhe prejardhja;
- huazimet.

Këta faktorë gjuhësorë, nga rrjedh homonimia, ndahen në tre grupe kryesore, që përbëjnë edhe tri rrugët e lindjes së homonimeve në anglisht:

1. homonimi nga zhvillimi konvergjent i tingujve (përputhja fonetike e fjalëve të ndryshme);
2. homonimi nga polisemia me anë të zhvillimit divergjent të kuptimeve (shpërbërja e polisemisë);
3. homonimi nga fjalëformimi (konversioni, prejardhja).

Tani po ndalemi në veçanti në secilën gjuhë duke analizuar dhe ilustruar me shembuj pikat e lartpërmendura.

### 3.3.1. Rrugët e lindjes së homonimeve në gjuhën shqipe

Siç u përmend më sipër, rrugët e lindjes së homonimeve në gjuhën shqipe janë tri: **përputhja fonetike e fjalëve krejt të ndryshme, shpërbërja e polisemisë dhe formimi i fjalëve të reja.**

**3.3.1.1. Përputhja fonetike e fjalëve krejt të ndryshme** është arritur historikisht gjatë ndryshimeve fonetike të kryera brendapërbrenda gjuhës shqipe. Kështu p.sh., etimologjia ka vërtetuar se fjala *pjek*<sub>I</sub> “vë diçka në zjarr, e zbruj...” ka ardhur nga një trajtë më e hershme *\*pek*, nëpërmjet një zberthimi të *-e -së* në *ie* (kjo dukuri vihet re edhe te *rresht - rrjesht*, latinisht *reta* - shqip *rrjetë* etj.), kurse fjala *pjek*<sub>II</sub> “takoj” ka ardhur nga trajta më e vjetër *\*plek*, nëpërmjet kalimit të *pl* në *pj* (sikurse vihet re kjo dukuri në ndonjë të folme të shqipes, p.sh., në disa fshatra të Dibrës e të Shijakut, ku *pl* jep *pj*: *plak- pjak*, *plumb- pjumb* etj.) Pra, nëpërmjet ndryshimesh fonetike të tilla është arritur që fjalët e vjetra krejt të ndryshme *\*pek* e *\*plek* të kenë sot të njëjtën formë *pjek*<sub>I</sub> e *pjek*<sub>II</sub>.




Fig. 3.1. Përputhja fonetike e *pjek*

Me këtë rrugë kanë dalë edhe homonimet *pres*<sub>I</sub> dhe *pres*<sub>II</sub> (dallimi që kanë në të kryerën e thjeshtë: *preva*: *prita* e në kohë e mënyra të tjera, tregon se këto dy folje vijnë prej rrënjësh të ndryshme); *anë*<sub>I</sub> “krah,brinjë” (nga *\*anda*) dhe *anë*<sub>II</sub> “enë” (nga asnjësi *anëtë*)<sup>128</sup>; *bajzë*<sub>I</sub> “hobe” (nga *\*bae*) dhe *bajzë*<sub>II</sub> “një lloj rose e egër” (nga *balzë*); *ah*<sub>I</sub> “dru gjethor...; *ah*<sub>II</sub> “britma që del nga shpirti” dhe *ah*<sub>III</sub> “hak” etj.

Të kësaj natyre janë edhe homonimet që lindin nga përputhja fonetike e fjalëve me burime të ndryshme, si një fjalë shqipe dhe një fjalë e huaj a dy fjalë të huaja që kanë hyrë në shqipe. Kështu, kemi homonimet *verë*<sub>I</sub> “stina më e nxehtë e vitit...” (e huazuar nga latinishtja) dhe *verë*<sub>II</sub> “pije që del nga thartimi i mushtit të rrushit” (nga një rrënjë indoevropiane *\*ven*); *dukë*<sub>I</sub> “pamje” dhe *dukë*<sub>II</sub> “titull i feudalit të lartë” (nga italishtja); *ar*<sub>I</sub> “flori” (nga latinishtja) dhe *ar*<sub>II</sub> “një masë toke” (nga frëngjishtja); *çun*<sub>I</sub> “djalë i vogël” dhe *çun*<sub>II</sub> “varkë peshkimi” (nga bullgarishtja); *bandë*<sub>I</sub> “orkestër frymore” (nga italishtja) dhe *bandë*<sub>II</sub> “fashë” (nga gjermanishtja); *gaz*<sub>I</sub> “trup zakonisht pa ngjyrë dhe i padukshëm...” *gaz*<sub>II</sub> “një ndjenjë gëzimi...” etj.

<sup>128</sup>Çabej, E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, 1982, f. 18-19.

Jashtë kufijve të gjuhës letrare, brenda të folmeve të ndryshme, takohen përputhje fonetike fjalësh, për shkak të ndryshimeve fonetike dialektore; p.sh. *baj<sub>I</sub>* “mbart” dhe *baj<sub>II</sub>* “bëj”; *vloj<sub>I</sub>* “valoj” dhe *vloj<sub>II</sub>* “fejoj”; *brimë<sub>I</sub>* “brymë”, *brimë<sub>II</sub>* “brymë” dhe *brimë<sub>III</sub>* “britmë”; *gja<sub>I</sub>* “gjah” dhe *gja<sub>II</sub>* “gjë” etj. Edhe këto përputhje, që gjenden vetëm brenda ligjëritimit dialektor, duhet të njihen, që të lehtësohet puna për ngulitjen e normës leksikore.<sup>129</sup>

### 3.3.1.2. Shpërbërja e polisemisë

Ashtu si në anglisht, polisemia shpërbëhet, kur njëri nga kuptimet e një fjale shumëkuptimshme largohet fare prej të tjerave, aq sa këput lidhjet me to dhe nën po atë veshje tingullore fillon të jetojë në gjuhë një njësi e pavarur, bëhet temë semantike për formimin e kuptimeve të tjera, dhe si fjalë më vete, vihet në marrëdhënie sinonimie e antonimie me fjalë të tjera, shërben si temë fjalëformuese për krijimin e fjalëve të reja, lidhet me të tjera fjalë në togfjalësha e në njësi frazeologjike etj. Kështu janë ndarë në fjalë të veçanta dy kuptime të fjalës *kallëzoj*. Tani ne mund t’i trajtojmë si homonime *kallëzon<sub>I</sub>* “i bën të njohur dikujt një çështje që duhet të dijë; tregon, rrëfen” dhe *kallëzon<sub>II</sub>* “nxjerr kalli drithi”, edhe pse ndërmjet tyre ka lidhje etimologjike, kuptimi i *kallëzon<sub>I</sub>* ka ardhur nga kuptimi i *kallëzon<sub>II</sub>*. Sot lidhja midis këtyre kuptimeve nuk duket, kështu që polisemia e dikurshme e foljes *kallëzoj* është zbërthyer në homonimet e mësipërme. Këto fjalë, pastaj, janë zhvilluar më vete: prej *kallëzon<sub>I</sub>* janë formuar fjalët *kallëzim*, *kallëzues*, *kallëzimtar*, (rasa) *kallëzore*, kurse prej *kallëzon<sub>II</sub>* është formuar *kallëzore*; *kallëzon<sub>I</sub>* lidhet me *kallëzon* një ngjarje, *kallëzon* bukur, e *kallëzoi* tek i ati etj., kurse *kallëzon<sub>II</sub>* lidhet me fjalët *kallëzon* gruri, *kallëzon* shpejt etj.<sup>130</sup>

Kalimin nga polisemia në homonimi mund ta paraqitim me skemën e mëposhtme:




Fig. 3.2. Shpërbërja e polisemisë të fjala *kallëzon*

<sup>129</sup>Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë, 1999, f. 43 – 44.

<sup>130</sup>Po aty f. 44 - 45.

Me këtë rrugë kanë dalë në shqip edhe homonimet *rrënjë*<sub>I</sub> “pjesë nën rrënjë e një bime” dhe *rrënjë*<sub>II</sub> “lloj dushku...”; *bar*<sub>I</sub> “bimë zakonisht një vjeçare, pa kërcell dhe me gjethe të holla...” dhe *bar*<sub>II</sub> “ilaç”; *sfurk*<sub>I</sub> “vegël bujqësore prej druri a prej metali...” dhe *sfurk*<sub>II</sub> “zool. kandërr e madhe e helmuese me dy çataj...” etj.

Shkëputja e kuptimit nga vargu i kuptimeve të fjalës dhe shndërrimi i tij në një fjalë më vete nuk arrihet menjëherë. Gjatë zhvillimit historik të gjuhës rritet vlera e tij në ligjërim, zgjerohet përdorimi, humbasin lidhjet me kuptimet e tjera, zhvillohet vetë si një temë kuptimore prodhuese, vendos lidhje të reja me fjalët e tjera, shkurt funksionon nën të njëjtën veshje tingullore si një fjalë më vete. Për këtë arsye, shpesh homonimia na duket si skaji më i tejtmë i largimit të kuptimeve leksikore.

### 3.3.1.3. Fjalëformimi si rrugë për lindjen e homonimeve

Nga fjalë të ndryshme krijohen fjalë që përputhen nga forma, p.sh., nga emri *rend,-i* formohet folja *rendoj* “vë në rend, radhit”, kurse nga emri *rende,-ja* formohet një formë tjetër *rendoj* “grij me rende”. Kështu kanë lindur homonimet *rendoj*<sub>I</sub> dhe *rendoj*<sub>II</sub>. Me këtë mënyrë kanë dalë edhe homonimet *i paditur*<sub>I</sub> “që nuk di, injorant” (nga *i ditur*) dhe *i paditur*<sub>II</sub> “i akuzuar në gjyq” (nga *padit*); *pasanik*<sub>I</sub> “njeri i pasur” (nga *pasë*) dhe *pasanik*<sub>II</sub> “ai që shkon pas një tjetri, pasues i dikujt, me kuptim të keq” (nga *pas*); *fillore*<sub>I</sub> “shkollë që jep njohuritë e para” (nga *filloj*) dhe *fillore*<sub>II</sub> “lloj levenxe njëfillëshe” (nga *fill*) etj.

Homonimet në shqip mund të lindin edhe nga një temë e vetme, kur për formimin e fjalëve kanë shërbyer prapashtesa homonimike, p.sh., *dorak*<sub>I</sub> “doreza e parmendës” dhe *dorak*<sub>II</sub> “dorac” (nga *dorë*); *fikth*<sub>I</sub> “fik i paarrirë, fik i vogël” dhe *fikth*<sub>II</sub> “(anat.) një kockë e fytyrës të burrave që del pak jashtë” (nga *fik*) etj.

Shumë homonime të pjesshme dalin në gjuhën shqipe edhe kur formohen fjalë me ndërrim të kategorisë leksiko-gramatikore, p.sh., *përmbys*<sub>I</sub> (folje) dhe *përmbys*<sub>II</sub> (ndajfolje); *grumbull*<sub>I</sub> (emër) dhe *grumbull*<sub>II</sub> (ndajfolje); *buzë*<sub>I</sub> (emër) dhe *buzë*<sub>II</sub> (parafjalë); *lakuriq*<sub>I</sub> (mbiemër) dhe *lakuriq*<sub>II</sub> (emër); *rreth*<sub>I</sub> (emër) dhe *rreth*<sub>II</sub> (parafjalë); *tetëpjetë*<sub>I</sub> (ndajfolje) dhe *tatëpjetë*<sub>II</sub> (emër); *ndryshk*<sub>I</sub> (emër) dhe *ndryshk*<sub>II</sub> (folje); *krimb*<sub>I</sub> (emër) dhe *krimb*<sub>II</sub> (folje), etj. Këta shembuj homonimesh janë krijuar me anë të konversionit, një rrugë mjaft prodhuese për lindjen e homonimeve, në veçanti për homonimet leksiko-gramatikore.

Në gjuhën shqipe ka edhe vargje homonimesh të krijuara me rrugë të ndryshme, si: *bar*<sub>I</sub> “bimë e gjelbër...” dhe *bar*<sub>II</sub> “ilaç” e krijuar nga zberthimi i polisemisë, kurse *bar*<sub>III</sub> “kafene” e krijuar nga përputhja fonetike e fjalës së huazuar nga anglishtja.

### 3.3.2. Lindja e homonimeve në gjuhën angleze

Gjuha angleze shpesh i ngjan një fjalëkryqi të çuditshëm. Ajo është plot me fjalë që kanë të njëjtën formë (emërtim), por kuptime të ndryshme leksikore. Lind pyetja: si ka mundësi që e njëjta shenjë gjuhësore të nënkuptojë dy gjëra krejtësisht të ndryshme? P.sh., si ka mundësi që fjala *lead* të nënkuptojë një folje që do të thotë *prij*, *udhëheq* dhe, gjithashtu, të emërtojë një metal të rëndë, *plumb*.

Përgjigjja e parë vjen nga fakti se anglishtja është një gjuhë e pushtuar. Ajo ka qenë nën ndikimin e shumë gjuhëve të tjera përgjatë historisë së saj. Fjalë që sot duken të njëjta mund të kenë ardhur nga burime krejtësisht të ndryshme. Disa fjalë mund të kenë filluar nga i njëjti burim, por, gradualisht, kanë fituar nuanca të ndryshme kuptimore midis shekujve XIII dhe XVI.<sup>131</sup>

Me kalimin e shekujve dhe ndërsa njerëz të ndryshëm adaptonin fjalët, mënyra si ata i shqiptonin ato mund të sillte zhvendosje dhe ndryshim të theksit. Një shembull i spikatur është fjala *bear*. Anglishtja është plot me fjalë të tilla që të ngatërrojnë, por që e bëjnë atë një gjuhë të pasur. Më poshtë po japim një listë fjalësh të tilla homonimike në gjuhën angleze:

|  |  |
|--|--|
| <i>angle</i> (kënd/këndvështtrim)        | <i>dash</i> (vizë lidhëse/sulm)            |
| <i>long</i> (i gjatë/dua shumë)          | <i>tap</i> (rubinet/trokitje e lehtë)      |
| <i>ball</i> (top/majë)                   | <i>deck</i> (kuvertë/pako letrash bixhozi) |
| <i>shell</i> (predhë/guackë)             | <i>tick</i> (tik-tak/shenjë v/këpushë)     |
| <i>bank</i> (bangë/breg lumi)            | <i>fast</i> (i shpejtë/agjërim, kreshmë)   |
| <i>mean</i> (do të thotë/mesatare/i keq) | <i>sole</i> (i vetëm/shputë)               |
| <i>bat</i> (shkop/lakuriq nate)          | <i>might</i> (mund/fuqi)                   |
| <i>sound</i> (tingull/shëndoshë)         | <i>till</i> (deri në/kasë)                 |
| <i>bear</i> (ari/mbart)                  | <i>gross</i> (bruto/i madh)                |
| <i>staff</i> (shtab/shtizë)              | <i>tip</i> (majë/cep/këllëf/bakshish)      |
| <i>beef</i> (mish viçi/ankesë)           | <i>knot</i> (nyjë/flongo/komb)             |
| <i>pound</i> (kile/stërlinë)             | <i>stalk</i> (kërcell/bisht)               |
| <i>toll</i> (taksë/kumbim)               | <i>lap</i> (xhiro/prehër)                  |
| <i>race</i> (racë/garë)                  | <i>stall</i> (tezgë/vend parkimi/govatë)   |
| <i>top</i> (majë/të sipërmet)            | <i>bowl</i> (tas/teatër i hapur)           |
| <i>lead</i> (udhëheq/plumb)              | <i>rang</i> (vë unazë/tingëllon)           |
| <i>state</i> (shtet/gjendje)             | <i>box</i> (kuti/sport.boks)               |
| <i>rock</i> (shkëmb/tundem)              | <i>wind</i> (erë/përshtëndes me dorë)      |
| <i>cape</i> (kep/pelerinë)               | <i>light</i> (dritë/e lehtë)               |
| <i>row</i> (rradhë/vozit)                | <i>stick</i> (shkop/ngjit)                 |
| <i>yard</i> (oborr/depo)                 | etj. <sup>132</sup>                        |

### 3.3.3. Rrugët e lindjes së homonimeve në gjuhën angleze

Homonimet në gjuhën angleze u shfaqën për shkak të zhvillimit historik të sistemit të gjuhës, si rezultat i ndryshimeve fonetike, morfologjike, semantike etj.

Në **gjuhën angleze**, karakteri *njërrokësh* dhe *struktura e saj analitike*, ndikojnë dukshëm në zhvillimin e homonimisë. Mbaresat (infleksionet) pothuaj janë zhdukur në anglishten e sotme dhe janë zëvendësuar nga fjalë të veçanta me karakter abstrakt (parafjalë, folje ndihmëse etj.), të cilat vendosin lidhjet që dikur shpreheshin nga mbaresat.<sup>133</sup>

<sup>131</sup> <http://www.myboe.org/portal/default/Resources/Viewer/ResourceViewer?action=2&resid=13873>

<sup>132</sup> Po aty

<sup>133</sup> [http://revolution.allbest.ru/languages/00000517\\_0.html](http://revolution.allbest.ru/languages/00000517_0.html)



Numri i madh i homonimeve lidhet, gjithashtu, me një tipar karakteristik të anglishtes, siç është *identiteti fonetik i fjalës dhe temës së saj*. Është shumë e dukshme që n.q.s. shpeshtësia e përdorimit të fjalëve bie ndesh me gjatësinë e tyre, fjalët njërrrokëshe do të jenë më të shpeshta. Për më tepër, ndërsa fjalët e shpeshta janë, gjithashtu, shumëkuptimshme, është e natyrshme që ato zhvillojnë kuptime, që në rrjedhën kohore largohen nga kuptimi kryesor. Kur lidhjet midis tyre shkëputen plotësisht, disa nga këto kuptime të reja i humbasin të gjitha lidhjet me pjesën tjetër të strukturës dhe dalin si njësi të veçanta leksikore. Dukuria njihet si *shpërbërje e polisemisë*.<sup>134</sup>

Studiuesit përmendin dy procese kryesore që çuan drejt shfaqjes së homonimisë:

1. **homonimi nëpërmjet zhvillimit konvergjent të tingujve, kur dy ose tre fjalë me origjinë të ndryshme, rastësisht përputhen nga ana fonetike.**
2. **homonimi e zhvilluar nga polisemia nëpërmjet zhvillimit divergjent të kuptimeve.**

Të dyja rrugët e lindjes së homonimisë, mund të shoqërohen me dukuri të tilla si: rënia e mbaresave dhe procese të tjera morfologjike.

### 3.3.3.1. Homonimi nëpërmjet zhvillimit konvergjent të tingujve, kur dy ose tri fjalë me origjinë të ndryshme, rastësisht përputhen nga ana fonetike

Zhvillimi konvergjent i tingujve është faktori më i rëndësishëm për krijimin e homonimeve në gjuhën angleze. Shumica e homonimeve krijohen si rezultat i zhvillimit konvergjent të tingujve, i cili bën që të përputhen nga ana fonetike dy ose më shumë fjalë, të cilat kohë më parë, ishin fonetikisht të ndryshme.

Në anglishten e vjetër fjalët *\*gesund* “i shëndetshëm” dhe *\*sund* “not (lloj sporti)” ishin fjalë krejt të ndryshme në formë dhe kuptim. Me kalimin e kohës, këto fjalë ndryshuan kuptimin dhe formën e tyre fonetike. Format e tyre të mëvonshme rastësisht u përputhën: ang. vjet. *\*sund* > ang. mod. *sound* “ngushticë”; ang. vjet. *\*gesund* > ang. mod. *sound* “i shëndetshëm”. Këtij grupi iu bashkua, gjithashtu rastësisht, emri *sound* “tingull” së bashku me foljen korresponduese, që erdhën nga frëngjishtja dhe latinishtja *sonus*, dhe folja *sound* “të matësh thellësinë”. Përputhja është e gjitha rastësore.

Dy folje të ndryshme latine: *cadere* “bie, rrëzohem” dhe *capere* “mbaj” janë burimet përkatëse të homonimeve *case I* “rast që ndodh” dhe *case II* “një kuti”. Në qoftë se i referohemi origjinës së fjalëve, vëmë re se, *case I* < frëngj. vjet. *\*cas* < lat. *casus* “bie, rrëzohem” dhe *case II* < frëngj. vjet. e veriut *\*casse* < lat. *capsa*. Homonimia në këtë rast është shumë e qartë. Shembuj të tjerë të këtij lloji janë: *sea* “det” (ang. vjet. *\*sæ*) :: *see* “shikoj” (ang. vjet. *\*seon*); *meat* “mish” (ang. vjet. *\*mete*) :: *meet* “takoj” (ang. vjet. *\*metan*); *eye* “sy” (ang. vjet. *\*eage*) :: *I* “unë” (ang. vjet. *\*ie*); *son* “bir” (ang. vjet. *\*sunu*) :: *sun* “diel” (ang. vjet. *\*sunne, sunna*); *love* em. “dashuri” (ang. vjet. *\*lufu*) :: *love*, fol. “dua, dashuroj” (ang. vjet. *\*lufian*); *answer*, em. “përgjigje” (ang. vjet. *\*andswaru*) :: *answer*, fol. “përgjigjem” (ang. vjet.

<sup>134</sup> Po aty

*\*andswarian*); *work*, em. “punë” (ang. vjet. *\*weore*) :: *work*, fol. (ang. vjet. *\*wyrca*).<sup>135</sup>

Siç dihet, ndryshimet fonetike rezultojnë me ndryshime në sistemin morfologjik të gjuhës angleze, dhe veçanërisht në thjeshtëzimin e fjalës dhe në humbjen e mbaresave. Këto procese çuan në identitetin fonetik të shumë fjalëve, të cilat, më parë, kishin strukturë të ndryshme morfologjike: *love*, em. “dashuri” (në anglishten e vjetër *\*lufu*) dhe *love*, fol. “dua, dashuroj” (në anglishten e vjetër *\*lufian*); *answer*, em. “përgjigje” (në anglishten e vjetër *\*andswaru*) dhe *answer*, fol. “përgjigjem” (në anglishten e vjetër *\*andswarian*); *work*, em. “punë” (në anglishten e vjetër *\*weorc*) dhe *work* fol. “punoj” (në anglishten e vjetër *\*wyrca*); *warm*, mb. “i ngrohtë” (në anglishten e vjetër *\*wearm*) dhe *warm*, fol. “ngroh” (në anglishten e vjetër *\*werman*) dhe shumë raste të tjera. Këto ndryshime të shpeshta fonetike çojnë drejt faktit që homonimet, të cilat u shfaqën si rezultat i zhvillimit konvergjent të tingujve në gjuhën angleze janë të shumta. Huazimet e shumta nga gjuhë të tjera, kryesisht nga gjuhë të Romantizmit, si gjuha latine dhe ajo frënge, ndikuan në homonimi, pasi ato u ishin nënshtruar ndryshimeve fonetike. Për shembull, *rite*, em “rit”:: *to write* fol. “shkruaj”:: *right* mb. “e drejtë”, fjala e dytë dhe e tretë janë më origjinë vendase, ndërsa fjala *rite* është e huazuar nga gjuha latine (lat. *ritus*); *bank* em. “breg” është fjalë vendase dhe *bank*, em. “bangë, institucion financiar” është e huazuar nga gjuha italiane; *match*, em. “lojë” është fjalë vendase dhe *match*, em. “shkrepse” është e huazuar nga gjuha frënge<sup>136</sup>.

Po sjellim edhe një shembull tjetër, të cilin po e ilustruam për ta bërë më të qartë këtë çështje. Në figurën e mëposhtme shohim se si ka ndodhur në kohë (diakronikisht) përputhja fonetike të fjala e gjuhës angleze [meil].




Fig. 3.3. Përputhja fonetike e [meil]<sup>137</sup>

### 3.3.3.2. Homonimi e zhvilluar nga polisemia nëpërmjet zhvillimit divergjent të kuptimeve

Zhvillimi divergjent i kuptimeve vihet re kur kuptime të ndryshme të së njëjtës fjalë largohen aq shumë nga njëra-tjetra, sa që vjen momenti kur ato shihen si dy njësi

<sup>135</sup> Stefanllari, I. *A Course in English Lexicology*, GEER, Tiranë, 2011, f. 100 – 101.

<sup>136</sup> Po aty f. 100 – 101.

<sup>137</sup> Ullman, S. *An introduction to the Science of Meaning*, Oxford Basil Blackwell, 1962, f. 176.

të veçanta leksikore. Homonime të tilla, pjesërisht mund të burojnë nga njëra-tjetra, por pika e tyre e përbashkët e origjinës shtrihet përtej kufijve të anglishtes. Me shfaqjen e një kuptimi të ri, shumë të ndryshëm nga i mëparshmi, struktura semantike e fjalës burimore shpërbëhet. Kuptimi i ri fiton një ekzistencë të re dhe një strukturë të re semantike të tijën. E gjithë kjo lidhet me zberthimin ose *shpërbërjen e polisemisë* në gjuhën angleze.

Homonimet e grupit *box* kanë lindur nga shpërbërja e polisemisë dhe janë të lidhura nga pikëpamja etimologjike. Forma e tyre e njëjtë nuk është rastësore, por bazohet në lidhjen gjenetike. Ato të gjitha burojnë nga njëra-tjetra dhe e kanë origjinën te fjala latine *buxus*. Fjalori i anglishtes “The Concise Oxford Dictionary” ka pesë fjalë tituj (entry) për *box*<sup>138</sup>:

*box I* n. “a kind of small evergreen shrub” (em. “një lloj kaçube e vogël me gjelbërim të përhershëm”);

*box II* n. “receptacle made of wood, cardboard, metal, etc. and usually provided with a lid” (em. “depozitë, enë prej druri, kartoni, metali etj. dhe zakonisht është me kapak”);

*box III* v. “to put into a box” (fol. “vendos në kuti”);

*box IV* n. “slap with the hand on the ear” (em. “shuplakë me dorë mbi vesh”);

*box V* v. “a sport term meaning ‘to fight with fists in padded gloves’” (fol. një term sportiv që do të thotë “të luftosh me grushta me doreza boksi”).

Në disa raste, ato ndryshojnë aq shumë nga fjala që burojnë, sa dalin me të njëjtën përbërje tingullore. Për shembull, fjalët *flower* dhe *flour* e kanë origjinën e tyre nga e njëjta fjalë e anglishtes së periudhës së mesme dhe të vjetër *flour*, *\*flur*.

Kalimin nga polisemia në homonimi mund ta paraqitim me skemën e mëposhtme:




Fig. 3. 4. Shpërbërja e polisemisë të fjala *\*flur* ang. vjet / *flour* ang. mes.

<sup>138</sup> *The Concise Oxford Dictionary*, 12-th ed., Oxford University Press, 2011.

Megjithatë, duhet theksuar se, pavarësisht nga numri i madh i shembujve që rezultojnë nga ky proces, është e vështirë të vendoset një kriter të qartë sipas të cilit mund të analizohet shpërbërja e polisemisë. I gjithë koncepti bazohet në pohimin se a ka ndonjë lidhje midis kuptimeve apo jo. Përgjigjja është shumë subjektive dhe e pasaktë. Në shembujt e përputhjes (konvergjencës) fonetike u përmend se *case I* dhe *case II* janë fjalë të ndryshme sepse ndryshojnë në origjinë dhe u ndoq një kriter gjuhësor i përcaktuar. Ndërsa në rastin e shpërbërjes së polisemisë nuk ka një kriter që të na prijë; ne mund të bazohemi vetëm tek intuita dhe eksperiencia gjuhësore individuale.

Është interesante të theksohet se nga rreth 2540 homonime<sup>139</sup>, vetëm 7 % kanë lindur nga shpërbërja e polisemisë, gjithë të tjerat janë të ndryshme etimologjikisht. Prania e kriterit etimologjik vihet re në përgjithësi në fjalorë shpjegues të anglishtes, ku fjalët ndahen sipas origjinës së tyre. P.sh. *match I* “shkrepëse” (nga frëngj. vjet. \**mesche*, frëngj. *mèche*) dhe *match II* (nga angl. vjet. \**gemacca* “shok, mik”), etj.

### 3.3.3.3. Fjalëformimi është rruga e tretë e lindjes së homonimeve në gjuhën angleze

Në të shumtën e rasteve, kjo rrugë trajtohet e kombinuar me dy të parat. Këtu homonimet lindin nën ndikimin e dy mënyrave fjalëformuese:

- a. konversionit
- b. prejardhjes

a. **Konversioni** është një mënyrë fjalëformimi shumë prodhuese në gjuhën angleze. Me anë të tij formohet *patterned homonymy*. Aktualisht, homonimia e emrave dhe foljeve, si rezultat i proceseve të humbjes së mbaresave nga njëra anë dhe konversionit nga ana tjetër, është një nga tiparet më të rëndësishme të anglishtes së sotme. Si rezultat, shumë emra dhe folje dalin me të njëjtën formë p.sh., *code* “kod” dhe *(to) code* “kodoj”; *drink* “pije” dhe *(to) drink* “pi”; *work* “punë” dhe *(to) work* “punoj”; *mouth* “gojë” dhe *(to) mouth* “shqiptoj” etj. Kjo mund të kombinohet edhe me ndryshime semantike, si p.sh., në çiftet e fjalëve *long* mb. dhe *long* fol. Pra (*long* mb. < angl. vjet. \**lang*, *long* fol. < angl. vjet. \**langian*).<sup>140</sup>

Vihet re se fjalorët shpjegues të anglishtes nuk i vendosin si fjalë më vete homonimet që lindin nga konversioni.

b. Procesi i fjalëformimit me anë të **prejardhjes**, gjithashtu, mund të çojë në homonimi. Ky proces ndodh si rezultat i fjalëformimit me të njëjtën ndajshitesë. P.sh., prapashtesa *-er* formon fjalë të ndryshme nga e njëjta temë: *trail – trailer<sub>I</sub>* “bimë zvarranike” dhe *trailer II* “rimorkio”. Prapashtesa *-s* i shtohet temës homonimike *arm* dhe formon *arms* em. “armë zjarri” dhe *arms* fol. “armatos”.

<sup>139</sup> Hornby, S. A. *Oxford Advanced Learner’s Dictionary*, International Student’s Edition, Oxford University Press, 2000.

<sup>140</sup> [http://revolution.allbest.ru/languages/00000517\\_0.html](http://revolution.allbest.ru/languages/00000517_0.html)

Duke e përmbyllur këtë analizë diakronike të homonimisë në gjuhën angleze, duhet theksuar se ka dy rrugë nga të cilat vijnë homonimet, përkatësisht zhvillimi konvergjent i formës tingullore (përputhja tingullore) dhe zhvillimi divergjent i kuptimit (siç paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme).

Rruga e parë përmbledhet në:

- vetëm ndryshim fonetik;
- ndryshim fonetik i kombinuar me humbjen e mbaresave;
- formim të pavarur nga baza homonimike me anë të ndajshesave homonimike.

Rruga e dytë karakterizohet nga:

- kushtëzohet brenda një klase leksiko-gramatikore;
- kombinohet me ndryshim të klasës leksiko-gramatikore dhe ndryshim të funksioneve gramatikore dhe shpërndarjes;
- bazohet në formim të pavarur nga e njëjta bazë nga morfema homonimike.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur origjinën e homonimeve në gjuhën angleze.

**Tabela 3.1. Origjina e homonimeve** <sup>141</sup>

|  |   |   |
|--|---|---|
| E pavarur nga ndryshimet Morfologjike  | <p>ang.vjet.*<i>gemæn</i> ——— “i përgjithshëm”</p> <p>lat. <i>medianus</i> ——— <i>mean</i> ——— “mesatar”</p> <p>ang.vjet.*<i>mænan</i> ——— “mendoj”</p> | <p><i>chest</i> “kuti e madhe”</p> <p>ang.vjet. *<i>cest</i></p> <p><i>chest</i> “kraharor”</p>   |
| E kombinuar me ndryshime morfologjike. | <p>ang.vjet.*<i>lufu</i> em. “dashuri”</p> <p>————— <i>love</i> em., fol. “dashuri, dua”</p> <p>ang.vjet.*<i>lufjan</i> fol. “dua”</p>                  | <p><i>wait</i> fol. “pres”</p> <p>ang. mes. <i>waiten</i> fol.</p> <p><i>wait</i> em. “pritje”</p> <p><i>silence</i> em. “pritje”</p> <p>lat. <i>silentium</i> em.</p> <p><i>silence</i> fol.”pres”</p> |

<sup>141</sup> Lyons, J. *Semantics I*, Cambridge University Press, 1977, f. 217.

Procesi ndonjëherë mund të jetë më i ndërlikuar. Folja *stick* e zhvilluar si një përzjerje e *stiken* ang. mes. < \**stician* ang. vjet. < *sticca* ‘peg’ dhe *steken* ang. mes. e cila buron nga *stigma* gr. Në ditët tona ka të paktën dy homonime *stick* fol. “të futësh majën në” dhe *stick* em. “shkop, kallam”.

Me kohë vihet re që numri i homonimeve në përgjithësi është rritur.

### 3.4. Ndikimi i homonimisë në gjuhën shqipe dhe atë angleze

Në zhvillimin aktual të gjuhës letrare shqipe e angleze, homonime të reja mund të lindin gjatë fjalëformimit, nga përputhja fonetike e fjalëve, nga huazimi i fjalëve të ndryshme, nga prurjet e dialekteve dhe, së fundi, në raste të veçanta, homonimia lind për shkak të largimit të madh të kuptimeve të po asaj fjale, pra nga shpërbërja e polisemisë.

Të gjitha këto rrugë, jo rrallë, shpjen në lindjen e pashmangshme të homonimisë ndërmjet fjalëve të ndryshme dhe atëherë ajo bëhet një fakt objektiv në gjuhë. Si e tillë, ajo hyn në marrëdhënie me faktet e tjera të gjuhës dhe mund të lërë gjurmë në zhvillimin e tyre, duke i dhënë asaj një drejtim tjetër. Në të gjitha këto raste flasim për *ndikimin e homonimisë në gjuhë*.<sup>142</sup>

Dy ose më shumë fjalë, që përfundojnë si homonime, ka raste që sjellin vështirësi në komunikim. Duke patur të njëjtën trajtë fonetike, ndërsa shënojnë sende e nocione krejt të ndryshme, ato prishjnë kthjelltësinë e mendimeve. Gjuha ka prirje që t’i mënjanojë ndeshjet homonimike, në mënyrë që kuptimi të kapet prej të gjithëve me përpikmëri e qartësi. Vetvetiu fillon edhe *kundërveprimi i gjuhës për të shmangur homoniminë*.<sup>143</sup> Kjo shmangie e homonimisë arrihet me rrugë të ndryshme:

#### 3.4.1. Bie nga përdorimi një homonim dhe zëvendësohet me një fjalë tjetër<sup>144</sup>

Në **gjuhën shqipe** të folur, sot më shpesh përdoret *ilaç* në vend të *bar II*. Kjo ndodh për shkak të homonimisë që krijohet ndërmjet *bar II* “ilaç” dhe *bar I* “bimë e blertë e njomë...”

Në shqipe kjo rrugë është më e zakonshme në ligjërimin dialektor. Në krahinën e Korçës, ku *drejt* shqiptohet *dreq*, përdoret *djall* për *dreq*, sepse kjo e fundit do të krijonte homonimi me të parën. Po ashtu, për shkak të shqiptimit të tingullit *rr* pothuaj njëlloj me *r*, fjala *arrë* “pemë me kokrra” shqiptohet *arë* “tokë që lërohet e mbillet, tokë buke”. Fjala *arrë* zëvendësohet me *kaçkë* për të shmangur homoniminë.<sup>145</sup>

<sup>142</sup> Lloshi, Xh. “Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe”, *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Mihal Duri, Tiranë, 1972, f. 227.

<sup>143</sup> Po aty

<sup>144</sup> Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë, 1999, f. 51.

<sup>145</sup> Po aty

Në gjuhën angleze, kur një homonim bie nga përdorimi, ai zëvendësohet nga një fjalë tjetër që mund të vijë nga vetë anglishtja/dialektet, mund të jetë e huazuar ose të krijohej e re. P.sh., në anglishten e folur, sot më shpesh përdoret *prostitute* (em.) në vend të *quean* për shkak të homonimisë që krijohet midis *queen* [kwi: n] “mbretëreshë” dhe *quean* [kwi: n] “grua me emër të keq, prostitutë”. Fjala zëvendësuese *prostitute* (lat. *prostituta*) është e huazuar.

### 3.4.2. Një rrugë tjetër për shmangien e homonimisë në të dyja gjuhët është shfrytëzimi i trajtave gramatikore, si rezultat, ndryshimi i pjesshëm i njëjës prej fjalëve homonimike.<sup>146</sup>

Në shqip kemi *trup*, - i “pjesë kryesore e qenieve a e bimëve, që mban organe, gjymtyrë, degë etj.” dhe *trupë*, -a “njësi ushtarake”; *rrjetë*, - a “një thurje prej filli që përdoret për të zënë peshk, në lodra sportive me dorë dhe në punë të tjera” dhe *rrjet*, - i “tërësia e kanaleve, e hekurudhave, e udhëve etj. të një vendi; tërësia e njësisive të një veprimtarie”; *rregull*, - i “të qenët e çdo sendi në vend të vet, aty ku duhet dhe ashtu si duhet të jetë” dhe *rregull*, - a “normë ku pasqyrohet një raport i përhershëm ndërmjet dukurive”, etj.<sup>147</sup>

Në anglisht, rritja e vazhdueshme e numrit të homonimeve sjell keqkuptime në komunikim. Si rezultat, gjatë procesit të përkthimit ose mësimdhënies së saj si një gjuhë e huaj, fillimisht, synohet që të shmangjet homonimia. Mënjanimi i homonimeve leksiko - gramatikore bazohet në kriterin morfologjik, n.q.s. forma e fjalës ka një mbaresë tipike për një klasë dhe të pamundur për të tjera, atëherë klasa e kësaj fjale është përcaktuar. P.sh., *laughed* është një folje, sepse emri *laugh* nuk do të pranonte asnjëherë mbaresën - *ed*. Nga dy homonimet *complete* (fol.) dhe *complete* (mb.) vetëm folja mund të marrë mbaresa të tilla si: - *s*, - *ed*, - *ing* etj.

---

<sup>146</sup> Po aty

<sup>147</sup> Po aty

## KAPITULLI IV

### POLISEMIA DHE HOMONIMIA NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE

#### 4.1. Shkallëzimi i prejardhjes semantike

Gjuha është në lëvizje të pandërprerë, sidomos në aspektin semantik. Në këtë mënyrë zhvillohet polisemantizmi, i cili çon drejt homonimisë, por pa mbërritur gjithmonë atje<sup>148</sup>.

Në gjuhën shqipe dukuria e krijimit të shumë homonimeve nga *shpërbërja e polisemisë* është pranuar që në tekstin “Leksikologjia shqipe për shkollat e larta” (1961). Aty është thënë se homonimet shpeshherë na duken si shkalla më e lartë e polisemisë. Kjo shpjegohet, se një nga burimet e homonimeve është polisemia. Derisa kuptimet e ndryshme të një fjale ruajnë diçka të përbashkët në mes tyre, një farë lidhje kuptimi, ato grupohen nën një fjalë dhe kemi të bëjmë me poliseminë. Por, kur një kuptim ndahet nga kuptimi kryesor i fjalës dhe humbet lidhjet me të, atëherë kemi të bëjmë me homonime.<sup>149</sup>

Duke e quajtur homoniminë si shkallën më të lartë të polisemisë, është pranuar një shkallëzim i caktuar i prejardhjes semantike, i cili nënkupton edhe shkallë të tjera të kësaj prejardhjeje më të ulëta se kjo.

Pesë njësitë kryesore të semantikës janë: *përbërësi i kuptimit*, njësia më e vogël kuptimore; *nuanca kuptimore*, varianti kuptimor brenda të njëjtit kuptim; *kuptimi leksikor*, njësia themelore e semantikës; *nyja semantike*, elementi thelbësor që lidh kuptimet e një blloku; *struktura kuptimore*, njësia më e madhe e semantikës që përfshin të gjitha kuptimet leksikore të fjalës. Në varësi të rendit që këto njësi kuptimore lidhen me njëra-tjetrën, mund të nxjerrim edhe përfundime në lidhje me shkallëzimin e prejardhjes kuptimore, të cilën studiuesi Jani Thomai e paraqet si më poshtë<sup>150</sup>:

Shkalla e parë e kësaj lëvizjeje semantike, është lindja e një përbërësi të ri brenda të njëjtit kuptim leksikor. Në këtë shkallë, ndryshimi semantik duhet kuptuar si pasurim, si zgjerim i kuptimit, si rritje e vëllimit të tij e në këtë masë edhe si ndryshim i cilësisë së tij. Kuptimi në këtë rast bëhet më i përcaktuar, më i përpiktë, specializohet e lidhet më drejtpërdrejt me realien përkatëse.

Shkalla e dytë e prejardhjes semantike është lindja e një nuance të re kuptimore. Nuancë e re kuptimore lind kur kuptimit leksikor i shtohen ose i ndryshohen më shumë se një përbërës semantik, po jo shumica dhe as përbërësi semantik themelor.

Shkalla e tretë e lëvizjes semantike është lindja e një kuptimi të ri leksikor. Ndryshimi në këtë shkallë shoqërohet me shndërrime të rëndësishme, cilësore, pasi kalojmë nga një njësi semantike në një tjetër, kapërcehen kufijtë e një kuptimi leksikor. Pra me pak fjalë gjatë prejardhjes kuptimore lind një kuptim i ri, pra kalohet në një njësi të re semantike.

<sup>148</sup> Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1989, f. 168.

<sup>149</sup> Thomai, J. *Leksikologjia shqipe për shkollat e larta*, Tiranë, 1961.

<sup>150</sup> Po aty f. 228 – 231.



Shkalla e katërt e lëvizjes semantike është formimi i një blloku të ri kuptimesh me një nyjë të re semantike. Formimi i bllokut të ri të kuptimeve sipas një nyje semantike, tregon për zgjerimin e përmbajtjes leksikore të fjalës, sidomos të fjalës me strukturë semantike të gjerë.

Këto blloqe semantike kushtëzohen si nga pikënisja semantike e prejardhjes, ashtu edhe nga drejtimi që merr prejardhja.<sup>151</sup> Nga hallka në hallkë zgjerohet vëllimi, po njëkohësisht rritet edhe shkalla e abstraktimit. Hallkat jo vetëm që lidhen ndërmjet tyre, por edhe integrohen njëra te tjetra, sikurse përbërësit semantikë të kuptimit leksikor ose kuptimet leksikore te struktura kuptimore e fjalës.

Shkalla e pestë e lëvizjes semantike është shpërbërja e polisemisë dhe krijimi i homonimeve (nga shkëputja më vete e një kuptimi leksikor ose e një nyje semantike). Kjo është shkalla më e lartë e zhvillimit të polisemantizmit, në kuptimin e diferencimit semantik. Ky diferencim semantik maksimal, siç e kemi thënë, i ndërpret fare lidhjet e kuptimit që shkëputet nga kuptimet e tjera e, sidomos, nga kuptimi kryesor, dmth, në strukturën e tij nuk ka pothuaj asnjë nga elementët semantikë që u takojnë kuptimeve të mëparshme dhe, anasjelltas, ka elemente semantikë, nga të cilat pothuaj asnjë nuk e gjejmë në kuptimet e tjera. Siç shihet, si ndryshimet sasiore, ashtu edhe ato cilësore, janë maksimale, gjë që na çon në njësi leksikore të ndryshme homonimike.

Duke analizuar këtë rrugë të zhvillimit kuptimor dhe me këtë shkallëzim të ndryshimeve semantike e të njësisë semantike, del qartë vendi i homonimisë në lidhje me poliseminë e me prejardhjen semantike.

Shprehje e lëvizjeve në gjuhë është si lindja e homonimeve me rrugë të ndryshme, ashtu edhe çdo ndryshim në kuptimet, të cilat mund të çojnë, gjithashtu, deri në homonimi.

Nga sa vihet re më lart, zgjerimi i strukturës semantike çon drejt polisemantizmit. Është e vështirë të flasësh në gjuhë për ekzistencën e fjalëve me një kuptim të vetëm. Ato përbëjnë raste shumë të rralla. Struktura kuptimore e fjalëve, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë angleze, ndryshon dhe zgjerohet në një numër të gjerë kuptimesh. Ka raste kur lindja e kuptimeve të reja shtyn kuptimet e vjetra në skajin e strukturës, duke e tendosur aq shumë fillin semantik që i mban këto kuptime të lidhura, sa që këto të fundit gradualisht fillojnë të shkëputen, duke krijuar kështu një njësi të re leksikore.

Ky proces, i cili njihet si *shpërbërja e polisemisë* është një nga rrugët e krijimit të homonimeve në të dyja gjuhët. Gjuha është në lëvizje të pandërprerë, sidomos struktura semantike e saj. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që çdo zgjerim kuptimor domosdoshmërisht përfundon me lindjen e homonimeve. Pranimi i homonimisë të lindur me këtë rrugë është relativisht i ri krahasuar me rrugët e tjera, dhe është pranuar nga shumë autorë të njohur, si O. Xhespërsen-i (O. Jespersen), L. Bllumfilld-i (L. Bloomfield), Sh. Belli (Sh. Bally), R. Godëll-i (R. Godel), V. Shmit-i (V. Schmidt), V. V. Vinëgreidof-i (V. V. Vinogradov) etj. Përkundrejt kësaj pikëpamjeje, ka dijetarë, si S. Ullmen-i (S. Ullman), P. Gairo (P. Guiraud) etj., që

---

<sup>151</sup> [Thomai, J. *Tiparet themelore të derivacionit semantik në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, 3, Tiranë, 1981.] Cituar sipas Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1989, f. 230.

pranojnë vetëm homonimet e formuara prej rrënjësh të ndryshme, që janë përputhur fonetikisht gjatë zhvillimit historik të gjuhës, kurse rastet e përputhjeve të tjera homofonike i shohin si shfaqje të polisemisë.<sup>152</sup>

#### 4.2. Polisemia dhe homonimia një labirint konceptual

Studimi i homonimisë në një gjuhë shpesh është shoqëruar me studimin e polisemisë sepse dallimi midis të dyjave ndodh të mos jetë shumë i qartë. Në një copëz teksti, ndodh të ndeshemi me një grup fjalësh, të cilat mund të na duken si fjalë homonimike ose polisemantike. Duke pasur parasysh që të dyja llojet e fjalëve janë shpesh të ngjashme në formën e shkruar, pa asnjë shenje të veçantë dalluese, lehtësisht mund të keqdrejtohem për të hamendësuar nëse kemi të bëjmë me homonime që duken si fjalë polisemantike ose e kundërta. Megjithatë, del si domosdoshmëri përcaktimi i një kufiri të qartë midis të dyjave, sepse këto forma ndryshojnë nga njëra-tjetra jo vetëm për nga natyra, por, gjithashtu, në funksion dhe në atë që nënkuptojnë. Në këtë pjesë të studimit është bërë përpjekje për të identifikur çelësat dhe strategjitë që mund të përdoren për të bërë të qarta ndryshimet midis dy llojeve të fjalëve. Duke qenë se nuk ka një proces të përcaktuar për të bërë këtë gjë, ne duhet të përdorim njohurinë tradicionale nga gjuhësia, semantika dhe shkencat njohëse (konjitive). Ndërmarrja e një dallimi të përcaktuar midis të dy llojeve të fjalëve përbën një kusht paraprak për zhvillimin e mjeteve, sistemeve dhe burimeve për zhvillimin natyral të gjuhës, funksionimin e saj, paqartësinë e kuptimit të fjalës, procesin e përkthimit, procesin e të nxënimit (të mësuarit), gjuhësinë njohëse (kognitive) dhe gjuhësinë e aplikuar.

Përpjekje janë bërë për të kuptuar poliseminë, për të eksploruar natyrën e homonimisë dhe lidhjen e tyre konceptuale, mungesa e së cilës mund të gjymtojë një studiu në inisiativën e ndërmarrë drejt paqartësisë së kuptimit të fjalës.

Vitet e fundit, shumëkuptimësia e fjalëve në një gjuhë natyrale është diskutuar gjerësisht në semantikë, gjuhësinë e aplikuar, letërsi dhe në inteligjencën artificiale. Duke ndjekur këtë tendencë, studimi i homonimisë dhe polisemisë ka tërhequr vëmendje të veçantë në semantikën leksikore [Ullman; Kruz (Cruse); Palmër (Palmer); Nida (Nida)], gjuhësinë njohëse (konjitive) [Kaikens (Cuyckens) dhe Zauada (Zawada); Din (Deane)], gjuhësinë kompjuterike [Ravin (Ravin) dhe Likok (Leacock)], analizën e ligjëritimit [Liç (Leech); Kaidilër (Kreidler)], mësimdhënien e gjuhës [Tod (Todd)], në psikolinguistikë [Pinkër (Pinker); Gibs (Gibbs)], në stilistikë

---

<sup>152</sup> [Jespersen, O. *Monosyllabism in English*, British Academy, London, 1928; Bloomfield, L. *Language*, London, 1933; Bally, Ch. *Traité de stylistique française*, Georg, Genève, 1937; Godel, R. "Homonymie et identité", *Cahiers de F. De Saussure*, VII, 1948; Schmidt, W. *Deutsche Sprachkunde*, Berlin: Volk u. Wissen, 1959; Vinogradov, V. V. *O formax slova*, Izveslija Akademii Nauk SSSR, Otdelenije literatury I jazyka, tom. III, vypusk I, 1944; Ullman, S. *The Principles of Semantics*, Glasgow, 1951; Guiraud, P. *La sémantique*, Press Universitaires De France, Paris, 1955.] Cituar sipas Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 218.

[Lajëns; Ellën (Allan)] gjuhë dhe letërsi [Fërth (Firth); Jul (Yule); Cruse] dhe në shumë fusha të tjera.<sup>153</sup>

Informacioni i përfutur nga analiza e mjaft njësive leksikore shumëkuptimëshe ka sjellë një kontribut me vlerë në të kuptuarit e natyrës dhe procesit të njohjes e përvetësimit të gjuhës. Në këtë këndvështrim, shtrohet kërkesa e menjëhershme për të shqyrtuar lidhjen midis homonimisë dhe polisemisë me pritshmërinë që informacioni i përfutur nga kjo pjesë e studimit të ndihmojë për t'u futur në brendësi të dukurisë dhe kapërcimin e pengesave që vijnë nga paqartësia e fjalëve.

Çfarë është polisemia? Në polisemi një fjalë e caktuar manifeston shumëllojshmëri të kuptimit në varësi të kontekstit ku përdoret.<sup>154</sup> Ndërsa studiohet polisemia në një gjuhë, vihet re që shumëllojshmëria e kuptimit të fjalëve është një tipar karakteristik i përgjithshëm i një gjuhe.<sup>155</sup> Pothuajse të gjitha gjuhët natyrale kanë një grup fjalësh që janë të afta të përmbajnë shumëllojshmëri objektësh, idesh dhe kuptimesh në situata që varen nga konteksti ose jo. Ky tipar i veçantë i fjalëve, i lejon një përdoruesi të sjellë (në përdorim) më tepër se një kuptim, i cili mund të ndryshojë për sa i përket tiparit leksikor, morfo-sintaksor, tiparit nënkategorizues, tiparit seleksionues leksikor, tiparit semantik, përdorimit idiomatik, përdorimit proverbial dhe figurative.<sup>156</sup>

Ndërsa në rastin e homonimisë, kuptime të ndryshme të palidhura ndahen nën të njëjtën sipërfaqe të njëjtë të formës së fjalëve.<sup>157</sup> Fjalë të tilla shpesh manifestojnë forma të njëjta ortografike, por janë të ndryshme në kuptim. Një referencë e shpejtë e kuptimeve respektive dhe etimologjisë së formave ndihmon për të identifikuar shumë lehtë homonimet në një tekst. Homonimia, në përgjithësi, shprehet në dy mënyra: homografe (forma tingullore të njëjta dhe kuptime të ndryshme) dhe homofone (forma tingullore të ndryshme dhe shqiptime të njëjta). Ashtu si fjalët polisemantike, fjalët

---

<sup>153</sup> [Ullman, S. *Semantics: An Introduction to the Science of Meaning*, Oxford, Blackwell, 1962; Cruse, A.D. *Lexical Semantics*, Cambridge University Press, 1986; Palmer, F. R. *Semantics*, CUP, Cambridge, 1995; Nida, E. A. *The molecular level of lexical semantics*. Te, *International Journal of Lexicography*, 10(4): 265-274, 1997; Cuyckens, H. dhe Zawada, B. (eds.) *Polysemy in Cognitive Linguistics*, John Benjamins, Amsterdam, 2001; Deane, P. *Polysemy and cognition*, *Lingua*, 75(2):325-361, 1988; Ravin, Y. dhe Leacock, C. *Polysemy: An overview* te Ravin, Y. dhe Leacock, C (eds.) *Polysemy: Theoretical and Computational Approaches*, OUP Inc., New York, 2000; Leech, G. *Semantics*, London, Penguin, 1974; Kreidler, Ch.W. *Introducing English Semantics*, Routledge, London, 1998; Todd, L. *An Introduction to Linguistics*, Longman York Press, Essex, 1987; Pinker, S. Steven S Pinker. 1995 *The Language Instinct: The New Science of Language and Mind*, Penguin, London, 1995; Gibbs, R. W.; Beitel, D. J.; Harrington, M dhe Sanders, P. 1994. *Taking a stand on the meanings of 'stand': bodily experience as motivation for polysemy*, *Journal of Semantics*, 11(2): 231-251, 1994; Lyons. J. *Structural Semantics*, Cambridge University Press, 1963; Allan, K. *Natural Language Semantics*, Blackwell, Oxford, 2001; Firth, J. R. *Modes of meaning*, *Linguistics* 1934-1951, OUP, Oxford, 1957; Yule G. *The Study of Language: An Introduction*, CUP, Cambridge, 1985; Cruse, A. *Meaning in Language: An Introduction to Semantics and Pragmatics*, Oxford University Press, Oxford, 2000] Cituar sipas Dash, N.S.

[http://www.academia.edu/919591/Polysemy\\_and\\_Homonymy\\_A\\_Conceptual\\_Labyrinth](http://www.academia.edu/919591/Polysemy_and_Homonymy_A_Conceptual_Labyrinth)

<sup>154</sup> [Fellbaum, Ch. D. *Autotroponymy*. Te, Yael Ravin, Y.; Leacock, C. *Polysemy: Theoretical and Computational Approaches*, New York, Oxford University Press Inc., f. 52-67, 2000] Cituar po aty.

<sup>155</sup> [Frank R. Palmer. F. R. *Semantics*, CUP, Cambridge, 1995] Cituar po aty.

<sup>156</sup> [Sinclair. J. M. *Corpus, Concordance, Collocation*, Oxford University Press, Oxford, 1991.] Cituar po aty.

<sup>157</sup> [Fellbaum, Ch. D. *Autotroponymy*. Te, Yael Ravin, Y.; Leacock, C. *Polysemy: Theoretical and Computational Approaches*, New York, Oxford University Press Inc., f. 52, 2000] Cituar po aty.

homonimike, gjithashtu konsiderohen të paqarta për shkak të arsyeve të lartpërmendura.<sup>158</sup>

#### 4.2.1. Lidhja polisemi - homonimi

Gjuhëtari L. Lipka (L. Lipka) njeh katër mundësi për vendosjen e raporteve paradigmatiche ndërmjet kuptimeve të shenjave gjuhësore<sup>159</sup>:

a. Shënuesit, format fonologjike dhe grafemike janë të njëjta, por të shenjuarit, kuptimet, janë të ndryshme dhe nuk kanë kurrfarë lidhje me njëri-tjetrin. Në këtë rast, shenjat gjuhësore, leksemat, emërtohen si homonime dhe marrëdhënia ndërmjet tyre, si *homonimi*.

Në rastin kur kemi përafërsi kuptimesh, mund të themi se kemi të bëjmë me polisemi, por dallimin ndërmjet tyre do ta shohim më tej.

b. Shenjuesit janë të ndryshëm, por të shenjuarit janë pothuajse të njëjtë. Në këtë rast kemi të bëjmë me *sinonimi*.

c. Për vendosjen e raporteve paradigmatiche ndërmjet varianteve kuptimore, një mundësi tjetër është kur të shenjuarit dhe shenjuesi janë të ndryshëm. Sipas përmbajtjes së këtyre shenjave mund të kemi marrëdhënie të ndryshme ndërmjet tyre. Kur flasim për një marrëdhënie kontrasti, kemi të bëjmë me *antonimi*.

d. Rasti i katërt është kur diskutohet për një marrëdhënie hierarkike ndërmjet varianteve kuptimore. Në këtë rast kemi të bëjmë me *hiponimi*.

Vetëm tri tipet e fundit të raporteve paradigmatiche janë marrëdhënie kuptimore ndërmjet *njësive leksikore*.<sup>160</sup> Në rastin e homonimisë, nuk kemi të bëjmë me raporte kuptimore ndërmjet shenjave apo njësive leksikore, sepse këtu kemi vetëm një *leksemë*. Është e pamundur të flasim për raporte paradigmatiche kur bëhet fjalë për një leksemë të vetme.

Rrjedhimisht, mund të themi, së pari, se të gjithë semantikanët e kanë shqyrtuar poliseminë dhe homoniminë si pjesë të marrëdhënieve të tjera kuptimore, ashtu si sinoniminë dhe antoniminë, duke u përpjekur që të zbulonin marrëdhëniet ndërmjet shenjave gjuhësore, kuptimeve të shenjave polisemantike dhe homonimike. Së dyti, këto marrëdhënie polisemantike dhe homonimike janë të ndryshme vetëm nga këndvështrimi diakronik, sepse, kur trajtohen nga ana sinkronike, si formulime

---

<sup>158</sup> Po aty

<sup>159</sup> Lipka, L. *English Lexicology, Lexical structure, Word semantics and Word-formation*, Gunter Narr Verlag Tubingen, 2002, f. 152.

<sup>160</sup> Cruse, A. D. *Lexical Semantics*, Cambridge University Press, 1986, f.80.

Në lidhje me termat *njësi leksikore* dhe *leksemë* është e nevojshme që të bëjmë dallimin ndërmjet tyre sipas Kruzit. Njësia leksikore është bashkimi ndërmjet një kuptimi dhe formës leksikore; me formë leksikore kuptojmë një lloj abstraktimi nga e gjithë tërësia e formave të mundshme morfologjike të një fjale; ndërsa leksema është tërësia e njësive leksikore. Në këtë mënyrë, është e zakonshme të flasim për një leksemë që ka disa kuptime si polisemantike. Nga ana tjetër, për një formë leksikore, e cila shenjon njësi leksikore që u përkasin më shumë se një leksemë, themi se kemi të bëjmë me homonimi. Pra, në rastin e homonimisë flasim për leksema të ndryshme ndërsa te polisemia kemi të njëjtën leksemë të përbërë nga disa njësi leksikore. Si te homonimia ashtu edhe te polisemia, leksema konsiderohet njësia kryesore e kuptimit, ndërsa njësitë leksikore thjesht si variante të saj.

teknike, ato janë të ngjashme (e njëjta shenjë me kuptime të ndryshme). Në këndvështrimin sinkronik përpqimi të gjejmë ndryshimet midis të dy proceseve, duke u përpjekur të vendosim ndonjë lloj marrëdhënie kuptimore ndërmjet kuptimeve, duke u bazuar kryesisht në ndonjë lidhje subjektive, asociative (shoqëruese) ose psikologjike<sup>161</sup>.

Homonimia dhe polisemia janë faktorët e ekzistencës së dykuptimisë në gjuhë: konteksti ofron një nga mundësitë kryesore për të shmangur këtë dykuptimësi. Rrjedhimisht, kjo e fundit ka tërhequr edhe vëmendjen e shkencës së përkthimit për një kohë relativisht të gjatë. Disa studiues, si: Katford-i (Catford), Njumark-u (Newmark), Nida (Nida)<sup>162</sup> janë të mendimit se vetëm konteksti është një nga mënyrat për të zgjidhur dykuptimësinë, me qëllim që ajo të interpretohet saktë dhe të përkthehet në gjuhën tjetër. Për këtë arsye, homonimia dhe polisemia shërbejnë mjaft shpesh për të krijuar lojë fjalësh, zakonisht për efekte humori. Po marrim dy shembuj, përkatësisht në shqip dhe në anglisht, ku homonimia dhe polisemia janë të pranishme në fjali. P.sh.

*Kur binte tërmet më parë,  
Ortek ose stuhi nga reja,  
Na bënin ndërtesa të reja*<sup>163</sup>

Në këtë fjali, kemi homonimi të fjala re-ja, *re-ja* I em. “dukuri natyrore” dhe (të) *reja* II mb. “të kohëve të fundit”.

*They passed the port at midnight*<sup>164</sup>.

Kjo fjali është ndërtuar mbi dykuptimësinë leksikore, si rrjedhojë e pranisë së homonimisë dhe polisemisë: të fjala *port* kemi rastin e homonimisë *port* I “lloj liker” dhe *port* II “liman”; ndërsa folja *passed* është polisemantike me kuptimet e mundshme “kaloj” ose “jap, pasoj”. Si rrjedhim, kjo fjali ka dy kuptime: “Ata kaluan portin në mesnatë” ose “Ata shpërndanë liker në mesnatë”.

Shembujt e mësipërm ilustrojnë faktin se situata pragmatike dhe të dhënat e kontekstit ndihmojnë dëgjuesin për të zgjedhur interpretimin e duhur të këtyre fjalive. Edhe pse ne shpesh e shoqërojmë homoniminë dhe poliseminë me dëgjuesin, kjo dukuri nuk përfshin vetëm atë. Nga ana tjetër kemi folësin, i cili, gjithashtu, duhet të bëjë zgjedhjen e duhur në rrafshin e shenjuesve, ku mund të ketë më shumë se një shenjues (homonimia) apo në rrafshin e të shenjuarve ku ekziston, gjithashtu, më shumë se një mundësi zgjedhjeje (polisemia). Kjo ndodh për arsye se dykuptimësia e shkaktuar nga polisemia dhe homonimia, është e pranishme në nivele të ndryshme gjuhësore dhe jo vetëm në rrafshin e përmbajtjes.

<sup>161</sup>Gomez, C. M. *A functional description of semantic relationships*, Language design 4, 2002, f. 21- 47.

<sup>162</sup>Catford, C. J. *A Linguistic Theory of Translation*, Oxford University Press, 1965.

Newmark, P. *A textbook of Translation*, Prentice Hall, 1988.

Nida, A. E. *Contexts in translating*, John Benjamins Publishing Company, 2001.

<sup>163</sup>Lashova, S.; Grillo, O. K. *Gomari që deshte të bëhej mbret*, Fabula dhe epigram, Tiranë, 1997, Toena

<sup>164</sup>Lyons, J. *Semantics* 2, Cambridge, University Press, 1977, f. 397.

Në këtë mënyrë, flasim për homonime fonologjike, homonime leksikore, homonime gramatikore dhe homonime sintaksore, si në nivelin e sintagmave, ashtu dhe në atë të fjalisë. Siç vihet re, dykuptimësia që kemi në kontekst, lind nga thëniet si rrjedhojë e homonimisë në nivelet e sipërpërmendura, duke u bërë kështu më shumë një çështje e pragmatikës dhe e interpretimit, sesa e kuptimit. Kjo vjen ngaqë dykuptimësia lind në nivelin e ligjërit dhe jo në atë të sistemit gjuhësor. Si rrjedhojë, dykuptimësia, si një çështje që lidhet me interpretimin, është rezultat i përdorimit të homonimisë në një akt konkret të komunikimit.<sup>165</sup>

Nëse do ta trajtonim të njëjtën çështje nga këndvështrimi semantik, do të nxirrnim si përfundim se në pjesën më të madhe të rasteve si homonimia, ashtu edhe polisemia, i përkasin paradigmave leksikore aq të largëta nga njëra-tjetra, saqë format e tyre të përmbajtjes nuk do të vendosin asnjë lloj raporti mes tyre. Këtu bëjnë përjashtim rastet kur homonimet janë formuar si rrjedhojë e shpërbërjes së polisemisë.<sup>166</sup>

Duke u bazuar në këtë argument, disa studiues shprehen se homonimia dhe polisemia nuk përbëjnë në vetvete raporte leksikore, pasi këto të fundit duhet të vendosen në rrafshin e përmbajtjes dhe jo në atë të shprehjes.

Por problematika e marrëdhënieve të homonimisë me poliseminë, del në dukje kur kemi të bëjmë me një fjalë të vetme dhe kuptimet e saj dhe jo me fjalë të ndryshme. Në këtë rast është disi e ndërlikuar çështja e dallimit të polisemisë nga homonimia. Struktura kuptimore e fjalëve në të dyja gjuhët, si në shqip edhe në anglisht, është mjaft e gjerë. E njëjta fjalë mund të përfshijë disa kuptime që, në disa raste, duken të largëta. Për shembull, fjalët që tregojnë pjesët e trupit në të dyja gjuhët kanë një strukturë mjaft të ndërlikuar kuptimore dhe shumë shprehje frazeologjike rrjedhin prej tyre.

Duke u bazuar te kriteri etimologjik, si edhe lidhjet që fjala ka me sendet, nocionet, lidhjet leksikore, morfologjike, sintaksore dhe sferën e përdorimit të saj, dallohet më qartë karakteri i lidhjes polisemi / homonimi. Në këtë mënyrë, mund të shqyrtohet vendi që zë fjala dhe kuptimi i saj në sistemin e gjuhës. Nëse e shohim çështjen me hollësi, vëmë re se të gjitha këto na çojnë përsëri te kuptimi leksikor i fjalës dhe se si ai bashkëvepron njëkohësisht me të tri faktorët: realitetin objektiv, veprimtarinë njohëse ndaj këtij realiteti dhe me vetë sistemin e gjuhës.<sup>167</sup>

Në rastin e homonimisë ndodh procesi i kundërt, ngaqë një prej varianteve kuptimore nuk e ruan më lidhjen sendore me realitetin dhe, për këtë arsye, shenjon një nocion të ri të pavarur në ndërgjegjen e folësit e, më tej, në sistemin e gjuhës. Ky variant i shkëputur krijon lidhje të reja morfologjike e sintaksore, ka një kuptim kryesor si qendër fjalëformimi dhe, pa dyshim, edhe lidhje të reja leksikore e frazeologjike. P.sh., në gjuhën shqipe sot do të ishte e vështirë të dallohej që fjalët *cup I* “sup” dhe *cup II* “për te” dikur kanë pasur të njëjtën etimologji, ku kuptimi i përbashkët do të ishte “majë teke”.<sup>168</sup> Në gjuhë angleze fjalët *spring I* “kërcej” dhe *spring II* “pranverë” kanë qënë dikur fjalë polisemantike të lidhura me njëra-tjetrën përsa i përket kuptimit kryesor “veprim ose koha e çeljes”.

<sup>165</sup> Gomez, C. M. *A functional description of semantic relationships*, Language design 4, 2002, f. 21-47.

<sup>166</sup> Po aty f. 21- 47.

<sup>167</sup> Çabej, E. *Studime Gjuhësore I*, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 95.

<sup>168</sup> Po aty

Raportet polisemi - homonimi paraqitin një varg problemesh të lidhjeve *kuptim - formë*.<sup>169</sup> Lidhja ndërmjet polisemisë dhe homonimisë është e dyfishtë: së pari, të dyja janë mënyra të shprehjes së diçkaje - njëra me njësi semantike e tjetra me njësi leksikore të veçanta. Në këtë mënyrë, ato përbëjnë rrugë të ndryshme të pasurimit të leksikut, pavarësisht nga struktura. Së dyti, polisemia kalon në homonimi. Ne shprehemi kështu duke pranuar pikëpamjen që ka homonime që vijnë nga shpërbërja e polisemisë. Por mund të ndodhë edhe e kundërta, kur kuptimet e dy homonimeve, që takohen në ndonjë komponente semantike, mund të mblidhen në një fjalë polisemike. Historia gjuhësore dhe etimologjia arrijnë në përfundimin se ky proces nuk ka shumë gjasa të ndodhë<sup>170</sup>. Kështu që kjo lidhje e dytë ndërmjet polisemisë e homonimisë shkon rregullisht vetëm në një drejtim – nga polisemia në homonimi dhe jo në të kundërtën. Kjo ndodh për arsye se kuptimet e homonimeve janë shumë larg nga njëri-tjetri dhe nuk kanë ndonjë përbërës semantik të përbashkët që mund të çojë drejt grupimit të këtyre kuptimeve nën një nyjë të vetme semantike. Megjithatë siç e përmendëm më lart, kjo dukuri ka ndodhur në të dyja gjuhët.

#### 4.2.2. Polisemi që formohet nga homonimia (Kontaminim homonimik)

Siç e vumë re nga shkallëzimi i prejardhjes semantike, një nga burimet e homonimisë është shpërbërja e polisemisë. Në të njëjtën mënyrë kemi raste kur vetë polisemia vjen nga homonimia. Kështu, për ato fjalë që nuk kanë pasur ndonjë dallim kuptimor të dukshëm ndërmjet tyre, por që kanë qenë të ngjashme për nga ana tingullore, folësit e një gjuhe janë të prirur t'i konsiderojnë si një fjalë të vetme me kuptime të ndryshme. Duke e vëzhguar çështjen nga ana diakronike, kemi të bëjmë me dukurinë e homonimisë, sepse kemi burime të ndryshme etimologjike.

*Kontamini homonimik*, shkrirja e dy fjalëve të ndryshme në një dhe ndikimi i ndërsjellë i kuptimeve, ndodh kur kuptimet kanë ndonjë afërsi, qoftë edhe të jashtme, e mund të lidhen në një farë mënyre. Xhevat Lloshi thekson se kjo dukuri ngjet rrallë me fjalë, të cilat lidhen drejtpërdrejt me sendet konkrete e të përdorimit të përditshëm, që kanë kuptim të përcaktuar qartë, ndërsa është më tepër e mundshme me fjalë të përgjithshme e abstrakte, veçanërisht me foljet, ose gjatë huazimeve të ndryshme, kur bëhen përpjekje për ta përvetësuar më lehtë fjalën e huaj, duke e lidhur me ato të gjuhës.<sup>171</sup>

Duke e vëzhguar çështjen nga ana sinkronike, ku edhe zhvillohet ligjërimi, ne harrojmë të mendojmë për etimologjinë e fjalëve. Ne jemi të prirur që të vendosim një lidhje ngjashmërie më tepër mbi baza psikologjike sesa gjuhësore. Kjo lloj polisemie është shumë e rrallë, e rrjedhimisht, shembujt që mund të jepen nuk janë kategorikë, sepse varen kryesisht nga qëndrimet subjektive të folësit të një gjuhe nëse i konsideron këto kuptime si dy fjalë të ndryshme apo variante kuptimore të së njëjtës fjalë. Për shembull, në gjuhën shqipe mendohet se te fjala *amull*, bashkë me fjalët e

<sup>169</sup> Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 173.

<sup>170</sup> Për shkrirjen në një fjalë të vetme, d.m.th. për kontaminimin homonimik, ka shkruar Xhevat Lloshi në punimin *Rreth disa shfaqeve të ndërlimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, te “Studime filologjike”, 1965, 3 – shih “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalve në gjuhën shqipe”, 1972, I, f. 227, 230 dhe 231.

<sup>171</sup> Lloshi, Xh. *Rreth disa shfaqeve të ndërlimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, te *Studime filologjike*, 1965, 3 – shih *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, 1972, f. 227, 230 dhe 231.

tjera të lidhura me të, kemi kryqëzim të disa kuptimeve e formave, ndoshta edhe të disa fjalëve të ndryshme; në kuptimin e fjalës *dëfrej* ka ndikuar edhe fjala *fryj* etj. Në rastin e fjalës *endet*, si pësore nga *end* dhe *endet* për “bredh, vij poshtë e përpjetë”. Pra, etimologjia njeh disa raste kur fjalë të ndryshme, për shkak të homonimisë së rrënjëve të tyre me tingëllim të njëjtë ose të ngjashëm kanë ndikuar njëra mbi tjetrën e janë kryqëzuar<sup>172</sup>.

Xh. Lloshi shprehet se në veçanti pjesëzat, parafjalët, parashtesat dhe prapashtesat e sotme janë në shumë raste rezultat i kontaminimit të disa fjalëve të ndryshme, për faktin se ato nuk kanë kuptime të plota e të pavarura leksikore, me strukturë të qartë, gjë që e lehtëson ngatërrimin e tyre, mjafton të përfundojnë me tingëllim të njëjtë. Edhe në fushën e homonimisë gramatikore, sipas Xh. Lloshit, mjaft forma të ndryshme, të cilat janë përputhur nga ana tingëllore, janë shkruar me njëra-tjetrën, njëra ka marrë funksionet e tjetrës dhe është reduktuar numri i tyre, si ka ngjarë p.sh., me rasat.

Gjithashtu, hasim raste kur fjala, për lehtësi përdorimi, lidhet me një fjalë tjetër edhe nga kuptimi për shkak të homonimisë. P.sh., te shprehja *humbas pusullën*, e cila shqiptohet sikur të kishim të bënim vërtet me një *pusullë*, ndërsa fjala e vërtetë në rastin konkret do të jetë *busull* (e ngjashme me një shprehje në gjuhën greke).<sup>173</sup>

Në gjuhën angleze, te fjala *corn*, një nga kuptimet është “*misër*”; etimologjia e këtij kuptimi mund të kërkohet te anglishtja e vjetër, ndërsa kuptimi tjetër “*kallo*” vjen nga frëngjishtja e vjetër. Për nga ngjashmëria e tyre tingullore, të dy kuptimet lidhen me të njëjtën fjalë *corn*.<sup>174</sup> Shembuj të tjerë të kontaminimit homonimik në gjuhën angleze janë fjalët *weed* “barëra të këqija” dhe *weeds* “rroba të zeza”; *shock of corn* “duaj misri” dhe *shock of hair* “tufë flokësh”, fjalë me etimologji të ndryshme, por që shpesh konsiderohen si polisemantike, ndoshta për shkak të ngjashmërisë së jashtme të objekteve.

Homonimia dhe tingëllimet e ngjashme janë shkak e burimi kryesor i lindjes së *etimologjive popullore*. Kjo dukuri shërben si bazë për klasifikimin e shumë kuptimeve polisemantike, si pjesë e homonimeve të një gjuhe. Për këtë arsye, dallimi ndërmjet polisemisë dhe homonimisë është një nga çështjet më të ndërlikuara, që vë në mëdyshje studiuesit e semantikës leksikore, si edhe leksikografët gjatë hartimit të fjalorëve. Ajo përbën një çështje mjaft komplekse.

Por rastet e kontaminimit homonimik janë më të pakta në krahasim me formimin e homonimeve nga shpërbërja e polisemisë. Lindja e homonimeve nëpërmjet kësaj rruge ka sjellë debate në lëmin e studimeve gjuhësore.

Jani Thomai i trajton në vija të përgjithshme lidhjet ndërmjet polisemisë dhe homonimisë.<sup>175, 176</sup>

Lindja e homonimeve nëpërmjet shpërbërjes së polisemisë është çështje e diskutueshme jo vetëm në truallin e shqipes, por edhe të gjuhëve të tjera, si ajo angleze. Sot ka *tri pikëpamje themelore* në lidhje me të. Dy nga pikëpamjet janë shumë të skajshme dhe të kritikueshme. E treta është pikëpamja bazë, ku mbështetemi për të pohuar lindjen e shumë homonimeve nga zberthimi i polisemisë.

<sup>172</sup> Po aty f. 227, 230 dhe 231.

<sup>173</sup> Po aty f. 227, 230 dhe 231.

<sup>174</sup> Herbst, Th. *English Linguistics: A Coursebook for Students of English*, Germany, 2010, f.353.

<sup>175</sup> Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974, f. 17 – 51.

<sup>176</sup> Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984, f. 96 – 108.



Sipas njërës prej tyre, me rrugën e prejardhjes semantike nuk mund të lindin njësi të reja leksikore, pra, nuk formohen homonime; vargu i kuptimeve mund të vijojë pambarimisht, kuptimet mund të largohen shumë nga kuptimi fillestar e përsëri mbetemi brenda kufijve të së njëjtës fjalë. E meta themelore e kësaj pikëpamjeje është se fshin raportet ndërmjet përmbajtjes dhe formës, mohon kalimin në gjuhë nga njësi semantike në njësi leksikore. Në këtë mënyrë kufizohet zhvillimi i gjuhës dhe do të kishim mbetur brenda një rrethi vicioz, ku çdo variant kuptimor i ri do të na çonte te kuptimi kryesor.<sup>177</sup>

Sipas pikëpamjes tjetër të skajshme, çdo variant leksiko - semantik është njësi e re leksikore; pra, nëpërmjet prejardhjes semantike lindin çdo herë fjalë homonime. E meta themelore e kësaj pikëpamjeje është, në të kundërt me të parën, se ajo e shkëput dhe e largon formën nga përmbajtja, si edhe nuk njeh mikrosistemin semantik të fjalës.<sup>178</sup>

Qëndrimi më i drejtë ndaj polisemisë dhe homonimisë do të ishte nëse të gjithë procesin do ta thjeshtonim duke theksuar se, në kushte të caktuara, gjatë prejardhjes semantike, një njësi semantike mund të kthehet në njësi leksikore, ashtu si çdo ndryshim thelbësor në dukuri të tjera mund të çojë në një gjendje të re<sup>179</sup>. Duke marrë parasysh këtë formulim kaq të thjeshtuar, lidhjet dhe dallimet në rrafshin leksikor e semantik të binomit polisemi – homonimi bëhen edhe më të qarta.

Lidhjet leksikore janë të dukshme, sepse njësia polisemantike dhe ajo homonimike janë dy leksema të mëvetësishme dhe dallohen lehtë nga njëra-tjetra. Ndërsa lidhjet semantike dallohen vetëm nëse analizojmë strukturën kuptimore të fjalës polisemantike dhe kuptimin e fjalës homonimike, sepse struktura e saj kuptimore nuk ka rëndësi në këtë krahasim. Kjo është rruga që ndjekim në analizën tonë për të bërë dallimin ndërmjet tyre. Por ne shqyrtojmë procesin e prejardhjes kuptimore për të bërë identifikimin e lidhjes së tyre. Kalimi nga polisemia në homonimi sjell krijimin e një lekseme të re, duke bërë kështu kalimin nga një njësi semantike në një njësi të re leksikore. Pasi bëhet ky kalim, krijohen raporte të reja, kjo leksemë mund të jetë e njëkuptimshme ose e shumëkuptimshme dhe analiza zhvendoset nga rrafshi i brendshëm (i përmbajtjes) në rrafshin e jashtëm, në raportet që këto dy leksema vendosin me njëra-tjetrën. Ne jemi të interesuar në mënyrën se si ato lidhen brenda sistemit gjuhësor dhe jo në strukturat e tyre kuptimore.<sup>180</sup>

Kufiri ndarës ndërmjet polisemisë dhe homonimisë është momenti që ndodh kalimi nga një fjalë polisemantike në një fjalë homonimike. Procesi është mjaft dinamik dhe ndodh përgjatë një vijimësie të pasëgmentueshme, si rezultat, kufiri vështirë se mund të përcaktohet me përpikmëri. Në shumicën e rasteve, ky kufi është i papërcaktuar dhe kalimi nga polisemia në homonimi mund të imagjinohet si një segment, ku polisemia dhe homonimia janë skajet e tij dhe kalimi nga një skaj në tjetrin ndodh në mënyrë graduale e me vijimësi.<sup>181</sup>

Kalimi nga polisemia në homonimi ndodh për shkaqe më së shumti me karakter gjuhësor, por, gjithashtu, edhe me karakter psiko - lingvistik. Vetë lëvizja kuptimore në gjuhë është një dukuri objektive e nxitur nga kërkesat e praktikës gjuhësore, por që bëhet e mundur nga vetë sistemi i gjuhës. Kalimi nga polisemia në

<sup>177</sup> Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 171.

<sup>178</sup> Po aty

<sup>179</sup> Po aty

<sup>180</sup> Po aty f. 173 -177.

<sup>181</sup> Po aty f. 173 – 177.

homonimi është në fakt, një zhvillim dhe pasurim i gjuhës me njësi të reja leksikore. Sipas parimit të ekonomisë gjuhësore shenjuesi do të mbetet po ai, por do të rriteshin aftësitë e tij shenjuese. Ndërsa sipas parimit të diferencimit në gjuhë, me lindjen e një lekseme të re, kemi edhe lindjen e një shenjuesi të ri, i cili do të zhvillohet në mënyrë të pavarur nga shenjuesi burimor. Dihet që parimin e diferencimit zakonisht e trajtojmë për dy njësi leksikore të ndryshme, por ky parim mund të jetë po aq i vlefshëm edhe brenda strukturës kuptimore të një lekseme. Kjo ndodh për faktin se kuptimet e reja që lindin janë, gjithashtu, të prirura për t'u diferencuar nga njëra-tjetra dhe një diferencim i skajshëm është shkaku i lindjes së homonimeve. Kjo analizë na çon në përfundimin se shkaku themelor i këtij ndryshimi, është zhvillimi kuptimor, largimi i kuptimeve, lindja e elementeve të reja semantike, diferencimi i brendshëm në strukturën kuptimore të fjalës.<sup>182</sup>

### 4.3. Kriteria të dallimit polisemi / homonimi

Po i rikthehemi përsëri problemit qendror të këtij kapitulli, dallimit ndërmjet polisemisë dhe homonimisë.

Si përcaktohet kufiri ndërmjet *homonimisë dhe polisemisë*, ka qënë për një kohë të gjatë në qendër të vëmendjes së disa studiuesve. Një nga mënyrat për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje përputhet me kriterin e përcaktimit të polisemisë, ku variantet kuptimore janë të lidhura me njëri-tjetrin. Në pamje të parë, mund të thuhet se një nga kriteret e dallimit ndërmjet polisemisë dhe homonimisë mund të jetë pikërisht ekzistenca e kësaj lidhjeje ndërmjet kuptimeve, përcaktimi i së cilës mund të bëhet duke u mbështetur në fakte historike ose psikologjike.<sup>183</sup>

Nëse dy kuptime janë të lidhura për nga ana historike midis tyre, atëherë ata kanë të njëjtin burim ose janë kuptime të prejardhura. Nëse dy kuptimet janë të lidhura për nga ana psikologjike, kjo nënkupton se përdoruesit e gjuhës – në bazë të intuitës së tyre – vendosin për ekzistencën e kësaj lidhjeje dhe, rrjedhimisht, mendojnë se ato janë variante kuptimore të së njëjtës fjalë. Midis dy kuptimeve ekziston një lidhje me baza psikologjike, kur folësit e gjuhës e vendosin këtë lidhje në bazë të rregullave të zgjerimit të strukturës kuptimore, siç është, për shembull transferimi metaforik dhe metonimia.

Përcaktimi i kësaj lidhjeje me anën e parimeve të tilla nuk është gjithnjë i suksesshëm, sepse gjithmonë folësit e një gjuhe kanë të drejtë kur ata mendojnë se kuptimet i përkasin të njëjtin burim ose jo, sidomos në rastin kur ato janë mjaft të largëta. Për këtë arsye, dallimi ndërmjet tyre mund të bëhet ose në rrafshin diakronik, ose në atë sinkronik. Qasja më tradicionale është ajo diakronike, ku njësitë homonimike rrjedhin nga burime të ndryshme leksikore dhe ngjashmëria e tyre në formën e shkruar ose fonologjike mund të jetë rezultat i ndryshimeve që gjuha pëson apo edhe i huazimeve. Dallimi diakronik ndërmjet homonimisë dhe polisemisë është një çështje që mund të zgjidhet në parim.<sup>184</sup>

Nga ana tjetër, trajtimi sinkronik i kësaj çështjeje nuk është po aq i prerë sa trajtimi diakronik me një përgjigje të vetme po ose jo. Çështja e lidhjes sinkronike

<sup>182</sup> Po aty f. 173 – 177.

<sup>183</sup> Leech, G. *Semantics. The study of Meaning 2<sup>nd</sup> ed.* Penguin Books, 1981, f.227.

<sup>184</sup> Lyons, J. *Linguistics semantics: An Introduction*, Cambridge University Press, 1995, f.60.

ndërmjet kuptimeve është më tepër një interpretim nëse kemi një zgjerim të mundshëm të strukturës kuptimore ose jo dhe deri ku ka vazhduar ky zgjerim. Këtu kemi të bëjmë më shumë me një çështje shkallëzimi (nëse qëndron ndonjë marrëdhënie kuptimore ndërmjet fjalëve), sesa me një çështje përcaktimi (nëse e kanë të njëjtin burim apo jo).<sup>185</sup>

Në qendër të trajtimit sinkronik gjendet procesi i zgjerimit metaforik, çka qëndron në thelb të kompetencës gjuhësore. Ne jemi të aftë jo vetëm të zbatojmë rregullat, por edhe të krijojmë forma të reja në analogji me ato ekzistuese. Këtu shfaqet një tjetër problem, pasi është e pamundur që të bësh një dallim të qartë ndërmjet shndërrimeve të rastësishme kuptimore të ndonjë individi në një situatë të caktuar, me ato transferime e zgjerime kuptimore të konvencionalizuara e që gjenden në fjalor. Ky fakt ka ndikimet e tij në çdo teori gjuhësore madje, ndikon edhe në çështjen e ndërlikuar të dallimit ndërmjet polisemisë dhe homonimisë<sup>186</sup>.

Mendimet dhe sugjerimet për të gjetur kriteret e përshtatshme me anë të të cilave mund të bëhet ky dallim, janë të ndryshme. Gjithashtu, ka pasur edhe nga ata studiues që kanë ndryshuar qëndrimet e tyre ndaj kësaj çështjeje. Gjithsesi, ata bien dakord për kriteret e renditura më poshtë<sup>187</sup>: kriteri i etimologjisë, lidhja e ngushtë kuptimore (kriteri semantik) dhe ngjashmëria apo dallimi formal.

Kësaj liste i shtohet edhe një trajtim tjetër i mundshëm për të përcaktuar kufirin midis polisemisë dhe homonimisë, kriteri i lidhjes me referentin.

#### 4.3.1. Kriteri i prejardhjes etimologjike

I pari që do të marrim në konsideratë është kriteri etimologjik. Parimi i përgjithshëm i ndarjes së fjalëve sipas këtij kriteri është ky: fjalët që kanë origjinë të përbashkët grupohen së bashku si polisemantike, ndërsa ato fjalë, të cilat nuk kanë të njëjtën origjinë, konsiderohen si homonimike. Për shembull, fjalët *çap/ë*, - *a* I “vegël bujqësore për të prashitur” dhe *çap/ë*, - *a* II “kafshatë” kanë etimologji të ndryshme. Edhe në gjuhën angleze fjalët *ear* I “organ dëgjimi” dhe *ear* II “kalli misri” kanë etimologji të ndryshme, pasi në anglishten e vjetër ato kanë pasur forma të ndryshme e rrjedhimisht edhe burime të ndryshme. Për këtë arsye, ne i klasifikojmë ato si homonime. Ndërsa fjalët polisemantike rrjedhin nga i njëjti burim, sepse të gjitha kuptimet, si pjesë e strukturës semantike të fjalës, janë të lidhura me kuptimin kryesor ose ndërmjet tyre nëpërmjet njëse semantike. Në këtë mënyrë, këtu nuk mund të diskutojmë për fjalë me etimologji të ndryshme, siç ndodh rëndom me pjesën më të madhe të leksikut.

Megjithatë, në anglisht, po ashtu edhe në shqip, kemi shumë fjalë të cilat janë trajtuar dhe paraqitur në fjalorë si homonime. Ato madje, kanë edhe formë të ndryshme. Por nëse do të gjurmonim etimologjinë e tyre, do të vihej re se kanë të njëjtin burim prejardhjeje. Le të sjellim si shembull raste nga gjuha shqipe, si: *çik/ë*, - *a* I “copë e vogël”; *çik/ë*, - *a* II “vajzë, çupë”; *çik/ë*, - *a* III “zog i vogël shtegtar ...”,

<sup>185</sup> Po aty

<sup>186</sup> Po aty

<sup>187</sup> Lipka, Lyons, Lloshi, Thomai, Memushaj e studiues të tjerë i trajtojnë këto kriteret si disa nga bazat kryesore për të vendosur dallimin ndërmjet këtyre dy dukurive kuptimore. Trajtimi që secili prej tyre i bën këtyre kriterëve takohet në disa pika të përgjithshme, të cilat paraqiten edhe këtu.

etimologjitë e të cilave Gustav Mejer-it i lidh me fjalën e italishtes *cica* “ thërrime, kafshatë, një çikë”. Edhe *çikë* – *ragazza* është identike me të <sup>188</sup>. Megjithatë, fjala e italishtes nuk u mjafton domethënieve të shumta të fjalës shqipe *çikë*. Kjo është një fjalë e gjuhës së fëmijës, që ndeshet në gjuhë të ndryshme. Për gjuhët neo-latine, kemi *chico* “djalë” apo *chica* “vajzë” që mund të krahasohen me fjalën shqipe *çikë* “vajzë”, të cilën Mayer-i (Mejër) me të drejtë e përfshin te grupi i kuptimeve të kësaj fjale<sup>189</sup>.

Duke e krahasuar edhe me gjuhën angleze, sjellim rastin e fjalës *flower* “lule” dhe *flour* “miell”, ku të dyja leksemat vijnë nga periudha e anglishtes së mesme me të njëjtën formë *flour* apo fjalë të tjera, si: *glamour* “magjepsje” dhe *grammar* “gramatikë”, që kanë të dyja origjinë të përbashkët nga fjala *grammar*. Një formë variante e saj në dialektin scocez del si *grammarye*, me kuptimin “magjepsje”. Po kështu, *person* “person” dhe *parson* “pastor” kanë të njëjtin burim nga latinishtja *persona*.

Në gjuhën angleze, për shkak të veçantisë së saj (grafemat dhe fonemat nuk përputhen me njëra-tjetrën), ai grup, ato fjalë, janë lehtësisht të perceptueshme si homonime, pavarësisht nga fakti se dikur ato kanë qenë e njëjta leksemë, por për shkak të ndryshimeve që gjuha përjeton, forma dhe kuptimi i tyre janë larguar shumë nga burimi i tyre origjinal. Ndërsa në gjuhën shqipe ky dallim nuk është dhe aq i dukshëm, pasi kemi për nga forma të njëjtën fjalë, por me kuptime të ndryshme. Në rrafshin sinkronik asnjëherë nuk mund të bëjmë gjykime të shëndosha në lidhje me prejardhjen etimologjike të fjalëve. Kjo do të sillte përsëri një ndarje të gabuar të fjalëve polisemantike nga ato homonimike, çka nënkupton se kriteri i etimologjisë, në përgjithësi, është një kriter i mjaftueshëm, por jo kusht i domosdoshëm, për arsye se ekzistojnë shumë fjalë – si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze – për të cilat nuk jemi të sigurt për sa i përket origjinës së tyre.

Nga ana tjetër, jo gjithmonë është e qartë se çfarë nënkupton marrëdhënia etimologjike ndërmjet fjalëve; deri në ç’masë jemi në gjendje të hulumtojmë për të caktuar origjinën e saktë të fjalëve të marra në shqyrtim. Për shembull, në anglisht, fjala *port I* “port” dhe *port II* “liker” dalin si homonime, duke u nisur nga parimi etimologjik. Origjina e kuptimit të parë lidhet me fjalën e latinishtes *portus* dhe etimologjia e kuptimit të dytë vjen nga qyteti në Portugali, ku prodhohet një lloj vere “oportu”. Megjithatë, nëse shkojmë më tej në historinë e fjalës *oportu*, që do të thotë “porti”, do të zbulonim se edhe kjo vjen nga fjala e latinishtes *portus*. Pra, kuptimet e leksemave *port I* dhe *port II* kanë origjinë të përbashkët dhe normalisht duhet të klasifikohen si fjalë polisemantike dhe jo si homonimike, sipas kriterit të etimologjisë.

Kriteri etimologjik nuk është asnjëherë i zbatueshëm në rrafshin sinkronik të gjuhës. Pavarësisht informacionit që fjalorët ekzistues na japin në lidhje me origjinën dhe historinë e fjalëve të veçanta, si folës të gjuhës nuk jemi të vetëdijshëm për etimologjinë e fjalëve që përdorim, sepse kjo nuk ndikon as në procesin e dhënies së informacionit dhe as gjatë procesit të interpretimit të këtij informacioni. Vetëm në raste shumë të veçanta, kur jemi duke analizuar një tekst, mund të analizojmë se si kuptimi sinkronik i një lekseme mund të jetë i ndryshëm nga ai etimologjik. Megjithatë, ky fakt nuk luan ndonjë rol specifik në përcaktimin e homonimisë.

<sup>188</sup> Meyer, G. *Fjalor Etimologjik i Gjuhës Shqipe – 1891*, Botimet Çabej, Tiranë, 2007, f. 107.

<sup>189</sup> Çabej, E. *Studime Gjuhësore I*, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 100.

Etimologjia na ndihmon të zbulojmë rrugët e formimit të homonimeve ose të përcaktojmë llojin e tyre, por vetëm parimi etimologjik nuk do të na ndihmonte për të dalluar poliseminë nga homonimia.

#### 4.3.2. Kriteri i lidhjes kuptimore (kriteri semantik)

Një tjetër kriter mjaft i rëndësishëm që përdoret nga gjuhëtarët për të bërë dallimin midis polisemisë dhe homonimisë, është ekzistenca ose jo e një lidhjeje të ngushtë ndërmjet kuptimeve, pra deri ku janë të mbivendosura kuptimet me njëri-tjetrin për të pasur një leksemë me kuptime të ndryshme ose dy leksema të ndryshme.

Ky është një nga kriteret më me peshë, i cili merr parasysh edhe kriteret psikologjike, dmth., asosacionet subjektive të secilit prej nesh për të vendosur nëse ka një lidhje kuptimore ose jo. Në këtë mënyrë, nuk flasim për ndonjë kriter objektiv për të bërë dallimin e duhur ndërmjet leksemave të ndryshme apo kuptimeve të ndryshme të së njëjtës lekseme. Për shembull, për folësit e gjuhës shqipe, lidhja që ekziston ndërmjet kuptimeve të fjalëve *kasap* “dikush që therr bagëtinë”; “xhelati” dhe “kirurgu i paaftë” është mjaft e qartë dhe ato janë lehtësisht të perceptueshme si kuptime të lidhura me njëri-tjetrin. Nga ana tjetër, te fjala e gjuhës angleze *bachelor* “beqar”, “i diplomuar”, “shqytar”, “fokë e paçiftuar” mund të perceptohen nga intuitede subjektive e folësve si katër kuptime që nuk kanë asnjë lidhje me njëri-tjetrin, ndërkohë që ato janë variante kuptimore të së njëjtës leksemë.

Duke pasur parasysh strukturën kuptimore të fjalës, mund të themi se kuptimet e fjalës polisemantike shfaqen gjithnjë të lidhura me të njëjtin grup fonetik bazë (që ndryshon vetëm në sistemin e kategorive gramatikore, jo në sistemin fjalëformues). Kur njëra njësi semantike (themelore) e fjalës polisemantike largohet aq shumë sa mund të themi se i ka shkëputur lidhjet me njësitë e tjera semantike të kësaj strukture, mund ta pranojmë me të njëjtën veshje tingullore si njësi më vete leksikore.<sup>190</sup>

Megjithatë, Jani Thomai vë në dukje dy probleme në lidhje me këtë kriter: së pari, dallimi i fjalës polisemantike nga fjalët homonimike nuk vërehet dot nga “jashtë”, ngaqë kalimi nga homonimia në polisemi nuk shoqërohet me ndryshime të formës në gjuhën shqipe. Ndërsa në gjuhën angleze kemi një veçanti tjetër, për arsye se kjo gjuhë është pasuruar me ndryshime të formës dhe, rrjedhimisht, ka ndikuar në rritjen e numrit të homonimeve rastësore në këtë gjuhë. Së dyti, kriteri mbetet gjithnjë subjektiv, sepse nuk mund të përcaktohet prerazi se kur është larguar kuptimi aq sa mund të themi se ka lindur një homonim. Për më tepër, lidhja ndërmjet kuptimeve është më tepër një çështje shkallëzimi dhe duhet vërtetuar. Intuitede e folësve nuk është e mjaftueshme për të qenë një kriter universal i zbatueshëm për sistemin e gjuhës. Një metodë tjetër për të shpjeguar nocionin e lidhjes kuptimore përfshin analizën në përbërës kuptimorë të kuptimeve të leksemës<sup>191</sup>. Problem është se në këtë qasje është domosdoshmëri të përcaktohen përbërësit kuptimorë, që këto leksema kanë të përbashkët dhe cilët përbërës duhet t’i ndajnë ato, në mënyrë që të quhet një lidhje e mjaftueshme ndërmjet kuptimeve. Për aq kohë sa nuk mund t’u përgjigjemi këtyre pyetjeve, teknika e shpërbërjes kuptimore nuk mund të jetë një kriter bindës për dallimin ndërmjet polisemisë dhe homonimisë.

<sup>190</sup> Thomai, J. *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Botimet EDFFA, 2009, f. 194.

<sup>191</sup> Lyons, J. *Semantics 2*, Cambridge University Press, 1977, f. 552.

Megjithatë, gërshetimi i kësaj metodë me analizën brenda konteksteve ose mikrokonteksteve, ku fjalët shfaqin kuptimet e tyre mund të ishte një zgjidhje më objektive. Pra, përcaktimi i kuptimeve të fjalës varet në një shkallë të lartë nga sasia, vëllimi dhe qartësia e konteksteve, që formohen nga valencat e saj me fjalë të tjera.<sup>192</sup>

Homonimet leksiko-semantike, sikurse edhe ato etimologjike, janë rrjedhojë e zhvillimit historik të gjuhës. Në rastin e dytë kemi njësi leksikore të ndryshme që janë përafuar dhe janë bërë të njëjta për nga forma; ndërsa në rastin e parë kemi të njëjtën fjalë, kuptimet leksikore të së cilës janë larguar e janë ndarë në homonime.

Homonimet që dalin nga zbërthimi i polisemisë janë pasojë e zhvillimit semantik, e lëvizjes në hallkat e së njëjtës strukturë kuptimore. Nya semantike që lidh këto hallka këputet; njëra hallkë pëson ndryshime të thella e të shpejta dhe krijon lidhje të reja të shumëllojshme<sup>193</sup>. Ajo fiton funksione të reja, si terminologjike e stilistike, ashtu edhe tipare të reja, të ndryshme nga ato të hallkave të tjera, duke u mënjanuar e duke fituar kështu një zhvillim tërësisht të pavarur nga hallkat, me të cilat ka qenë dikur e lidhur. Për shembull, në gjuhën shqipe mund të citojmë disa homonime të lindura mbi bazën e këtij procesi:

*anë I* “pjesa e një sendi ose e një vendi, që gjendet më larg nga mesi i tij”

*anë II* “fill mëndafshi a pambuku jo shumë i trashë, që përdoret në endje me tepër për pjesët anësore të pëlhurave dhe për vijat e zbukurimeve”

*arrëz I* “rruaza e parë e qafës mbi të cilën mbështetet koka”

*arrëz II* “arrishtë, pyll me arra”

*arrëz III* “bot. bimë barishore njëvjeçare, me gjethe si të tërfilit, të vendosura dendur rreth kërcellit, që rritet nëpër fushat anës detit”

*çoj I* “e marr me vete dhe e përcjell deri në një vend tjetër ose deri te dikush, shpie”

*çoj II* “shkëput diçka nga toka ose nga dyshemeja dhe e mbaj pezull në duar, marr diçka nga vendi i vet dhe e mbaj në dorë ose e vë më lart, ngre”

*ngjit I* “bashkoj një gjë tek një tjetër me një lëndë veshtullore si zamkë, tutkall, etj.”

*ngjit II* “shpie diçka nga një vend më i ulët në një vend më të lartë, ngre”

Të njëjtat përfundime vlejné edhe për gjuhën angleze: homonimet e mëposhtme janë formuar, gjithashtu, si rrjedhojë e shpërbërjes së polisemisë; tre kuptimet e para të fjalës *bow* kanë origjinë të përbashkët nga *buga*; ndërsa te fjala *firm* mund të gjurmohet prejardhjen e tyre etimologjike nga fjala *firmus* e latinishtes.

<sup>192</sup>Thomai, J. *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Botimet EDFa, 2009, f. 203.

<sup>193</sup>Po aty f. 196.

*bow I* em. “përkulje, përshëndetje”  
*bow II* jokal. “përkulem, ul kokën”  
*bow III* em. “hark shigjete, hark violine”  
*bow IV* em. “bashi i anijes”

*firm I* em. “firmë, shoqëri tregëtare”  
*firm II* mb. “i fortë, i qëndrueshëm”  
*firm III* kal. “forcoj, përforcoj”

Duhet theksuar se zgjerimi i strukturës kuptimore nuk është vetëm burimi i homonimeve semantiko-leksikore. Edhe homonimet leksiko-gramatikore që dalin nëpërmjet prejardhjes semantike përbëjnë një grup tjetër të veçantë. Kështu kemi kalimet nga *buzë I* em. te *buzë II* paraf.; nga *rreth I* em. te *rreth II* ndajf. e te *rreth III* paraf. Nga anglishtja, shembujt janë edhe më të shumtë. Mjafton të përmendim se një nga rrugët e formimit të fjalëve të reja në anglisht është konversioni ose kalimi nga një kategori gramatikore në një tjetër, p.sh., nga *bang I* pasth. “fap, fët” ose *back I* em. “shpinë, kurriz”; *back II* kal. jokal. “eci mbrapa, zmbrapsem” dhe *back III* ndajf. “prapa, mbrapsht”.

Këto kalime janë shoqëruar jo vetëm me ndryshime të karakterit leksikor, por edhe gramatikor. Kemi këtu rastin e dobësimit të kuptimit leksikor dhe përforcimin e funksionit gramatikor, me ndryshimin e lidhjeve gramatikore e të kategorisë leksiko-gramatikore. Kuptimi leksikor ka pësuar ato ndryshime që i detyrohen prej ndryshimit leksiko-gramatik (kalimit për shembull, nga emër në folje ose në ndajfolje) dhe kjo e ka thelluar dallimin ndërmjet kuptimit leksikor të parë dhe përdorimit të tij me vlera të reja leksiko-gramatikore.

Ky largim i madh humbet edhe njëjën semantike lidhëse, e si rrjedhim, kalimi në homonimi është më i qartë, kurse motivimi i lidhjeve dhe i zhvillimeve semantike është shumë i dobët. Përgjithësisht, sa më të skajshme të bëhen kuptimet e një fjale, aq më i dobët bëhet motivimi i lidhjeve të tyre, si edhe i lëvizjeve nga njëri te tjetri, sidomos te fjalët shërbyese. Te fjalët shënuese, lidhja kuptimore është më e fortë sepse baza sendore-logjike e zhvillimit kuptimor është më e qartë.<sup>194</sup>

Për shkak të këtyre ndryshimeve të thella semantike, gramatikore e leksiko-gramatikore, nuk mund të mendohet në asnjë moment që në këto raste kemi njësi polisemantike.

#### 4.3.3. Kriteri i ngjashmërisë ose i dallimit formal

Së pari, duhet theksuar se ngjashmëria apo dallimi formal është një nocion i lidhur me mjetin (mediumin) e shprehjes, me gjuhën e folur ose me atë të shkruar. Në varësi të mediumit, ne bëjmë edhe interpretimin e kushtit të ngjashmërisë formale. Së dyti, duhet të bëjmë dallimin në anglisht midis shqiptimit dhe formës së shkruar të fjalëve. Gjuha shqipe, ndryshe nga ajo angleze, është një gjuhë fonetike, ku fonemat përputhen me grafemat. Së treti, duhet të marrim parasysh edhe aspektet morfologjike e sintaksore të fjalëve, për arsye se kur dy fjalë kanë të njëjtën formë dhe i përkasin të njëjtës kategori gramatikore, atëherë i klasifikojmë si homonime të mirëfillta.<sup>195</sup> Por

<sup>194</sup> Thomai, J. *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Botimet EDFA, 2009, f. 197.

<sup>195</sup> Në kreun e III-të trajtohen kriteret që duhet të përmbushen për të patur homonimi absolute ose të mirëfilltë, ku ngjashmëria formale si dhe barazvlefshmëria sintaksore janë dy kushte të rëndësishme.

në gjuhën angleze kemi edhe ato raste kur dy fjalë janë të ngjashme vetëm për nga forma e tyre e shqiptimit (homofonet) dhe nga përputhja grafemore (homografet). Megjithatë, duhet saktësuar se termi homonimi është mjaft i gjerë dhe i përfshin të gjitha format e sipërpërmendura.

- |                  |                                      |                                      |
|------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| <b>Boj/ë – a</b> | - 1. “lëndë për të ngjyer ...”       | = BOJË <sub>I</sub>                  |
|                  | - 2. “shtat “                        | = BOJË <sub>II</sub>                 |
| <b>Toast</b>     | - 1. “bread made brown and crisp”    | = TOAST <sub>I</sub> “bukë e thekur” |
|                  | - 2. “wish happiness, success while” | = TOAST <sub>II</sub> “dolli”        |

Fig. 4.1. Paraqitja e kuptimeve homonimike të leksemave *bojë* dhe *toast*

Shembujt e mësipërm tregojnë se kemi të bëjmë me një formë dhe dy kuptime të ndryshme nga njëri-tjetri; për këtë arsye, janë paraqitur si dy leksema në diagram. Ndërmjet këtyre kuptimeve apo shenjuesve, nuk qëndron asnjë lidhje semantike. Dallimi formal i leksemave është edhe më i qartë për ato fjalë, të cilat janë të ndryshme edhe për nga veçoritë e tyre morfologjike e sintaksore, si për shembull fjalët *fly*<sub>I</sub> “fluturoj” dhe *fly*<sub>II</sub> “mizë” apo *can*<sub>I</sub> “mundem” dhe *can*<sub>II</sub> “konservoj” dhe *can*<sub>III</sub> “konservë”; ndërsa në gjuhën shqipe përputhjet e disa trajtave të fjalëve që nga ana paradigmore janë të ndryshme, janë lënë jashtë shqyrtimit si homonime, pasi ato dalin të tilla vetëm në disa trajta të kufizuara për shkak të natyrës flektive mjaft të pasur që ka gjuha shqipe. Për shembull, *fik* si folje dhe *fik* si emër; *kyç* si emër dhe *kyç* si folje; *shuk* em. “topth që mbledhet duke mbledhur e duke ngjeshur diçka” dhe *shuk* kal. “bëj shuk diçka” apo kemi rastin e homofomisë së mbiemrit me emrin tematik, *punëtor - punëtor*; *llafazan - llafazan*.

Edhe kur diskutojmë kriterin e ngjashmërisë formale për homonimet e mirëfillta, kemi rezerva në rastin e atyre fjalëve që u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës ose madje së njëjtës pjesë të ligjeratës, por nuk kanë një barazvlefshmëri sintaksore. Këtu mund të përmendim rastin e homonimeve në gjuhën angleze *lie*<sub>I</sub> “gënjej” dhe *lie*<sub>II</sub> “shtrihem”. Edhe pse këto leksema përmbushin kriterin e ngjashmërisë formale, ato nuk përmbushin kriterin e barazvlefshmërisë sintaksore, pasi ato dalin përkatësisht edhe në këto forma: *lied*, *lying* dhe *lay*, *lain*, *lying*, duke mos u përputhur në të gjithë paradigmen e tyre.

Mund të vërejmë se në gjuhën shqipe, përgjithësisht çiftet homonimike i përkasin së njëjtës pjesë të ligjeratës dhe kanë të njëjtën formë; si rrjedhojë, rrallë herë kemi forma të ndryshme në paradigmen e tyre. Këtu mund të japim disa shembuj:

- buç-i*<sub>I</sub> “krahin. xhungë, bullungë”  
*buç-i*<sub>II</sub> “zool. krahin. gjarpër, nëpërkë”



*bush-i I* “bot. shkurre me shumë degë ose dru deri tetë metra i lartë, me gjethe vezake jorënëse, me lule të vogla në tufë, që e ka lëndën të verdhë, të fortë e me gjethe vezake jo rënëse, me lule të vogla në tufë, që e ka lëngun të verdhë, të fortë e me palcë dhe që përdoret për të bërë orendi, vegla pune, çibukë, lodra, etj.”

*bush-i II* “mit. qënie e përfytyruar si kafshë, e cila, sipas besimeve të kota, jetonte nëpër kënetë dhe ndillte shi duke ulëritur”

*çek-u I* “urdhërpagesë e shkruar sipas një modeli të caktuar, me të cilën dikush ka të drejtë të tërheqë nga banka ose nga arka një shumë të caktuar prej llogarisë së ndërmarrjes, të institucionit ose të personit që e ka lëshuar këtë dokument në emër të tij.”

*çek-u II* “banor vendas i Çekisë ose ai që e ka prejardhjen nga Çekia.”

*çek-u III* “ushqimi që merr me vete bariu për të ngrënë gjatë ditës.”

Për sa më sipër, ngjashmëria mund të jetë dy llojesh: ngjashmëri që lidhet me veçoritë leksiko-semantike dhe ngjashmëri që lidhet me veçoritë formale e sintagmatike. Të marra më vete, në bazë të grupit të parë mund të përcaktojmë sinoniminë dhe poliseminë, ndërsa duke u bazuar në grupin e dytë të ngjashmërive, mund të përcaktojmë homonimet e mirëfillta që i përkasin së njëjtës kategori leksiko-gramatikore, pra, që përputhen nga ana fonetike, flektive, paradigmatiche sintagmatike. Vetëm duke gërshetuar të dyja këto grupe ngjashmërisht mund të arrijmë të dallojmë poliseminë nga homonimia. Nëse dy njësi gjuhësore janë të njëlltoja nga ana leksiko-semantike e formale-sintagmatike, atëherë ato janë një njësi semantike (duke përjashtuar rastet e rralla të sinonimisë). Në të kundërt, ato janë homonime.

Por duhet theksuar se mungesa e ngjashmërisë formale-sintagmatike, siç është rasti i emrave në numrin njëjës e shumë apo foljeve me kuptime veprorë etj., nuk nënkupton domosdoshmërisht ekzistencën e homonimisë ose në të kundërt mund të kemi një ngjashmëri të pjesshme dhe përsëri kemi të bëjmë me homonimi (homografet apo homofonet).

Ky grup ngjashmërisht vlen më tepër për identifikimin e homonimeve të mirëfillta ose atyre të pjesshme, sepse te homonimet leksiko-semantike numri i kriterëve vjen e zvogëlohet. Meqënëse këto homonime kanë qënë dikur brenda së njëjtës strukturë kuptimore, ato kanë tipare të përbashkëta, të cilat vazhdojnë t’i ruajnë edhe kur dalin si njësi të reja leksikore. Për këtë arsye, njësitë e reja leksikore homonimike takohen shpesh në lidhjet leksiko-sintaksore dhe në tiparet formale, flektive e fjalëformuese, dmth., në tiparet paradigmatiche.

#### 4.3.4. Kriteri me baza referenciale

Ndryshe nga pikëpamjet e mësipërme, të cilat janë pak a shumë tradicionale, trajtimi me në qendër referentin mund të jetë mjaft bindës në rrafshin sinkronik. Si

fillim, do të shohim disa shembuj<sup>196</sup> ku në thelb të analizës do të jetë lidhja e kuptimeve me referentin.

1. The **bank** was flooded yesterday. (referenti - ndërtesa)  
(Banka u përmyt dje.)
2. The **bank** was very nice and understanding. (referenti - stafi)  
(Banka ishte mjaft e këndshme dhe mirëkuptuese.)
3. The **bank** was founded in 1990. (referenti - institucioni)  
(Banka u themelua më 1990.)
4. Money, in the form of **bank** notes, does not travel along the cable as well.  
(Paratë në kartmonedha nuk mund të transferohen nëpërmjet kabllit.)
5. A blood **bank**, memory bank (referenti - vendi ku ruhet diçka)  
(Bankë gjaku, bankë të dhënash)
6. River **bank** (referenti - bregu)  
(Bregu i lumit)
7. **Bank**-mound (referenti - pìrg, grumbull)  
(Pìrg dheu)
8. A **bank** of seats (referenti - mënyra e rregullimit të ndenjësve)  
(Një rradhë me ndenjësve)

ose

1. I just bought a **book** on boring postcards (referenti - objekti)  
(Unë sapo bleva një libër rreth kartolinave të mërzitshme.)
2. Malcolm wrote a **book** on boring postcards (referenti - teksti)  
(Malkolm shkroi një libër për kartolinat e mërzitshme.)
3. Jenny is a **bookkeeper** at Barclay's bank (referenti - profesioni)  
(Xheni është financiere te banka Barlay.)
4. We **booked in** at the hotel (referenti - kryerja e regjistrimit)  
(Ne u regjistruam në hotel.)
5. We **booked** our tickets this morning (referenti - blemë, rezervuam vende)  
(Ne i prenotuam biletat tona këtë mëngjes.)

Po marrim si rast studimi fjalën *bank*. Kuptimet e fjalës *bank* në fjalitë 1, 2 dhe 3 përkapen si tri kuptime të ndryshme vetëm duke iu referuar referentit, në këtë rast “ndërtesës”, “personelit” dhe “institucionit”. Për këtë arsye, për momentin do t’i referohemi si *polisemi referuese*.

Nga ana tjetër, Allen Kruz-i (Alan Cruise)<sup>197</sup> i shpjegon këto ndryshime kuptimore duke iu referuar aspekteve. *Banka* i referohet një objekti me të paktën tre aspekte – “rrethinat”, “stafi” dhe “institucioni”. Përparësia e teorisë së tij është se në këtë nivel semantik ndërthuret dhe një nivel tjetër, i cili lejon të bëhet dallimi midis polisemisë reale (aspektet e ndryshme të *bankës*) dhe varianteve kuptimore

---

<sup>196</sup> Këta shembuj janë marrë nga CD-ROM, model i Korpusit Kombëtar Britanik (British National Corpus CD-ROM Sampler) shpërndarë nga Departamenti Informatik i Shkencave Humane, Universiteti i Oksford-it, 1999, te Pierre Frath *Polysemy, homonymy and reference*, <http://u2.u-strasbg.fr/spiral/Equipe/Pierre/Articles/AMB-ART.RTF>

<sup>197</sup> Cruise, A. D. *Polysemy and related phenomena from a cognitive linguistic viewpoint*, te *Computational Lexical Semantics*, Studies in NLP Cambridge University Press, 1995.

kontekstuale (përdorimet e secilit aspekt). Problem i vetëm në këtë teori ka të bëjë me mbivendosjen kuptimore. P.sh., nëse themi *I hate this bank (E urrej këtë bankë)* cilit aspekt i referohemi? “ Stafit”, “institucionit” apo “ndërtesës”?

Më tej, Xhorxh Klaibër-i (George Kleiber)<sup>198</sup> ofron një teori tjetër referuese, e njohur si *metonimia intriguese*, ku në kushte të caktuara, një pjesë e objektit përdoret për të tërën ose anasjelltas. Teoritë e metonimisë kanë si qëllim të shpjegojnë se si ne jemi në gjendje që me një fjalë të vetme të përqëndrohemi në shumë pjesë të objektit ose tek objekti në tërësi. Përgjigjja qëndron në një nga tiparet e përgjithshme të gjuhës: përzgjedhja e një aspekti në veçanti nuk përjashton aspektet e tjera apo tërësinë. Ato qëndrojnë në sfond.

Në lidhje me poliseminë, ne jemi gjithnjë në kërkim të një lidhjeje kuptimore midis kuptimeve të ndryshme, ndërsa në rastin e homonimisë nuk ndodh një gjë e tillë.

Në fjalët polisemantike, shpesh mund të gjejmë lidhjen kuptimore midis kuptimeve ose çfarë ndodh zakonisht, lidhjen metaforike dhe metonimike. P.sh., ngjashmëria e fjalës *bank,/ë-a* “institucion financiar, ku depozitohen para” dhe *banka e gjakut* “vendi ku depozitohet gjaku”, është e dukshme dhe gjithkush mund ta kuptojë lidhjen metaforike midis këtyre dy kuptimeve. Në disa raste, kjo lidhje kuptimore nuk është gjithmonë e qartë, si p.sh., tek fjala *operacion* kemi të bëjmë me një operacion në mjekësi apo në ushtri?

E quajtur ndryshe *polisemi leksikore*, kuptimet e prejardhura të kësaj njësie nuk renditen në formën e një vargu (si tek teoria lineare), por kanë një lidhje përfshirëse, ku kuptimet e veçanta përmbliken në një kategori më të gjerë (skema semantike e tufës).

Në krahasim me kuptimet e fjalëve 6, 7 dhe 8, ne nuk arrijmë të dallojmë këtë lidhje kuptimore sikurse ndodh te polisemia dhe kjo mund të jetë për dy arsye. Së pari, dikur ka ekzistuar një fije semantike e përbashkët, një lidhje referuese, por tashmë ajo është harruar. Fjalët në anglisht *bank mound, bank of Albania, river bank* kanë një lidhje etimologjike; vijnë nga fjala gotike *benc*, që dikur ka pasur kuptimin e *një pirgu të vogël*. Më pas është përdorur si metaforë për bregun e lumit dhe për një tavolinë të vogël, veçanërisht për tavolinën ku bankierët bënin shkëmbimin e parave. Si rezultat, kemi në italisht *banca*, frëngjisht *banque* dhe anglisht *bank*. Në rastin e kuptimeve homonimike, ato janë larguar aq shumë, sa lidhjen e tyre nuk e kapin menjëherë.

Po kështu, në gjuhën shqipe vëmë re se sipas temës semantike të emrit *çakall*, - i, janë formuar dy fjalë në mënyrë të pavarur me drejtime të ndryshme homonimike: *çakalle, -ja* <sub>1</sub> (1. *Trakza e mullirit të blojës*; 2. *Mandalli i derës*; 3. *Njeri llafazan dhe çakalle, -ja*<sup>2</sup>) (1. *Dhi me brirë të drejtë përpyetë*; 2. *Dhi me qime të kuqërreme si të çakallit*). Në rastin e fjalës së parë, kemi një vijë të lëvizjes semantike që shkon nga kafsha tek angullima e saj, nga angullima te zhurma e trakzes së mullirit, nga zhurma e trakzës te trajta e saj dhe nga kjo, te mandallja e derës ose nga zhurma e trakzës te njeriu llafazan. Ndërsa në fjalën e dytë kemi një vijë tjetër semantike, të pavarur nga vija e parë; pra, nga kafsha te drejtimi i veshëve nga ky

---

<sup>198</sup> Kleiber, G. *Problèmes de sémantique. La polysémie en questions*, Presses Universitaires du Septentrion te Pierre Frath *Polysemy, homonymy and reference*, 1999.  
<http://u2.u-strasbg.fr/spiral/Equipe/Pierre/Articles/AMB-ART.RTF>

tipar te dhia me brirët përpjetë ose nga kafsha te ngjyra e qimeve, nga ky tipar te dhia e kuqërreme.<sup>199</sup>

Së dyti, nuk ka ekzistuar kurrë ndonjë lidhje kuptimore. Thjesht kemi një përputhje fonetike të fjalëve prej rrënjësh krejt të ndryshme, përputhje që është arritur historikisht gjatë ndryshimeve fonetike të kryera brenda gjuhës. P.sh., në anglisht kemi *there* “atje”; *their* “i, e atyre”; *they’re* “ata janë” ose në gjuhën shqipe *verë* I “stinë” rrjedh nga fjala latine *ver-is*, kurse *verë* II nga *lat. vinum*.

Me fjalë të tjera, kjo lidhje është harruar sepse referenti që shërbeu si baza e metaforës dhe metonimisë nuk ekziston më ose nuk ka pasur kurrë një referent të tillë. Sipas këtij këndvështrimi, mund të ndodhë që një fjalë apo togfjalësh të shënojë disa objekte njëheraz, sepse këto referentë kanë një farë ngjashmërie faktike apo formale, ndonjëherë edhe rastësore. Nëse kjo ngjashmëri midis objekteve është e motivuar, atëherë ne jemi të prirur t’i grupojmë fjalët që i shënojnë si elemente të një grupi, të lidhura nga ana semantike. Por, nëse ngjashmëria nuk është e motivuar, ne mendojmë se janë homonime.

Homonimia dhe polisemia janë emërtime për mospërputhjet e skalitura në veprimtarinë tonë referuese; polisemia është *referuese* kur një objekt lidhet me përdorime të ndryshme të së njëjtës fjalë; polisemia është *leksikore* kur disa objekte që nuk kanë asnjë ngjashmëri lidhen me përdorimet e ndryshme të së njëjtës fjalë. Atëherë fenomeni quhet *homonimi*.

Si përfundim, mund të themi se dallimi ndërmjet polisemisë dhe homonimisë nuk është i lehtë për t’u përcaktuar. Nga e gjithë kjo analizë del qartë se nuk kemi të bëjmë me dy dukuri në kundërshti absolute me njëra-tjetrën. Përkundrazi, këtu flasim për një shkallëzim formal dhe kuptimor, ku polisemia dhe homonimia largohen gradualisht për t’u vendosur në të dy skajet e kësaj vijimësie.

Më tej, nuk mund të flasim për një kriter të vetëm që do të na ndihmonte të bënim këtë dallim, por duhet të shikojmë një sërë kriteresh me qëllim që të vendosim mbi shkallën e lidhjes apo dallimin formal e kuptimor të leksemave. Lajëns-i nënvizon se dallimi ndërmjet homonimisë dhe kuptimit të shumëfishtë, mbetet së fundi i përcaktuar dhe arbitrar.<sup>200</sup>

Një trajtim më praktik ndaj çështjes së polisemisë dhe homonimisë, mund të kishim duke marrë në shqyrtim rastet e mëposhtme.

- a. Nëse dy kuptime të së njëjtës formë u përkasin fushave të ndryshme leksikore, atëherë ato duhet të trajtohen si homonime<sup>201</sup>. Për shembull, homonimet e gjuhës shqipe:

*bie* I jokal. “rrezohem nga një vend i lartë”

*bie* II kal. “mbart diçka nga vendi ku është dhe e sjell afër, sjell”

si dhe të asaj angleze:

<sup>199</sup> Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Botimet EDFa, Tiranë, 2009, f.200.

<sup>200</sup> Lyons, J. *Introduction to theoretical linguistics*, Cambridge University Press, 1968, f. 406.

<sup>201</sup> Kastovsky, D. *Wortbildung und Semantik*, 1982 te Lipka, L. *English Lexicology, Lexical structure, Word semantics and Word-formation*, Gunter Narr Verlag Tubingen, 2002, f. 156.

*row I* em. “rresht, rradhë”

*row II* em. “vozitje”

*row III* em. “potere”

pavarësisht strukturës së tyre mjaft të zhvilluar semantike, përbërësit e tyre kuptimorë u përkasin fushave të ndryshme leksikore duke mos u kryqëzuar me njëra-tjetrën.

- b. Dy leksema që janë homonimike formojnë një vatër më vete semantike e fjalëformuese. Ato vendosin lidhje të reja në sistemin e gjuhës dhe fjalët që formohen prej temës së tyre fjalëformuese janë të ndryshme.

Pr kemi homonime kur lidhja kuptimore e fjalëve nuk duket më, kur nuk dallojmë dot ndonjë bosht kuptimor midis tyre<sup>202</sup>. Për ta ilustruar marrim nga një shembull në gjuhën shqipe dhe atë angleze:

*kalori I* em. “tërësia e kalorësve” (kalorës, kalorësi, kalorazi)

*kalori II* em. “njësia e matjes së nxehtësisë” (kalorike, kalorifer)

*sound I* mb. “i shëndetshëm” (soundly, soundless)

*sound II* em. “tingull” (sound-box, sound-track, soundless, soundlessly)

*sound III* jokal. “tingëllon, kumbon” (sounding-board)

*sound IV* em. “sondë”

*sound V* kal. “mat me sondë thellësinë e ujit” (sounding-rod, soundings)

*sound VI* em. “ngushticë”

- c. Testi i sinonimisë

Disa studiues shprehen se zëvendësimi i kuptimeve të ndryshme të fjalëve nga sinonime mund të ndihmojë për të dalluar fjalët homonimike nga fjalët polisemantike. Kjo mënyrë dallimi e polisemisë nga homonimia në letërsi emërtohet si *kriter etimologjik*.

Në qendër të tij është nxjerrja në pah e lidhjes sinonimi - polisemi - homonimi. Nëse variantet kuptimore të fjalës mund të zëvendësojnë dhe bëjnë pjesë në të njëtin varg sinonimesh, atëherë mund të themi se këto kuptime janë polisema; nëse këto variante kuptimore zëvendësohen me sinonime të ndryshme, është arritur shpërbërja e polisemisë dhe kemi të bëjmë me homonime. P.sh., *çoj I* “dërgoj, *çoj II* “ngre lart”; *bie I* “rrëzohem”, *bie II* “sjell”, *bie III* “godas”.

Po kështu, në gjuhën angleze kemi *voice I* “tinguj të shqiptuar gjatë të folurit” (tingull); *voice II* “mënyrë për të shqiptuar tingujt gjatë të folurit” (tingull);

<sup>202</sup> Thomai, J. S. *Leksikologjia shqipe (për shkollat e larta)*, Tiranë, 1961, f. 30.

*voice III* “vibracion i kordave vokale në tinguj të shqiptuar” (tingull); *voice IV* “forma e foljes që shpreh lidhjen e kryefjalës dhe të veprimit”. *Voice I - voice II - voice III* nuk janë homonimike në karakter, megjithëse ato kanë kuptime të ndryshme për shkak se ato mund të zëvendësohen nga fjala sinonimike *sound* (tingull). Ndërsa për sa i përket fjalës *voice IV*, ajo është homonimike me tri kuptimet e para, sepse kuptimi i katërt i fjalës *sound* “tingull” nuk mund të zëvendësohet me tri kuptimet e para të fjalës *voice* (dmth., kuptimin e analizuar të fjalës *sound* “tingull”).

d. Testi i bashkërenditjes <sup>203</sup>

Le të sjellim një shembull:

*He played tennis in the afternoon and Hamlet in the evening.*

(Ai luajti tenis mbasdite dhe Hamleti në mbrëmje.)

Një kusht i domosdoshëm për bashkërenditjen është barazvlefshmëria e formave që bashkëlidhen. Ato, gjithashtu, duhet të kenë përndarje të njëjtë edhe në ndërtime të tjera në të gjitha fjalitë e një gjuhe.<sup>204</sup> Në fjalinë e mësipërme folja *play* del me dy kuptime: kur ajo është kalimtare “luaj një rol në teatër” dhe kur është jokalimtare “luaj për të kaluar kohën apo për t’u argëtuar”. Sipas këtij testi, mund të vërtetojmë se nuk kemi të bëjmë me një leksemë të vetme, por me dy leksema të ndryshme; ato nuk mund të lidhen me bashkërenditje pasi nuk përmbushin kushtin kryesor të saj.

Kjo fjali nxjerr në pah një çështje tjetër lidhur me dallimin ndërmjet polisemisë dhe homonimisë, nëse foljet kalimtare dhe jo kalimtare do të konsiderohen si dy leksema të veçanta apo si e njëjta leksemë. Shpërndarja e tyre sintaksore, rrjedhimisht, nuk është e njëjtë dhe për të klasifikuar dy leksema si të ngjashme, ato duhet të ndajnë edhe tipare të njëjta sintaksore. Në thelb, kuptimi leksikor i këtyre dy varianteve të së njëjtës fjalë nuk ndryshon; i vetmi ndryshim qëndron në lidhjet që ato vendosin në fjali, dmth., foljet kalimtare lidhen me emra në kallëzore a dhanore, ato jokalimtare nuk hyjnë në lidhje të tilla. Duke u mbështetur në këtë arsyetim dhe për sa kemi thënë më lart, këto variante do t’i konsiderojmë si homonimike.

Rrjedhimisht, nëse barazvlefshmëria sintaksore do të merret si një kusht i domosdoshëm për dallimin ndërmjet polisemisë dhe homonimisë, çka nënkupton se deri ku do të shkojmë me analizën klasifikuese të leksemave, kjo do të çonte në identifikimin e një numri më të madh leksemash<sup>205</sup>.

e. Testi i përkthimit (ose i krahasimit me gjuhë të huaja)

<sup>203</sup> Kastovsky, D. *Wortbildung und Semantik*, 1982 te Lipka, L. *English Lexicology, Lexical structure, Word semantics and Word-formation*, Gunter Narr Verlag Tubingen, 2002, f. 156.

<sup>204</sup> Lyons, J. *Semantics 2*, Cambridge University Press, 1977, f. 405.

<sup>205</sup> Po aty f. 561.

Një tjetër mjet me karakter praktik që na ndihmon ndonjëherë për të bërë dallimin polisemi / homonimi është krahasimi me gjuhë të huaja ose përkthimi; p.sh., *bar I* - ang. “grass” dhe *bar II* - ang. “medicament” etj.

f. Testi morfologjik

Kjo metodë është tipike për gjuhën angleze. Ky lloj testi nënkupton që polisemia dhe homonimia karakterizohen nga fjalëformim i ndryshëm. Për shembull, për fjalën *park I* “vend për të qëndruar dhe për t’u çlodhur”. Nga kjo fjalë, duke i shtuar prapashtesën “-ed”, në gjuhën angleze formohet fjala e re “*parked*”. Ndërsa në rastin e fjalës *park II* “vend për të mbajtur automjetet”, fjala e re që formohet prej saj është “*parking*”, me ndihmën e prapashtesës “-ing”.

Për të pasur kritere sa më objektive dhe që janë më të vlefshme në rrafshin sinkronik, duhet të marrim në shqyrtim një tipologji kriteresh, të cilat janë kryesisht me bazë referenciale dhe lidhje kuptimore që qëndron ndërmjet leksemave. Për më tepër, duhet t’i referohemi edhe *vendit që fjala zë në sistemin e sotëm të gjuhës shqipe*<sup>206</sup>; duke shqyrtuar kështu ndërlidhjet e fjalëve me njëra-tjetrën, lidhjet që kjo fjalë ka sot me sendet e konceptet, lidhjet me vargjet e fjalëformimit, lidhjet leksikore (antonimike, sinonimike, të fushës semantike, frazeologjike), lidhjet morfologjike e sintaksore dhe ato të përdorimit stilistik.

Në këtë mënyrë, përveç kriterëve të karakterit semantik, që janë edhe më të rëndësishmit, duhen marrë edhe kriteret formale si plotësuese. Nga njëra anë, kriteret semantike dhe ato paradigmore lidhen me vetë fjalën, duke e parë atë nga një këndvështrim i brendshëm; nga ana tjetër, valencat leksikore e sintaksore dhe përndarja sintaksore janë kritere që e shqyrtojnë fjalën sipas tipareve që realizohen jashtë kufijve të saj.

Është e qartë se kriteret e dallimit ndërmjet polisemisë dhe homonimisë nuk kanë të njëjtën vlerë në gjuhë të ndryshme. Në gjuhë si shqipja, kriteri flektiv (përgjithësisht paradigmantik) ka vlerë të veçantë, ndërsa në gjuhë si anglishtja ky kriter pothuajse nuk vlen fare dhe ndërkaq kriteri i lidhjeve leksiko - sintaksore (sintagmatike) mund t’i shërbejë mirë këtij dallimi. Për më tepër, në gjuhë flektive mpleksen edhe fjalët (leksemat) me trajtat e fjalëve (format morfo-sintaksore)<sup>207</sup>, si p.sh., *natën* – trajta e emrit në rasën kallëzore dhe *natën* ndajf.; ose *i fundit* em. në rasën gjinore me *i fundit* mb.; *anës* em. në rasën dhanore / rrjedhore dhe *anës* ndajf. e *anës* paraf. etj. Në këtë rast, në thelbin e kuptimit të fjalës së re ka hyrë edhe komponentja semantike gramatikore e rasës, kurse në temën e vet burimore fjala e re është një formë fjale.

<sup>206</sup> Lloshi, Xh. *Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, te *Studime mbi Leksikun dhe mbi Formimin e Fjalëve në Gjuhën Shqipe*, Mihal Duri, Tiranë, 1972, f. 227 – 233.

<sup>207</sup> Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Botimet EDFa, Tiranë, 2009, f. 208.

#### 4. 4. Parametra të dallimit polisemi / homonimi sipas Najlëdi Sikar Dash-it (Niladri Sekhar Dash)

Mjaft interes paraqet edhe studimi i Najlëdi Sikar Dash-it mbi poliseminë dhe homoniminë. Sipas tij dallimi i dy llojeve të fjalëve vjen më i qartë duke parashtruar disa parametra të përcaktimit të kufirit midis tyre<sup>208</sup>.

Shumë fjalë homonimike mund të shfaqen si polisemantike në një tekst. Megjithatë, analiza e origjinës, formës dhe kuptimit të tyre mund të ndihmojë për t'i izoluar ato nga grupi i fjalëve polisemantike, për të vendosur identitetin e tyre leksiko - semantik të aprovuar në gjuhë. Për të krijuar një kufi të dallueshëm midis të dy llojeve të fjalëve, janë propozuar të aplikohen parametra të ndryshëm, të cilat janë përmbledhur më poshtë:

- a. Polisemi quhet ekzistenca e më tepër se një specifikimi semantik për të njëjtën njësi leksikore. Homonimi, në të kundërt, quhet ekzistenca e më tepër se një specifikimi morfologjik, që ndan të njëjtin prezantim fonologjik dhe /ose ortografik (forma e shkruar).<sup>209</sup>
- b. Ndërsa fjalët polisemantike kanë një dhe vetëm një prejardhës etimologjik, homonimet nuk lidhen etimologjikisht.<sup>210</sup>
- c. Zgjidhja më e mirë e fjalëkryqit polisemi / homonimi është të kërkohet një thelb kuptimor. Në këtë mënyrë, fjalët homonimike që ndajnë të njëjtin kuptim thelbësor, pa diskutim që do të cilësohen si polisemantike.<sup>211</sup>
- d. Një fjalë që është polisemike do të ketë një shumëllojshmëri sinonimesh, secila duke i korresponduar një prej kuptimeve. Për më tepër, ajo, gjithashtu, do të ketë një grup antonimesh. Është tunduese të shprehemi se atje ku antonimi është i njëjtë, ka polisemi dhe se ndryshimi i antonimeve do t'i referohej homonimisë.<sup>212</sup>
- e. Paqartësia në format homonimike nuk ka mundësi të rezistojë në një diskutim të zgjatur, çka nuk mund të jetë e vërtetë për fjalët polisemike.<sup>213</sup>
- f. Në polisemi fjalët lidhen semantikisht dhe ndryshimet kuptimore vijnë nga përdorimi metaforik. Në homonimi fjalët janë të ndryshme në kuptime, të cilat përgjithësisht nuk kanë lidhje.<sup>214</sup>
- g. Në rastin e polisemisë, fjalët regjistrohen në fjalor nën një zë leksikografik dhe kuptimet e tyre të shumta normalisht listohen me numra seri, të shoqëruar me shembuj përdorimi në kontekste të ndryshme. Në rastin e homonimisë, fjalët homonimike listohen në fjalor nën zëra të ndryshëm leksikografikë. Në fjalorët e zakonshëm, homonimet ju përkasin zërave të veçantë leksikografikë.<sup>215</sup>

<sup>208</sup> Dash, N. S. *Polysemy and Homonymy*

[http://www.cfilt.iitb.ac.in/wordnet/webhwn/IndoWordnetPapers/08\\_iwn\\_PolysemyandHomonymy.pdf](http://www.cfilt.iitb.ac.in/wordnet/webhwn/IndoWordnetPapers/08_iwn_PolysemyandHomonymy.pdf)

<sup>209</sup> Cituar po aty [Leech, G. *Semantics*, Penguin, London, 1976, f. 230.]

<sup>210</sup> Cituar po aty [Yule, G. *The Study of Language: An Introduction*, CUP, Cambridge, 1985, f. 86.]

<sup>211</sup> Cituar po aty [Todd, L. *An Introduction to Linguistics*, Longman York Press, Essex, 1987, f. 80.]

<sup>212</sup> Cituar po aty [Palmer, F. R. *Semantics*, CUP, Cambridge, 1995, f. 107.]

<sup>213</sup> Cituar po aty [Kreidler, Ch. W. *Introducing English Semantics*, Routledge, London, 1998, f. 55.]

<sup>214</sup> Cituar po aty [Ravin, Y. dhe Leacock, C. *Polysemy: An overview*. In Ravin, Y. dhe Leacock, C. (eds.) *Polysemy: Theoretical and Computational Approaches*, OUP Inc., New York, 2000, f. 26.]

<sup>215</sup> Cituar po aty [Allan, K. *Natural Language Semantics*, Blackwell, Oxford, 2001, f. 42 – 43.]



Pavarësisht strategjive të pohuara më lart, dallimi ndërmjet dy llojeve të fjalëve, nuk ka qënë kaq e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë. Kjo për faktin se fjalët që janë të lidhura etimologjikisht, me kalimin e kohës largohen aq shumë sa lidhjet e tyre semantike të origjinës nuk janë më të kuptueshme.<sup>216</sup> Për më tepër, kuptimet e lidhura etimologjikisht, nuk janë gjithmonë të lidhura në leksikun mendor të përdoruesve; përkundrazi, ka raste kur forma të palidhura etimologjikisht, ndihen të jenë të lidhura në leksikun mendor.<sup>217</sup>

Për më tepër, si përdorues të gjuhës, njerëzit shpesh gjejnë një lidhje metaforike midis këtyre formave dhe synojnë të përshtasin të kuptuarit e tyre të fjalëve sipas kësaj. Në këtë mënyrë, nga një pikpamje historike, çfarë është një homonimi mund të rezultojë nga një konvergjencë aksidentale e formave dhe të rinterpretohet si një rast polisemie.<sup>218</sup> Megjithatë, duket se rruga e dallimit midis dy llojeve të fjalës është plot labirinte.

Duke marrë në konsideratë gjithë këto argument, disa kriteret e përgjithshme mund të sigurohen (shih tabelën e mëposhtme) si shenja të rëndësishme funksionale midis dy llojeve të fjalëve.

Tabela 4.1. Polisemia përkundrejt homonimisë

| <b>Kriteri</b>            | <b>Polisemi</b>                 | <b>Homonimi</b>                        |
|---------------------------|---------------------------------|--|
| Ekzistenca                | Niveli i fjalës                 | Niveli i fjalës                        |
| Struktura                 | Formë e njëjtë                  | Forma të ngjashme                      |
| Forma e shkruar           | Nuk varion në të shkruar        | Mund të variojë në të shkruar          |
| Shqiptimi                 | Nuk ka variacion                | Variacion në shqiptim                  |
| Shumëllojshmëri në kuptim | Shumica për shkak të kontekstit | Për shkak të kuptimit dhe etimologjisë |
| Konteksti                 | Luan një rol të rëndësishëm     | Nuk ka rol për të luajtur              |

Si përfundim, mund të themi se për arsye të ndryshme që lidhen me qartësinë konceptuale dhe aplikimet praktike ekziston një nevojë reale për të bërë dallimet midis sistemit principal të poli-semantizmit / shumëkuptueshmërisë (polisemisë) dhe konvergjencës së rastësishme ortografike dhe /ose shqiptimore (homonimisë). Në këtë pjesë të punimit u shpalosën disa ide mbi natyrën dhe formën e polisemisë dhe homonimisë, u shqyrtuan dhe krahasuan ndryshime të tyre të formës dhe të funksionit dhe u hodh dritë mbi disa probleme të pazgjidhura brenda të kuptuarit teorik të

<sup>216</sup> Cituar po aty [Ravin, Y dhe Leacock, C. *Polysemy: An overview*. Tek Ravin, Y dhe Leacock, C (eds.) *Polysemy: Theoretical and Computational Approaches*, OUP Inc., New York, 2000, f. 26.]

<sup>217</sup> Cituar po aty [Ullman, S. *Semantics: An Introduction to the Science of Meaning*, Oxford, Blackwell, 1962, f. 164.]

<sup>218</sup> Cituar po aty [Leech, G. *Semantics*, Penguin Books, 1976, f. 229.]

polisemisë dhe homonimisë në kontekst me konceptualizimin dhe paqartësinë e kuptimit të fjalës.

Megjithatë, disa studiues si Moravsik-i (Moravsick)<sup>219</sup> pranojnë rëndësinë e të analizuarit të variacionit kuptimor të fjalëve, por ata nuk mbështesin atë që përcaktimi e të gjitha niveleve të mundshme dhe potencialeve të variacionit kuptimor të sigurohen në leksik, sepse kjo mund të dëmtojë rëndë produktivitetin dhe fleksibilitetin e përdorimit të gjuhës. Fleksibiliteti është i domosdoshëm sepse në çdo fazë, çdo gjuhë nuk mund të shpalosë qartë çdo kuptim.

Të kuptuarit e dallimit midis polisemisë dhe homonimisë është i rëndësishëm në korrigjimin e informacionit, ku shumë dokumenta të rëndësishme të paraqitura në një formë mjaft të ngushtë, tashmë ndihen më mirë se sa nën ndikimin e të përkthyerit automatik.

Dhe akoma mbetet një çështje e hapur nëse duhet mbështetur linja e argumentit të Moravsik-it (2001) apo t'i bashkohemi grupit të gjuhëtarëve kompjuterikë, të cilët preferojnë të kuptojnë dallimin midis polisemisë dhe homonimisë dhe po ashtu, të sigurojnë të gjitha variacionet e kuptimit të fjalëve në leksik, të mundshme dhe potenciale për të kapërxyer problemet e shumta praktike dhe konceptuale të paqartësive dhe kthjellimit kuptimor.

#### 4.5. Polisemia dhe homonimia nga këndvështrimi leksikografik

Gjatë punës për hartimin e një fjalori duhet të ketë përputhje dhe uniformitet në trajtimin e fjalëve polisemantike dhe homonimike. Leksikografit i duhet të aplikojë parime uniforme për të vendosur se çfarë duhet të hyjë nën një dhe të njëjtin zë leksikografik dhe se si të trajtohen njësitë leksikore që kanë forma bazë identike [Stivënsen (Stevensén)]<sup>220</sup>. Leksikografi nuk duhet të përpiqet t'i bëjë kuptimet e vetme më të dallueshme nga njëra-tjetra ose duhet të përpiqet t'i bëjë kuptimet e ndryshme të lidhura më ngushtë se sa jepet nga të dhënat [Zgësta (Zgusta)].<sup>221</sup>

Parimet kryesore të hartimit të fjalorëve pasqyrohen në renditjen e njësisë leksikore sipas zërave leksikografikë, ku fjalët jepen në trajtën e tyre përfaqësuese. Ndërsa në fjalorët dygjuhësh apo edhe njëgjuhësh të gjuhës angleze jepet informacioni lidhur me shqiptimin e kësaj fjale. Pjesa më e madhe e folësve të gjuhës angleze janë të ndërgjegjshëm për faktin se forma e shkruar dhe shqiptimi i fjalëve nuk përputhen me njëra-tjetrën. Gjithashtu, ata e marrin të mirëqënë faktin se kur dy fjalë japin më vete në fjalorë, ato përbëjnë dy njësi të ndryshme leksikore edhe pse mund të shkruhen njësoj.

Megjithatë, kur flasim për pasqyrimin e homonimeve dhe fjalëve polisemantike në fjalor, çështja nuk është dhe aq e vështirë në rastin kur kemi dy fjalë, si: *night* “natë” dhe *knight* “kalorës”, pasi për nga forma e shkruar ato përbëjnë dy fjalë të ndryshme që paraqiten nën zërin e tyre përkatës leksikografik.

<sup>219</sup> Cituar po aty [Moravsick, J. M. *Metaphor; creative understanding and the generative lexicon*. Te Bouillon, P dhe Busa, F. (eds.) *The Language of Word Meaning*, CUP, Cambridge, 2001, f. 261.]

<sup>220</sup> Svensén, B. *A Handbook of Lexicography: The Theory and Practice of Dictionary - Making*. Cambridge: Cambridge University Press, 2009.

<sup>221</sup> Zgusta, L. *Manual of Lexicography*. The Hague/Paris: Mouton, 1971.

Fakti se këto fjalë përputhen në formën e tyre tingëllore, nuk është dhe aq i rëndësishëm për leksikografin. Ky është një informacion dytësor që nuk paraqitet në mënyrë të drejtpërdrejtë në fjalor. Por, kur kemi të bëjmë me fjalë që nga përbërja tingullore janë të ngjashme si: *match* <sub>I</sub> “ndeshje” dhe *match* <sub>II</sub> “shkrepse” ose *match* <sub>III</sub> “përshtat”, atëherë problemi bëhet edhe më i vështirë. Leksikografi nuk mbështetet vetëm në trajtën përfaqësuese të fjalës, por edhe në kuptimin e saj, për të vendosur nëse kemi të bëjmë me një njësi leksikore me shumë kuptime apo me dy njësi leksikore me kuptime të mëvetësishme.

Ka edhe raste më të ndërlikuara si te fjala *bank*. Si do të paraqiten kuptimet e saj në fjalor, si pjesë të një strukture të vetme semantike nën një zë leksikografik apo në dy apo më shumë zëra leksikografikë? Të gjitha këto çështje nuk zgjidhen vetëm në rrafshin sinkronik. Ato kanë nevojë për një prerje vertikale të problemit.

Çështja e dallimit të homonimisë ka një rëndësi të veçantë për leksikografin. Ai duhet të caktojë kufijtë kuptimorë për secilën njësi leksikore që pasqyrohet si zë leksikografik (fjalë titull). Por nuk mjafton një kriter për të bërë dallimin ndërmjet tyre. Gjithsesi, sipas parimit të përgjithshëm që leksikografi ndjek, homonimet janë fjalë që nuk kanë asnjë lidhje kuptimore dhe etimologjike me njëra-tjetrën, por në mënyrë rastësore janë të ngjashme për nga shqiptimi dhe forma e shkruar. Ndërsa te fjalët polisemantike, identifikojmë një lidhje semantike dhe etimologjike ndërmjet kuptimeve të cilat janë formuar si rrjedhojë e përdorimeve metonimike dhe metaforike të fjalëve.

Paraqitja e polisemisë në leksikografinë tradicionale kërkon renditjen e të gjitha kuptimeve të fjalës, grupin e këtyre kuptimeve sipas përbërësve kuptimorë që ata ndajnë me njëri-tjetrin. Kështu kemi paraqitjen e saktë të makrostrukturës dhe mikrostrukturës semantike të secilit zë e më pas shpjegimin e përmbajtjes së këtyre kuptimeve. Edhe pse midis fjalorëve mund të ketë ndryshime lidhur me numrin e kuptimeve që një fjalë polisemantike mund të ketë, në përgjithësi, si folësit e gjuhës ashtu edhe leksikografët nuk janë të një mendjeje lidhur me shkallën e zhvillimit të polisemisë brenda një fjale të caktuar. Problem kryesor në ndërtimin e artikullit për çdo fjalë, është zbërthimi dhe përcaktimi i drejtë i kuptimeve të ndryshme të fjalës dhe dallimi i lidhjeve reale, të përpikta midis kuptimeve dhe ngjyimeve të tyre.

Ngjyrimet e kuptimit janë ndarje të imta brenda kuptimit, të cilat mund të zhvillohen si rrjedhojë e përdorimit të fjalës në një kuptim të caktuar – të kufizuar apo në kushte të ndryshme – që ndikojnë në zhvillimet kuptimore. Këto ngjyime krijohen dhe kushtëzohen nga rrethana lidhur me ngushtimin dhe zgjerimin kuptimor. Në këtë rast, vështirësi të veçantë paraqesin fjalët shënuese, të cilat kanë kuptime e përdorime të shumta, me zhvillime e lidhje të shumëllojshme e të ndërlikuara kuptimore.

Kur një fjalë ka dy ose më shumë kuptime, këto renditen në mënyrë të tillë që të ruhen e të tregohen qartë lidhjet dhe varësia midis kuptimeve të ndryshme të fjalës, ku këto lidhje janë të dukshme dhe të kapshme. Në përgjithësi, në fillim vendoset kuptimi i përgjithshëm dhe më i njohur, e më pas kuptimet e tjera sipas shkallës së dendurisë dhe përhapjes që kanë në sistemin e gjuhës.

Zgësta vjen me një ide mjaft interesante lidhur me çështjen polisemi / homonimi nga këndvështimi leksikografik. Sipas tij<sup>222</sup> homonimia gjendet në mënyrën se si folësit kuptojnë dhe interpretojnë kuptimin ose kuptimet e formave

<sup>222</sup> Po aty f. 74.

identike. Ai argumenton se homonimia fillon në momentin kur folësit e një gjuhe nuk janë në gjendje të konceptojnë që kuptimet e ndryshme të jenë të lidhura. Kur kuptimet e vetme të një fjale humbin lidhjen e tyre, fjala dhe kuptimi i saj mund të ndahen në dy. Zgësta shpreh keqardhje për këtë gjë duke u shprehur se mënyra e vetme për të përcaktuar këtë është të bazohemi te interpretimi subjektiv i folësve. Kjo pikëpamje është mjaft interesante dhe konstaton interpretimet subjektive të folësve. Kjo pikëpamje përfshin faktin se nëse interpretimet e folësve përputhen me etimologjinë e të tjera kritere të dallimit polisemi / homonimi, atëherë interpretimi i tyre do të pranohet.

Sipas Zgësta-s<sup>223</sup> interpretimi i folësve varet shumë nga niveli i tyre i edukimit. Gjithashtu, një njohuri e plotë mbi kulturën e njerëzve, mënyrën e jetesës dhe historinë e tyre është, gjithashtu, e pandashme. Ai argumenton se, kur leksikografët merren me polisemi dhe homonimi, është mirë që ata të verifikojnë opinionet e tyre duke testuar opinionet ndërsubjektive të folësve të gjuhës, që kanë një nivel edukimi përfaqësues të arsyeshëm dhe zotërim të gjuhës. Leksikografët, gjithashtu, do të bënin mirë të konsideronin traditën leksikografike të gjuhës, nëse ekziston një e tillë.

Në vazhdim të asaj që Zgësta sugjeron, gjithashtu, nevojitet që leksikografët të konsultohen me burime historike dhe punime mbi kulturën e traditat e gjuhës. Kjo është një rrugë e gjatë, që i përball ata me shumë interpretime, të cilat i ndihmojnë ata për të konfirmuar gjetjet e tyre në fjalor.

Megjithatë, dallimi midis polisemisë dhe homonimisë nuk është gjithmonë i qartë. Ka shembuj kur është e vështirë të vendosim, nëse kemi të bëjmë me polisemi apo homonimi. Dallimi midis polisemisë dhe homonimisë është një çështje e diskutueshme për gjuhëtarët dhe leksikografët. Megjithatë, një numër kriteresh janë parashtruara nga gjuhëtarë dhe leksikografë në përpjekje për të përcaktuar kufijtë midis të dyja grupeve të fjalëve.

#### **4.6. Polisemia dhe homonimia në leksikografinë kompjuterike**

Leksikografia kompjuterike dhe si ajo i vjen në ndihmë përkthimit kompjuterik (të automatizuar) është një çështje tjetër me rëndësi lidhur me poliseminë dhe homoniminë. Kjo çështje shihet në rrafshin sinkronik. Në gjuhësinë e zbatuar, përkthimi kompjuterik është një nga çështjet më të rëndësishme. Ekzistenca e një leksiku mjaft të gjerë me burime leksikore të një cilësie shumë të lartë, me qëllim që sistemi kompjuterik të lexojë dhe të analizojë tekstin e më pas të realizojë përkthimin e tij, është një nga kërkesat themelore të përkthimit kompjuterik.

Leksikografia kompjuterike është më shumë e orientuar drejt zhvillimit të metodologjive dhe strategjive, të cilat e bëjnë krijimin e leksikut më të lehtë dhe më të shpejtë me anë të përfuturit automatik të të dhënave nga korpuset gjuhësore, nga interneti ose nëpërmjet thithjes së tyre nga burimet ekzistuese.

---

<sup>223</sup> Po aty f. 75.

Sistemi i kompjuterizuar duhet të jetë në gjendje që të përballet me disa probleme të qënësishme për gjuhët natyrale, si për shembull, tipet e ndryshme të dykuptimësisë; kuptimet e figurshme të fjalëve; poliseminë dhe homoniminë.

Polisemia dhe homonimia janë problemet më të shpeshta leksikore që hasen gjatë përkthimit kompjuterik. Leksiku që përdoret në sistemet e përkthimit kompjuterik, duhet të përmbajë një informacion të shumëllojshëm dhe të pasur, që mbulon të gjitha nivelet e përshkrimit gjuhësor. Ne mund të identifikojmë vështirësitë që hasen, duke i shqyrtuar nivelet një nga një:

- në nivelin fonologjik: homografia:           - *tear* <sub>I</sub> em. “gris”  
  - *tear* <sub>II</sub> fol. “lot”
- në nivelin morfologjik: homonimia:       - *back* <sub>I</sub> em. “kurrizi”  
  - *back* <sub>II</sub> ndajf. “mbrapa”  
  - *back* <sub>III</sub> fol. “të ecësh mbrapsht”
- në nivelin sintaksor: realizimi në sintagmë:       - *know* <sub>I</sub> fol. “njoh dike”  
  - *know* <sub>II</sub> fol. “di, kam njohuri”
- në nivelin semantik: homonimia:           - *seal* <sub>I</sub> em. “fokë”  
  - *seal* <sub>II</sub> em. “vulë”  
  - *seal* <sub>III</sub> fol. “vulos”
- polisemia p.sh., *get* “shkoj, bëhem, merr, marr, gjej, fitoj, kap, duhet, kuptoj, filloj, kam, etj.”
- hapësira leksikore p.sh., në gjuhën angleze nuk bëhet dallimi për *uncle* “xhaxha, dajo”

E vërteta është se nuk mund të gjejmë asnjëherë burime të mjaftueshme leksikore për t’iu përgjigjur këtyre problemeve, të cilat mund të jenë të pranishme në çdo sistem të përkthimit kompjuterik.

Polisemia dhe homonimia shtrojnë një problem tjetër lidhur me leksikografinë elektronike. Korpuset gjuhësore elektronike duhet të jenë të pasura dhe me informacion të bollshëm dhe njëkohësisht duhet të jenë të përditësuara dhe të thithin informacion nga burime të ndryshme. Kjo bëhet për të pasqyruar zhvillimin e vazhdueshëm të gjuhës dhe të plotësojnë nevojat dhe problemet që mund të dalin gjatë procesit të përkthimit.

I njëjti problem përsëritet edhe në korpuset elektronike lidhur me trajtimin e polisemisë dhe homonimisë. Megjithëse, korpuset elektronike rezultojnë të pasura

me burime leksikore, vihet re që kuptimet homonimike dhe polisemike të fjalëve nuk dallohen nga njëra-tjetra. Po sjellim një shembull për ta ilustruar:

Tabela 4.2. Kërkimi i fjalës *sow* në korpusin elektronik, British National Corpus (Korpusi Kombëtar Britanik)<sup>224</sup>

|          |                                  |   |   |   |   |  |
|----------|----------------------------------|---|---|---|---|--|
| <u>1</u> | <u>AC</u><br><u>W</u>            | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | the open gate, the wooden ramp covering the steps and the first huge saddle-back <b>sow</b> ambling down into the yard. The pigs were being craven towards the back door     |
| <u>2</u> | <u>AR</u><br><u>3</u>            | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | The hospitality of the host, and to spend his energies solely in trying to <b>sow</b> discontent and suspicion. Such persons are not only socially repugnant, in the climate |
| <u>3</u> | <u>AS</u><br><u>D</u>            | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | were offered a hare tricked out with wings to look like Pegasus, a wind <b>sow</b> with its belly full of live thrushes, quinces stuck with thorns to look like              |
| <u>4</u> | <u>B</u><br><u>M</u><br><u>R</u> | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | her brearily. Thought you were going to start doing your imitation of a sleeping <b>sow</b> any moment'. The tone of voice revealed the intensity of disgust,                |
| <u>5</u> | <u>BN</u><br><u>C</u>            | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | Beneath the bed, and she had never moved so fast, would the fat <b>sow</b> never rise? She must need to feed the bairn. Winnie grimaced and bore                             |
| <u>6</u> | <u>BP</u><br><u>8</u>            | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | In the bracken and forests are bleak. I could colonise you with gifts, <b>sow</b> a garden, reap a harvest in you, label you with nicknames as my                            |

<sup>224</sup> <http://corpus.byu.edu/bnc/?c=bnc&q=22675971>

|    |                       |   |   |   |   |   |
|----|-----------------------|---|---|---|---|---|
| 7  | <u>C9</u><br><u>8</u> | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | They don't need altering at all.'she hesitated, not wishing to <b>sow</b> the seeds of rebellion in Martha.' What a pity your father is so                          |
| 8  | <u>CD</u><br><u>Y</u> | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | To turn her into an Anglo-irish lady.' Ye'll not make this particular <b>sow</b> 's ear into a silk purse, young fella-me-lad!<br>Lily, about to                    |
| 9  | <u>CE</u><br><u>H</u> | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | Now the ship greyhound outline of a frigate but rather that of a clumsy old <b>sow</b> with submarine piglets suckling beside her.'<br>It's bigger than you'd think |
| 10 | <u>G0</u><br><u>L</u> | <u>W</u><br><u>f</u><br><u>ict</u><br><u>pros</u><br><u>e</u> | A | B | C | Use that influence. Klaus Buhle, through his papers and television interests, can <b>sow</b> the seed or us. He can defend us, can separate us from the             |

Kuptimet homonimike të njësisë leksikore *sow* I “dosë” dhe *sow* II “mbjell duke hedhur farat” nuk paraqiten të ndara nga kuptimet polisemantike. Kuptimet në fjalitë 1, 3, 4, 5, 8, 9 në korpus i përkasin *sow* I ndërsa kuptimet 2, 6, 7, 10 i përkasin *sow* II, të cilat dalin si kuptime polisemantike, si rezultat i kërkimit që i është bërë fjalës në kontekst (KWIC)<sup>225</sup>. Në këtë korpus renditet një listë e gjatë kuptimesh pa bërë asnjë ndarje ndërmjet polisemisë dhe homonimisë. Kjo gjë e vështirëson më tepër përzgjedhjen e kuptimit të duhur.

Futja e një informacioni të gjerë morfo-sintaksor është parë si zgjidhja më e mirë për të shmangur dykuptimësinë gjatë përkthimit kompjuterik. Korpuset elektronike që hartohen në bazë të informacionit mbi përndarjen e njësisë leksikore, sipas veçorive të tyre morfologjike, janë më efikase ndaj shmangies së dykuptimësisë leksikore.

Korpuset elektronike përmbajnë katër nivele të informacionit gjuhësor, atë të përfaqësimit fonologjik, morfologjik, sintaksor dhe semantik. Përshkrimi i plotë i njësisë leksikore përfshin një informacion minimal në lidhje me secilin nivel të

<sup>225</sup> Mënyrat e kërkimit në një korpus elektronik ndryshojnë në varësi të qëllimit të kërkimit, nëse kërkon të marrësh informacion mbi shpeshhtësinë e një fjale apo kontekstin në të cilin ajo del. KWIC = Key Word in Context, që nënkupton kërkimin e fjalës kyçe në kontekste të ndryshme. Përveç këtij konteksti të shkurtër që del në këtë tabelë, ka edhe një kontekst më të zgjeruar, si edhe të dhëna mbi burimin se nga ku janë tërhequr.

përshkrimit gjuhësor. Si i tillë, në nivelin fonologjik jepet informacion mbi veçoritë fonologjike të njësisë leksikore; niveli morfologjik ofron informacion lidhur me kategorinë gramatikore dhe paradigmën e kësaj njësie, ndërsa informacioni sintaksor përshkruan veçoritë e qënësishme dhe situatësore të njësisë leksikore në një strukturë të dhënë sintaksore. Informacioni semantik merr për bazë teorinë e përfaqësimit semantik sipas teorisë së Leksikut Gjenerativ të Pustejovski-t (Pustejovsky)<sup>226</sup>. Sipas kësaj teorie, njësia semantike modelohet në katër nivele të ndryshme të përfaqësimit semantik. Secili nivel përshkruan përbërësit kuptimorë, përcakton llojin e ngjarjes që shënohet, përshkruan kontekstin semantik dhe pozicionon këtë njësi në hierarkinë e marrëdhënieve semantiko-sintaksore që ajo ka me njësitë e tjera të leksikut.

Katër nivelet e informacionit gjuhësor bëjnë një dallim më të hollë ndërmjet aspekteve të ndryshme të kuptimit të fjalës dhe natyrës së marrëdhënieve sintagmatike e paradigmatiche me njësitë e tjera leksikore. Kjo është arsyeja pse korpuset elektronike ofrojnë informacion të gjerë dhe të pasur, sidomos në nivelin semantik. Si rezultat, klasifikimi semantik i përbërësve kuptimorë është i mjaftueshëm për të bërë dallimin midis kuptimeve polisemantike dhe homonimike.

---

<sup>226</sup> Pustejovsky, J. *The generative lexicon*, *Computational Linguistics*, 17(4), (1991) 409-441.

Disa fjalë polisemike, duket se janë të paktën pjesërisht sistematike. Pustejovski 70, propozon që studiuesit e gjuhës të mbështeten te cilësitë e objektit, që nënkuptohet nga fjala, në ato që janë aspekte të njohura në mënyrën, se si i perceptojnë ato objektet. Katër janë cilësitë kryesore, pjesë përbërëse të objektit që nënkupton fjala; forma, pamja e jashtme, funksioni që kryen dhe origjina. Mund ta njohim poliseminë e fjalës *fast* “i shpejtë”, sipas dy shembujve të shprehur më poshtë. Kështu, në rastin e një *fast car* “makinë e shpejtë” paraqet shpejtësia në lidhje me kryerjen e funksionit të synuar për transportin e njerëzve, kurse në rastin e *fast food*, shpejtësia në lidhje me përgatitjen dhe shpërndarjen. Edhe në gjuhën shqipe kjo gjen përngjashmërinë si në shembullin “ecën shpejt” dhe “zgjohet shpejt” Për më tepër, cilësitë e objektit që shpreh fjala janë një mënyrë të kuptuari, se si të vendosim një kuptim të përgjithshëm, në një larmi kuptimesh të zgjeruara. Te shprehja “The ham sandwich at table 7 is getting restless” (personi te tavolina 7 nuk duket i qetë), togfjalëshi “ham sandwich” nuk i referohet pjesëve përbërëse të sandwich-it, por personit që përfshihet në këtë aktivitet, në përcaktimin e funksionit që synon “sandwich”.

Ka dy mënyra kryesore për të studiuar kuptimin e fjalës: e para në lidhje me fjalët e tjera dhe e dyta në lidhje me botën që na rrethon. Metoda tradicionale që përdoret në fjalor, është përcaktimi i një fjale, duke përdorur terma të fjalëve të tjera. Në fund të fundit, kjo metodë është ciklike, meqenëse duhet të përcaktojmë fjalët në funksion të fjalëve të tjera që përdorim, në funksion të asaj që ato shprehin dhe sipas përkufizimit që japim.



## KAPITULLI V

### KLASIFIKIMI I HOMONIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE

Në kreun e III-të përqëndrohem tek klasifikimi i homonimeve, i cili është po aq i rëndësishëm sa pikat e tjera të lartpërmendura.

Autorë shqiptarë dhe të huaj kanë studiuar me hollësi çështjen e klasifikimit të homonimeve në punime të tyre. Duke u bazuar në to, vëmë re se nuk ka një klasifikim të veçantë të homonimeve si në shqip dhe në anglisht. Çështja është interpretuar nga këndvështrime të ndryshme dhe si rezultat është arritur në klasifikime të llojeve të ndryshme, bazuar në kritere të ndryshme.

#### 5.1. Klasifikimi i homonimeve në gjuhën shqipe

##### 5.1.1. Klasifikim i homonimeve sipas Jani Thomait

Në gjuhën shqipe numërohen rreth 500 çifte ose vargje homonimesh të tipave të ndryshëm, që përfshijnë rreth 1050 fjalë. Jani Thomai në librin “Prejardhja semantike në gjuhën shqipe”<sup>227</sup> duke u bazuar në *parimin etimologjik* i klasifikon homonimet në dy grupe të mëdha. Për këtë klasifikim ai është mbështetur në të dhëna të *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, *Fjalorit të gjuhës shqipe* dhe *Studime etimologjike në fushë të shqipes* të Eqrem Çabej.

- **homonime pa lidhje etimologjike** janë rreth 220 çifte ose vargje. Këtu gjuhëtari dallon tri nëngrupe:

**a. homonime rrënjësh të ndryshme pa lidhje etimologjike** p.sh., *çap*, -i I “hap” dhe *çap*, -i II “zagar, lingua”; *re*, -ja I “grumbull avujsh uji, që rrinë pezull në qiell”, *re*, -ja II “nota e dytë e shkallës muzikore”, *re*, -ja III “nusja e shtëpisë”, *re*, -ja IV “fytyrë, çehre” dhe *re*, -ja V “leje, urdhër” (shqipja e vjetër); *mitër*, -a I “organ i gruas dhe i femrës së gjitarëve ku zihet e zhvillohet pjella”, *mitër*, -a II “bisk i vogël i të lashtave, mitë” dhe *mitër*, -a III “kësulë e lartë me dy maja, që mbajnë peshkopët dhe krerët e tjera” etj.

Homonimet e këtij grupi krijohen midis fjalëve shqipe, midis fjalëve shqipe e të huazuara, midis fjalëve të huazuara ose në mënyrë të gërshetuar.

Në këtë grup nuk mund të krijohet skemë e prejardhjes semantike, pasi nuk ka prejardhje semantike.

**b. homonime pa lidhje etimologjike, që janë formuar si fjalë nga rrënjë të ndryshme** p.sh., *gazoj* I “ngop me gaz karbonik ujin” (nga *gaz*, -i I) dhe *gazoj* II “e vë në lojë, tall dikë” (nga *gaz*, -i II); *ftohëm* I “marr të ftohtë” (nga *ftoh*) dhe *ftohëm* II “më ftojnë diku” (nga *ftoj*); *rendoj* I “rendit” (nga *rend*, -i) dhe *rendoj* II “grij në rende” (nga *rende*, -ja); *ngrihem* I “çohem në këmbë” (nga *ngre*) dhe *ngrihem* II “ngrij” (nga *ngrij*) etj.

Megjithëse nuk vijnë nga shpërbërja e polisemisë, këto homonime lidhen me prejardhjen semantike për arsye se kemi kalime nga një njësi leksikore në një

<sup>227</sup> Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 177 – 184.

njësi të re, me kuptim të ri, që trashëgon temën semantike, por që ka pësuar edhe ndryshime.

**c. homonime që janë ndarë si të tilla që në gjuhën e huaj** p.sh., *notë*, -a I “shenjë që përfaqëson një tingull muzikor”, *notë*, -a II “vlerësim i shkallës së njohurive ose i sjelljes së nxënësve” dhe *notë*, -a III “letër zyrtare që i dërgohet një shteti tjetër”; *revistë*, -a I “botim periodik” dhe *revistë*, -a II “rreshtim i trupave ushtarakë për inspektim para fillimit të një parade”; *legjendë*, -a I “gojëdhënë” dhe *legjendë*, -a II “shenjat e posaçme dhe shpjegimet që jepen poshtë ose anës një harte”; etj.

Pra, disa çifte homonimike kanë hyrë në gjuhën shqipe duke qënë homonime edhe në gjuhën e huaj nga janë huazuar. Në këtë mënyrë bashkë me fjalët shqipja ka huazuar edhe lidhjet e tyre homonimike.

- **homonime me lidhje etimologjike** (prejardhje) janë rreth 280 çifte ose vargje homonimike, me rreth 560 fjalë. Kjo do të thotë se pjesa më e madhe e homonimeve në gjuhën shqipe kanë lidhje kuptimore. Edhe këtu dallohen tri nëngrupe.

**a.** Pjesën më të madhe të homonimeve të këtij tipi e përbëjnë ato që kanë dalë nga zbërthimi i polisemisë. Ndryshe njihen si **homonime semantike**. P.sh., *akrep* I “kafshë e vogël helmuese” dhe *akrep* II “secila nga shigjetat në fushën e sahatit”; *bojë* I “lëndë për të lyer” dhe *bojë* II “shtat”; *arrëz*, -a I “rruaza e parë e qafës”, *arrëz*, -a II “pyll me arra, arrishtë” dhe *arrëz*, -a III “bimë barishtore njëvjeçare”; *bojë* I “lëndë e lëngshme për të lyer” dhe *bojë* II “shtat”, të dyja fjalët e kanë origjinë nga turqishtja *boj* “ngjyrë” dhe *boj* “shtat, lartësi njeriu”, por ndoshta ndarja në fjalë homonimike është bërë në gjuhën shqipe; *dhjetëshe* I “dhjetë njëshe” dhe *dhjetëshe* II “revole me dhjetë fishekë”; etj.


**b.** Grupin e dytë e përbëjnë ato që quhen **homonime të prejardhura**, homonimet që kanë dalë nga e njëjta temë, prej kuptimesh të ndryshme ose prej një kuptimi të saj ose prej temash të ndryshme me prapashtesa homonimike, kryesisht të një pjese të ligjeratës dhe me lidhje të drejtpërdrejtë, të prejardhjes semantike. P.sh., *bebe*, -ja I “foshnjë” dhe *bebe*, -ja II “vrinë e vogël dhe e rumbullakët në të zezën e syrit” (nga *bebe*)<sup>228</sup>; *hapës*, -i I “çelës” (nga *hap*) dhe *hapës*, -i II “punëtor që merret me hapjen e gropave, të puseve etj.” (nga *hap*); *ditar*, -i I “tërësia e shënimeve të përditshme a të kohëpaskohshme” (nga *ditë*) dhe *ditar*, -i II “njësi mase për tokën, afërsisht e barabartë me sipërfaqen, që mund të lërojë një pendë qe në një ditë” (nga *ditë*); etj.

Në varësi të natyrës së prejardhjes semantike të homonimeve në këtë grup, J. Thomai bën shtatë dallimet e mëposhtme (shtatë struktura të prejardhjes semantike).<sup>229</sup>

<sup>228</sup> Çabej, E. *SE II*, 187 – 188, *bebe* I është fjalë e gjuhës së fëmijës, e përdorur në shumë vende të botës; *bebe e syrit* mund të jetë një përkthim i fjalës turke *gözbebeği*, d.m.th. një kalk semantik, po me rrugë polisemie.

<sup>229</sup> Thomai, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 198 – 205.

1. Zhvillimin e homonimeve nga i njëjti kuptim i së njëjtës fjalë. Këto homonime ruajnë lidhje të forta kuptimi, për arsye se tema semantike është e përbashkët dhe njëkohësisht e njësuar dhe e ndarë.



2. Nga kuptime të ndryshme të së njëjtës fjalë zhvillohen drejtpërdrejt njësi leksikore homonimike.

*djeg* - *djegës*, ~ *i<sub>I</sub>* “punëtori që djeg furrën për pjekjen e tullave e të tjegullave”

*djeg* - *djegës*, ~ *i<sub>II</sub>* “bimë barishtore me gjethe vezake ...”

3. Nga kuptime të ndryshme të së njëjtës fjalë zhvillohen njësi leksikore homonimike, por të prejardhura në shkallë të ndryshme.

*ballë* – *balluk*, ~ *u<sub>I</sub>* “balluku i samarit”

*ballë* – *balluk*, *e*, ~ *ja* – *balluk*, ~ *u<sub>II</sub>* “cjap me balluke”

4. Nga kuptimi i një fjale zhvillohet një njësi leksikore e nga një kuptim i saj zhvillohet një njësi tjetër leksikore homonimike me të.

*dredh* – *dredhëz*, ~ *a<sub>I</sub>* “luleshtrydhe” – *dreshëz*, ~ *a<sub>II</sub>* “zbukurim...”

5. Nga kuptimet e fjalëve homonimike zhvillohen njësi leksikore homonimike.

*ngjit<sub>I</sub>* - *ngjitem<sub>I</sub>* - *ngjitje<sub>I</sub>*

*ngjit<sub>II</sub>* - *ngjitem<sub>II</sub>* - *ngjitje<sub>II</sub>*

6. Nga kuptimet e dy njësive johomonimike formohen njësi leksikore homonimike.

*fik* – *fikës<sub>I</sub>* “vegël që fik zjarrin”

*fik* – *fikës<sub>II</sub>* “beng” (ushqehet me fiq)

7. Strukturë e përzier e prejardhjes:

*fill* – *fillor / e* ~ *ja<sub>I</sub>* “mbulesë leshi e endur me një faqe”

*fill* - *fillor / e*, ~ *ja<sub>II</sub>* “drugë”

*fill* - *fillor / e*, ~ *ja<sub>III</sub>* “shkolla filllore”

c. Grupin e tretë të këtij tipi e përbëjnë **homonimet** kryesisht **pjesësh shërbyese**, që kanë dalë nga kalimi prej një kategorie leksiko-gramatikore në një tjetër me lidhje semantike të drejtpërdrejta dhe pa ndonjë format. P.sh., *brenda* *I* ndajf. “në vendin a në hapësirën që përfshijnë kufijtë e diçkaje” dhe *brenda* *II* parafj. [brenda dhomës]; *ku* *I* ndajf. [ku je?],

Duke vazhduar përsëri me Jani Thomain te libri “Leksikologjia e gjuhës shqipe”<sup>230</sup>, ai i ndan homonimet e gjuhës shqipe në **homonime të plota** dhe **homonime të pjesshme**.

**Homonime të plota (ose të mirëfillta)** janë të njëjta me homonimet e plota leksikore që do të përmendim më poshtë. Sipas J. Thomai këto janë fjalë që tingëllojnë njësoj, kanë përmbajtje leksikore krejt të ndryshme, por janë të së njëjtës kategori leksiko-gramatikore (dmth., dy emra, dy folje, dy mbiemra etj.). Kjo përbën homonimi të plotë sepse fjalët homonimike përputhen në të gjitha trajtat e tyre dhe nganjëherë edhe në fjalët e prejardhura prej tyre. P.sh., foljet *pjek* *I* “vë në zjarr” dhe *pjek* *II* “takoj” zgjedhohen njëllotj: *piqni*, *poqa*, *piqja*, *kam pjekur*, *do të pjek etj.* Vëmë re që këto fjalë përputhen në të gjitha trajtat. Nga foljet *pjek* *I* dhe *pjek* *II* krijohen dy emra veprimi *pjekje* *I* dhe *pjekje* *II*, të cilat janë homonime, gjithashtu. Po kështu janë homonime të plota *nis* *I* “filloj një punë” dhe *nis* *II* “stolis, zbukuroj”, si edhe fjalët që krijohen prej tyre *nisem* *I* / *nisem* *II*; *nisje* *I* / *nisje* *II*; *i nisur* *I* / *i nisur* *II*; *i panisur* *I* / *i panisur* *II*.

**Homonime të pjesshme** janë fjalë që përputhen pjesërisht ndërmjet tyre. Këto përputhje zakonisht ndodhin ndërmjet trajtave të veçanta të fjalëve, që zakonisht u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës (p.sh., trajta e një emri me trajtën e një foljeje etj.). Sipas J. Thomai këto variante homonimesh ndryshe quhen **homonime leksiko-gramatikore**, sepse fjalët tingëllojnë njëllotj, por kuptimet leksikore dhe kuptimet gramatikore i kanë të ndryshme dmth., këto fjalë u përkasin kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore.

Më tej J. Thomai duke marrë parasysh *shqiptimin, formën e shkruar (grafike) dhe kuptimin e fjalës*, i ndan homonimet leksiko-gramatikore në tri lloje: **homofoma**, **homografe** dhe **homofone**. Ky klasifikim konsiderohet si më i pranueshmi dhe më i përhapuri i homonimeve si në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Ai është i njëjtë për të dyja gjuhët.

**1. Homofomat (ose homonime absolute)**<sup>231</sup>, siç i quan Rami Memushaj) në gjuhën shqipe janë më të shumta se llojet e tjera, ndryshe nga anglishtja ku mbizotërojnë homofonet. Homofomat krijohen si rezultat i përputhjes së formave të veçanta të fjalëve të ndryshme p.sh.

| <b>folje</b>      | <b>emër</b>        |
|-------------------|--------------------|
| <i>vesh</i>       | <i>vesh</i>        |
| <i>qepa (qep)</i> | <i>qepa (qepë)</i> |
| <i>pata (kam)</i> | <i>pata (patë)</i> |
| <i>zë</i>         | <i>zë (zëri)</i>   |

<sup>230</sup> Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë, 1999, f. 47 – 48.

<sup>231</sup> Memuashaj, R. *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 172.

|                 |                            |
|-----------------|----------------------------|
| <i>ka (kam)</i> | <i>ka (kau)</i>            |
| <i>çaj</i>      | <i>çaj (çaji)</i>          |
| <i>qe (jam)</i> | <i>qe (qetë)</i>           |
| <i>fik</i>      | <i>fik (fiku)</i>          |
| <i>bredh</i>    | <i>bredh (bredhi) etj.</i> |

Po kështu *bashkë (bashka em.)* dhe *bashkë (ndajf.)*, *përdhes (përdhesi, em.)* dhe *përdhes (mb.) etj.*

Në gjuhën shqipe homofoma janë edhe trajtat përfaqësuese të mbiemrave dhe të emrave që kanë dalë prej tyre, si p.sh., *plak (mb.) - plak (em.)*; *i ri (mb.) - i ri (em.)*; *e verdhë (mb.) - e verdhë (e verdha e vezës, em.)*; *e drejtë (mb.) - e drejtë (e drejta qytetare, e drejta e votës, em.) etj.*

**2. Rastet e homofoneve**, dmth., të fjalëve që përputhen vetëm në shqiptim, por që shkruhen ndryshe, janë të rralla në gjuhën shqipe dhe vërehen kryesisht në ligjërimin dialektor; p.sh., *lak* ( fol. *lag* kur shqiptohet me bashkëtingëlloren fundore të shurdhuar) dhe *lak (laku, emër)*; *krimi* (em. *krimbi* kur shqiptohet me grupin -mb të asimiluar) dhe *krimi* “ dhunim i rëndë i ligjit, që ka si pasojë dënimin” etj.

**3. Homografet** në gjuhën shqipe dallohen nga theksi i ndryshëm dhe mund të jenë të një pjese të ligjeratës ose të pjesëve të ndryshme të ligjeratës. Si edhe homofomat, homografet janë përputhje të rastit të formave të veçanta të fjalëve krejt të ndryshme; p.sh., *ári* “metal i çmuar me ngjyrë të verdhë” dhe *arí* (ariu) “gjitarr mishngrënës i egër”; *bári* “bimë e njomë, e blertë” dhe *barí* (bariu) “ai që ruan bagëtinë”; *púsi* “gropë e thellë që hapim në tokë për të nxjerrë që andej ujë” dhe *pusí* (pusia) “pritë”; *fóle* (e kryera e thjeshtë e foljes *flas*, veta II) dhe *folé* (foleja) “çerdhe” etj.

Gjithashtu, në gjuhën shqipe, janë gjithmonë homografe, emri (mashkullor i shquar), që shënon një njeri sipas detyrës a funksionit, me emrin (femëror të pashquar të formuar me prapashtesën -i), që shënon degën, fushën, vendin etj., me të cilët lidhet njeriu; p.sh., *argjendári -argjendarí* (argjendaria); *bletári - bletarí* (bletaria); *drejtóri - drejtorí* (drejtoria); *punëtóri - punëtorí* (punëtoria); *ministri - ministri* (ministria) etj.

### 5.1.2. Klasifikim i homonimeve sipas Xhevat Lloshit

Në gjuhën shqipe homonimet duke marrë si kriter *kuptimin* (kuptimin leksikor dhe atë gramatikor) klasifikohen në: **homonime leksikore, leksiko – gramatikore** dhe **homonime të pjesëve të ligjeratës**.

Sipas Xh. Lloshi **homonime leksikore** janë homonimet e mirëfillta, të cilat janë dy ose më shumë fjalë, të cilat tingëllojnë njësoj, kanë kuptime leksikore krejt të ndryshme dhe i përkasin të njëjtës pjesë të ligjeratës. Në gjuhën shqipe homonimet

leksikore i gjejmë më tepër midis emrave, janë të kufizuara ndërmjet foljeve, të rralla midis mbiemrave dhe shumë rrallë i ndeshim te pjesë të pandryshueshme të ligjeratës.

Duke u bazuar në shkallën e përputhjes së paradigmeve të tyre, gjuhëtari Xh. Lloshi<sup>232</sup> i klasifikon më tej **homonimet leksikore** në:

**a. homonime të plota leksikore**

**b. homonime leksikore të pjesshme**

Kur homonimet leksikore përputhen në të gjitha format e tyre gjatë ndryshimit sipas paradigmës, atëherë janë **homonime të plota leksikore**, p.sh., *shapkë* <sub>I</sub> “kasketë” dhe *shapkë* <sub>II</sub> “pandofla” dhe *shapkë* <sub>III</sub> “shaptore”. Këto janë forma që i përkasin të njëjtës pjesë të ligjeratës dhe dallimi qëndron vetëm tek kuptimi leksikor ose denotativ. Këto fjalë lakohen njëllëj: *shapka*, *shapkës*, *shapkën*, *shapkat*, *shapkave*, *shapkash* etj. dmth., përputhen në të gjitha trajtat. Po kështu *torte* <sub>I</sub> “litar i trashë, zakonisht prej lëkure bliri, që përdoret për të lidhur, për të mbartur a për të tërhequr barrë të rëndë” dhe *tortë* <sub>II</sub> “ëmbëlsirë në trajtë të rumbullakët a katërkëndëshe me përmasa të ndryshme”. Pjesa më e madhe e homonimeve në gjuhën shqipe bëjnë pjesë në këtë grup.

Kur nuk përputhen në një pjesë të formave, atëherë kemi **homonime leksikore të pjesshme**, p.sh., foljet *prek* <sub>I</sub> dhe *prek* <sub>II</sub>; *zihem* <sub>I</sub> dhe *zihem* <sub>II</sub> (nga zë dhe ziej); *shihet* <sub>I</sub> dhe *shihet* <sub>II</sub> (nga *shij* dhe *shoh*) etj. Ky klasifikim i homonimeve është mjaft i përhapur në gjuhën shqipe për shkak të karakterit sintetik dhe pasurisë flektive të saj.

Duke marrë parasysh një kriter tjetër, *rrugët e lindjes së homonimeve*, Xh. Lloshi<sup>233</sup> i nënklasifikon më tej **homonimet leksikore** në:

- **homonime etimologjike** (homonime nga dialektet dhe huazimet);
- **homonime të prejardhura** (homonime të lindura gjatë fjalëformimit);
- **homonime semantike** (nga zbërthimi i polisemisë).

**Homonime leksiko - gramatikore** janë dy ose më shumë fjalë që tingëllojnë njësoj, kanë kuptime leksikore krejt të ndryshme dhe kuptime gramatikore të ndryshme (u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës). Homonime të këtij lloji gjejmë midis emrave dhe mbiemrave, ndajfoljeve dhe parafjalëve etj., p.sh., *qepa* (emër) - *qepa* (folje); *kisha* (emër) - *kisha* (folje); *pata* (emër) - *pata* (folje); *mat* (emër) - *mat* (folje) etj. Këto janë indentike me homoformat që do të përmenden më poshtë. Bazuar në *rrugët e lindjes* së tyre, edhe homonimet leksiko-gramatikore ashtu si ato leksikore ndahen në:

<sup>232</sup> Lloshi, Xh. *Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*, te *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë 1972, f. 214 – 215.

<sup>233</sup> Po aty f. 214.

- **homonime etimologjike** (homonime nga dialektet dhe huazimet) p.sh., *bashkë* <sub>I</sub> (emër) - *bashkë* <sub>II</sub> (ndajfolje) rrjedhin nga dy rrënjë mjaft të largëta: *barshkë* dhe *baksk*<sup>234</sup>
- **homonime të prejardhura** (homonime të lindura gjatë fjalëformimit) p.sh., *përdhes* <sub>I</sub> “emër sëmundjeje” dhe *përdhes* <sub>II</sub> (mbiemër)
- **homonime semantike** (nga zbërthimi i polisemisë) p.sh., *shqipe* <sub>I</sub> “shqiponjë” dhe *shqipe* <sub>II</sub> “gjuha shqipe”. Dikur këto fjalë jepeshin si raste polisemie.

Megjithatë, studiues të ndryshëm janë shprehur në mënyra të ndryshme lidhur me homoniminë leksiko-gramatikore. Disa prej tyre janë të mendimit se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me homonime, por me polisemi, sepse këto fjalë ndryshojnë nga njëra-tjetra vetëm në funksionin sintaksor që ato kanë në varësi të kategorisë leksiko-gramatikore.

**Homonimet e pjesëve të ligjëratës (homonimet gramatikore)** janë fjalë që tingëllojnë njësoj, kanë kuptim leksikor të afërt, kuptim themelor gramatikor të ndryshëm dhe ju përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës, p.sh., *ndryshk* (folje) - *ndryshk* (emër); *plak* (emër) - *plak* (mbiemër); *përshesh* (emër) - *përshesh* (folje); *ngut* (emër) - *ngut* (folje); *kyç* (emër) - *kyç* (folje); *hap* (folje) - *hap* (emër); *hov* (emër) - *hov* (ndajfolje); *shtyp* (emër) - *shtyp* (folje) etj.

### 5.1.3. Klasifikim i homonimeve sipas Rami Memushajt

Rami Memushaj në librin “Hyrje në gjuhësi”<sup>235</sup>, vjen pothuaj me të njëjtën mënyrë klasifikimi të homonimisë në gjuhën shqipe si në rastet e lartpërmendura. Ajo që gjejmë të veçantë në librin e tij është ndarja e homonimeve në disa lloje nga *pikëpamja e prejardhjes*.

- a. Homonime të krijuara me **rrugë fonetike** prej fjalësh me rrënjë të ndryshme, që nëpërmjet evolucionit fonetik janë përputhur me njëra-tjetrën. Kështu *verë* <sub>I</sub> “stinë” rrjedh nga fjala latine *ver, -is*, kurse *verë* <sub>II</sub> nga fjala latine *vinum*; *plek* <sub>I</sub> “vë diçka në furrë” ka dalë nga një rrënjë më e vjetër *pek*, ndërsa *plek* <sub>II</sub> “takoj” rrjedh prej rrënjës *plek* etj.
- b. Homonimet **fjalëformuese** lindin brenda një gjuhe prej së njëjtës rrënjë ose temë dhe me të njëjtin mjet fjalëformues, por në mënyrë të pavarur prej njëra-tjetrës. P.sh., *verore* “zhabë e vogël” dhe *verore* “fije që varin në qafë fëmijët ditën e verës”; *dhiare* “bareshë dhish” dhe *dhiare* “rrugë e ngushtë nëpër brinja e male”; etj.
- c. Homonimet **leksiko-gramatikore** janë fjalë homonime, njëra prej të cilave ka lindur prej tjetrës nëpërmjet *konversionit*, domethënë duke ndryshuar klasën dhe funksionin gramatikor. Në këtë mënyrë janë formuar në gjuhën shqipe emra prej foljesh: *përshesh*, *mund* ose folje prej emrash: *ndryshk*, *myk*. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe mbiemra të panyjëtuar, të cilët përdoren edhe si emra, dhe formojnë

<sup>234</sup> Çabej, E. *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, I*, Tiranë, 1960, N.4, f. 47 - 48.

<sup>235</sup> Memushaj, R. *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 173 - 174.

çifte homonimike. P.sh., burrë *plak - plak* i mbajtur, repart *ushtarak - ushtarak* i nderuar etj.

- d. Homonimet *semantike*, të përfuara nga *shpërbërja e polisemisë*. P.sh., *fletë* I “gjethe” dhe *fletë* II “copë letre” kanë lindur në këtë rrugë. Fjalë dikur polisemantike sot janë homonimike. Ky tip është përmendur edhe më lart.

## 5.2. Klasifikimi i homonimeve në gjuhën angleze

### 5.2.1. Klasifikim i homonimeve sipas Uoltër Skit-it (Walter Skeat)

Në gjuhën angleze filologu Uoltër Skit (1835 – 1912) i klasifikoi homonimet në të njëjtën mënyrë si Jani Thomai në gjuhën shqipe. Duke marrë parasysh *shqiptimin, formën e shkruar (grafike) dhe kuptimin e fjalës*, ai i grupoi ato në:

#### 1. homonime perfekte

#### 2. homofone

#### 3. homografe

1. **Homonimet perfekte** në gjuhën angleze janë fjalë të njëjta në shqiptim dhe në të shkruar, por të ndryshme në kuptim si p.sh.,

*scale* em. “baza e sistemit të matjeve”

*scale* em. “luspa peshku”

*liver* em. “një person që jeton”

*liver* em. “veshka, organ në trupin e njeriut”

*case* em. “diçka që ka ndodhur”

*case* em. “kuti”

*bear* em. “ari”

*bear* fol. “mbart, transportoj, vuaj, prodhoj etj”

*flat* em. “apartament”

*flat* mb. “i rrafshët” etj.

2. **Homofonet** janë fjalë që tingëllojnë njësoj, por ndryshojnë në të shkruar dhe në kuptim. Edhe për këtë grup shembujt janë të shumtë:

*sea* (det) / *see* (shoh)

*piece* (pjesë) / *peace* (paqe)

*night* (natë) / *knight* (kalorës)

*steel* (çelik) / *steal* (vjedh)

*son* (bir) / *sun* (diell)

*rain* (shi) / *reign* (mbretërim)

*not* (jo) / *knot* (nyje)

*write* (shkruaj) / *rite* (rit)



|   |   |
|---|---|
| <i>air</i> (ajër) / <i>heir</i> (trashëgimtar)  | <i>scent</i> (aromë) / <i>cent</i> (cent) / <i>sent</i> (dërgova) |
| <i>him</i> (m.atë) / <i>himn</i> (himn)         | <i>buy</i> (blej) / <i>bye</i> (mirupafshim) / <i>by</i> (nga)    |
| <i>storey</i> (katëshe) / <i>story</i> (tregim) | <i>or</i> (ose) / <i>ore</i> (mineral) / <i>oar</i> (rrem)        |

Në fjalinë “The mill-*wright* on my *right* thinks it *right* that some conventional *rite* should symbolize the *right* of every man to as he pleases” (Mulli-ndërtuesi në të djathtën time ka të drejtë, që disa rite konvencionale duhet të zimbolizojnë të drejtën e çdo njeriu sipas dëshirës.) Tingulli kompleks [rait] është emër, mbiemër, ndajfolje dhe folje, pra ka katër gjermëzime të ndryshme dhe gjashtë kuptime të ndryshme.

Ndryshimi mund të vërehet edhe në përdorimin e gjermës kapitale si në rastin e *bill* dhe *Bill* në shembullin në vazhdim: “How much is my milk *bill*?” (Sa është *fatura* e qumshtit?); “Excuse me, Madam, but my name is *Bill*.” (Më falni zonjë, por emri im është *Bill*) etj.

**3. Homografet** janë fjalë të ndryshme në shqiptim dhe në kuptimin e tyre por rastësisht, të njëjta në formën e shkruar. P.sh.,

|                           |                                |                        |
|---------------------------|--------------------------------|------------------------|
| <i>bow</i> [bou] hark     | <i>row</i> [rou] radhë, rresht | <i>tear</i> [tɛə] gris |
| <i>bow</i> [bau] përkulem | <i>row</i> [rau] grindje       | <i>tear</i> [tiə] lot  |

|                                |                                 |                                    |
|--------------------------------|---------------------------------|------------------------------------|
| <i>lead</i> [li:d] drejtoj     | <i>sewer</i> [ˈsouə] rrobaqepës | <i>wind</i> [wind] erë             |
| <i>lead</i> [led] metal. plumb | <i>sewer</i> [sjuə] kanal       | <i>wind</i> [waind] gjarpëroj etj. |

Sipas Irina V. Arnold-it (Irina V. Arnold) është debatuar shpesh mbi çështjen e homografisë në gjuhën angleze. Disa gjuhëtarë mendojnë se homografia si dukuri duhet trajtuar jashtë homonimisë, sepse si objekt i gjuhësisë është gjuha e folur. Në përgjithësi, kjo pikëpamje nuk është pranuar. Për shkak të ndikimeve të edukimit dhe kulturës, anglishtja e shkruar është një formë kombëtare e përgjithshme e të shprehurit. Një folës i zakonshëm nuk e ndan formën e shkruar nga ajo e folur. Përkundrazi, ai parapëlqen t’i analizojë fjalët sipas gjermave dhe jo sipas fonemave me të cilat ai nuk është i familjarizuar. Kjo është arsyeja pse një gjuhëtar duhet të vlerësojë së bashku, formën e shkruar dhe shqiptimin e fjalëve kur analizon rastet e identitetit të formës dhe shumëllojshmërisë të përmbajtjes.<sup>236</sup>

Klasifikimi i lartpërmendur i homonimeve nuk është shumë i saktë dhe nuk reflekton tipare të caktuara të rëndësishme të këtyre fjalëve, dhe më e rëndësishmja, as statusin e tyre si pjesë ligjrate. Shembujt tregojnë që homonimet, së bashku, mund t’iu përkasin së njëjtës kategori gramatikore ose kategorive të ndryshme. Është e qartë, që një klasifikim i homonimeve duhet të reflektojë këtë tipar dallues. Gjithashtu, paradigmat e çdo fjale duhet të merren parasysh, sepse siç u vu re edhe në

<sup>236</sup> Arnold, I. *The English Word*, 1986.

gjuhën shqipe, paradigmat e disa homonimeve përputhen plotësisht, ndërsa të tjera përputhen pjesërisht.

### 5.2.2. Klasifikim i homonimeve sipas A. I. Smirnitski-it (A. I. Smirnitsky)

Një tjetër klasifikim u sugjerua nga A. I. Smirnitski<sup>237</sup>. Ai i shtoi klasifikimit të U. Skit-it një kriter më tepër, kuptimin gramatikor. Ai i nënndau grupet e homonimeve perfekte të Skit-it në dy lloj homonimesh: në *perfekte*, të cilat janë identike në të shkruar, në shqiptim dhe në formën gramatikore dhe në *homoforma*, të cilat përputhen në të shkruar dhe në shqiptim, por kanë kuptime të ndryshme gramatikore. Rrjedhimisht, A. I. Smirnitski i klasifikon homonimet në dy grupe të mëdha:

- **homonime të plota**
- **homonime të pjesshme**

**Homonimi e plotë** leksikore ndodh kur disa fjalë janë homonimike në të gjitha format e tyre. Ato i përkasin të njëjtës kategori gramatikore dhe kanë të njëjtën paradigmë. Ne ndeshim homonimi të plotë tek paradigmat e dy ose më shumë fjalëve të ndryshme.

P.sh., *seal*<sub>I</sub> em. “fokë” dhe *seal*<sub>II</sub> em. “vulë, vulë dylli ose plumbi”. Paradigmat e të dyja fjalëve (*seal – seal; seals – seals; seal’s – seal’s; seals’ – seals’*) janë të njëjta dhe kur i ndeshim jashtë një konteksti është e vështirë të gjykohet nëse është *seal*<sub>I</sub> apo *seal*<sub>II</sub>.

Shihet qartë se kur flasim për homonimi të plotë, ne flasim për fjalë homonimike. Shumica e homonimeve të plota gjenden brenda të njëjtës pjesë ligjrate p.sh., *band*<sub>I</sub> em. “shirit” dhe *band*<sub>II</sub> em. “orkestër”. Ndonëse rrallë, raste të homonimisë të plotë ndeshen edhe midis pjesëve të ndryshme të ligjeratës, p.sh.,

*for* [ fo:] paraf. “për”

*for* [ fo:] lidh. “sepse”

*four* [ fo: ] num. “num. katër”

Në raste të tjera, p.sh., *seal*<sub>I</sub> em. “fokë” dhe *seal*<sub>II</sub> fol. “mbyll fort, puthit”, ne shohim se megjithëse disa forma të këtyre fjalëve janë homonimike, paradigmat e tyre nuk janë të njëjta. Krahasojmë paradigmat e këtyre dy fjalëve:

*seal*<sub>I</sub>

*seal* (rasa emërore, numri njëjës)

*seal’s* (rasa gjinore, numri njëjës)

*to seal*<sub>III</sub>

*seal* (koha e tashme, veta e parë)

*seals* (koha e tashme, veta e tretë)

<sup>237</sup> <http://studentbank.ru/view.php?id=32196>

*seals* (rasa emërore, numri shumës)      *sealed* (koha e shkuar dhe pjesore)  
*seals'* (rasa gjinore, numri shumës)      *sealing* (pjesore me –ing)

Vetëm disa prej formave të tyre janë homonimike. Në këtë rast, ne nuk mund të flasim për fjalë homonimike, por për forma fjalësh homonimike ose ndryshe **homonimi të pjesshme**. Homonimet e pjesshme ndahen në tri nëngrupe:

- a. **Homonime të pjesshme leksiko - gramatikore të thjeshta** janë fjalë, të cilat i përkasin të njëjtës kategori gramatikore. Paradigmat e tyre kanë një ose disa forma identike (në të shkruar dhe/ose shqiptim). P.sh.,

*(to) found*, fol. (forma bazë) “krijoj, themeloj” :: *found*, fol. ( e shkuara e foljes *to find*) “gjeta”

*(to) bound*, fol. (forma bazë) “kërcej, hidhem” :: *bound*, fol. (e shkuara e foljes *to bind*) “lidha”

- b. **Homonime të pjesshme leksiko - gramatikore komplekse** janë fjalë, të cilat u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës, të cilat kanë vetëm një formë identike në paradigmat e tyre. P.sh.,

*know*, fol. [nou] “di” :: *no*, pjesëz [nou] “jo”

*knew*, fol. (koha e shkuar e *know*) [nju:] “dija” :: *new*, mbi. [nju:] “e/i ri”

*knows*, fol. (koha e tashme, veta e tretë e *know*) [nouz] “di” :: *nose*, em. [nouz] “hunda”

- c. **Homonime të pjesshme leksikore** janë fjalë, të cilat i përkasin të njëjtës pjesë ligjrate dhe janë identike vetëm në forma të tyre korresponduese. P.sh.,

*lie* fol. (koha e tashme, veta e parë) “shtrihem”

*lie* fol. (koha e tashme, veta e parë) “gënjej”

*lies* (koha e tashme, veta e tretë, nj.) “shtrihet”

*lies* (koha e tashme, veta e tretë, nj.) “gënjen”

*lay* (koha e shkuar) “u shtriva”

*lied* (koha e shkuar) “gënjeva”

*lain* (pjesore) “shtrirë”

*lied* (pjesore) “gënjyer”

### 5.2.3. Klasifikim i homonimeve sipas I. V. Arnold-it (I. V. Arnold)

Një klasifikim mjaft i detajuar është dhënë edhe nga Irina Vladimirovna Arnold-i<sup>238</sup> (1908 - 2010). Ajo klasifikon vetëm homonimet perfekte dhe sugjeron katër kritere të klasifikimit të tyre: 1) kuptimin leksikor 2) kuptimin gramatikor 3) format bazë (ose format përfaqësuese) dhe 4) paradigmën. Sipas këtyre kritereve, ajo rezulton në grupet e mëposhtme homonimike:

a. Homonime identike në kuptimet e tyre gramatikore, format përfaqësuese dhe paradigmën, por të ndryshme në kuptimet e tyre leksikore. P.sh.,

*board*, em. “këshill”

*board*, em. “copë druri e prerë hollë, dërrasë”

b. Homonime identike në kuptimet e tyre gramatikore dhe format përfaqësuese, por të ndryshme në kuptimet leksikore dhe paradigmën. P.sh., *(to) lie* (gënjëj) dhe *(to) lie* (shrihem).

*(to) lie*, fol. (forma bazë) – *lied* (koha e shkuar) – *lied* (pjesore)

*(to) lie*, fol. (forma bazë) – *lay* (koha e shkuar) – *lain* (pjesore)

c. Homonime që ndryshojnë në kuptimet e tyre leksikore, paradigmën, por përputhen në format e tyre përfaqësuese. P.sh.,

*light*, em “dritë” - *lights* (numri shumës)

*light*, mb. “i, e lehtë” - *lighter* (shkalla krahasore) - *the lightest* (shkalla sipërore)

d. Homonime të ndryshme në kuptimet leksikore, kuptimet gramatikore, në format përfaqësuese dhe paradigmën, por përputhen në një prej formave të paradigmave të tyre. P.sh.,

*a bit*, ndajf. “pak”

*bit*, fol. “kafshoi” (koha e shkuar e foljes *to bite*)

<sup>238</sup> <http://yukari-h.livejournal.com/37896.html>

#### 5.2.4. Klasifikim i homonimeve sipas Ilo Stefanllarit

**Ilo Stefanllari** te “A course in English Lexicology” (“Kursi i Leksikologjisë Angleze”)<sup>239</sup> thekson se kur flasim për homoniminë në gjuhën angleze duhet patur parasysh se anglishtja moderne është shumë e pasur me *fjalë* dhe *forma – fjalësh homonimike*.

*Sipas llojit të kuptimit*, I. Stefanllari i klasifikon homonimet e gjuhës angleze në: **homonime leksikore, leksiko - gramatikore** dhe **gramatikore**.

Tek **homonimet leksikore**, ndryshimi shihet vetëm tek kuptimi i tyre leksikor. P.sh. *seal*<sub>I</sub> em. “fokë” dhe *seal*<sub>II</sub> em. “vulë”.

**Homonimet leksiko – gramatikore** ndryshojnë nga kuptimi leksikor dhe gramatikor. P.sh., *seal*<sub>I</sub> em. “fokë” dhe *seal*<sub>III</sub> fol. “mbyll fort, puthit”.

Homonimet leksiko – gramatikore klasifikohen më tej në:

- a. Homonime identike në shqiptim, por të ndryshme në kuptimet leksikore dhe gramatikore, p.sh., *seal*<sub>I</sub> em. “fokë” – *seal*<sub>III</sub> fol. “mbyll fort, puthit”.
- b. Homonime identike në shqiptim, të ndryshme nga ana gramatikore dhe pjesërisht të ndryshme nga ana semantike, p.sh., *seal*<sub>I</sub> em. “vulë, vulë dylli ose plumbi” – *seal*<sub>III</sub> fol. “mbyll fort, puthit”.

Homonimet leksiko - gramatikore normalisht përfshijnë pjesë të ndryshme të ligjeratës, por ndodh që të ndeshen edhe brenda të njëjtës pjesë ligjrate, p.sh., foljet *to find* (në kohën e shkuar të thjeshtë) dhe *to found* (forma përfaqësuese<sup>240</sup>, “infinitive”), ku forma të tyre homonimike ndryshojnë nga ana leksikore dhe gramatikore.

*to find* “gjej” - *to found* “krijoj, themeloj”  
*found* (koha e shkuar e thjeshtë) “gjeta”- *found* (forma përfaqësuese<sup>241</sup>, “ang. the infinitive”)

Anglishtja moderne numëron shumë forma fjalësh homonimike të cilat ndryshojnë vetëm në kuptimin e tyre **gramatikor**. Homonimet gramatikore janë forma fjalësh që i përkasin të njëjtës paradigme, ndryshojnë në kuptimet e tyre gramatikore. Në paradigmat e shumicës së foljeve në gjuhën angleze, forma e kohës së shkuar të thjeshtë është homonimike me atë të pjesores, p.sh.,

<sup>239</sup> Stefanllari, I. *A Course in English Lexicology*, Geer, Tiranë, 2011, f. 97.

<sup>240</sup> Në gjuhën shqipe, ekuivalente e termit anglisht ‘base form’ është ‘trajtë përfaqësuese’.

<sup>241</sup> Në gjuhën shqipe, ekuivalente e termit anglisht ‘base form’ është ‘trajtë përfaqësuese’.

|                          |                          |
|--------------------------|--------------------------|
| Koha e shkuar e thjeshtë | Pjesore                  |
| <i>played</i> (luajta)   | <i>played</i> (luajtur)  |
| <i>loved</i> (doja)      | <i>loved</i> (dashur)    |
| <i>stayed</i> (qëndroja) | <i>stayed</i> (qëndruar) |
| <i>asked</i> (pyeta)     | <i>asked</i> (pyetur)    |

Për sa u përket emrave, tek paradigmat e tyre, ne gjejmë forma homonimike midis rasës gjinore njëjës dhe rasës emërore shumës<sup>242</sup> p.sh., *boy's* “i, e djalit” dhe *boys* “djemtë”, *reader's* “i, e lexuesit” dhe *readers* “lexuesit” etj. Është lehtësisht e dallueshme se homonimia gramatikore është homonimi e formave të ndryshme të së njëjtës fjalë.

### 5.2.5. Klasifikim i homonimeve sipas Xhon Lajëns-it (John Lyons)

Xhon Lajëns-i, në librin “Semantics 1” (“Semantika 1”)<sup>243</sup> ndalon në veçanti tek klasifikimi i homonimeve në gjuhën angleze. Klasifikimi që ai paraqet është mjaft interesant dhe i veçantë në llojin e tij. Në këtë klasifikim të homonimeve, Lajëns-i udhëhiqet nga parimi i kundërshtimit dhe merr parasysh ndryshimin ose ngjashmërinë në kuptimin e tyre leksikor dhe gramatikor, në paradigmat dhe format bazë. Klasifikimi i homonimeve sipas Lajëns-it paraqitet në tabelën e mëposhtme. Tiparet dalluese në këtë tabelë janë: *kuptimi leksikor* (i ndryshëm jepet me  $A$ , afërsisht i njëjti jepet me  $\bar{A}$ <sup>244</sup>), *kuptimi gramatikor* (i ndryshëm me  $B$ , i njëjti me  $\bar{B}$ ), *paradigma* (të ndryshme me  $C$  dhe të njëjta me  $\bar{C}$ ), dhe *format bazë* (të ndryshme me  $D$  dhe të njëjta me  $\bar{D}$ ).

Në tabelën e mëposhtme:

- Termi ‘afërsisht i njëjti kuptim leksikor’ do të thotë që elementët që janë në kundërshti kanë të përbashkët disa komponentë përbërës.
- Termi ‘kuptim i njëjti gramatikor’ do të thotë që të dy elementët i përkasin të njëjtës pjesë ligjrate.
- Termi ‘e njëjta paradigmë’ përfshin edhe rastet kur fjala ka një formë të vetme, dmth., kur fjalët janë të pandryshueshme.
- Kombinimeve kontradiktore (që nuk përputhen) ju është hequr vizë. Për shembull, është e pamundur që dy fjalë të jenë identike në të gjitha format e tyre dhe të ndryshme në format bazë, ose që dy homonime të mos ndryshojnë në kuptimet e tyre leksikore dhe gramatikore, sepse në këtë rast ato nuk do të ishin homonime.

Të gjitha këto çojnë në shtatë raste të mundshme:

<sup>242</sup> ‘Common case plural’ nuk ka një ekuivalent në gramatikën e gjuhës shqipe.

<sup>243</sup> Lyons, J. *Semantics I*, Cambridge University Press, 1977, f. 211 – 213.

<sup>244</sup> Shenja ‘ $\bar{A}$ ’ lexohet [ $A$  me vizë] ( $A$  bar, në anglisht).

Tabela 5.1. Klasifikimi i homonimeve sipas Lajëns-it

|   | $A$   |  | $\bar{A}$   |   |                                  |
|---|---|--|---|---|----------------------------------|
|   | Kuptimi i ndryshëm leksikor   |  | Afërsisht i njëjti kuptim leksikor  |   |                                  |
| $B$<br>Kuptimi i ndryshëm gramatikor    | <i>light, -s</i> em.<br>“dritë”<br><i>light, -r, est</i> mb.<br>“e lehtë”<br><br><i>flat, -s</i> em.<br>“pallat”<br><i>flat, -er, -est</i> mb.<br>“e rrfshët” | <i>for, parafj.</i><br>“për”<br><i>for, lidh.</i><br>“sepse”   | <i>before, parafj.</i><br>“para”<br><i>before, ndajf.</i><br>“përpara”<br><i>before, lidh.</i><br>“përpara” | <i>eye, -s</i> em.<br>“sy”<br><i>eye, -s, -ed.</i><br>-ing fol.<br>“shikoj” | E njëjta formë bazë<br>$\bar{D}$ |
|   | <i>might</i> em.<br>“fuqi”<br><i>may – might</i> fol.<br>“mund”   |  |   |   | Formë bazë e ndryshme<br>$D$     |
| $\bar{B}$<br>Kuptim i njëjtë gramatikor |   |  | /   |   | Formë bazë e ndryshme<br>$D$     |
|   | <i>lie – lay – lain</i> fol.<br>“shtrihem”<br><i>lie – lied – lied</i> fol.<br>“gënjej”   | <i>spring, -s</i> em.<br>“pranverë”<br><i>spring, -s</i> em.<br>“burim”<br><i>spring, -s</i> em.<br>“kërcim” | /   |   | E njëjta formë bazë<br>$\bar{D}$ |
|   | Paradigma të ndryshme<br>$C$  | E njëjta paradigme ose nuk ka ndryshime<br>$\bar{C}$   | Paradigma të ndryshme<br>$C$  |   |                                  |

$A B \bar{C} \bar{D}$  Elementët e këtij grupi *light* em. “dritë” dhe *light* mb. “i,e lehtë” ndryshojnë në kuptimin leksikor dhe gramatikor, kanë paradigma të ndryshme, por të njëjtën formë bazë. Ky grup përfshin shumë homonime. Një nënndarje e mëtejshme e tij merr parasysh pjesët e ligjeratës të elementëve përbërës, me pak fjalë, ndryshimet: emër - folje, mbiemër - folje, emër - mbiemër etj.

$A B C D$  Ky grup është i ngjashëm me të parin, vetëm se jo të dy elementët janë në formën e tyre bazë. Për shembull, emri *might* “fuqi” është në formën e tij bazë, njëjës, por folja *may* “mund” përputhet me të vetëm në kohën e shkuar të thjeshtë (Simple Past Tense) *might*. Kjo mungesë përputhjeje midis formave bazë nuk është e shpeshtë. Si rezultat, pak shembuj janë të mundshëm. Këtu mund të shtojmë edhe *bit* em. “një copë e vogël” dhe *bit* koha e shkuar (Simple Past Tense) dhe pjesore e *bite* “godas”.

$A \bar{B} \bar{C} \bar{D}$  Ky grup përfshin çifte të ndryshme fjalësh në kuptimin e tyre leksikor dhe gramatikor, por jo në paradigmat e tyre. P.sh., *for* parafj. “për” dhe *for* lidh. “sepse”.

$\bar{A} \bar{B} \bar{C} \bar{D}$  Ky grup përbën atë që quhet “patterened homonymy”<sup>245</sup>. Ndryshon nga grupi i mësipërm sepse elemente të këtij grupi kanë diçka të përbashkët në kuptimin leksikor, p.sh., *before* parafj. “para, përpara”; *before* ndajf. “përpara, para se, më parë”; *before* lidh. “përpara, sesa”.

$\bar{A} B C \bar{D}$  Këtu përfshihen gjithë homonimet që krijohen si rezultat i konversionit, p.sh., *eye* em. “sy” dhe *eye* fol. “shoh”; *long* mb. “i gjatë” dhe *long* fol. “zgjat”; *work* fol. “punoj” dhe *work* em. “punë” etj. Elementët e këtij grupi ndryshojnë në kuptimin e tyre gramatikor dhe në paradigme. Ky grup, gjithashtu, i përket “patterened homonymy”. Kuptimi i fjalës së dytë mund të merret me mend n.q.s. dihet kuptimi i të parës.

$A \bar{B} C \bar{D}$  Këtu përfshihen homonime që kanë kuptim të ndryshëm leksikor, kuptim të njëjtë gramatikor dhe paradigma të ndryshme: *lie* “shtrihem” – *lay* “u shtriva” – *lain* “shtrirë” dhe *lie* “gënjej” – *lied* “gënjeva” – *lied* “gënjyer”. Ky grup nuk ka shumë shembuj.

$A \bar{B} \bar{C} \bar{D}$  Ky është rasti më tipik i homonimisë, i pranuar nga të gjithë studiuesit dhe i argumentuar pothuaj në çdo tekst. Kuptimet leksikore janë të ndryshme, por homonimet i përkasin të njëjtës pjesë ligjerate: *spring* I em. “kërcim”; *spring* II em. “burim” dhe *spring* III em. “stina e verës”.

Shihet qartë që ky model paraqet një skemë të përgjithshme. Aktualisht një grup homonimesh mund të përmbajë elemente që i përkasin grupeve të ndryshme në këtë klasifikim. Marrim si shembull, *fell* I em. “lëkura e kafshëve që ndërrohet”; *fell* II em. “kodër”; *fell* III mb. “i rreptë, i egër”; *fell* IV em. dhe fol. “pres pemë” dhe “grumbull pemësh të prera”; *fell* V (koha e shkuar e foljes *fall*) “bie, rrëzohem”. Ky grup mund të ndahet në çifte sipas tabelës së mësipërme. Kështu *fell* I dhe *fell* II mund të grupohen te ABCD; *fell* I dhe *fell* IV te ABCD dhe *fell* IV dhe *fell* V te ABCD.

<sup>245</sup> ‘Patterened homonymy’ ka ekuivalente të përafërt në gjuhën shqipe ‘Homonime të pjesëve të ligjeratës’.



### 5.3. Krahasim midis klasave homonimike në gjuhën shqipe dhe angleze

Si përfundim, shihet qartë se në të dyja gjuhët, studiues të ndryshëm bazohen në kritere të ndryshme për të klasifikuar homonimet. Si rezultat, klasifikimet janë të llojeve të ndryshme. Duke bërë krahasimin midis klasave homonimike të të dyja gjuhëve rezulton se:

- Përputhje të plotë klasifikimi gjejmë vetëm në rastin e homoformave / homonimeve perfekte, homofoneve dhe homografeve.
- Vëmë re ngjashmëri klasifikimi:
  - Homonimet leksikore dhe homonimet leksiko – gramatikore ekzistojnë në të dyja gjuhët.
  - Homonimet e pjesëve të ligjeratës ekzistojnë, gjithashtu, në të dyja gjuhët.
  - Si në gjuhën shqipe dhe atë angleze, përmenden homonimet e plota leksikore dhe homonimet e pjesëshme leksikore.
- Vëmë re ndryshime në klasifikim.
  - Klasifikimi i Xhon Lajëns-it është i veçantë dhe i detajuar. Tiparet dalluese të homonimeve vlerësohen njëherazi. Në gjuhën shqipe nuk gjejmë diçka të ngjashme.
  - Në gjuhën angleze nuk përmendet klasifikim i homonimeve sipas burimeve të tyre.
  - Në gjuhën angleze nuk ekziston klasifikimi i mirëfilltë i homonimeve me lidhje etimologjike dhe jo etimologjike, megjithëse aty – këtu përmendet diçka.

### 5.4. Klasifikim i homonimeve sipas Aristotelit

Aristoteli vjen me një tjetër klasifikim mjaft interesant në lidhje me homoniminë. Në analizën e tij filozofike ndaj kuptimit, ai i klasifikon homonimet në **rastësore** dhe **gorastësore**<sup>246</sup>.

---

<sup>246</sup> <http://philosophy.tamu.edu/~rasmith/Courses/Ancient/predication.html>

## **Homonime rastësore**

Homonimia rastësore krijohet nga një përputhje rastësore në historinë e një gjuhe. P.sh., në gjuhën shqipe nuk ka asnjë lidhje midis *pres<sub>I</sub> diçka me thikë* dhe *pres<sub>II</sub> trenin* ose në gjuhën angleze ndërmjet homonimeve *page<sub>I</sub> “fletë libri”* dhe *page<sub>II</sub> “shërbëtor, korrier”*. Aristoteli ishte i ndërgjegjshëm për këtë rastësi gjuhësore, e cila mund të shfrytëzohet edhe qëllimisht për shkak të dykuptimisë që vihet re.

## **Homonime jorastësore**

Sipas Aristotelit, homonimia jorastësore lidhet me rastet ku lidhja ndërmjet leksemave nuk është thjesht rastësore, por ato janë të lidhura me diçka të përbashkët dhe të rëndësishme.

Socrates is healthy.

(Sokrati është i shëndetshëm.)

Socrates' diet is healthy.

(Dieta e Sokratit është e shëndetshme.)

Aristoteli shprehet se lidhja që ekziston midis kuptimeve të “*i shëndetshëm*” nuk është rastësore, sepse të dy këto kuptime lidhen me çfarë është e shëndetshme për njerëzit. Sokrati është *i shëndetshëm* nëse bazohemi tek përkufizimi i fjalës “*i shëndetshëm*”; dieta e tij është *e shëndetshme* sepse i shërben përmirësimit të shëndetit të tij.

Rasti i homonimisë jorastësore është i njëjtë me formimin e homonimeve nga shpërbërja e polisemisë, ku kuptimet e fjalëve homonimike janë të lidhur me njëri-tjetrin. Në pamje të parë lidhja e tyre nuk duket e perceptueshme, por këto kuptime ndajnë diçka të përbashkët dhe për këtë arsye lidhja e tyre nuk është rastësore.

## KAPITULLI VI

### TRAJTIMI LEKSIKOGRAFIK I HOMONIMEVE NË GJUHËSINË SHQIPTARE DHE ANGLEZE

Një studim i thelluar mbi homoniminë nuk është i plotë pa shqyrtuar edhe paraqitjen e tyre në fjalorët e të dyja gjuhëve. Pasqyrimi i homonimisë në fjalor është një çështje që i përket gjuhësisë së zbatuar.

Homonimia në praktikën leksikografike ka qënë shpesh një burim problemor. Duke vëzhguar homoniminë në praktikën leksikografike shqipe dhe angleze, vihet re se shumë prej problemeve janë të ngjashme, por sigurisht që secila gjuhë ka edhe veçoritë e saj në këtë drejtim.

Po përmendim fillimisht disa pika, që duket të jenë të përbashkëta në trajtimin e homonimisë në fjalor, për të dyja gjuhët.

Kërkesa themelore që shtrohet para çdo fjalori është të arrihet një paraqitje sa më e drejtë dhe sa më e përpiktë nga ana shkencore e sistemit leksikor të gjuhës, për periudhën të cilës i përket fjalori, në dritën e një çështjeje të ngushtë, siç është homonimia.

Problemi i formës themelore, formës përfaqësuese të fjalës në fjalor, ka gjetur zgjidhje të ndryshme sipas autorëve të ndryshëm dhe si rezultat, kjo ka sjellë luhajtje të mëdha të numrit të homonimeve për të dyja gjuhët.

Vështirësia më e madhe, në të dyja gjuhët, del në sistemin e dhënies së homonimeve, në mënyrën grafike të dallimit të tyre nga kuptimet e një fjale të vetme. Çështja është se brenda të njëjtit fjalor ndodh të mos ruhet i njëjti parim.

Që këtë del si kërkesë për çdo fjalor në të dyja gjuhët, që homonimet të pasqyrohen sipas një parimi të vetëm, të caktuar që më parë dhe të dallohen nga ana grafike në mënyrë të njëjtë. Vendin e parë nga renditja është e mira ta zërë gjithnjë fjala homonime, që është më e përdorur dhe më e përhapur.

Në fjalorët e sotëm, në përgjithësi, homonimet duke qënë njësi leksikore të ndryshme, fjalë të veçanta, vihen veç e veç, duke i shënuar me numra arabe ose romake.

Me shtimin e fjalëve nga një fjalor në tjetrin, është rritur numri i homonimeve. Nevoja e një studimi të mëtejshëm të historisë së fjalës, si punë paraprake për hartimin e fjalorëve, është një kërkesë tjetër për hartimin e fjalorëve në të dyja gjuhët. Vendosija e një kriteri universal të dallimit homonimi – polisemi, përbën një problem tjetër të përbashkët në leksikografinë e të dyja gjuhëve. Kanë paraqitur vështirësi paraqitjeje në fjalor, homonimet që kanë dalë nga zberthimi i polisemisë, sepse në disa raste nuk mund të caktohet me përpikmëri nëse kemi një fjalë me dy kuptime a dy fjalë me kuptime të ndryshme<sup>247</sup>. Këtë problem e kemi prekur në pikën e fundit të këtij kapitulli.

---

<sup>247</sup> Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 51.

## 6.1. Homonimia në leksikografinë shqiptare

### 6.1.1. Vështrim deri në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (1954)<sup>248</sup>

Ndërsa studiojmë paraqitjen e homonimeve në fjalorë të hershëm të gjuhës shqipe, ndeshim në disa vështirësi. Së pari, problemi i formës themelore, i formës përfaqësuese të fjalës në fjalor, ka gjetur zgjidhje të ndryshme sipas autorëve, sidomos për foljet, gjë që sjell luhatje të mëdha në numrin e homonimeve. Për shembull, në *Fjalorin e shkurtër shqip - rusisht* (1951)<sup>249</sup> ndeshim dy homonime *kushtoj<sub>I</sub> - kushtoj<sub>II</sub>*, ndërsa te *Fjalori e gjuhës shqipe* (1954)<sup>250</sup> kemi tjetër formë përfaqësuese *kushtoj - kushton* dhe homonimia fshihet. Po ashtu, nuk dalin homonime *pres<sub>I</sub> - pres<sub>II</sub>* në Fjalorin e vogël assyp e italisht, Shkodër 1895, nga J. Junku, sepse atje merret infinitivi *me pree - me prit*, e po ashtu në fjalorin e F. Kordinano-s (F. Cordignano) nuk dalin *bie<sub>I</sub> - bie<sub>II</sub>*. Siç vihet re, vështirësia më e madhe qëndron në sistemin e dhënies së homonimeve, në mënyrën grafike të dallimit të homonimeve nga kuptimet e një fjale të vetme. Çështja është se brenda të njëjtit fjalor nuk ruhet i njëjti parim. Në fjalorin e S. Men-it (S. Mann) (*A historical Albanian - English dictionary*, 1948)<sup>251</sup> nuk gjejmë shenja të veçanta për homonimet, por janë ndarë në vende të veçanta *bie<sub>I</sub> - bie<sub>II</sub>*, ndonëse *diktoj<sub>I</sub> - diktoj<sub>II</sub>* jepen bashkë, të ndara me shifra arabe, si kuptime të një fjale; jepen si homonime të veçanta *çaj<sub>I</sub> - çaj<sub>II</sub>*, por jepen bashkë *dhe<sub>I</sub>* lidhëz, *dhe<sub>II</sub>* nga folja “jap”, kurse *dhe<sub>III</sub>* për tokën jepet më vete si homonim; së bashku janë dhënë *gaz<sub>I</sub> - gaz<sub>II</sub>*; *gjatoj<sub>I</sub> - gjatoj<sub>II</sub>*; *do<sub>I</sub> - do<sub>II</sub>* etj. Te fjalori i A. Leot-it (A. Leotti)<sup>252</sup>, në fillim homonimet jepen në një vend, të ndara aty-këtu me shifra, kështu te *a* është futur madje dhe trajta e shkurtër e parashtesa, që nuk ndeshen më vete, ndërsa te *po* jepen 6 homonime të veçanta, te *që* jepen 7 etj. Në fjalorin e G. Weigand-it (G. Weigand) (*Albanesisch - deutsches und deutsches - albanesisches Wörterbuch*, Leipzig, 1915) homonimet janë ndarë edhe në glosa të veçanta, edhe me shifra romake, por kjo nuk ruhet deri në fund, homonimet te *jo* jepen si kuptime, po ashtu *na* për *merre* dhe *na* për *merre*. Në fjalorin shqip - greqisht të Kostandin Kristoforidhit (1961)<sup>253</sup> homonimet te *po* jepen në një vend, të ndara me shifra arabe, kurse *na* jepen 4 homonime si fjalë të veçanta, janë ndarë dy homonime *që*, kurse *po* pjesëz dhe *po* lidhës kundërshtore jepen bashkë etj. Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954 i është përmbajtur deri në fund një parimi të vetëm, po ashtu si Fjalori i shkurtër shqip - rusisht, gjë që e lehtëson shumë qëndrimin e tyre ndaj homonimeve. Sigurisht që mungesa e shenjave dalluese për homoniminë në fjalorin e parë, mund të sjellë ngatërresë praktike, p.sh., kemi tri homonime *koll*, fjala e tretë referohet tek *kollë*, kurse tek kjo *kollë* kemi po ashtu dy homonime. Nga sa kemi përmendur deri tani, dilte si kërkesë që për çdo fjalor të ardhshëm, homonimet të pasqyroheshin sipas një parimi të vetëm, të caktuar që më parë dhe të dallohen nga ana grafike në mënyrë të

<sup>248</sup> *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954.

<sup>249</sup> [*Fjalori i shkurtër shqip - rusisht*, nën red. e Kostallarit, A. 1951.]

Cituar sipas Lloshi, Xh. “*Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*”, *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vëllimi I, Tiranë, 1972, f. 218.

<sup>250</sup> [*Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1954.] Cituar po aty.

<sup>251</sup> [Man, S. *An historical Albanian - English dictionary*, 1948.] Cituar po aty.

<sup>252</sup> [Leoti, A. *Fjalori shqip - italisht*, Romë, 1937.] Cituar po aty.

<sup>253</sup> [Kristoforidhi, K. *Fjalori shqip - greqisht*, 1961.] Cituar po aty.

njëjtë. Vendin e parë nga renditja është e mira ta zërë gjithmonë fjala homonimike, që është më e përdorur dhe më e përhapur<sup>254</sup>.

Përpara çdo fjalori shtrohej kërkesa themelore që të arrihej një paraqitje sa të ishte e mundur më e drejtë dhe sa më e përpiktë nga ana shkencore e sistemit leksikor të gjuhës shqipe, për periudhën, të cilës i përket fjalori dhe nën dritën e një çështjeje të ngushtë, siç është homonimia. Në fjalorët e parë të gjuhës shqipe, për shkak të sasisë së kufizuar të materialit leksikor, çështja e homonimeve, nuk ka dalë [p.sh., në pjesën shqip – gjermanisht të fjalorit të I. R. von Zajlandë (I. R. von Xyländer), Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren, Frankfurt am Main 1835]. Me shtimin e fjalëve nga njëri fjalor në tjetrin, është rritur numri i homonimeve, por janë veçuar kryesisht ato, që ndryshojnë mjaft, pra homonimet leksiko-gramatikore (*dhëmb<sub>I</sub>* – *dhëmb<sub>II</sub>* folje; *zë<sub>I</sub>* – *zë<sub>II</sub>* folje etj.) dhe homonimet e pjesshme. Me thellimin e studimeve etimologjike, edhe në fjalorë hyri parimi etimologjik i dallimit të tyre, gjë që del qartë në fjalorin etimologjik të G. Mejer-it (Etymologisches Wörterbuch der Albanesischen Sprache, Strassburg, 1891) dhe në fjalorin e G. Ueigënt-it. Fakti që në disa fjalorë gjejmë në një vend homonimet etimologjike (p.sh., *brimë<sub>I</sub>* për britmë, *brimë<sub>II</sub>* për vrimë dhe *brimë<sub>III</sub>* për brymë nuk dallohen në fjalorët e S. Men-it, F. Kordinano-s dhe te L. Lukaj-t, Fjaluer shqyp – srbohrvatisht, Beograd, 1935) shtronte nevojën e një studimi të mëtejshëm të historisë së fjalës, si punë paraprake edhe për hartimin e fjalorëve. Numri i homonimeve me burime të ndryshme vazhdonte të rritej sidomos me hyrjen e fjalëve të ndryshme nga dialektet në gjuhën e përbashkët. Duke qënë se mund të dalë gjatë punës një mori e madhe homonimesh, shtrohej një kërkesë tjetër, që në fjalorë të jepeshin me kujdes trajtat dialektore të fjalëve dhe ato që do të jepeshin të dalloheshin mirë kur ishin homonime. Në fjalorin e L. Llukaj-t dhe S. Men-it gjejmë në një fjalë titull, *cingare<sub>I</sub>* për cigare dhe *cingare<sub>II</sub>* për zile bagëtish; te J. Junku janë ngatërruar *fuçi* për shkak të shqiptimit dialektor të afërt (*fuci*, a potere, forza, botte); *gocë<sub>I</sub>* – *gocë<sub>II</sub>* jepen si një fjalë te A. Leot-i, F. Kordinano, K. Kristoforidhi; te S. Men-i jepen në një vend *brom<sub>I</sub>* – *brom<sub>II</sub>* dhe po atje shtohet *bromp*, ndërsa te *bacë* futet edhe kuptimi shishe (bottle); *çikëz<sub>I</sub>* – *çikëz<sub>II</sub>* jepen në një fjalë titull etj. Fjalori i gjuhës shqipe për shkak të materialit të gjerë, ka shumë homonime dialektore nga të cilat një pjesë mund të ishin shmangur si p.sh., në fjalët *boj<sub>I</sub>* – *boj<sub>II</sub>*; *kumë<sub>I</sub>* – *kumë<sub>II</sub>*; *dreq* për *drejt* etj. Punimet dialektologjike, studimi i gjeografisë së fjalës, do të zgjidhnin gradualisht jo vetëm çështjen e fatit të fjalëve dialektore për gjuhën e përbashkët, por do të ndihmonin edhe në sqarimin e ndikimit të homonimisë në gjuhë.<sup>255</sup>

Në gjuhën shqipe shumë homonime kanë ardhur nga huazimet. Kjo për shkak të marrëdhënieve të shqipes me gjuhë të tjera në fusha të ndryshme, si në kulturë, politikë, shkencë, teknikë etj. Rrugët e hyrjes së fjalëve të huaja kanë qënë shpesh të ndërlikuara dhe kjo ka qënë arsyeja pse këto fjalë janë paraqitur në mënyrë jo të përpiktë në fjalorët e mëparshëm. Kështu p.sh., janë konsideruar si një fjalë *gradë<sub>I</sub>* - *gradë<sub>II</sub>* në Fjalorin e F. Kordinano-s dhe tek Fjaluer i Rii i Shcypes, Shkodër, 1908; *ashik<sub>I</sub>* - *ashik<sub>II</sub>* te A. Leot-i, L. Lukaj dhe Fjalori i shkurtër shqip – rusisht etj. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (1954), në disa raste vihet re një përpjekje për ta shmangur homoniminë, si p.sh., *boj* – *bojë*; *odë* – *ode*; *kafas* – *kafaz* etj.<sup>256</sup>

<sup>254</sup> Lloshi, Xh. *Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*, te *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Tiranë 1972, f. 218.

<sup>255</sup> Po aty f. 219.

<sup>256</sup> Po aty f. 219.

Nevoja e qartësimit të strukturës semantike të fjalës, shtroi kërkesa të reja. Përpyqjen e parë në këtë drejtim e gjejmë te fjalori i Kostandin Kristoforidhit. Zgjidhjet e drejta në këtë fjalor tregojnë se te hartuesit shqiptarë të fjalorëve ka patur gjithmonë një kuptim më të drejtë të strukturës semantike të fjalës shqipe, dhe si rrjedhim, një paraqitje të drejtë të homonimeve. Në vitet 1960 – 1970 mungonin punime teorike mbi polisemisë dhe homonimisë. Kjo gjë solli një lëkundje të dyanshme, ku homonimia quhej si polisemi dhe polisemia si homonimi. Sjellim përsëri si shembull fjalorin e K. Kristoforidhit, ku janë dhënë si fjalë të veçanta *çel* dhe *çel* “ndeaz zjarrin”. Një copëtim të madh gjejmë te A. Leot-i; në një faqe të vetme janë ndarë si homonime *cekë<sub>I</sub>* “prek” dhe *cekë<sub>II</sub>* “dëmtoj pak”; *cen<sub>I</sub>* “e metë” dhe *cen<sub>II</sub>* “zakon, ves”. Veçimi i kuptimeve të fjalëve të ndryshme te fjalori i fundit nuk na bën të mendojmë, se ishte shtruar tashmë problemi i zbërthimit të polisemisë në homonimi. Ky problem ka dalë për herë të parë në Fjalorin e shkurtër shqip – rusisht. Pikërisht këtu filloi përpjekja për një shtresim stilistik të leksikut të shqipes. Autorët me sa duket i janë përmbajtur mendimit për mundësinë e zbërthimit të lehtë të polisemisë në homonimi, që duket edhe në shembujt e dhënë si homonime: *plot<sub>I</sub>* – *plot<sub>II</sub>*; *pjesë<sub>I</sub>* – *pjesë<sub>II</sub>*; *bashkim<sub>I</sub>* – *bashkim<sub>II</sub>* etj.<sup>257</sup>

Në fjalorët e hershëm të shqipes, homonimet e pjesëve të ligjeratës ndonëse nuk janë trajtuar si të tilla, ka qënë e lehtë të dalloheshin. Ndërsa homonimet e lindura gjatë fjalëformimit, me studimin e thelluar të fjalëformimit në gjuhën shqipe, kanë pasur lëkundje në paraqitjen e tyre në fjalorë.<sup>258</sup> Te J. Junku, homonimet *pjek<sub>I</sub>* – *pjek<sub>II</sub>* ngatërrohen te *m’u pjek* dhe *t’piekun*, gjë që ndeshet te F. Kordingano dhe Fjaluer i Rii i Shcypes, Shkodër, 1908. Te A. Leot-i janë dhënë si një fjalë homonimet e prejardhura *pasanik<sub>I</sub>* – *pasanik<sub>II</sub>*, janë ndarë foljet *vloj<sub>I</sub>* – *vloj<sub>II</sub>*, por te *valoj* jepet edhe *u vlua* për “u fejuar” etj. Te L. Lukaj gjejmë si një fjalë *gjatoj<sub>I</sub>* – *gjatoj<sub>II</sub>*; te S. Men-i *dorak<sub>I</sub>* – *dorak<sub>II</sub>*; te K. Kristoforidhi gjejmë *gjëmoj<sub>I</sub>* – *gjëmoj<sub>II</sub>* etj. Në fjalorin e gjuhës shqipe (1954) fjalët *lakore*, *faqore*, *ditor*, *ditar* etj. janë në të vërtetë dy homonime të prejardhura të marra si kuptime të një fjale të vetme. Homonimet gjatë fjalëformimit mund të lindin edhe më pas, sidomos në rastin e krijimit të termave të rinj për terminologjinë e shkencave e degëve të ndryshme, ku njohja e shkaqeve të homonimisë dhe shmangia e saj kanë qënë kusht i rëndësishëm për arritjen e qartësisë dhe njëkuptimësisë të termit. Në rastin e fundit kërkohej akoma më tepër shmangia e formimeve të reja që mund të ngjallnin shoqërime të papëlqyeshme, të paqarta ose për të qeshur, për shkak të homonimisë. Problemet e kontaminimit homonimik dhe të përjashtimit të fjalëve për shkak të homonimisë në gjuhën shqipe janë prekur në punimet e profesor Eqrem Çabej rreth etimologjisë<sup>259</sup>.

### 6.1.2. Paraqitja e homonimeve në *Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe* (1980)<sup>260</sup>

“Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe” i vitit 1980 është një fjalor shpjegues i tipit të mesëm e me karakter normativ. Dy ishin qëllimet kryesore që gjuhësia në vitet 1970 -1980 i shtronte këtij fjalori për të ndjekur:<sup>261</sup>

<sup>257</sup> Po aty f. 219 - 220

<sup>258</sup> Po aty f. 220.

<sup>259</sup> Çabej, E. *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII*, te *Bul. Un. Sht. Të Tiranës S. Shk. Shoq.*, 1962.

<sup>260</sup> *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.

- të ishte një fjalor shpjegues normativ
- të ishte njëkohësisht një fjalor informues

Në rrugën për hartimin e këtij fjalori me vlerë kombëtare dhe historike, gjuhëtari Androkli Kostallari vuri re se krahas kuptimit të detyrave kryesore që i dëlnin këtij fjalori shpjegues në kushtet historike të kristalizimit të normës letrare dhe përcaktimit të tipareve të përgjithshme të tij, ishte e nevojshme të përpunoheshin edhe parimet dhe kriteret themelore për zgjidhjen e problemeve të veçanta më të qënësishme si p.sh., zgjedhja e fjalëve (përbërja e fjalës, frazeologjia dhe ilustrimet në fjalor, struktura e fjalorit dhe struktura e artikullit për çdo fjalë, zbërthimi dhe shpjegimi i kuptimit të fjalëve, pasqyrimi i veçorive stilistikore të fjalëve, karakteristika gramatikore e fjalëve, njohuritë etimologjike në fjalor, çështje të drejtshkrimit dhe problemi i theksit. Midis tyre, një nga më të rëndësishmet ishte mënyra e pasqyrit të homonimeve në këtë fjalor.<sup>262</sup>

1. Homonimet në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” janë paraqitur si fjalë më vete, të shënuara me shifra romake (I, II, III ...). Rendi i dhënies ishte sipas rendit të pjesëve të ligjëratës – emri, mbiemri, përemri, numërorët, folja, ndajfolja, pjesëza, pasthirrma.

2. Dallimi i homonimeve do të bëhej sipas parimit semantiko – strukturor, dmth., çështja e kufijve të një fjale të caktuar (si edhe e kufijve të kuptimeve brenda një fjale) do të zgjidhej duke pasur parasysh:

- ndërtimin semantik të vetë fjalës;
- vendin që zë fjala në strukturën e gjuhës së sotme, tërësinë e veçorive strukturore të saj: lidhjet e saj fjalëformuese, marrëdhëniet e saj me fjalët e një rrënje etj.; duhet pasur sidomos parasysh se ndër veçoritë e ndryshme strukturore të fjalës kanë rëndësi vendimtare për dallimin e homonimeve, në rradhë të parë, lidhjet fjalëformuese, ndërsa veçoritë e karakterit thjesht gramatikor, si p.sh., regjimi i ndryshëm tek foljet, mungesa e ndonjë trajte (të shumësit ose të njëjësit) mund të jenë karakteristike edhe për kuptimet e ndryshme të një fjale të vetme dhe nuk dëshmojnë gjithmonë, se kemi të bëjmë me homonimi.

3. Në fjalor dallohen tri tipe ose tri grupe homonimesh:

**a. homoformat**, dmth., fjalët që përputhen nga pikëpamja tingullore në një ose në disa forma, por ndryshojnë në trajta të tjera; si bazë për këtë në fjalor merret homonimia e trajtave përfaqësuese, p.sh.,

I *çaj-i m* dhe II *çaj çava*, *çarë kal...*; *çaj dru*; *çaj akullin*; *çaj dëborën* etj.;

I *ca njerëz* = disa njerëz (përem.) dhe II *rri* edhe *ca*, u bë *ca* më mirë, shko *ca* më tutje, *ca* nga *ca* etj. (ndajfolje);

<sup>261</sup> Kostallari, A *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe”*, te *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vëllimi II, Tiranë 1972. f. 14.

<sup>262</sup> Po aty f. 16.

I *punëtor – i m* dhe II *punëtor-e mb.*;

I *thatë i, e mb.* dhe II *( i ) thatë-i m sh. të thatë-t etj.*;

I *mund, - a, -ur* (folje) dhe II *mund –i m*;

I *pjek, poqa, pjekur* (folje) dhe II *pjek-u m* = shkop i madh në lodrën me cingël, etj.

**b. fjalët me prejardhje të ndryshme**, që janë përputhur nga pikëpamja tingullore në të gjitha trajtat ose në shumicën e trajtave, p.sh.,

I *pjek, poqa, pjekur kal. .. pjek bukë, pjek mishin në hell, pjek tulla etj.* dhe II *i pjek, poqa, pjekur kal.* = takoj

I *çek-e* si emër = që ka lindur e banon në Çeki dhe II *çek-u* në veprimet bankare etj.;

I *marinë-a f.* tërësi e mjeteve detare të një shteti; marina tregëtare; marina e luftës etj. ; dhe II *marinë-a f.* bot. shkurre përherë e blertë që rritet në vende me lagështirë, kunupice etj.

Dy tipet e para janë ato që dallohen relativisht lehtë.

**c. homonimet semantike**, dmth., fjalët me prejardhje të përbashkët, te të cilat këputja, thyerja e lidhjeve semantike midis kuptimeve, ndarja e boshtit themelor semantik shkon aq larg sa që shoqërohet edhe me vendosjen e veçorive të reja strukturore-gramatikore e fjalëformuese, p.sh.,

I *botë* = baltë e bardhë dhe II *botë* = rrezullimi, toka, njerëzia, njerëzit; kjo e dyta ka edhe shumë p.sh., dy *botë* etj. dhe fiton produktivitet të ri fjalëformues: *botor-e, botëror-e, botërisht, i përbotshëm, botëkuptim* etj.

I *zot-i* = perëndia dhe II *zot-i, i zot-i* = pronari; (krhs. *toka pa zot, qen pa zot, i dal pa zot, Shqipëria ka zot*); e dyta ka veçori strukturore dalluese – p.sh., *nyja e parme ( i zoti i shtëpisë etj. )* dhe është produktive si temë fjalëformuese (*zotni e zotëri, zotëroj, zotohem* etj. )

I *fletë-a* = gjeth-i ; II *fletë-a* = krah. flatër; III *fletë-a* = një fije letër; e treta ka krijuar një varg fjalëformues që nuk e kanë e para dhe e dyta: *flet-ore, flet-ushkë, ç-flet-oj* etj.

Në këtë tip hyjnë edhe formimet e prejardhura me tema dhe afikse të njëllajta, p.sh.:

I *dorëz-a* e thikës, shpatës, parmendës, derës etj dhe II *dorëz-a* = dorashkë etj.



Tipi i tretë paraqet më tepër vështirësi për t'u dalluar, sepse ka edhe raste, kur procesi i ndarjes semantike nuk është kryer plotësisht. Këto vështirësi mund të kapërxehen nga zbatimi i rreptë i parimit semantiko-strukturor në një analizë të hollësishme të çdo fjale dhe të lidhjeve të saj leksiko-semantike, gramatikore e fjalëformuese, të marra së bashku.<sup>263</sup>

### 6.1.3. Paraqitja e homonimeve në *Fjalorin e Shqipes së Sotme (2002)*

Fjalori i shqipes së sotme i vitit 2002 me gjithsej 35.000 fjalë, numëron rreth 1050 homonime. Ky fjalor i është përmbajtur deri në fund një parimi të vetëm, gjë që e lehtëson shumë edhe qëndrimin e tij ndaj homonimeve. Ky fjalor përfaqëson rezultatet më të mira të leksikografisë shqiptare dhe në lëmin e homonimeve, gjithashtu. Mënyra e paraqitjes së homonimeve në të është si vijon:

- Homonimet e mirëfillta jepen si fjalë më vete dhe dallohen me shifra romake, p.sh.,

BAR, ~ I I m.sh. ~ ËRA, ~ ËRAT. 1. bot. Bimë me kërcell të hollë

BAR, ~ I II m.sh. ~ NA, ~ NAT. 1. Lëndë e përgatitur

BAR, ~ I III m.sh. ~ E, ~ ET. 1. Lokal i vogël

BAR, ~ I IV m.sh. ~ Ë, ~ ËT. 1. Njësi e matjes

VÉR / Ë, ~ AI f.sh. ~ A, ~ AT. 1. Stina

VÉR / Ë, ~A II f. 1. Pije

- Homoformat si p.sh.,

BREDH, ~ I. m.

BREDH jokal

ZË, ~ RI.

ZË kal, etj

jepen si fjalë më vete, por nuk dallohen me shifra romake.

Pjesët e pandryshueshme të ligjeratës, që kanë formë fonetike të njëjtë dhe lidhje të drejtpërdrejta fjalëformuese, jepen nën të njëjtën fjalë titull, por ndahen në paragrafë të veçantë me shifra romake, p.sh.,

<sup>263</sup> Kostallari, A. *Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe"*, te *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vëllimi II, Tiranë 1972. f. 51.

DREJT. I. ndajf. 1 ....

II. Parafj. 1.....

RRETH . I. ndajf. 1.....

II. parafj. 1....

III. pj. 1.....<sup>264</sup>

#### **6.1.4. Krahasim i pasqyrimit të homonimeve në fjalorët shpjegues të shqipes: *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe (1980)*<sup>265</sup> dhe *Fjalori i Shqipes së Sotme (2002)*<sup>266</sup>**

Parimi kryesor i përcaktimit të homonimisë në gjuhë varet nga vendi që çdo njësi leksikore zë në sistemin e gjuhës, në marrëdhëniet që ajo ka me njësi të tjera, në një periudhë të caktuar të zhvillimit gjuhësor. Për më tepër, kërkimet etimologjike dhe gjuhësore i vijnë në ndihmë çdo gjuhëtari për të bërë një përcaktim e pasqyrim sa më të drejtë të kësaj dukurie në fjalor. Veçanërisht kur bëhet fjalë për ato raste të dyshimta nëse jemi përballë një njësie leksikore homonimike apo polisemantike.

Zhvillimet historike, politike, kulturore dhe social-ekonomike kanë ndikimin e tyre në zhvillimin e gjuhës. Kësisoj është e nevojshme që këto zhvillime të pasqyrohen në fjalorët shpjegues. Pas botimit të *Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe* 1980, u ndje si e nevojshme botimi i një fjalori të ri, i cili do t'iu përgjigjej në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesave të shoqërisë. *Fjalori i Shqipes së Sotme* (2002) ndoqi po të njëjtat parime hartimi sikurse dhe fjalori i mëparshëm, por të plotësuar me një varg parimesh e kriteresh të veçanta sipas kohës së hartimit.

Sigurisht në ndryshimet e pasqyruara lidhur me leksikun e shqipes edhe homonimia kishte vendin e saj të veçantë, ku u vërejtën disa ndryshime në pasqyrimin e saj. Më poshtë po sjellim një përmbledhje të këtyre ndryshimeve sipas gërmave të veçanta.

Te gërma - **A** - vërejmë se homonimet e paraqitura në fjalorin e 1980-ës *ajazm/ë*, ~*a<sub>I</sub>*. *f. fet*. Ujë i bekuar dhe *ajazm/ë*, ~ *a<sub>II</sub>* *bot*. shih *mend/ër*, ~*a*; njësia e dytë leksikore nuk është më në fjalor e për këtë arsye, këto dy fjalë nuk dalin si homonime në gjuhën standarte. Ka shumë të ngjarë që mund të kemi pasur një fjalë të dialektit për fjalën 'mendër' që ishte homonime me fjalën e standartit, por që më 1980 kuptimi i saj kishte konotacione negative fetare dhe një pozitë të skajshme të fjalës.

Te fjalët *aktiv*, ~*e<sub>I</sub>* "që vepron me gjallëri" dhe *aktiv*, ~*e<sub>II</sub>* "që ka më shumë të ardhura se shpenzime"; të dy mbiemra të emëruar nga *aktiv*, ~*i<sub>I</sub>* *m. sh.* ~ *e*, ~ *et aktiv*, ~ *i<sub>II</sub>* *m.sh.* ~*e*, ~ *et* në botimin e ri nuk gjendet më mbiemri *aktiv*, ~ *e<sub>II</sub>* pasi përkufizimi për këtë mbiemër *llogari aktive* nuk përputhet me emrin temë fjalëformuese, si edhe me konceptin që shenjon.

<sup>264</sup> *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002, f. 10.

<sup>265</sup> *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.

<sup>266</sup> *Fjalori i Shqipes së Sotme*, Botimi i dytë, TOENA, Tiranë, 2002.

*apostrof/oj* <sub>I</sub> “vë apostrofin” dhe *apostrofim*, ~ *i*<sub>II</sub> “veprimi sipas kuptimit të foljes”; nuk gjenden më si njësi leksikore e rrjedhimisht, nuk dalin më si homonime me njësinë leksikore *apostrof/oj* <sub>I</sub> “i drejtohem me një apostrofë, i bëj thirrje”.

Po kështu kuptimi krahinor i *arb/ër*, ~ *ri*<sub>II</sub> - “fushë, rrafsh i hapët” ka rënë nga përdorimi e bashkë me të dhe forma homonimike e tij me emrin *arb/ër*, ~ *ri*<sub>I</sub> - “emër përmbledhës për shqiptarët në mesjetë”.

Homonimet *armat/ë*, ~ *a*<sub>I</sub> “njësi e madhe ushtarake” dhe *armat/ë*, ~ *a*<sub>II</sub> “zinxhir ari që e varin gratë në qafë si stoli” nuk dalin më si të tilla në fjalor, pasi kuptimi i fjalës së dytë nuk është më në përdorim.

*arrç*, ~ *i*<sub>III</sub> “bulkth, i quajtur ndryshe dosëz” gjithashtu, mungon duke mos formuar më vargun homonimik *arrç*, ~ *i*<sub>I</sub> “shkurre gjetherënëse dy - tre metra e lartë, me gjethe të këmbyera si të arrës” dhe *arrç*, ~ *i*<sub>II</sub> “arrëza e fytit”.

*as*, ~ *i*<sub>II</sub> “ruaza e vogël romake prej bakri” është hequr nga fjalori, e cila ishte homonime me *as*, ~ *i*<sub>II</sub> “letër loje”.

*atlas*, ~ *i*<sub>II</sub> “ruaza e parë e qafës, tek e cila mbështetet koka, arrëza e qafës” kuptim që i përket një sferë të veçantë përdorimi si anatomia, nuk është shënuar në fjalor e për rrjedhojë nuk paraqitet si homonime me *atlas*, ~ *i*<sub>II</sub> “përmbledhje hartash gjeografike”.

Gjithashtu, te gërma - **B** - gjejmë kuptime homonimike, të cilat nuk janë pasqyruar në fjalorë, për arsye se janë kuptime të vjetra që nuk përdoren më si për shembull: *back/ë*, ~ *a*<sub>I</sub> “dackë”; *barbariz.ëm*, ~ *mi*<sub>II</sub> “fjalë ose shprehje e huazuar pa nevojë nga një gjuhë tjetër”; *baritur* (*i, e*)<sub>II</sub> “i shëtitur”; *baxh/ë*, ~ *a*<sub>II</sub> “taksë bashkiake që paguhej në kohën e sundimit osman dhe në vitet para çlirimit për shitjen e bagëtive e të sendeve të tjera në treg”; *beret/ë*, ~ *a*<sub>II</sub> “revolver i vogël i prodhimit italian”; *bojalli*, ~ *e*<sub>I</sub> “që është i ngjyrosur me ngjyra të ndryshme”; *boks*, ~ *i*<sub>III</sub> “e ndarë e vogël brenda në stallë”; *buqic/ë*, ~ *a*<sub>I</sub> “dry” dhe *buqic/ë*, ~ *a*<sub>II</sub> “zog i vogël sa një trumcak ...”; *bursist*, ~ *i*<sub>II</sub> “kapitalist që luan në bursë me kursin e monedhave të arit, të aksioneve e të letrave të tjera me vlerë”; ose mund të jenë kuptime specifike që përdoren vetëm në një fushë të caktuar si: *bathor/e*, ~ *ia*<sub>II</sub> “presh i egër, badër” kuptim specifik në botanikë; *bushel/ë*, ~ *a*<sub>II</sub> “turjele e madhe për të hapur vrima në dru”.

Apo kuptime të fjalëve që dalin vetëm në dialekte si: *bejle/g*, ~ *gu*<sub>II</sub> “tufa e luleve në majë të bimës së misrit”; *ben/ g*, ~ *gu*<sub>II</sub> “gjerdan me gurë të çmuar ose me florinj”; *bisbiq*, ~ *i*<sub>I</sub> “kulaç që bëhet me miell misri të situar hollë, me qumësht dhe me gjalpë”; *buç*, ~ *i*<sub>I</sub> “xhungë, bullungë”.

Një njësi e re leksikore *buk/ël*, ~ *la*<sub>III</sub> “kërpudhë e kuqërreme me tul dhe me shije të ëmbël, që hahet” është shtuar, e cila formon një varg homonimik me *buk/ël*, ~ *la*<sub>I</sub> - “kafshë e vogël mishngrënëse e familjes së kunadhes” dhe *buk/ ël*, ~ *la*<sub>II</sub> “tufë e trashë flokësh, e dredhur si kaçurrel”.

Ndryshimet që vëmë re te gërma - **C** - janë të po së njëjtës natyrë, ku njësitë leksikore me kuptime të vjetëruara, si: *cák/ë* ~ *a*<sub>II</sub> “pjesë e caktuar e një pagese, kuotë”; apo me kuptime specifike, si: *cep*<sub>II</sub> “vesh i vogël rrushi” dhe ato krahinore si: *cullóhem* <sub>I</sub> “bëhem si fëmijë” e *cullóhem* <sub>II</sub> “më fryhet barku” nuk dalin më si çifte homonimike në fjalor.

Ndërkaq çifti homonimik *cum/ër* ~ *ri*<sub>I</sub> “copë e shkurtër trungu, që shërben për t’u ulur në të ose për të mbështetur diçka mbi të” dhe *cumër* ~ *ri*<sub>II</sub> “lloj qefulli me trup

boshtor e të zhdërvjellët” kanë shërbyer si tema fjalëformuese për çiftin tjetër homonimik *cumrak* ~ *u<sub>I</sub>* “cung i vogël” dhe *cumrak* ~ *u<sub>II</sub>* “cumër i vogël”, ku fjala e dytë nuk ruhet më në botimin e ri.

Për gërmën - Ç - i vetmi ndryshim është shtimi i një njësie të re leksikore, pjesë e vargut homonimik: *çe/k*, ~ *ku<sub>I</sub>* “urdhër pagesë me të cilën dikush ka të drejtën të tërheqë nga banka” dhe *çe/k*, ~ *u<sub>II</sub>* “banor vendas i Çekisë ose ai që e ka prejardhjen nga Çekia” dhe *çe/k*, ~ *u<sub>II</sub>* “ushqimi që merr me vete bariu për të ngrënë gjatë ditës” dhe njësia e re *çek* ~ *a*, ~ *ur<sub>IV</sub>* “prek me dorë” me etimologji të ndryshme nga të parat, një variante e proto-shqipes \**tserka*.

Po kështu të gërma - D - dhe - DH - gjejmë të lëna jashtë fjalorit kuptimet e vjetra dhe krahinore të fjalëve që formonin homonime me fjalën e standartit, për shembull, *dërrmoj<sub>II</sub>* “zbres”; *ditar*, ~ *i<sub>II</sub>* “njësi mase për tokën”; *divan*, ~ *i<sub>II</sub>* “përmbledhje poezish lirike në letërsinë orientale”; *dóç/e* ~ *ja<sub>II</sub>* “shtamë e vogël, zakonisht me një vesh”; *dran/g*, ~ *gu<sup>1</sup>* “këlysh i disa kafshëve të egra”; *dúd/ë* ~ *a<sub>II</sub>* “man i zi. Kokërr mani shumë e pjekur dhe e butë, që bie vetë në tokë”; *dhjetësh/e*, ~ *ja<sub>II</sub>* “revole me dhjetë fishekë”.

Gërma - E - ka shtuar dy njësi të reja homonimike në vargun ekzistues, përkatësisht *e<sub>V</sub>* “pjesëz në fillim të fjalive pyetëse për të tërhequr vëmendjen” dhe *e<sub>VI</sub>* “pashtrëm për të shprehur habi”. Kemi edhe futjen e një çifti të ri homonimik *elips*, ~ *i<sub>I</sub>* ose *elips/ë*, ~ *a<sub>I</sub>* “vijë e lakuar, tërësisht e mbyllur, në trajtë vezake si të vijës së përfutur nga prerja e pjerrët e një koni ose cilindri me një rrafsh” dhe *elips/ë*, ~ *a<sub>II</sub>* ose *elips*, ~ *i<sub>II</sub>* “heqja e një fjale ose e një gjymtyre të nënkuptueshme në një togfjalësh a në një fjali, për t’u shprehur më shkurt”.

Duhet theksuar se kemi një paraqitje të saktë të vargut homonimik të mëposhtëm, ku në fjalorin e vitit 1980, kuptimet *édëz*, ~ *a<sub>II</sub>* “bot. endë” dhe *éndëz*, ~ *a<sub>III</sub>* “zool. vezët që lëshon miza në peshk” ishin dhënë si kuptime polisemantike, edhe pse i përkasin dy fushave të ndryshme.

ÉNDËZ, ~ A <sup>1</sup> f. sh. ~ A, ~ AT. Pëlhurë merimange, cergë

ÉNDËZ, ~ A <sup>2</sup> f. sh. ~ A, ~ AT. bot. Endë

ÉNDËZ, ~ A <sup>3</sup> zool. Vezët që lëshon miza në mish, në peshk etj.

ÉNDËZ, ~ A <sup>4</sup> f. sh. ~ A, ~ AT. vjet. Masë gjatësie, e barabarë me perimetrin e kokës së njeriut, që përdorej për të matur pëlhurën, basmën etj.

Për më tepër edhe në këtë gërmë gjejmë kuptime të vjetra ose krahinore që janë shmangur së bashku me çiftet homonimike që ato formonin si: *éhu/ll*, ~ *lli<sub>II</sub>* “lëndë lisi”, *emisár*, ~ *i<sub>II</sub>* “tek. kanal nëpër të cilin kalon e derdhet në det a diku gjetkë uji i një kënete, i një liqeni; *éndës*, ~ *e<sub>II</sub>* “endacak”.

Përveç dy çifteve të rinj homonimikë, *fytak*, ~ *u<sub>I</sub>* “enë e vogël për ujë me një lëfy” dhe *fytak*, ~ *u<sub>II</sub>* “grykës, llupës” dhe *grunor/e*, ~ *ja<sub>I</sub>* “grunishtë” si dhe *grunor/e*, ~ *ja<sub>II</sub>* “lloj dardhe që piqet në një kohë me grurin”, të gjitha ndryshimet e tjera, që vihen re te gërmat - F; - G; - GJ - lidhen me rënien e kuptimeve krahinore, kuptimeve të fushave specifike apo kuptimeve të vjetra, të cilat formonin çifte homonimike me standartin gjuhësor. Mund të përmendim disa prej tyre: *fil<sub>I</sub>* “zool. elefant” dhe *fil<sub>II</sub>* “det. buza në të dy anët e kuvertës së anijes”; *foke<sub>II</sub>* “sëmundje e

rëndë ngjitëse, që shfaqet me ethe dhe me majisje të lëkurës”; *gab/ë*, ~ *a<sub>II</sub>* “zool., krahin. shkabë”; *gris/ë*, ~ *a<sub>I</sub>* “krahin. e grisur”; *gugúsh/e<sub>I</sub>* “kumri”; *gjep*, ~ *i<sub>II</sub>* “enë me grykë të ngushtë e me lëfyty të hollë”.

Ndryshime të pakta në numër vihen re dhe te gërmat - **H** - ; - **I** - ; - **J** - . Përveç ndarjes së strukturës semantike dhe formimit të çiftit homonimik *heqési*, ~ *i<sub>I</sub>* “vjet. ndihma që i jepte heqësi një kusari për të vjedhur ose një gjaksi për të vrarë dikë” dhe *heqési*, ~ *i<sub>II</sub>* “vuajtje, të hequrat” ndryshimet e tjera kanë të bëjnë me rënien e kuptimeve krahinore.

Gërma - **K** - është disi më ndryshe. Këtu gjejmë një numër të madh ndryshimesh dhe në mënyrë të veçantë rënien e njëjësive homonimike, kuptimi i të cilave ka pasur karakter ideo-politik, si: *kafaz*, ~ *i<sub>II</sub>* “nëpunës në shërbim të konsullit ose të një përfaqësie diplomatike”; *këshilltar*, ~ *i<sub>II</sub>* “anëtar i këshillit popullor”; *kúad/ër*, ~ *ri<sub>I</sub>* “tërësia e punonjësve të një institucion”.

Fjalët e dialektit dhe të sferave specifike, gjithashtu, janë mënjeluar, për shembull, *kalánd/ër*, ~ *ra<sub>II</sub>* “tek. makinë me cilindra, që shërben për të lëmuar ose për t’i dhënë shkëlqim një pëlhurë a një stofi”; *krápj/e*, ~ *a<sub>II</sub>* “anat. heqës”; *kall<sub>II</sub>* “krahin. ndez”; *kór/e*, ~ *ja<sub>II</sub>* “krahin. turp, marrë”; *kros*, ~ *i<sub>II</sub>* “qeros”; *kuk/ój<sub>I</sub>* “përkul si hark” dhe *kuk/ój<sub>II</sub>* “mbush plasat e vozës a të një ene tjetër prej druri që të mos rrjedhë”; *kumbará*, ~ *ja<sub>II</sub>* “vjet. shih. bomb/ë”.

Ndërkaq, kemi futjen e një çifti të ri homonimik *këndim*, ~ *i<sub>I</sub>* “veprimi sipas këndoj” dhe *këndim*, ~ *i<sub>II</sub>* “veprimi sipas këndoju”.

Gërmat - **L** - ; - **LI** - ; - **M** - ; - **N** - dhe - **O** - kanë shumë pak ndryshime. Kështu që po përmendim vetëm njësitë dhe kuptimet e reja që janë futur, ndërkohë që janë të pakta edhe rëniet e kuptimeve. Këtu gjejmë: *lárëz*, ~ *a<sub>III</sub>* “lloj sëmundjeje që i ngjan zgjebes” që i bashkëngjitet dy fjalëve ekzistuese homonimike *lárëz*, ~ *a<sub>I</sub>* “bot. shih *larushk*, ~ *u*” dhe *lárëz*, ~ *a<sub>II</sub>* “zool. zog i vogël sa një harabel”, si dhe një çift i ri homonimik, si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit kulturore: *mis*, ~ *i<sub>I</sub>* “pjesë e trupit, gjymtyrë” dhe *mis*, ~ *i<sub>II</sub>* “vajza më e bukur e përzgjedhur në një konkurs”.

Ndryshime të shumta, kryesisht rënie të njëjësive dhe kuptimeve krahinore, i gjejmë te gërma - **P** - dhe pothuajse aspak te gërma - **Q** - . Meqënëse janë një numur i madh fjalësh që nuk dalin më si kuptime homonimike, po përmendim vetëm disa çifte: *i pagëzuar<sub>I</sub>* “fet. që ka bërë pagëzimin” dhe *i pagëzuar<sub>II</sub>* “që nuk ka njohur gëzimet kryesore në jetë”; *përgjërát / ë*, ~ *a<sub>I</sub>* “qënie shumë e shëmtuar, përbindësh” dhe *përgjërát / ë*, ~ *a<sub>II</sub>* “përgjërím”; *përkthyer (i, e)<sub>I</sub>* “që është kthyer në një gjuhë nga një gjuhë tjetër” dhe *përkthyer (i, e)<sub>II</sub>* “që është i kthyer në një anë, i harkuar”; *plen/g*, ~ *u<sub>I</sub>* “send i rëndë si plumb” dhe *plen/g*, ~ *u<sub>II</sub>* “krahin. dhunë, turp”; *pol*, ~ *i<sub>II</sub>* “krahin. kind, palat e fustanit” dhe *pol*, ~ *i<sub>III</sub>* “thith, çivi dere”; *prév/ë*, ~ *a<sub>I</sub>* “mit. vitore” dhe *prév/ë*, ~ *a<sub>II</sub>* “krahin. udhë shumë e rrahur”.

Gërmat - **R** - dhe - **Rr** - nuk kanë ndonjë njësi të re leksikore, që formon homonimi me fjalët ekzistuese. Edhe në këto gërma kemi rënie të disa kuptimeve dialektore ose të vjetëruara duke shmangur homoniminë me standartin.

Për shembull, kemi rrëzimin e disa elementëve në vargun homonimik *re*, ~ *ja<sub>III</sub>* “nusja e shtëpisë” dhe *re*, ~ *ja<sub>IV</sub>* “krahin. fytyrë, pamje, çehre” dhe *re*, ~ *ja<sub>V</sub>* “leje, urdhër”; mënjanimin e çiftit *reklamues*, ~ *i<sub>I</sub>* “ai që i bën reklamë një malli, i cili nuk i ka cilësitë e nevojshme ose nuk i plotëson kërkesat”; si edhe mungesën e disa njëjësive leksikore me kuptimet e tyre përkatëse: *reaktiv*, ~ *i<sub>II</sub>* “bised. aeroplan me motor reaktiv”; *rend*, ~ *i<sub>III</sub>* “vrap”; *rend/ój<sub>I</sub>* “rendit”; *roman*, ~ *i<sub>II</sub>* “krahin. shih shulës, ~ i”;

*rragë* <sub>I</sub> “pëlhurë e trashë prej liri, që përdoret për thasë”; *rrik/ë*, ~ *a* <sub>II</sub> “kuti druri e varur në mur për të mbajtur lugët, lugës”; *rrókme*, ~ *ja* <sup>2</sup> - “krahin. punë që e ndërmerr dikush për të bërë”.

Të njëjtën dukuri vëmë re dhe te gërmat - **T** - dhe - **Th** -, ku kemi mënjanimin e disa elementëve, si: *tabák*, ~ *u* <sub>II</sub> “vjet. lëkurëregjës”; *táj/ë*, ~ *a* <sub>I</sub> “spec. vidhë”; *tretár*, ~ *i* <sub>I</sub> “hist. ai që i merrte pronarit për përdorim tokën a bagëtinë dhe i jepte një të tretën e prodhimit”; *tullár*, ~ *i* <sub>I</sub> “vegjë, tezgjah”; *thartór /e*, ~ *ja* <sub>I</sub> “hirrë e thartuar me farë kosi”; *thékem* <sub>I</sub> “prekem thellë në zemër, mallëngjehem”; si dhe çiftin e ri homonimik: *tull/ë*, ~ *a* <sub>I</sub> material për ndërtimin e mureve” dhe *tull/ë*, ~ *a* <sub>II</sub> “tullac”.

Për sa i përket gërmave - **U** - dhe - **V**-, përveç ristrukturimit kuptimor si te fjala *úrëz*, ~ *a* <sub>II</sub> “vjet. vendi përballë këmbëzës, ku vihej baruti”, e cila jepet si kuptim polisemantik dhe jo më si i shkëputur; kemi dhe rrëzimin e disa njësisve leksikore, ku tema fjalëformuese dhe të gjitha kuptimet e tjera të prejardhura prej saj nuk janë paraqitur si te: *varr/ó/j* <sub>I</sub> “plagos” dhe *varrohem* <sub>I</sub>, *varrim* <sub>I</sub>; *vizóhet* <sub>I</sub> “zgjatet diçka si vijë, formon një vijë” dhe *vizóhet* <sub>II</sub> pësore e *vizoj* <sub>II</sub> “shënoj vizën në pashaportë”. Vëmë re dhe një çift të ri homonimik: *vájsh/ëm* (*i*) <sub>I</sub> “që është si vaj, i ngjet vajit” dhe *vájsh/ëm* (*i*) <sub>II</sub> “që shpreh trishtim a dhimbje”.

Së fundi, ndryshimet te gërmat - **X** -; - **Xh** -; - **Y** -; - **Z** - dhe - **Zh** - janë më të pakta, pasi edhe numri i homonimeve në këto gërma është dhe më i vogël. E njëjta dukuri është e pranishme dhe te këto homonime, pra shmangien e disa homonimeve si: *xin/ë*, ~ *a* <sub>I</sub> “majë pene për të shkruar”; mosparaqitjen e homofomës *zgjidhem* <sub>I</sub> pës. e zgjedh. “fara zgjidhet me kujdes”; *zhák /ë*, ~ *a* <sub>I</sub> “pellg me ujë të ndenjtur”; *zhap* <sub>II</sub> “bised. fut me forcë diku (një njeri, një send, etj.)”; *zhavéll/ë*, ~ *a* <sub>I</sub> “hist. lloj shtize jo shumë e gjatë”.

Në përfundim të këtyre gjetjeve, nga krahasimi i dy botimeve të fjalorëve shpjegues të shqipes, që përkrijnë edhe me ndryshime të mëdha jashtëgjuhësore, vëmë re një shmangie thelbësore të homonimeve. Shtimi i njësisve të reja homonimike është shumë herë më i kufizuar sesa shmangia e tyre. Kjo gjë mund të jetë bërë me qëllim që të mënjanohej ato kuptime, të cilat nuk janë më aq të përdorshme në gjuhën standarte.

Lëvizja e vazhdueshme gjuhësore shkakton vetvetiu vjetërimin e disa kuptimeve dhe lindjen e shumë të tjerave. Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme që kjo gjëndje të pasqyrohet në një fjalor shpjegues. Do të ishte e udhës që këto çifte apo vargje homonimike të ruheshin për arsye studimore duke i mbledhur në një fjalorth të veçantë për homoniminë.

### 6.1.5. Homonimet në *FGJSSH* (1980) sipas Agim Spahiut<sup>267</sup>

I një rëndesie të veçantë në gjuhën shqipe është fjalorthi i studiuesit Agim Spahiut që daton në 1 nëntor 2008. Ky fjalorth i homonimeve është sajuar nga Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe i vitit 1980. Ai është i veçantë dhe shërben si mbështetje për mjaft punime leksikografike dhe studime në fushën e homonimisë në gjuhën shqipe. Duke u ndalur në çështjen e përfshirjes së homonimeve në Fjalorin e Gjuhës së Sotme

<sup>267</sup> [http://shkenca.org/pdf/gjuhe/homonimia\\_ne\\_fgjssh.pdf](http://shkenca.org/pdf/gjuhe/homonimia_ne_fgjssh.pdf).

Shqipe të vitit 1980, vihet re që ai është shumë i pasur me to. Studiuesi thekson se duke vënë në përdorim programet e njohura të Linuks-it (Linux), ka arritur të klasifikojë grupet e fjalëve, që formojnë homonime të shënuara me numra romakë: I, II, III etj. Pra, paraqitja e homonimeve në fjalor i përmbahet një parimi të vetëm. Me to është arritur të sajohet një fjalorth, të cilin e gjejmë në internet te [http://shkenca.org/pdf/gjuhe/homonimia\\_ne\\_fgjssh.pdf](http://shkenca.org/pdf/gjuhe/homonimia_ne_fgjssh.pdf).

Për të parë konkretisht mënyrën e paraqitjes së homonimeve në të janë sjellë disa shembuj konkretë:

- **ARTIKULL I** m. 1. Shkrim me përmbajtje publicistike a shkencore, që trajton një çështje të caktuar dhe që botohet në një gazetë, në një revistë apo në një përmbledhje. Artikull kryesor. Artikull kritik (shkencor, informativ). Artikull përkujtitor. Artikull gazete. Autori, titulli i artikullit. Përmbledhje artikujsh. Shkruaj (botoj) një artikull.

2. Ndarje në një fjalor, që përfshin fjalën titull, shpjegimet dhe të gjitha të dhënat e tjera për të. Artikujt e fjalorit. Artikulli për fjalën ...

3. drejt. Shih NEN ~I. artikulli i parë i ligjit.

**ARTIKULL II** m. Lloj prodhimi, malli a sendi, i caktuar për t'u shitur. Artikuj industrial (ushqimorë). Artikuj shkollorë (kulturorë, sportivë). Artikuj të ndryshëm. Artikuj ndërtimi. Artikuj të përdorimit të gjerë. Artikuj për fëmijë. Lista e artikujve. Prodhoj një artikull të ri.

- **NOTË I** f. 1. muz. Shenjë, që përfaqëson një tingull muzikor sipas shkallës dhe gjatësisë; vetë tingulli kur këndohet ose luhet në një vegël; let. muz. Tekst i një vepre muzikore, i shkruar me këto shenja; fletë ose fletore me tekste të pjesëve muzikore. Nota <re>. Notë e plotë. Notë katërshe (tetëshe). Nota nën pentagram (mbi pentagram). Mësoj notat. Marr një notë, këndoj me zë një tingull ose i bie në vegël. Këndoj (i bie) me nota. E hedh në nota. I vë përpara notat.

2. fig. ngjyrimi që merr diçka e shprehur ose e shkruar sipas ndjenjave dhe qëndrimit të njeriut; tipar dallues që merr në shprehjen e jashtme një dukuri; veçori e shprehje në një vepër artistike. Nota optimiste (të gëzuara). Nota të zymta (pesimiste). Nota lirike (dramatike). Nota antifeudale (antiklerikale). Nota shqetësimi (ironie). Sjell nota të reja (një notë të re).

**NOTË II** f. Vlerësimi i shkallës së njohurive ose i sjelljes së nxënësve i shprehur me një numër. Natë e mirë (e keqe, e dobët). Notë kaluese (pakaluese). Notë negative, notë pakaluese. Nota mesatare. Nota e sjelljes (e përparimit). Nota vjetore. Libreza e notave. U, i (zbres, ngre) notën. I thyen notën e sjelljes. Vlerësoj me notë. Dal me nota të mira. Nuk mësojmë për notë.

**NOTË III** f. dipl. Letër zyrtare që i dërgon një shtet një shteti tjetër me anë të një përfaqësuesi. Notë diplomatike. Notë proteste. Shkëmbim notash. I drejtoi (i dërgoi) një notë.

Pra grupet homonimike, në renditje alfabetike, vijnë me homonime të listuara njëra nën tjetrën, ku vendin e parë e zë fjala homonime më e përhapur në përdorim. Fjalët homonimike shkruhen me gërma kapitale dhe shoqërohen me një numër të

madh romak. Më pas vjen e renditur pjesa e ligjeratës që ato i përkasin dhe kuptimet e tyre, të shoqëruara me shembuj përkatës.

### 6.1.6. *Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe (2008) nga Bahtijar Kryeziu dhe Ali Jashari*<sup>268</sup>

Në gjuhën shqipe, zgjidhja më e plotë në fushën leksikografike, në këndin e ngushtë të çështjes së homonimisë do arrihej me hartimin e një fjalori të homonimeve, që do të shërbente si mbështetje për punime të mëtejshme leksikografike. *Fjalori i homonimeve të gjuhës shqipe* nga Bahtijar Kryeziu dhe Ali Jashari është i pari dhe i vetmi fjalor i plotë i homonimisë në gjuhën shqipe, me përjashtim të ndonjë kontributi më të pjesshëm në formën e fjalorthit që u përmend më lart. Ai është një bashkëpunim mjaft i frutshëm i gjuhëtarit nga Kosova Bahtijar Kryeziu dhe Profesorit të Gjuhësisë nga Shqipëria Prof. Dr. Ali Jashari. Profesor A. Jashari ka ardhur përpara lexuesit dhe studiuesit edhe me një fjalor tjetër të përmasave shumë më të mëdha i titulluar *Fjalor me Shprehje të Huazuara në Gjuhën Shqipe*.<sup>269</sup>

Hartimi i një fjalori homonimik ka qënë një dëshirë e hershme e autorëve, për të përmbledhur dhe shpjeguar homonimet e gjuhës shqipe për dy arsye: e para për pasurinë e madhe homonimike që ka gjuha shqipe të pasqyruar nëpër fjalorë të ndryshëm shpjegues<sup>270</sup>, nga të cilët është marrë gjithë lënda; e dyta, sepse mjaft koncepte e probleme për homoniminë tashmë janë trajtuar dhe zgjidhur nga gjuhësia shqiptare dhe këto kanë shërbyer për përzgjedhjen e materialit të vjelë.

Ky fjalor është i pari i këtij lloji në gjuhën shqipe. Me hartimin e tij, autorët kanë synuar t'i shërbejnë sadopak shkollarëve që mësojnë gjuhën shqipe e më gjerë.

Duke shfrytëzuar fjalorë të ndryshëm të shqipes, autorët kanë nxjerrë rreth 700 e ca çifte homonimesh të tipave të ndryshëm, që përfshijnë gati 1470 fjalë. Ja disa shembuj nga mënyra e paraqitjes së homonimeve në fjalor:

- **DÁM/Ë, ~Aı** f. Lojë me dy veta, me nga gjashtëmbëdhjetë gurë, që lëvizin mbi një pllakë të ndarë në gjashtëdhjetë e katër katrorë; pllaka dhe gurët që

<sup>268</sup> Kryeziu, B; Jashari. A. *Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe*, Shkëndija, Prishtinë, 2008.

<sup>269</sup> Jashari, A. *Fjalor me Shprehje të Huazuara në Gjuhën Shqipe*, Dudaj, Tiranë, 2007.

<sup>270</sup> [Abdullah Zyberi, *Fjalor i fjalëve të rralla*, Prishtinë, 1979; Ali Dhrimo, Edmond Tupja, Eshref Ymeri, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002; D. N. Gazulli, *Fjalorthi i ri*, Visaret e kombit, vëll. XI ( fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqipnis, Tiranë, 1941.; *Fjalori i ri i shqypes*, Bashkimi, Shkodër, 1908; *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980; *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984; *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002; Jak Junku, *Fjaluur i voghel Scyp e Ltinisct*, n'Scoder, 1895; K. Cipo, E. Çabej, A. Krajni, O. Muderrizi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954; Mehmet Ahmetaj, *Fjalor i të folmeve të shqiptarëve në Mal të Zi*, Prishtinë, 1996; P. Haxhillazi-s. Ahmeti, *Fjalor i shqipes së Plavës e Gucisë*, T, 2004; Pano Tase, *Fjalorthi i ri*, Visaret e kombit, vëll XII (fjalë të rralla të përdorura në Jug të Shqipnis), Tirane, 1941; Petrit Zeneli, *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të rralla*, Tiranë, 1999; Qemal Murati, *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset e Maqedonisë*, Shkup, 2003; Thanasi Feka, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004., etj.]

Cituar sipas Bibliografia e Veprave të Vjela te Kryeziu, B; Jashari. A. *Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe*, Shkëndija, Prishtinë, 2008, f. 227 - 229.



shërbejnë në këtë lojë. *Gurët e damës. Tabela e damës. Luajnë damë. Bleu një damë.*

**DÁM/Ë, ~AII** f. sh. ~ **A(T)** 1. Grua e martuar, zonjë. *Damë plakë. Damë shoqërimi.*

2. Grua a vajzë që vallëzon me një kavalier. *E ndërroi damën. Kërceu me të gjitha damat. Damat në fuqi!* 3. *Shah.* Mbretëreshë. *Dama e bardhë (e zezë). I mori damën. Ndërruan damat.* 4. Një nga figurat në lojërat me letra, që paraqet një grua; letra me këtë figurë; çupë. *Damë kupë (spathi). Hodhi damën.*

- **PÓST/Ë, ~AI** f.sh. ~ **A (T)** 1. Institucion zyrtar që merret me shpërndarjen e letrave, të shtypit, të pakove etj. *Posta qendrore (e lagjes). E dërgoi me postë.*

2. Mënyra e dërgimit dhe e shpërndarjes e një institucioni të tillë ose dërgesa vetë. *Postë ajrore. Pullë poste. Kuti poste. Mori (solli) postën.*

**PÓST/Ë, ~AII** f.sh. ~ **A (T)** *usht.* Vend i posaçëm në një njësi të vogël ushtarake për të ruajtur; ushtarakët e kësaj njësie. *Postë kufitare (ushtarake). Postë vrojtimi.*

Si vihet re nga këta shembuj autorët përdorin në fjalor disa shenja.

Grupet homonimike vijnë në renditje alfabetike. Elementet e tyre përbërës dmth., fjalët homonimike shkruhen me gërma kapitale dhe shënohen me numrat e vegjël romake: I, II, III etj. tek cepi poshtë në fund të fjalës, p.sh., **DÁM/Ë, ~AI, DÁM/Ë, ~AII**. Ato shoqërohen nga pjesa e ligjeratës, të cilës i përkasin. Më tej, vijnë me numra njëri pas tjetrit kuptimet e secilës fjalë homonimike.

Në fjalor gjejmë, gjithashtu, edhe shenja të tjera si p.sh.,

- ‘ - theksi i fjalës;
- ~ - shenja që përfaqëson pjesën e pandryshueshme të fjalës;
- - shenja që vihet pas a përpara një teme fjalëformuese ose pas një parashtese.

Fjalori ka tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe ka gjetur përdorim të gjerë për shkak të vlerave të tij të veçanta.

## 6.2. Homonimia në leksikografinë angleze

Lidhur me paraqitjen e homonimeve në fjalorë, ndiqet i njëjti parim si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze. Homonimet jepen në fjalor si fjalë më vete të shënuara me shifra romake ose me numra arabë në shqip dhe në anglisht.

Për një leksikograf të gjuhës angleze, vendosja e kufijve të fjalës ka qenë vazhdimisht një problem i diskutuar. P.sh., është e lehtë të kuptosh, që fjala *match* të *safety matches*, është një fjalë e ndarë nga folja *match* “përshtas, kombinoj”. Por, hartuesi i fjalorit duhet të ketë argumentuar kur i rendit nën të njëjtën fjalë titull (entry) në fjalor *match* si të *football match* dhe *match* të *meet one’s match* “i barabartë, shok”. E njëjta gjë ndodh me foljen *bear*, të *bear a burden*, *bear troubles*, *bear fruit*, *bear offspring*. A duhet ajo të vëzhgohet si një fjalë e vetme apo si një grup i dy ose ndoshta

më shumë homonimesh? Në mënyrë të ngjashme, folja *charge*, te *charge the gun*, *charge the man with theft*, *charge somebody a stiff price* mund të shihet në mënyra të ndryshme.

Pra siç vihet re, problemi i vendosjes së kriterit të diferencimit midis fjalëve të ndryshme identike në shqiptim, dhe kuptimeve të ndryshme të së njëjtës fjalë, është i vështirë për t'u zgjidhur. Leksikografi duhet të jetë sa më i saktë në renditje të tilla në fjalor sepse nga kjo varet nëse ai do t'i kursejë apo harxhojë kohë lexuesit.

Hartuesit e fjalorëve në gjuhën angleze kanë ofruar zgjidhje të ndryshme.

Është një praktikë e njohur në leksikografinë e gjuhës angleze të kombinojë në një fjalë titull (entry) fjalë me formë fonetike identike, ose, me fjalë të tjera, t'i grupojë fjalë të tilla nën një njësi leksikore të pandryshueshme, pavarësisht se ato mund t'u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës. Në leksikografinë angleze të pasluftës ndiqej një tjetër praktikë. P.sh., Fjalori anglisht - rusisht, i botuar nga V. D. Arakin (V. D. Arakin) e paraqit fjalën '*right*' nën nëntë fjalë tituj, ndërsa Hornbi (Hornby) në fjalorin e tij, të njëjtën fjalë e jep nën katër fjalë titull.

E vërteta qëndron në faktin se nuk ekziston një kriter universal për dallimin midis homonimisë dhe polisemisë, në qoftë se nuk pranohet zgjidhja që ka ofruar hartuesi i fjalorëve V. I. Abajev-i (V. I. Abayev), i cili ndoqi të dhënat e etimologjisë. Ai sugjeroi që të diferencohen si homonime vetëm ato fjalë, të cilat kanë burime të ndryshme dhe që rastësisht u përputhën nga ana fonetike. Zgjidhja e ofruar prej tij kufizohet nga fakti se burimet e ndryshme të fjalëve mund të identifikohen brenda historisë së gjuhës. Fjalët, të cilat përputheshin fonetikisht para se të hynin në fjalorin e anglishtes, nuk u përfshinë.

Megjithatë, kriteri etimologjik mund të çojë shpesh në pasaktësi në situatën e sotme. Fjalori i sotëm i gjuhës angleze nuk është thjesht një replikë e fjalorit të anglishtes së vjetër me disa shtesa nga huazimet. Në shumë aspekte, ai është një sistem i ndryshëm dhe ky sistem nuk do të paraqitet plotësisht nëse leksikografi drejtohet vetëm nga parimi etimologjik.

Një procedurë tjetër, jo shumë rigorozë, por më e thjeshtë, bazuar në të dhëna sinkronike dhe në një analizë transformuese është quajtur *transformim shpjegues*. Ajo bazohet në supozimin se, n.q.s. kuptime të ndryshme, që paraqiten me të njëjtin kompleks fonetik, mund të përkufizohen me ndihmën e një togfjalëshi identik, ato mund të vëzhgohen si variante të së njëjtës fjalë; n.q.s. jo, atëherë, ato janë homonime. Studiojmë fjalitë e mëposhtme:

1. A child's voice is heard. (Një zë fëmije u dëgjua.)
2. His voice ... was ... annoyingly well-bred. (Zëri i tij ... ishte ... bezdisës.)
3. The voice - voicelessness distinction ... sets up some English consonants in opposed pairs ... (Dallimi e zëshme – e pazëshme ... I vendos disa bashkëtingëllore të gjuhës angleze në çifte të kundërta ...)
4. In the voice contrast of active and passive ... the active is the unmarked form. (Në kontrastin e zërit të aktives dhe pasives ... aktivja është forma e pashënuar.)

Variante i parë *voice I* mund të përkufizohet si “tinguj të artikuluar në të folur ose kënduar si karakteristikë e një personi të caktuar”; *voice II* si “mënyrë e tingujve të artikuluar në të folur ose kënduar”; *voice III* si “dridhje e kordave vokale në tingujt e artikuluar”. Siç vihet re, të gjitha përkufizimet përmbajnë në thelb një element që përbën bazën e përgjithshme të pandryshueshme të kuptimit të tyre. Megjithatë, është e pamundur të përdorim të njëjtin element bazë për kuptimin e shembullit të katërt. Përkufizimi në këtë rast do të ishte *voice IV* “formë foljeje, që shpreh lidhjen midis kryefjalës dhe veprimit”. Ky përkufizim e diferencon kuptimin e katërt nga tri të parat. Pra, ky mund të konsiderohet homonim me fjalën polisemantike të tri varianteve të para.

Procedura e përshkruar më lart mund të ndihmojë në rastin kur fjalët në diskutim u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës, p.sh., folja *voice* mund të ketë kuptimin “shqipton një tingull me ndihmën e kordave vokale”.

Kjo procedurë na çon tek problemi i *patterened homonymy* dmth., i kuptimit leksikor të pandryshueshëm i pranishëm të homonime, që janë zhvilluar nga i njëjti burim dhe ju përkasin pjesëve të ndryshme të ligjeratës.

Pra, a është e drejtë që një leksikograf të vendosë foljen *to voice* me kuptimin e mësipërm nën të njëjtën fjalë titull me tri variantet e para të emrit? E njëjta pyetje bëhet për fjalët *after* “pas” dhe *before* “para” - parafjalë, lidhëz dhe ndajfolje.

Brezi i vjetër e gjuhëtarëve anglezë pranoi si plotësisht të mundshme që e njëjta fjalë të ketë funksionin e pjesëve të ndryshme të ligjeratës.<sup>271</sup> Çifte të tilla fjalësh si *act* n. “veprim” - *act* v. “veproj”; *back* n. “kurrizi” - *back* v. “kthehem mbrapa”; *drive* n. “udhëtim me makinë” - *drive* v. “ngas makinën”, të lartpërmendurat *after* dhe *before* etj, u trajtuan të gjitha si një fjalë që funksiononte si pjesë e ndryshme e ligjeratës. Më vonë, kjo pikëpamje u kritikua. U vendos që e njëjta fjalë nuk mund t’iu përkasë në të njëjtën kohë pjesëve të ndryshme të ligjeratës, sepse kjo do të binte ndesh me përkufizimin e fjalës si një sistem formash. Edhe kjo pikëpamje u kritikua, gjithashtu. Nëse dikush e mbështet këtë të fundit atëherë ai duhet të vëzhgojë si fjalë të veçanta të gjitha rastet kur fjalët janë emra të numërueshëm në një kuptim dhe të panumërueshëm në një tjetër, kur foljet mund të përdoren si kalimtare e jokalmimtare etj.

P.sh., në rastin e fjalës *hair<sub>I</sub>* “gjithë flokët që rriten në kokën e njeriut” do të ishte një fjalë, një emër i panumërueshëm, ndërsa “një fije floku” do të tregojë me një fjalë tjetër *hair<sub>II</sub>* e cila, duke qënë e numërueshme dhe e ndryshme në paradigmë, nuk mund të ishte e njëjta fjalë. Zgjedhja e këtij kriteri në hartimin e një fjalori do të krijonte shumë absurditete, për më tepër, që një fjalor i tillë do të kërkonte shumë hapësirë në të shkruar dhe shumë kohë në përdorim.

Pra deri këtu, mund të thuhet se saktësia në punën leksikografike sigurohet me një përdorim rigoroz të *kriterit etimologjik të kombinuar me metoda linguistike sinkronike*.

Dallimi i homonimeve bëhet sipas parimit semantiko-strukturor, ku çështja e kufijve të kuptimeve zgjidhet duke u bazuar në ndërtimin semantik të vetë fjalës dhe në vendin që ajo zë në sistemin e gjuhës, ku shqyrtohet e gjithë tërësia e veçorive strukturore – lidhjet e saj fjalëformuese, marrëdhëniet me fjalët e tjera që vijnë nga e njëjta rrënjë, si dhe veçoritë gramatikore të saj.

<sup>271</sup> Nesfield, J. C. *English Grammar Past and Present*, London, 1946, f. 81 – 83. Midis fjalëve që funksionojnë si pjesë të ndryshme ligjrate Nestfield përmend: *a, all, any, as, better, both, but, either, else*.

Ashtu si në gjuhën shqipe, në fjalorët e gjuhës angleze dallohen tri grupe homonimesh:

1. Homoformat, dmth., fjalët homonimike që ndryshojnë nga njëra-tjetra në kategorinë leksiko-gramatikore. Në gjuhën shqipe merren për bazë vetëm ato që shfaqen si homonime në trajtën përfaqësuese të fjalëve dhe jo në format e tjera, ndryshe nga anglishtja ku numri i tyre është më i madh, pasi kemi një përputhje të rrënjës me temën. Në fjalorin e shqipes vetëm homonimet e mirëfillta jepen si fjalë më vete dhe dallohen me shifra romake, ndërsa homoformat jepen në zëra leksikografikë të veçantë, por nuk dallohen me shifra romake. Në anglisht ato dallohen në të njëjtën mënyrë sikurse dhe homonimet e mirëfillta, por nuk gjejme një pasqyrim të njëjtë nga fjalori në fjalor.

*çaj*, ~ *i* *m.* *bot.* shkurre me gjethe me erë të këndshme, që thahen për të përgatitur me to pije;  
*çaj/kal.*, ~ *va*, ~ *rë* e ndaj diçka në copa për së gjati.

*bag* *I* [ *bæg* ] *n.* container made of flexible material (paper, cloth, leather) with an opening at the top used for carrying things from place to place.

(thes, torbë, qese, trastë)

*bag* *II* [ *bæg* ] *vt.* put things into a bag or bags (shtie në thes)

Duke krahasuar fjalorët Oxford Advanced Learner's Dictionary (1974)<sup>272</sup> dhe botimin tjetër të po këtij fjalori në vitin 2000<sup>273</sup>, kemi një ndryshim në paraqitjen e homoformave. Në fjalorin e botimit më të fundit, nuk bëhet dallimi ndërmjet homonimeve leksiko-gramatikore si homonime të mirëfillta, pra me zëra leksikografikë më vete. Ato janë të paraqitura nën një zë leksikografik, ku bëhet vetëm dallimi i kuptimeve sipas përkatësisë leksiko-gramatikore të së njëjtës njësi leksikore.

Duke e krahasuar me një fjalor tjetër, American Heritage Dictionary (1985)<sup>274</sup>, edhe këtu nuk bëhet dallimi ndërmjet homonimeve leksiko-gramatikore.

Ndërsa në fjalorin Longman Dictionary of English Language (1991), kemi p.sh., dy zëra leksikografikë për secilën njësi leksikore *skin* *I* (folje) dhe *skin* *II* (emër)<sup>275</sup>.

Ajo që duhet theksuar për të tri fjalorët e lartpërmendur, ndryshe nga fjalori i shqipes, është se ata bëjnë dallimin ndërmjet homonimeve gramatikore. Domethënë,

---

<sup>272</sup> [Hornby, S. A. *Oxford Advanced Learner's Dictionary of Current English, New Edition*, Oxford University Press, 1974.]

Cituar sipas Jackson, H.; Amvela, Z. E. *Words, Meaning and Vocabulary, An Introduction to Modern Lexicology, 2-nd Edition*, Athenaeum Press, London, 2007, f. 205.

<sup>273</sup> [Hornby, A. S. *Oxford Advanced Learner's Dictionary*, Oxford University Press, 2000.] Cituar po aty.

<sup>274</sup> [*American Heritage Dictionary*, Second College edition, Houghton Mifflin Company, 1985.] Citua po aty.

<sup>275</sup> Jackson, H.; Amvela, Z. E. *Words, Meaning and Vocabulary, An Introduction to Modern Lexicology, 2-nd Edition*, Athenaeum Press, London, 2007, f. 205.

këtu paraqiten edhe ato grupe homonimesh, të cilat mund të kenë të përbashkët vetëm një ose më shumë nga format e paradigmës së tyre, por këto fjalë nuk janë të ngjashme në trajtat e tyre përfaqësuese.

**rung**<sup>1</sup> [ rʌŋg ] a rod or bar forming a step of a ladder (këmbë shkalle)

**rung**<sup>2</sup> [ rʌŋg ] past participle of **ring**<sup>2</sup> (ra zilja)

Më tej, duke ju referuar fjalorëve dygjuhësh anglisht - shqip dhe shqip - anglisht, vëmë re se ata ndjekin të njëjtat parime sipas gjuhëve përkatëse, me përjashtim të dallimit që u bëhet foljeve kalimtare nga ato jokalimtare me shifra romake, sikurse paraqiten edhe homonimet në fjalorët e shqipes.

*bag*<sup>1</sup> [bæg] *em.* thes, torbë, qese, trastë

*bag*<sup>2</sup> [bæg] *I. kal.* shtie në thes

*II. jokal.* gufohet, zgjerohet, hapet

**çoj**<sup>1</sup> *kal.* **çova, çuar**, to send

**çoj**<sup>1</sup> *kal.* **çova, çuar**, to raise, to lift

Pjesët e pandryshueshme të ligjeratës, që kanë trajtë fonetike të njëjtë dhe lidhje të drejtpërdrejtë fjalëformuese, jepen nën të njëjtën fjalë titull, por ndahen me paragrafë të veçantë me shifra romake në fjalorin e shqipes. Për shembull,

**ÁFËR. I.** ndajf. **1.** Në largësi të vogël ...

**2.** ... etj.

**II.** parafj. **1.** Përdoret me një emër ...

**2.** ... etj.

**III.** pj. Pak a shumë, rreth, afërsisht

Në lidhje me fjalorët e anglishtes, përsëri duke krahasuar të tri fjalorët e sipërpërmendur, gjejmë një mospërpurthje në paraqitjen e tyre.

### **round**

- **adjective** 1. shaped like a circle or cylinder. (*mb.* rumbullak)
- **noun** 1. a circular piece or section. (*em.* qark)
- **adverb** chiefly Brit. 1. So as to rotate or cause rotation (*ndajf.* përreth)
- **preposition** chiefly Brit. 1 on every side of (a focal point). (*parafj.* rreth)
- **verb** 1. pass and go round. 2 make (a figure) less exact but more convenient for calculations: we'll round the weight up to the nearest kilo. (*fol.* shkoj rrotull, rumbullakos)

Ndërsa në fjalorin e vitit 1974, e gjejmë këtë fjalë të paraqitur nën pesë zëra leksikografikë, si pesë njësi të ndryshme leksikore homonimike.

**round**<sup>1</sup> [ raund ] adj **1.** shaped like a circle or a ball

(*mb.rrumbullak*)

**round**<sup>2</sup> [ raund ] adv **1.** in a circle or curve to face the opposite way

(*ndajf. përreth*)

**round**<sup>3</sup> [ raund ] n **1.** sth round;

(*em. qark*)

**round**<sup>4</sup> [ raund ] prep **1.** expressing movement in a path that passes on all sides of and comes back to the starting point

(*parafj. rreth*)

**round**<sup>5</sup> [ raund ] vt, vi **1.** make or become round

(*fol. shkoj rrotull, rrumbullakos*)

Në shpjegimet hyrëse të secilit fjalor, duke u përpjekur të gjejmë edhe arsyen pse kemi një përfaqësim kaq të ndryshëm të këtyre fjalëve, ndodhemi para shpjegimeve të ndryshme lidhur me paraqitjen e homonimeve. “Fjala titull mund të dalë si pjesë të ndryshme ligjrate dhe në këtë rast kërkohet një zë leksikografik i gjatë dhe i ndërlikuar. Ose fjala titull mund të shkruhet njëllor sikurse edhe një fjalë tjetër, por kuptimet e tyre nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën, ndonjëherë ndryshojnë nga shqiptimi. Në të gjitha këto raste, fjalët titull renditen më vete me një numër të lartshënuar për secilën prej tyre”<sup>276</sup>. Sipas këtij shpjegimi, të gjitha ato fjalë, që shkruhen njëllor por që ndryshojnë nga njëra-tjetra nga kuptimi gramatikor dhe leksikor, renditen më vete.

“Në anglisht ekzistojnë disa fjalë të njëjta, por që shkruhen ndryshe dhe kanë kuptime krejtësisht të ndryshme. Numri i vogël, i sipërsënuar për homonimet, tregon secilën fjalë titull me të njëjtën formë të shkruar (grafike). Nëse kanë shqiptim të ndryshëm, ky jepet te secila fjalë titull”<sup>277</sup>. Këtu dallimi i homonimeve bëhet në bazë të kuptimit semantik, dmth., vetëm kur kemi kuptime krejtësisht të largëta nga njëri-tjetri.

“Fjalë identike në formën e shkruar, por me etimologji të ndryshme paraqiten në zëra leksikografikë më vete; këta zëra leksikografikë dallohen nga një numër i sipërsënuar”<sup>278</sup>. Në këtë fjalor, përcaktimi i homonimisë përcaktohet në etimologjinë e tyre. Rrjedhimisht, ato nuk paraqiten si zëra leksikografikë më vete, nëse ato nuk kanë origjinë të ndryshme. Kështu që kuptimet e njësive leksikore si pjesë të ndryshme të ligjëratës, nuk do të dallohen si fjalë titull më vete.

- 1.** Në grupin e dytë të homonimeve që janë paraqitur në fjalor, bëjnë pjesë **fjalët me etimologji të ndryshme**, por që kanë formë të njëjtë tingullore në trajtat e tyre përfaqësuese ose edhe në format e tjera të paradigmes. Ky është grupi pa ndonjë

<sup>276</sup> Hornby, S. A. *Oxford Advanced Learner's Dictionary of Current English, New Edition*, Oxford University Press, 1974, f. 27.

<sup>277</sup> Hornby, S. A. *Oxford Advanced Learner's Dictionary*, International Student's Edition, Oxford University Press, 2000, f. 9.

<sup>278</sup> *American Heritage Dictionary*, Second College edition, Houghton Mifflin Company, 1985, f. 42.

problem të veçantë, sepse homonimia këtu del e përkufizuar qartë dhe kriteri i etimologjisë është një kriter i besueshëm për të përcaktuar nëse kemi ndonjë lidhje ndërmjet kuptimeve apo jo.

2. Homonimet semantike, dmth., fjalët me prejardhje të përbashkët, të cilat këputja e lidhjeve semantike midis kuptimeve shkon aq larg sa që shoqërohet edhe me vendosjen e veçorive të reja strukturore, gramatikore e fjalëformuese. Ky është edhe grupi më i vështirë për t'u dalluar, sepse ka raste kur procesi i ndarjes semantike nuk është përfunduar plotësisht. Këtu nuk kemi një kriter të vetëm për të bërë përcaktimin e homonimisë, por një tërësi rregullash e parimesh semantiko-strukturore, një analizë të hollësishme të çdo fjale dhe lidhjeve të saj leksiko-semantike, gramatikore e fjalëformuese të marra së bashku.

#### sound<sup>1</sup>

- **noun** 1. vibrations which travel through the air or another medium and are sensed by the ear. (em. tingull)
- DERIVATIVES **soundless** adjective
- ORIGIN Latin *sonus*

#### sound<sup>2</sup>

(mb. i shëndoshë)

- **adjective** 1. in good condition
- **adverb** soundly
- DERIVATIVES **soundly** adverb **soundless** noun
- ORIGIN Old English

#### sound<sup>3</sup>

(fol. tingëllon)

- **verb** 1. ascertain the depth of water in (the seam a lake, etc.) by means of a line or pole or using sound echoes.
- DERIVATIVES **sounder** noun
- ORIGIN Old French *sonder*, from Latin *sub-* 'below' + *unda* 'wave'.

#### sound<sup>4</sup>

(em. ngushticë)

- **noun** a narrow stretch of water forming an inlet or connectiong two larger bodies of water.
- ORIGIN Old Norse, 'swimming, strait';

ÇÍK/Ë, ~ A<sup>1</sup> f. sh. ~ A, AT. 1. Copë a pjesë e vogël, që këputet nga diçka ose që del kur thyhet, copëtohet a grihet diçka; grimë. Çika buke (*mishi*). Çika letre. Çika balte.

2 ....

3 ....

ÇÍK/Ë, ~ A<sup>2</sup> f.sh. ~ A, AT. Vajzë, çupë. Çikë e vogël. Çikat e malësisë.

ÇÍK/Ë, ~A<sup>3</sup> f. sh. ~ A, AT. Zool. Zog i vogël shtegëtar, që i ka puplat ngjyrë ulliri në pjesën e sipërme të trupit dhe me dy rripa të bardhë e të hollë në krahë.

3. Homonimet e prejardhura që mund të jenë formuar me rrugë të ndryshme fjalëformuese sipas rregullave të secilës gjuhë.

Nga të gjitha këto grupe homonimesh që janë paraqitur në fjalor, më problematiku është grupi i tretë. Këtu duhet vendosur nëse do të kemi një zë leksikografik për secilin homograf, në varësi të prejardhjes së tyre etimologjike apo lidhjes kuptimore. Parimi i përgjithshëm në këtë rast do të ishte aq zëra

leksikografikë sa edhe etimologji të ndryshme për secilin kuptim<sup>279</sup>. Megjithatë edhe ketu mund të vërejmë disa përjashtime. Për shembull, në anglisht te fjala *mite* kemi dy zëra leksikografikë, *mite* I “insekt” dhe *mite* II “monedhë”; edhe pse të dyja kanë të njëjtën origjinë, prej grupit të gjuhëve gjermanike, ato jepen më vete në fjalor, sepse në anglisht kanë hyrë në rrugë të ndryshme, e para në përiudhën e anglishtes së vjetër dhe e dyta në një periudhë të mëvonshme dhe nga grupi i gjuhëve gjermanike, përkatësisht, hollandishtes.

Për më tepër, te folja *graze*, përsëri kemi dy zëra leksikografikë, edhe pse të dy njësitë leksikore kanë etimologji të njëjtë: *graze* I “kosit barin” dhe *graze* II “rruaj”, ku kuptimi i së dytës është një zgjerim kuptimor i së parës. Nuk është e qartë pse kjo fjalë është dhënë si dy zëra leksikografikë.

### 6.2.1. Paraqitja e homonimeve te *Oxford Advanced Learner's Dictionary* nga A. S. Hornby (A. S. Hornby) (2000)<sup>280</sup>

Një nga fjalorët më të suksesshëm dhe më të përdorshëm sot në gjuhën angleze është *Oxford Advanced Learner's Dictionary* nga A. S. Hornby, botimi i gjashtë, 2000. Këtu listohen rreth 2540 homonime. Mënyra e paraqitjes të tyre është si vijon:

- Homografet jepen si fjalë më vete dhe dallohen me numra arabë. P.sh.,

**punt**<sup>1</sup> / p<sup>^</sup>nt / *noun, verb*

- *noun* **1** a long shallow boat with a flat bottom and square ends which is moved by pushing the end of a long pole against the bottom of a river **2** (*BrE, informal*) a bet **3** (in rugby or American football) a long kick made after dropping the ball from your hands

(em. 1. lundër gjahtarësh 2. bast 3. shkelmim i topit)

- *verb* **1** to travel in a punt especially for pleasure: [V] *We spent the day punting on the river.* **2** [VN] to kick a ball hard so that it goes a long way, sometimes after it has dropped from your hands and before it reaches the ground.

(fol. 1. të udhëtosh me lundër 2. shkelmoj topin)

**punt**<sup>2</sup> /pʌnt/ *noun* the unit of money in the Republic of Ireland<sup>281</sup>

(em. prerja e parasë në Irlandë)

- Homonimet perfekte nuk jepen si fjalë më vete, por prezantohen me numra nën të njëjtën fjalë titull (njësoj si fjalët polisemantike). Ja si paraqiten ato në këtë fjalor:

<sup>279</sup> Jackson, H.; Amvela, Z. A. *Words, Meaning and Vocabulary, An Introduction to Modern Lexicology*, 2007, 2-nd Edition, Athenaeum Press, London, f. 204.

<sup>280</sup> Hornby, A. Z. *Oxford Advanced Learner's Dictionary*, Oxford University Press, 2000

<sup>281</sup> Po aty f. vii.



**case** / keɪs / *noun, verb*

- *noun*

**SITUATION 1** [C] a particular situation or a situation of a particular type: *In some cases people have had to wait several weeks for an appointment.* **2 (the case)** [sing.] ~ (**that...**) the true situation: *If that is the case* (=if the situation described is true), *we need more staff.* **3** [C, usually sing.] a situation that relates to a particular person or thing.

**POLICE INVESTIGATION 4** [C] a matter that is being officially investigated, especially by the police: a murder case, a case of theft.

**IN COURT OF LAW 5** [C] a question to be decided in a court of law: The case will be held next week. , a court case, to win/ lose a case

**ARGUMENTS 6** [C, usually sing.] ~ (**for/against sth**) a set of facts or arguments that support one side in a court of law, discussion, etc...

**CONTAINER 7** [C] (often in compounds) a container or covering used to protect or store things. **8** [C] = SUITCASE: *Let me carry your case for you.*

**OF DISEASE 9** [C] the fact of sb having a disease or an injury...

**PERSON 10** [C] a person who needs, or is thought to need, special treatment or attention: *He's hopeless case.*

**GRAMMAR 11** [C, U] the form of a noun, an adjective or pronoun in some language, that shows its relationship to another word: the nominative/accusative.....

- *verb* [ VN]

**IDM. case the joint** (informal) to look carefully around a building so that you can plan how to steal things from it at a later time.<sup>282</sup>

*case* (*em.* situatë; rast për hetim; çështje gjyësore; agument; enë; rast sëmundjeje; person; gjini; etj.)

*case* (*fol.* shqyrtoj).

\* \* \*

Në anglishten moderne janë hartuar fjalorë specifike për homoniminë ose homografinë, të cilat i shërbejnë më së miri qëllimit të tyre dhe janë të lehtë në përdorim. Le të përmendim disa prej tyre:

---

<sup>282</sup>Hornby, A. S. *Advanced Learner's Dictionary*, Oxford University Press, 2000, f. 180.

**6.2.2. *A dictionary of English homonyms: pronouncing and explanatory* (1899) - Një fjalor i homonimeve të gjuhës angleze: shqiptues dhe shpjegues nga A. F. Inglot-i (A. F. Inglot)<sup>283</sup>**

Ky fjalor është shumë i hershëm dhe një nga kopjet e tij të pakta ndodhet në bibliotekën e Universitetit Viktoria.<sup>284</sup> Ky mendohet të jetë fjalori më i hershëm homonimik në gjuhën angleze. Ai është paralelisht i përkthyer në gjuhën italiane dhe frënge. Ky fakt e bën atë mjaft interesant dhe të veçantë në llojin e tij.

Ky punim i thjeshtë dhe i vogël përmban një koleksion fjalësh të gjuhës angleze, shumë të ngjashme në shqiptim, të ndryshme në formën e shkruar dhe me kuptime të ndryshme, që njihen me emrin homonime.

Në rrugë e hartimit të fjalorit, autori e ka parë të nevojshme t'i japë problemit të trajtimit të homonimisë në fjalor një zhvillim më të plotë, pa shmangur prezantimin e një numri të caktuar fjalësh të konsideruara të vjetëruara, por të cilat pavarësisht këtij fakti përdorshin lirshëm në ligjërimin e zakonshëm, në mënyrë që t'i aftësonin studentët e gjuhës angleze të kapeshin me vështirësinë e paraqitur nga fjalët homonimike, sidomos në situatat e të shkruarit të diktuar.

Për më tepër, është e dukshme që përkthimi në frëngjisht dhe italisht i çdo homonimi të gjuhës angleze, që përmban teksti, do të përbënte një ndihmë të konsiderueshme, në veçanti për të huajt që studionin gjuhën angleze.

Për një shpjegim të plotë të shqiptimit të fjalëve, përdoruesit duhet të shohin hyrjen dhe faqet 2 dhe 8 me shpjegimet përkatëse.

Mënyra e paraqitjes së homonimeve në fjalor është si më poshtë vijon:

- **Brick**, *n*, brik. A square mass of burned clay, used in building, etc.  
Mattone.  
Brique. (em. tullë)  
*Brig*, *n*, brig. A vessel with two masts.  
Brigantino.  
Brigantine. (em. brig, lloj anijeje)  
*Prick*, *vt*, prik. To pierce with a sharp-pointed instrument or substance.  
Pungere con qualche cosa puntita.  
Piquer, percer. (fol. kal. sëmbon)  
*Prig*, *n*, prig. A wiseacre; fop; conceited.  
Saputello, sguaiatello; presuntuoso.  
Un impertinent; un petit maitre; un présomptueux.<sup>285</sup> (em. shkencëtar i madh)
- **Pause**, *n*, pâz. A temporary stop or rest.  
Pausa.  
Pause. (em. pushim)

<sup>283</sup>Inglot Bey, A. F. *A dictionary of English homonyms: pronouncing and explanatory*, Paternoster House, London, 1899.

<sup>284</sup>Universiteti Viktoria, kolegji i Universitetit të Torontos, Kanada, i krijuar në vitin 1836 dhe i emërtuar sipas Mbretëreshës Viktoria.

<sup>285</sup>Inglot Bey, A. F. *A dictionary of English homonyms: pronouncing and explanatory*, Paternoster House, London, 1899, f. 25.

*Paws*, *n*, pâz. The foot or the feet of beasts of prey having claws.  
*Zampe avanti* granfle; zampe.  
*Pattes*; griffes. (em. putra)  
*Pose*, *vt*, pôz. To set; to interrogate closely.  
*Posare*; iterrogare o far delle domande difficili.  
*Embarrasser*; iterroger ou faire des interrogations difficiles.<sup>286</sup>  
*(fol. kal. paraqes; marr në pyetje)*

Fjala jepet me të errëta, më pas vjen pjesa e ligjeratës të cilës ajo i përket, shqiptimi dhe kuptimi i saj në gjuhën angleze. Më pas jepet kuptimi i fjalës në italisht dhe frëngjisht. Në vijim jepen njëra poshtë tjetrës homonime të saj në gjuhës angleze, të gjitha të paraqitura në po të njëjtën mënyrë. Ky fjalor i vogël nga përmasat duket të ketë qënë mjaft i përdorshëm. Për shkak të vlerave dhe vjetërsisë së tij, fjalori gjendet i plotë edhe në internet.<sup>287</sup>

### 6.2.3. *The encyclopedia of homonyms 'sound-alikes' (1977) - Enciklopedia e homonimeve 'që tingëllojnë njësoj' nga Dora Njuhaus-i (Dora Newhouse)*<sup>288</sup>

“I vetmi koleksion i plotë fjalësh që tingëllojnë njësoj i botuar ndonjëherë dhe një libër reference për çdo njeri nga Dora Njuhaus-i.”<sup>289</sup> Ky libër është një enciklopedi homonimesh dhe i vjen në ndihmë kujtudo që i nevojitet një i tillë për anglishten amerikane.

Duke punuar si mësuese vullnetare dhe duke përdorur metodën e Dr. Loubak-ut (Dr. Laubach) në mësimdhënien e anglishtes si gjuhë e dytë, autorja e librit zbuloi se pothuaj të gjithë studentët e saj të huaj ndeshnin vështirësi me fjalët që tingëllojnë njësoj, por që ndryshonin në kuptim dhe në formën e shkruar (homofonet ose homonimet). Ajo vinte re që kartolinat e të vegjëlve dhe të rinjve kishin fjali të tilla plot me gabime si “I am going to camp in *too* days” dhe “*There* barber cut my *hare* too short and made me *bawled*”. Në rastet e mësipërme fjalitë e sakta nga ana drejtshkrimore do të ishin: “I am going to camp in *two* days” (Do të shkoj në kamp për *dy* ditë) dhe “That barber cut my *hair* too short and made me *bald*.” (Berberi m’i preu flokët shumë shkurt dhe më nxorri tullac). Një student, i cili do të shfletonte fjalorin për drejtshkrimin e fjalëve *hare* dhe *bawled* do të kuptonte që kishte gabuar, pasi të lexonte në fjalor përkufizimet e fjalëve *hair* dhe *bald*.

Në kohën kur botoi këtë enciklopedi homonimesh, Dora Njuhaus-i theksoi se me përjashtim të pak librave për fëmijë, nuk gjendej në bibliotekat e shkollave ndonjë libër vetëm për homonimet. – “Ishte e vështirë për mua të besoja që nuk ekzistonte asnjë libër që t’ju kushtohej këtyre fjalëve të keqshkruara, keqshqiptuara, që të ngatërronin mendimin.” thekson autorja<sup>290</sup>.

<sup>286</sup> Po aty f. 127.

<sup>287</sup> <http://archive.org/stream/dictionaryofengl00beyauoft#page/124/mode/2up>

<sup>288</sup> Newhouse, D. *The encyclopedia of homonyms 'sound-alikes'*, Newhouse Press, USA, 1977.

<sup>289</sup> Po aty f. 224.

<sup>290</sup> Po aty f. 227.

E shtyrë nga nevoja e madhe për një libër të tillë, Dora Njuhaus-i hulumtoi dhe shkroi këtë fjalor homonimesh. Këtu studentët gjejnë ndryshimin ndërmjet fjalëve të tilla si: *to, too, two*; (drejt, gjithashtu, dy) ose *for, fore* dhe *four* (për, përpara, katër).

Kjo enciklopedi është një ndihmë e madhe për t'ju dhënë të interesuarve “the write attitude” (qëndrimin e duhur). Autorja luan shpesh me homonimet si p.sh., *write - right* (shkruaj – e drejtë), etj.<sup>291</sup>

Po listojmë disa shembuj nga mënyra e paraqitjes së homonimeve në fjalor:

- **Aid** (v) – assist, help, befriend, support (fol. ndihmoj)
- **Aide** (n) – attaché, right-hand man, assistant officer (em. ndihmës)
  
- **Eight** (n) – number 8 (em. numri tetë)
- **Ate** (v) – devoured, past of to eat (fol. koha e shkuar e foljes *ha*)
- **Ait** (n) – small island (em. ishull i vogël)
  
- **Mite** (n) – 1. small insect, particle, piece. 2. very small amount (em. 1. morr bimësh 2. grimë)
- **Might** (n) – strength, power, vigor, energy (em. fuqi, energji)

Ky libër është nga fjalorët e parë homonimikë në gjuhën angleze. Këtu homonimet nuk paraqiten me numra arabë ose romakë, por listohen duke u ndjekur nga pjesa e ligjeratës, të cilës i përkasin dhe nga kuptimi i tyre.

#### 6.2.4. *A dictionary of homophones* (1997) - *Një fjalor homofonesh nga Leslie Presson-i (Leslie Presson)*<sup>292</sup>

Ky fjalor përmban më tepër se 600 grupe homofonesh të listuara alfabetikisht. Ai është i lehtë në përdorim dhe u hartua për të qënë një burim ndihmës për studentë të anglishtes amerikane, shkrimtarë, botues dhe persona, që preferojnë lojën e fjalëve. Fjalitë që merren si shembuj për çdo grup homofon japin përdorimin e duhur të çdo fjale. Fjalët tituj (zërat) janë të gjitha fjalë që shkruhen ndryshe, p.sh., *all ways/always* (gjithë rrugët, mënyrat/ gjithmonë), po ashtu edhe fjalë që kanë të paktën një shqiptim të pranuar që është i njëjtë me një tjetër, si *want/wont* (dëshiroj/nuk do të), *bad/bade* (i keq / urdhëroi).

Shtimi i prapashtesave sjell ngatërresa, sidomos kur rrokja e parë në të dyja fjalët është një tingull zanor i patheksuar, si në rastin e *affects/effects* (ndikon/ efekte) dhe *allusion/illusion* (aludim/ iluzion). Në ligjërime ato tingëllojnë njësoj dhe për këtë arsye përfshihen në fjalor.

<sup>291</sup> Po aty f. 229.

<sup>292</sup> Presson, L. *A dictionary of Homophones*, Barron's Educational Series, USA, 1997.

Ngatërresat në shqiptim të fjalëve si: *marry/merry* (të martohesh/i gëzuar), *fairly/ferry* (zanë /target) dhe *berry/bury* (mana /të varrosësh) dhe çështja e fjalëve që fillojnë me *w* dhe *wh* u zgjidhën nga Keneth G. Uilsën-i (Kenneth G. Wilson) te libri “The Columbia Guide to Standard American English” (Guida Kolumbia për Gjuhën Standarte Amerikane). Përshkrimi i varianteve dialektore, të cilat zëvendësojnë anglishten zyrtare dhe përdorimi i pranuar i tyre ishte baza e zgjedhjes së homofoneve në këtë fjalor.

Grupet homofonike janë renditur në fjalor sipas rendit alfabetik. Çdo zë leksikografik ndiqet nga një shkurtime që na jep informacion mbi pjesën e ligjeratës, të cilës i përket fjala dhe kjo shkruhet me shkronja të pjerrëta.

|                                |                                      |
|--------------------------------|--------------------------------------|
| ( <i>adj.</i> ) – mbiemër      | ( <i>n.</i> ) - emër                 |
| ( <i>adv.</i> ) – ndajfolje    | ( <i>prep.</i> ) - parafjalë         |
| ( <i>conj.</i> ) – lidhëzë     | ( <i>pron.</i> ) - përemër           |
| ( <i>interj.</i> ) – pasthirmë | ( <i>v.</i> ) – folje <sup>293</sup> |

Po listojmë dy shembuj konkretë nga fjalori dhe mënyra e paraqitjes së homofoneve në të:

|   |  |
|---|--|
| <b>gnu</b> – ( <i>n.</i> ) an antelope                                | ( <i>em.</i> antilopë)                           |
| <b>knew</b> – ( <i>v.</i> ) did understand; remembered                | ( <i>fol.</i> koha e shkuar e foljes <i>di</i> ) |
| <b>new</b> – ( <i>adj.</i> ) fresh; for the first time <sup>294</sup> | ( <i>mb.</i> e re)                               |

I *knew* that the *gnu* was *new* to the zoo.

(E dija që antilopa ishte e re në kopshtin zoologjik)

**pole** – (*n.*) a tall, round rod: an opposing point; a point of interest; (*v.*) to push along with a pole

(*em.* shtizë, shtagë; çështje interesi; *fol.* shtyj me shtagë)

**Pole** – (*n.*) a native or resident of Poland (*em.* polak)

**Poll** – (*n.*) a place to vote; a gathering of opinions; (*v.*) to canvass; to register

(*em.* qendër votimi; *fol.* bëj sontazh)

The *Pole* read a sign on the *pole* that gave directions to the *polls*.<sup>295</sup>

(Polaku lexoi një shenjë mbi shtyllë që të orientonte për te qendra e votimit.)

<sup>293</sup> Presson, L. *A dictionary of Homophones*, Barron’s Educational Series, USA, 1997, f. vi.

<sup>294</sup> Po aty f. 52.

<sup>295</sup> Po aty f. 94.

Përkufizimet e shkurtra dhe fjalitë janë përdorur në mënyrë të tillë që të ndihmojnë lexuesin për të dalluar ndryshimet midis fjalëve. Për kuptimet shitesë, përdoruesi i fjalorit duhet t'i referohet një fjalori aktual të përgjithshëm. Fjalori, gjithashtu, shoqërohet me ilustrime që tregojnë ngatërime humoristike që vijnë nga forma grafike e gabuar i fjalëve.

#### 6.2.5. *Dictionary of Homonyms* (2007) - *Fjalor i homonimeve nga Deivid Rothuell-i (David Rothwell)*<sup>296</sup>

*Fjalori Homonimik Wordsworth* është i pari i këtij lloji i botuar në Britani. “A nuk ju ndodh të ngatërroheni me fjalë të tilla si *to* (drejt), *too* (gjithashtu) dhe *two* (dy)? A ju nevojitet të dini pesë përkufizimet e fjalës *fluke* (çështje fati, gjysmëbisht balene, kundërmajë etj.) Ky fjalor është një ndihmesë për fansat e fjalëkryqeve, një thesar për krijuesit e lojërave të fjalëve dhe një burim i pafund magjepsës për këdo të interesuar në gjuhën angleze.”<sup>297</sup>

Së pari, për autorin zgjedhja e homonimeve nuk është një shkencë ekzakte. Për shembull, a duhen klasifikuar fjalët *which* (cili, cila) dhe *witch* (shtrigë) si homofone? Në qoftë se do të shpreheshim në mënyrë të drejtpërdrejtë, ato nuk do të klasifikoheshin nën fjalën *homofone*. Një ndryshim i madh dëgjimor vihet re në tingëllimin e të dyja fjalëve. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për fjalët *while* (ndërsa) dhe *wile* (*josh; dredhi*); *were* (ishin) dhe *where* (ku) etj. Problemi është se në shumicën e rasteve përdoruesit e gjuhës nuk e kapim me vesh ndryshimin e vogël. Shumë pak nga ne shprehen aq saktë sa Profesor Higin (Higgins) te vepra e Bernard Shou-t (Bernard Show) “*Pigmelion*” (“*Pygmalia*”) ose si te degëzimi i të njëjtës vepër “*My Fair Lady*” (“*Zonja ime e pagabuar*”). Ndodh që fjalë që nuk janë homofone në teori, të rezultojnë të tilla në praktikë.<sup>298</sup>

Së dyti, dhe ndoshta më e rëndësishmja, nuk është aq e lehtë të vendosësh nëse një fjalë zotëron disa kuptime të ndryshme ose nëse këto variante janë thjesht nuanca të së njëjtit kuptim bazë. Për shembull, fjala me katër gërma *love* mund të nënkuptojë disa gjërash. *I love Susan* (Unë e dua Susan), *I love custard tarts* (Më pëlqejnë shumë tortat me krem karamel), *I love the music of Byrd* (Mua më pëlqen muzika e Byrd-it) dhe *I love playing chess* (Mua më pëlqen të luaj shah) janë të gjitha fjali me të njëjtën folje kryesore *love*, por a mendon ndonjëri seriozisht se të dashurosh Susan është i njëjti lloj emocioni si të pëlqesh shumë tortat me krem karamel? Sigurisht, që në të gjitha rastet fjala ‘*love*’ nënkupton një pëlqim të fuqishëm, një dashuri për, një përkushtim për. Lind pyetja, a është *love* një fjalë homonimike?<sup>299</sup> Kjo pyetje kërkon gjykim dhe ka shumë shembuj në këtë botim ku lexuesit mund të mos biem dakord me autorin. D. Rothuell-i shprehet: “As unë nuk mund të shpreh qëndrueshmëri për sa i përket zgjedhjes së fjalëve. Unë qëndroj tek fjala *detail* (detaj) dhe vendos nëse ajo është ose jo një homonim, duke gjykuar vetëm nga një i menduar i thellë dhe me bazë.”<sup>300</sup>

<sup>296</sup> Rothwell, D. *Dictionary of Homonyms*, Wordsworth Reference, Great Britain, 2007.

[www.wordsworth-editions.com](http://www.wordsworth-editions.com).

<sup>297</sup> Po aty f. 544.

<sup>298</sup> Po aty f. 6.

<sup>299</sup> Po aty f. 6.

<sup>300</sup> Po aty f. 7.

**detail**  
(detaj)

A detail tends to mean a small part of a bigger whole. Parliamentary committees are meant to examine every detail of a Bill. When investigating a crime, the police must take note of every detail. But a detail can also be a small detachment of troops or police officers commanded to perform some specific duty.<sup>301</sup>

Fjala *porridge* (qull, miell tërshëre) ka dy kuptime të dallueshme. Ndërsa te fjala *ledge* (parvaz, buzë shkëmbi, platformë e sipërme) dallimi midis kuptimeve nuk është aq i qartë. Tre kuptimet e dhëna nga fjalori janë konceptualisht shumë të lidhura dhe si rrjedhim, është e vështirë të flitet për homonimi. Pavarësisht këtyre problemeve, nuk mund të themi që ky fjalor është i plotë, sepse edhe vetë ideja e të qenit i plotë është subjektive. Autori shprehet që: “Pa dyshim që kam harruar këtu homonime perfekte dhe kjo vjen nga pakujdesia ose lodhja verbale. Ajo çfarë mund të them është thjesht të kërkoj të falur”.<sup>302</sup>

Dialektet e anglishtes britanike nuk janë pjesë e fjalorit. “Të përballesha me variante të ndryshme dialektore do të ishte e pamundur”.<sup>303</sup> Homonimet në libër vijnë të gjitha nga Anglishtja Britanike Standarte, e cila është marrë si normë në hartimin e fjalorit.

Ja disa shembuj që tregojnë mënyrën e paraqitjes së homonimeve në fjalor:

- **art** (art)  
When one studies art at school or college, the word is confined to such visual activities as painting, sculpture, tapestry making, etc. However, the word is extended to any activity that requires skill. Hence you can demonstrate the art of a blacksmith or be proficient in the art of diplomacy. The word **art** is also an old-fashioned form of the word ‘are’, still sometimes used in jocular or mock-poetic contexts: ‘Thou art a scurvy knave’.<sup>304</sup>
- **oh, owe** (oh; kam borxh)  
**Oh** is a simple exclamation that can express surprise, regret or pain. If you **owe** something, you are indebted in some way. You may owe money, thanks or loyalty.<sup>305</sup>
- **spy** (spiunoj)  
Through the novels of countless writers, we all know about the activities of a **spy** as he or she pursues the secretive business of finding out about A for the benefits of B despite the earnest efforts of C to keep A secret. It is understandable that a spy should be so named, because the verb ‘to spy’ means to watch, to keep observation.

---

<sup>301</sup> Po aty f. 176.

<sup>302</sup> Po aty f. 10.

<sup>303</sup> Po aty f. 10.

<sup>304</sup> Po aty f. 41.

<sup>305</sup> Po aty f. 342.

Në fjalor ndeshim dy lloj paraqitjesh si në rastin e parë *art* dhe të tretë *spy*, ku i njëjti shqiptim dhe formë e shkruar (homografe) nënkuptojnë fjalë të ndryshme dhe rastin e dytë, ku takojmë homofonet *oh* dhe *owe*. Në të gjitha rastet jepen fjalët homonimike dhe shpjegohet kuptimi i tyre më pas.

**6.2.6. Homonyms. When you need to write the right words (2011) - Homonimet. Kur ju duhet të shkruani fjalën e duhur nga Kethi Zengolux-i (Kethy Zengolewicz)<sup>306</sup>**

Libri i Kethi Zengolux-it është mjaft praktik dhe një referencë e lehtë në përdorim. Autorja përmend se kur ajo përpiqet të sjellë kuptim të anglishtes amerikane, tabela e mëposhtme i vjen gjithmonë në ndihmë.

Tabela 6.1.<sup>307</sup>

| Fjala    | I njëjti tingëllim i fjalës | E njëjta formë e shkruar (grafike) | I njëjti tingëllim i shkronjës | I njëjti kuptim |
|----------|-----------------------------|------------------------------------|--------------------------------|-----------------|
| Homonim  | Po                          | Jo, jo zakonisht                   | Po                             | Jo              |
| Homograf | Po                          | Po                                 | Po                             | Jo              |
| Homofon  | Jo                          | Jo                                 | Po                             | Jo              |

Në këtë minifjalor, nuk ka ndonjë veçanti për sa i përket paraqitjes së homonimeve. Për shembull:

**BALL**: a spherical or approximately spherical body or shape; sphere. *Throw the **ball** to Billy.* (top)

**BAWL**: to utter or proclaim by outcry; shout out. *At the mention of the lost keys, she started to **bawl**.*<sup>308</sup> (bërtas)

**PRAISE**: the act of expressing approval or admiration. *They always **praise** people for good deeds.* (lavdërim)

**PRAYS**: offers devotion to God or an object of worship. *The family always **prays** before eating a meal.*<sup>309</sup> (lutet)

<sup>306</sup> Zengolewicz, K. *Homonyms. When you need to write the right words*, Lexington, USA, 2011. [www.kathyzenzengolewicz.com](http://www.kathyzenzengolewicz.com)

<sup>307</sup> Po aty f. 6.

<sup>308</sup> Zengolewicz, K. *Homonyms. When you need to write the right words*, Lexington, USA, 2011, f. 14.

<sup>309</sup> Po aty f. 37.



Siç vihet re, fjalët homonimike vijnë sipas renditjes alfabetike. Ato shkruhen me gërma kapitale dhe nënvizohen. Më pas vjen shpjegimi i kuptimit të fjalës dhe një shembull në fjali ku fjala homonimike shkruhet e theksuar (me të errët).

Kjo referencë e gatshme dhe e volitshme në përdorim është një vegël për të mbështetur përdorimin e saktë të anglishtes amerikane.<sup>310</sup>

### 6.2.7. *An English homophone dictionary - Një fjalor homofon i gjuhës angleze nga Sabër-i dhe Thorp-i (Suber dhe Thorpe)*<sup>311</sup>

Ky fjalor nuk ka dalë ndonjëherë në shtyp, por është një listë e thjeshtë homonimesh e publikuar në internet.

Fjalët e çdo grupi homofonik këtu janë listuar sipas renditjes alfabetike. Çdo grup i tillë është prezantuar vetëm një herë, te fjala e parë, sipas alfabetit. Për shembull, çifti homofon *knot* “nyje”, *not* “jo” është listuar nën fjalën *knot*.

Kur emrat homofonë në numrin njëjës janë, gjithashtu, homofone në shumës, kjo jepet në kllapa. P.sh., *ad* (-s) “reklamë”; *add* (-s) “shton”; *adze* “sqepar”. Në të njëjtën mënyrë, kur homofonet folje mbeten të tilla edhe në vetën e tretë, numri njëjës, në kohën e tashme, kjo jepet në kllapa. P.sh., *accept* (-s) “pranoj”; *except* (-s) “me përjashtim të”. I njëjti tregues përdoret kur një fjalë e grupit homofonik është emër dhe tjeta është folje. P.sh., *poor* “i varfër”; *pore* (-s) “pore”; *pour* (-s) “derdh”. Këto variante në listë nuk ju përkasin listave të veçanta, as edhe kur bëhet fjalë për forma të tjera paradigmatiche të gjuhës angleze si p.sh., *-ed*, *-ing*, ose rase gjinore ‘s etj.

Gjithashtu, pjesë e kësaj liste homofonesh në gjuhën angleze janë edhe fjalë të vjetëruara, në rastin kur autorët i njohin ato, si p.sh., *\*dain* “përrua” dhe *deign* “begenis, denjoj”.

Po sjellim disa shembuj konkretë të paraqitjes së homofoneve në këtë listë:

|                               |                                      |
|-------------------------------|--------------------------------------|
| accede (-s), exceed (-s)      | (aderoj, kaloj)                      |
| accept (-s), except (-s)      | (pranoj, me përjashtim të)           |
| acclamation, acclimation      | (brohoritje, përshtatje ndaj klimës) |
| ad (-s), add (-s), adze       | (reklamë, shtoj, sqepar)             |
| addition (-s), edition (-s)   | (shtesë, botim)                      |
| ade (-s), aid (-s), aide (-s) | (pije frutash, ndihmë, ndihmës)      |
| adherence, adherents          | (aderim, pasuesit)                   |
| admittance, admittants        | (pranim, pranuesit)                  |
| adolescence, adolescents      | (adoleshencë, adoleshentë)           |
| aerie, airy <sup>312</sup>    | (kala, i ajrosur)                    |

<sup>310</sup> Po aty f. 9.

<sup>311</sup> Suber ; Thorpe *An English homophone dictionary*.

<http://legacy.earlham.edu/~peters/writing/homofone.htm>

<sup>312</sup> [egacy.earlham.edu/~peters/writing/homofone.htm](http://legacy.earlham.edu/~peters/writing/homofone.htm)

Vihet re që kjo listë I paraqet ndryshe fjalët homonimike. Jepen të listuara alfabetikisht vetëm grupet homofonike dhe nuk ka asnjë të dhënë tjetër mbi elementët përbërës të tyre.

#### 6.2.8. Alan Cooper's Homonyms list<sup>313</sup> - Lista e homofoneve nga Alan Kupër-i (Alan Cooper)

Alan Kupër paraqet një listë interesante homonimesh në anglishten amerikane.

Ai shkruan se për shkak të natyrës së tyre të çuditshme, ka mundësi që listës së tij t'i mungojnë homonime shumë të dukshme të gjuhës. Për këtë arsye ai e ka lënë të hapur listën e tij, në kuptimin që i shton asaj herë pas here fjalë të tjera homonimike.

“Unë jam autori dhe unë i bëj rregullat, dhe të them të vërtetën jam shumë tolerant ndaj tyre”. Këto janë fjalët e Alan Kupër-it mbi rregullat ku ai e bazon hartimin e listës homonimike. Kjo është edhe arsyeja pse shpesh paraqitja e homonimeve në fjalorë të ndryshëm vjen në mënyra të ndryshme.

Po cilat janë konkretisht rregullat ku Kupër-i është mbështetur në hartimin e fjalorit. Po i listojme ato më poshtë:

- Shqiptim bashkëkohor i gjuhës standarte anglo-amerikane, ku homografet janë të shpeshta dhe ku disa prej tyre ose të gjitha i ngjajnë një loje interesante.
- Herë pas here bëhen shtesa për emra të përveçëm.
- Shkurtime janë të lejuara në fjalor.
- Tingujt “D” dhe “T” nuk janë të ngjashme. P.sh., “metal” (metal) nuk është njësoj si “medal” (medalje), megjithëse janë të njëjtë në tingëllim. Po ashtu, “mettle” (temperament) dhe “meddle” (përzihem). Disa tinguj “T” duket të jenë të ngjashëm me tingullin “ED” si p.sh., në rastin e “passed” (kaluar) dhe “past” (e shkuar).
- Përkufizimet janë të autorit me ndihmën e Webster's New World Dictionary, Third College Editions (Fjalori Webster's New World, Botimi i tretë).
- Çiftet homonimike paraprihen nga një kuadrat i kuq. Nëse grupi homonimik përfshin më shumë se tri fjalë, kuadrati do të jetë blu.
- Autori thekson se ai është i vetmi autoritet, i cili vendos se çfarë fjalësh do të hyjnë në listë dhe çfarë jo, por ai thekson se i mirëpret mendimet e përdoruesve të fjalorit.<sup>314</sup>

Të tjera punime të ngjashme në gjuhën angleze, mund të listojmë:

- Scholastic Pocket Dictionary of Synonyms, Antonyms, Homonyms me 2000 homonime.
- Një listë e plotë homonimike e gjejmë në internet te [www.English-for-students.com/Homonyms-B.html#chitika\\_close\\_button](http://www.English-for-students.com/Homonyms-B.html#chitika_close_button)

<sup>313</sup> Shih [http://www.cooper.com/alan/homonym\\_list.html](http://www.cooper.com/alan/homonym_list.html)

<sup>314</sup> Po aty

- “Dictionary of Homonyms” nga Rogers Reference ku janë dokumentuar 6139 homonime të gjuhës angleze. Për më shumë informacion mund t’i referoheni <http://rogersreference.com/>
- “Homonym / Homophone Page” nga Treisi Finiftër (Tracy Finifter)  
([www.taupecat.com/personal/homophones/](http://www.taupecat.com/personal/homophones/))

Siç vihet re, gjuha angleze (në variante të ndryshme të saj: britanike, amerikane etj.) në ndryshim nga ajo shqipe, përmban shumë fjalorë homonimikë, fjalortha ose lista të tilla të botuara ose të hedhura në internet me një shumëllojshmëri autorësh. Disa prej tyre janë profesionistë, por të tjerë janë amatorë në këtë fushë, të frymëzuar në punën e tyre nga dukuria gjuhësore e homonimisë dhe vlerat e saj.

## KAPITULLI VII

### HOMONIMET SI MJETE STILISTIKORE

#### 7.1. Një vështrim i përgjithshëm mbi kalamburin (lojë fjalësh)

**Kalambur** është një formë e lojës së fjalëve që sugjeron dy ose më shumë kuptime, duke hedhur dritë mbi shumëkuptimësinë e fjalëve (poliseminë) ose të fjalëve që tingëllojnë njësoj (homoniminë), për një efekt të qëllimshëm humoristik ose reteorik. Këto paqartësi mund të vijnë nga përdorimi me qëllim i gjuhës homofonike, homografike, metonimike ose metaforike.

Kalamburet, të cilat gjithmonë lënë mbresë te njerëzit me efektet e tyre të veçanta reteorike, përdoren gjerësisht në komunikimin e përditshëm dhe në lloje të ndryshme ligjërimesh. Gjatë studimeve të bëra mbi këtë pikë të punimit jemi ndeshur me disa terma lidhur me lojën e fjalëve të krijuar mbi homoniminë. Midis tyre kemi zgjedhur të përdorim “**lojë fjalësh**” ose “**kalambur**”. Të tjera terma të përdorur janë “paronomazi” dhe “imitime parodike”, të cilat kanë një karakter më të përgjithshëm. P. sh., në punimet e linguistit gjerman L. Rainers (L. Rainers), dallohen katër forma të imitimeve parodike (kalamureve):

1. Lojë fjalësh që lind nga tingëllimi dykuptimor i një fjalie;
2. Lojë fjalësh që rrjedh si rezultat i ngjashmërisë së dy fjalëve;
3. Lojë fjalësh e ndërtuar nga transferimi i fjalës si rrjedhim i asaj që një pjesë e fjalës është e ngjashme me pjesën e një fjale tjetër;
4. Lojë fjalësh e krijuar nga përmbysja e fjalisë (kthim nga ana tjetër)<sup>315</sup>

Është pikërisht forma e parë e theksuar nga L. Rainers-i, e cila na intereson si ndërtim gjatë përdorimit stilistikor të homonimeve. Forma e dytë dhe e tretë lidhen me përdorimin e paronomazisë, fenomen, i cili përmendet shkurtimisht në një prej pikave të këtij kapitulli.

Pra, fjala **kalambur** ka kuptim të gjerë, por ky punim përqëndrohet te **kalamburi homonimik** (lojë fjalësh e krijuar me bazë homoniminë).

Një kalambur ndryshon nga një *malapropism* sepse një *malapropism* përdor një shprehje jo të duhur që synon një shprehje tjetër (zakonisht të saktë), por një kalambur përdor një shprehje të saktë, e cila synon një tjetër shprehje (ndonjëherë e saktë por në shumicën e rasteve në mënyrë absurde humoristike). Henri Bërgson-i (Henri Bergson) e përkufizon kalamburin si një fjali ose një thënie në të cilën “shprehen dy grupe të ndryshme idesh, dhe ne përballemi vetëm me një seri fjalësh.” Kalamburet mund të shihen si ndërtime humoristike ose idiomatike, përdorimi dhe kuptimi i të cilave ju përkasin totalisht një gjuhe të veçantë dhe kulturës së kësaj gjuhe.

<sup>315</sup> Rainers, L. *Stilkunst. Win Lehbruch deutscher Prosa*, 3, Aulf. München, 1950, f. 537.

Kalamburet përdoren për të krijuar humor dhe ndonjëherë kërkojnë një fjalor të pasur për t'i kuptuar. Ato janë përdorur për shumë kohë nga komedianë të mëdhenj, si: Uilliam Shekspir-i, Oskar Uaild-i (Oscar Wilde) dhe Xhorxh Karlin-i (George Carlin). Shkrimtari i pjesëve teatrale Plautus-i është i famshëm për prirjen e tij për të krijuar dhe për të ndryshuar kuptimin e fjalëve me qëllim krijimin e kalambureve në gjuhën latine.

Përhapja e dukurisë së homonimisë në shumë gjuhë tregon se homonima është një dukuri e natyrshme, që shpjegohet me numrin shumë të madh të tyre në gjuhë, sidomos në anglishte, dhe me atë që lidhja midis kompleksit tingullor dhe konceptit të shënuar prej tij është arbitrare, dmth., e pakushtëzuar nga natyra e këtij të fundit. Tingëllimi i njëjtë i fjalëve me të shënuar të ndryshëm nuk i pengon folësit që të kuptojnë, sipas kontekstit gjuhësor ose situatës së ligjërimit, se cili është i shënuari. Sikurse ndodh edhe me kuptimet e ndryshme të një fjale polisemantike, homonimet nuk ngjallin keqkuptime sepse përmbajtja e tyre sqarohet në situatat ku përdoren këto fjalë.

Po ka edhe raste kur homonimia e vështirëson kuptimin e përmbajtjes së një thënieje, siç ndodh kur nuk njihet gjuha apo në situata të caktuara ligjërimit.

Homonimet përftojnë mjete stilistikore. Prania e tyre në stile të ndryshme e bën gjuhën tërheqëse, interesante, të gjallë, plot nota humorit për dëgjuesin ose lexuesin. E ashtëquajtura “**lojë fjalësh**” ose **kalambur** (*fr. calembour* “lojë fjalësh”) në gjuhën shqipe ose “**pun**” [pʌn] në gjuhën angleze, bazohet në interpretimin homonimik të së njëjtës fjale ose shprehje dhe është përdorur gjerësisht në gjuhën shqipe dhe angleze për të sjellë nota humorit. Një lojë fjalësh është një shprehje, në të cilën dy përdorime të ndryshme të një fjale paraqitin dhe shtojnë një ide qesharake.

Në ligjërimit e zakonshëm, homonimia nuk bie në sy, madje janë gjuhëtarët që e tregojnë si dukuri, përndryshe folësit e zakonshëm nuk e njohin aspak.

## 7.2. Përkufizimi i termit “kalambur” (lojë fjalësh)

Në përgjithësi, lojërat e fjalëve i referohen përdorimit humoristik të një fjale në mënyrë të tillë që të sugjerojnë dy ose më shumë prej kuptimeve të saj ose kuptimin e një fjale tjetër të ngjashme në shqiptim.

Le të shohim disa nga mënyrat se si fjalorë të ndryshëm në të dyja gjuhët, shqipe dhe angleze, e kanë përkufizuar këtë term:

**kalambur**, let. lojë fjalësh  
*Fjalor i Shqipes së sotme*, 2002<sup>316</sup>

**kalambur**, let. lojë fjalësh  
*Fjalor i Gjuhës Shqipe*, 2006<sup>317</sup>

<sup>316</sup> *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Botimi II, TOENA, Tiranë, 2002.

<sup>317</sup> *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2006.

**kalambur**, m. fjalë a shprehje të njëjta ose të ngjashme nga tingëllimi, por me kuptime të ndryshme, që përdoren për të bërë shaka; lojë fjalësh. Dialog me kalambure. Bëj kalambure. Flet me kalambure.

*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 2014<sup>318</sup>

**lojë fjalësh**, një shprehje që arrin qëllimin e saj ose mbart humor me anë të paqartesisë, nga dy kuptime të ndryshme, që sillen nga e njëjta fjalë (shiko *POLISEMI*) ose nga dy fjalë që tingëllojnë ngjashmërisht (shiko *HOMONIMI*). Në terminologjinë e retorikës, loja e fjalëve shihet si figurë e ligjeratës.

*The Oxford Dictionary of Literary Terms*, Chris Baldick, Oxford University Press, 2008<sup>319</sup>

**lojë fjalësh**, një lojë fjalësh mund të përkufizohet si “një përdorim argëtues i një fjale ose shprehjeje që ka dy kuptime, ose i fjalëve me të njëjtin shqiptim por me kuptime të ndryshme”.

*Longman Dictionary of Contemporary English*<sup>320</sup>

**lojë fjalësh**, një lojë fjalësh, ndonjëherë mbi kuptime të ndryshme të së njëjtës fjalë dhe ndonjëherë mbi kuptimin e ngjashëm ose tingëllimin e ngjashëm të fjalëve të ndryshme.

*The American Heritage Dictionary of the English Language*. Botimi i katërt, 2000, Houghton Mifflin Company.<sup>321</sup>

**lojë fjalësh**, përdorimi i fjalëve ose shprehjeve për të sjellë paqartësi dhe nënkuptim me kuptimet e tyre, zakonisht për efekte humoristike; një lojë fjalësh.

[mundësitë janë të vijë nga Italishtja *puntigloi* pikë detaji, lojë fjalësh, shiko PUNCTILIO]

*Collins English Dictionary*, Botimi i 10-të, 2009, William Collins Sons & Ltd.<sup>322</sup>

**lojë fjalësh**, një përdorim humoristik i një fjale në mënyrë të tillë që të sugjerojë kuptime të ndryshme ose një lojë mbi fjalët.

*Enciklopedia Britanike*<sup>323</sup>

### **lojë fjalësh, të krijosh lojë fjalësh**

1. përdorimi me humor i një fjale ose shprehjeje për të theksuar ose sugjeruar kuptimet ose përdorimet (aplikimet) e saj të ndryshme, ose përdorimi i fjalëve të cilat janë të ngjashme ose afërsisht të ngjashme në shqiptim, por të ndryshme në kuptim; një lojë mbi fjalë.
2. një fjalë ose shprehje e përdorur në këtë mënyrë.
3. *folje*, të krijosh lojë fjalësh  
[1655-65; ndoshta identike me pun - lojë fjalësh, të keqtrajtosh (fjalët)]

*Webster's College Dictionary*. 2010 K Dictionaries Ltd. Copyright 2005, 1997, 1991. Random House Kememan, Inc.<sup>324</sup>

<sup>318</sup> <http://www.fjalori.shkenca.org/>

<sup>319</sup> <http://www.thefreedictionary.com/pun>

<sup>320</sup> <http://www.thefreedictionary.com/pun>

<sup>321</sup> <http://www.thefreedictionary.com/pun>

<sup>322</sup> <http://dictionary.reference.com/browse/pun>

<sup>323</sup> [www.Britannica.com](http://www.Britannica.com)

<sup>324</sup> <http://www.thefreedictionary.com/pun>

**lojë fjalësh**, një lloj humori, ku fjalët që përdoren kanë tingëllim të ngjashëm, por kuptime të ndryshme.

*Kerman English Multilingual Dictionary*, 2006 - 2013<sup>325</sup>

### 7.3. Histori

Në Kinë, Shên Tao, një Taoist i cili jetoi 300 vjet para Krishtit, zhvilloi një teori të veçantë mbi artin e pushtetit. Sipas tij fakti i thjeshtë që një mbret është një mbret – Shên Tao e quan pozicionin e tij (*shih*) si mbret – e pajis atë me fuqi (*shih*); ai nuk ka nevojë për cilësi dhe kapacitete të tjera. Pra, ai përdorte fjalën *shih<sub>I</sub>* “fuqi” dhe *shih<sub>II</sub>* “pozicion” për të shprehur që një mbret ka fuqi për shkak të pozitës së tij. Si shumë doktrina mistike, ky besim ndërtohej mbi një lojë fjalësh. Dy fjalët *shih* (‘potencë’ ‘fuqi’ ‘forcë’) dhe *shih* (‘pozicion’ ‘rrethana’ ‘situatë’) nuk ishin thjeshtë identike në tingëllim, por ishin shkruar në të njëjtën formë. Bazuar në të njëjtin parim Z. Lansbëri (Z. Lansbury) është shprehur: “Jam krenar që më quajnë *maniak* (*crank<sub>I</sub>*); në fund të fundit *doreza* (*crank<sub>II</sub>*) është një pjesë shumë e rëndësishme në shumë makina.”<sup>326</sup>

Në Irakun e lashtë, rreth 2500 vjet para Krishtit, kalamburi përdorej nga shkruarit për t’i paraqitur fjalët në **kuneiform** (cuneiform). Shkrimi kuneiform është një nga sistemet e të shkruarit më të hershme, dalluar për shenjat e tij në formë shufre mbi pllaka prej argjile, të bëra me anë të një kallami me majë, që shërbente si mjet për të shkruar. Gradualisht, shkrimi ju shtuan fuqi të reja dhe ai tani filloi të përdorej për shumë qëllime institucionale, që nga regjistrimi i kontratave ligjore deri tek lëshimi i urdhrave administrative dhe dokumentimi i ngjarjeve politike. Loja me fjalët ose kalamburi ju jepte mundësi shkruarve të regjistrimit tingujt e të gjitha fjalëve të gjuhës Sumeriane, jo vetëm ato që mund të paraqiteshin në mënyrë vizuale.<sup>327</sup>

Maja-t janë njohur për përdorimin e kalamburit në shkrimet e tyre hieroglifike dhe në gjuhët e tyre moderne. Gjuhët moderne Maja dhe shkrimi i lashtë hieroglifik i tyre paraqitin një prirje për të luajtur me fjalët, me anë të kalamburit dhe metaforës (gjuhët e folura dhe të shkruara së bashku). Janë vënë re fakte të shumta mbi këtë praktikë dhe mënyrën e të menduarit në gjuhët moderne Maja [Brickër (Briker) 1973; B. Tedlok (B. Tedlock) 1982 a, b], po ashtu edhe në letërsinë koloniale të ruajtur Maja [Bradhërston (Brotherston) 1979; Edmënson (Edmonson) 1982; Edmënson dhe Brickër 1986; Rois (Roys) 1933, 1965]. Për më tepër, në vitet e fundit studiuesit e epigrafeve kanë vënë re përdorimin e glifëve<sup>328</sup> homofonikë që shërbejnë si kalambure dhe të cilat zëvendësojnë njëra-tjetrën në mbishkrimet e Periudhës Klasike. [Mathjus (Mathews) dhe Xhastson (Justeson) 1984; Hjuston (Houston) 1984].<sup>329</sup>

<sup>325</sup> Po aty.

<sup>326</sup> Waley, A. *Three ways of thought in ancient China*, Stanford University Press, 1982, 216 faqe, f. 81.

<sup>327</sup> Robson, E. *Mathematics in ancient Iraq: a social history*, Princeton University Press, 2008, 441 faqe, f. 31.

<sup>328</sup> glif (glyph, ang.) glif është një element i të shkruarit: një shenjë individuale mbi një vend të shkruar që kontribuon në kuptimin e asaj që është shkruar. <http://en.wikipedia.org/wiki/Glyph>

<sup>329</sup> Danien, E. C. dhe Sharer, R. J. *New theories on the ancient Maya*, University of Pennsylvania, University Museum of Archeology and Anthropology, UPenn Museum of Archeology, 1992, 245 faqe, f. 99.

Përdorimi i lojës së fjalëve është mjaft i dukshëm në letërsinë koloniale të Chilam Balam të Jukatan-it (Yucatan), tek e cila një shembull është gjendur në sekuencat e emrave të qyteteve, që ktheheshin rregullisht në kalambure. Për shembull, lista e lëvizjeve drejt perëndimit e Itza-s në *Chilam Balam i Cbumayel* përfshin informacionin e mëposhtëm turistik: “Kështu ata arritën në Tab Kab, ku Itza trazoi mjaltin [*Tab kab* do të thotë “ndarje toke”, por *buytab kab* do të thotë “trazoj mjaltin”], etj.<sup>330</sup>

Në Japoni, “grafomania” ishte një lloj kalamburi (visual). Le të sjellim një shembull me lojë fjalësh drejtshkrimore me një lloj mbivendosjeje “në majë të malit, ndodhet një mal tjetër,” e paraqitur nga pesë karaktere<sup>331</sup> që formojnë foljen *ide* “del”. Ideja e këtij kalamburi visual është se karakteri për “del” i ngjan dy karaktereve “malesh” të mbivendosura. Grafomania e kësaj renditjeje nuk ishte vetëm dobësi japoneze. Në fakt, mbivendosja e “dy maleve” vjen drejtpërdrejt nga një lloj më i ndërlikuar poeme kineze, e përfshirë në *Yü-t'ai hsín-yung*, një antologji e shekullit të 16-të e mirënjohur në Japoni.<sup>332</sup>

#### 7.4. Autorë të ndryshëm për kalamburin

Studiues dhe autorë të shumtë janë shprehur pozitivisht ose negativisht për kalamburin (lojën e fjalëve). Po sjellim disa opinione dhe mendime të tyre.<sup>333</sup>

Kalamburi i palavdishëm! Drajdën-i (Dryden)<sup>334</sup> e quajti atë “llojin më të ulët dhe më acarues të zgjuarsisë”. Për Ambrous Biërs-in (Ambrose Bierce)<sup>335</sup> ai ishte “forma e zgjuarsisë ku njerëzit e mëdhenj ndalen dhe budallenjtë synojnë”. Eksperiencia universale shpesh ka treguar që kalamburet nuk na bëjnë për të qeshur, por për të rënkuar. Thuhet që Kaligula (Caligula)<sup>336</sup> urdhëroi që një aktor të piqej i gjallë për përdorimin e një kalamburi të konsideruar negativ. Disa besojnë se ai ishte i prirur drejt ekstremesh.

Edison-i (Addison) e përkufizon kalamburin si një mendim të zgjuar, që ngrihet mbi përdorimin e dy fjalëve që përputhen rastësisht në shqiptim, por ndryshojnë në kuptim.

Si janë vlerësuar kalamburet nga shkrimtarët e mëdhenj komikë? Xhein Ostin (Jane Austin) krijoi njëherë kalambur të “*Mansfield park*”<sup>337</sup> (“Parku Mansfield”) dhe kjo shërbeu për të fajësuar moralin e autores së veprës. Libri i parë i Mark Tuein-it (Mark Twain) “*The Celebrated Jumping Frog of Calaveras Country*”<sup>338</sup> (“Bretkosa e gëzuar e Kalaveras-it”) i mrekulloi kritikët për mospraninë e kalambureve në të. “Nuk

<sup>330</sup> <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>

<sup>331</sup> fjalë karakter nënkupton formën e shkruar të fjalës

<sup>332</sup> Brown, D. M. dhe Hall, J. W. *The Cambridge History of Japan: Ancient Japan*, Cambridge University Press, 1993, 650 faqe, f. 463.

<sup>333</sup> Tartakovsky, J. *Pun for the Ages*, The New York Times, 2009.

<sup>334</sup> Dryden, poet i madh anglez i shekullit të 17-të

<http://www.poetryfoundation.org/bio/john-dryden>

<sup>335</sup> Bierce, Ambroise (1842 – 1914) ishte botues, shkrimtar, gazetar, fabulist dhe satirist amerikan.

<sup>336</sup> <http://en.wikipedia.org/wiki/Caligula>

<sup>337</sup> [Austin, J. *Mansfield Park*, London, July 1814.]

Cituar sipas Tartakovsky, J. *Pun for the Ages*, The new York Times, 2009.

<sup>338</sup> [Twain, M. *The Celebrated Jumping Frog of Calaveras Country*, New York Saturday Press, 1865.] Cituar po aty.



ka lojë fjalësh në të” tha një gazetë londineze. “Humori i tij është i natyrshëm në shkrimet e tij”. Edhe një nga humoristët më të mirë të shekullit XX, P. G. Uodhaus-i (P. G. Wodehouse), nuk e përdori kalamburin. Ndërsa Shekspir-i e përdori atë gjerësisht. Shumë prej lojërave të tij të fjalëve janë të pahijshme. Disa vlerësues të kohës elisabetiane e konsiderojnë përdorimin e kalamburit të tij si një shenjë të përsosmërisë letrare sesa një shenjë humori.

“Loja e fjalëve ose kalamburi është një art i tingëllimit harmonik të fjalëve, të cilat kur i kap veshi dhe bien mbi diafragmë, shkaktojnë një lëvizje të këndshme në këto pjesë, e cila duke u përcjellë nga shpirti në muskujt e fytyrës, ngre kafazin e kraharorit., shkruan Xhonatan Swift-i (Jonathan Swift).<sup>339</sup> - “Zotëri, askush nuk e dënoi ndonjëherë një lojë fjalësh dhe personin që e krijoi atë. Unë nuk njoh karakter me të dëmtuar dhe të ndaluar padrejtësisht në ditët e sotme sesa krijuesi i përpiktë dhe i gjorë i lojërave të fjalëve. Ai është paria e dhomave të ngrënies; është në modë që ai të ngacmohet; dhe ashtu si çdo gomar i shurdhër mendon që krijuesi i lojërave të fjalëve mund të shkëlmohej tek prostata. Lind pyetja, a mund të rri unë edhe një javë të vetme pa krijuar lojëra fjalësh (një betim ky i frikshëm) kur dihet që njerëzit më të mëdhenj, poetë dhe filozofë të të gjitha kohërave janë pjesë e kësaj liste të damkosur” shkruante Horas Smith-i (Horace Smith).<sup>340</sup>

“Njerëzit që krijojnë lojëra fjalësh janë si djemtë çapkënë, të cilët vendosin pengesa në shinat e hekurudhës. Ata zbavisin veten dhe fëmijët e tjerë, por loja e tyre e vogël mund të mërzisë rrjedhën e bashkëbisedimit të vagonëve të një treni mallrash për shkak të një vërejtjeje goditëse.” shprehej Oliver Wendell Holms-i (Oliver Wendell Holmes).<sup>341</sup>

Mendja e një krijuesi të vërtetë kalamburesh shkon rreth homofoneve, në kërkim të një loje fjalësh, në të njëjtën mënyrë si fëmijët e vegjël kënaqen me rimat ose belbëzimet me gjuhën.

Megjithëse shumë kritikë i konsiderojnë ato një formë e ulët krijimi, kalamburet janë përdorur nga mendjet më të mëdha. Samuel Xhonson-i (Samuel Johnson) i urrente ato, por miku i tij Edmund Bërki (Edmund Burke), fuqia intelektuale e të cilit frikësonte edhe Xhonson-in, ishte i famshëm për krijimin e lojërave të fjalëve.<sup>342</sup>

#### 7.4.1. Forma më e ulët e mençurisë

Sipas Sigmud Froid-it (Sigmund Freud) kalamburet mund të jenë forma më e ulët e mençurisë [dhe “burimi i gjithë mençurisë” sipas Henri Erskin-it (Henry Erskine)]. Por lind pyetja a e meritojnë ato gjithë përçmimin që është grumbulluar mbi to, nga kritikët e tyre në vite. Kolërixh-i (Coleridge) është shprehur që kalamburi ishte “i padëmshëm ... sepse ai asnjëherë nuk shkakton zili.” Edhe Sigmud Frojd-i e sulmoi këtë çështje duke shpjeguar pozitën e ulët të kalamburit me faktin që ato janë

<sup>339</sup> [Swift, J. *The physical definition of punning according to Cardan (Përkufizimi fizik i lojës sëfjalëve sipas Kardan)*] Cituar po aty.

<sup>340</sup> [Smith, H. *On puns and punsters, Gaeties and Gravities*, 1826.]

Cituar te <http://grammar.about.com/od/pq/g/punterm.htm>

<sup>341</sup> [Holmes, O. W. *The autocrat the breakfast-table*, The Atlantic Monthly, 1857.]

Cituar po aty.

<sup>342</sup> Shih te [http://www.nytimes.com/2009/03/28/opinion/28Tartakovsky.html?\\_r=0](http://www.nytimes.com/2009/03/28/opinion/28Tartakovsky.html?_r=0)

“më të lirë (në vlerë) - mund të krijohen me më pak vështirësi.” Ndërsa Oscar Lëvant-i (Oskar Levant) theksoi se: “Një kalambur është forma më e ulët e humorit.”

#### 7.4.2. Të lehta për t’u krijuar

Kalamburet janë të lehta për t’u krijuar. Mjafton të gjesh dy fjalë që tingëllojnë njëllor dhe zëvendësojmë njërin për tjetrën në një shprehje ose fjali. Për shembull, fraza e gjuhës shqipe “atje kemi patur *verën* e vitit të kaluar”, në përgjithësi mund të kuptohet për *verën* si pije; më rralë këtu mund të jetë fjala për diçka që pohohet se e kemi patur në një vend, një vit më parë në *verë*.

S. Lashova dhe O. Grillo shkruajnë:

Një lider më merr me *vete*

Ngado që *vete*.<sup>343</sup>

Në këtë shembull autorët luajnë me homonimet *vete* (përemër vetvetor) dhe *vete* (folje).

Ose frazat e tipit: “ai *do* të bëhet artist” dhe “ai *dó* të bëhet artist” që ndeshen në gjuhën e folur shqipe, janë të qarta pikërisht nga theksi i fjalës, i cili e lehtëson zgjedhjen në favor të njërit kuptim.

Në gjuhën angleze marrim këtë shembull: “The glutton commented after wolfing down a doughnut: I can’t believe I ate the *hole* thing!” Loja e fjalëve në këtë shembull qëndron te fjala *hole* (vrimë), që ka tingëllim të njëjtë me *whole* (të gjithën). Duke luajtur me këto fjalë homofone autori krijon këtë situatë: “I pangopuri komentoj pasi e mbaroi menjëherë petullën (në formë rumbullake me vrimë në mes): Unë nuk mund ta besoj që e hëngra të *gjithën* / *petullën me vrimë!*”

Disa studiues pretendojnë se kalamburi nuk është ‘një lojë fjalësh’. Ata e rezervojnë këtë term për rastet kur një fjalë identike me më shumë se një kuptim është përdorur, kështu që ajo mund të merret në të dyja kuptimet. Sjellim një shembull në gjuhën angleze për ta ilustruar këtë pikë.

Në shembullin e mëposhtën djaloshi përgjigjet me një lojë fjalësh:

- A. My grandfather came from Eastern Europe. (Gjyshi im erdhi nga Evropa Lindore.)
- B. *Russian?* (Rus?)
- A. No, he took his time. (Jo, i mori kohë.)

Në dialog loja e fjalëve qëndron te përgjigjja e djaloshit *Russian* (rus) që tingëllon, gjithashtu, si *rushing* (me nxitim).

<sup>343</sup> Lashova, S.; Grillo, O. K. *Gomari që desh të bëhej mbret, Fabula dhe epigram*, Tiranë, 1997, f. 38.

### 7.4.3. Jezusi përdori një lojë fjalësh

Të preferuara ose jo, kalamburet janë dhe do të jenë gjithmonë të pranishme, qysh prej kohëve të lashta. Aristoteli i aprovoi ato.

Edhe Jezu Krishti nuk mund t'i rezistonte përdorimit të një kalamburi të rastit. Ai tha: “Ti je *Pietri /shkëmb* (në greqisht ‘Petra’ do të thotë ‘shkëmb’) dhe mbi këtë *shkëmb* unë do të ngre kishën time”.<sup>344</sup>

Një burim i lashtë kalamburesh përfshihet në shumë tekste fetare, por Bibla është ajo që dallon më tepër. Që nga Testament i Vjetër dhe deri te Testamenti i Ri, autorët e teksteve biblike kanë përdorur lojën e fjalëve, shpesh të ndërtuar mbi homonimi.

Një nga kalamburet më të vjetra në botë vjen nga libri i Judës në Bibël, i cili u shkrua rreth 3000 vjet më parë. Në kapitullin dhjetë të librit të Judges gjejmë këtë fjali: “He had thirty sons, who rode on thirty *burros* and owned thirty *boroughs* in the region of Gilead...”. Fjalët *burros* “gomerë” dhe *boroughs* “lagje” janë homofone. Këto fjalë rimojnë në gjuhën angleze (gjuhë nga janë marrë shembujt) dhe ato janë shumë të ngjashme në gjuhën hebraishte biblike: *ayirim* për *borros* dhe *ayarim* për *boroughs*. Vëmë re që përkthyesit janë përpjekur të riprodhonin në gjuhën angleze një lojë fjalësh të hebraishtes.

Lexuesi e ndesh lojën e fjalëve në të dyja gjysmat e Biblës, disa prej të cilave nuk mund të përkthehen (në gjuhën angleze), por të gjitha janë shumë tërheqëse në gjuhën e origjinalit.

### 7.4.4. Poetë dhe dramaturgë mbi lojën e fjalëve

Dramaturgët e periudhës Elisabetiane i preferonin kalamburet, siç ishin, Don-i (Donne) dhe Mervell-i (Mervell). Motot e fisnikëve shpesh ndërtoheshin mbi kalambure. Në vitet 1700, Xhonatan Suift-i shkroi “*Një mbrojtje modeste e kalamburit*”<sup>345</sup> dhe Tomas Sheridën-i (Thomas Sheridan), shkroi “*Arti i lojës së fjalëve*”.<sup>346</sup> Ai propozoi tridhjet e katër rregulla për përdorimin e lojës së fjalëve. Midis rregullave të tij ishte ‘Rregulli i ndërprerjes’ (krijuesi i kalamburit mund të ndërpresë çdo bashkëbisedim, në çdo kohë) dhe ‘Rregulli i tendencës për të qeshur’ (krijuesi i kalamburit duhet të jetë i pari, i cili qesh me lojën e tij të fjalëve).<sup>347</sup>

### 7.4.5. Lojë fjalësh, por jo për të qeshur

Jo të gjitha lojërat e fjalëve krijohen për të shkaktuar humor apo pakënaqësi. Publiku i gjykon ato me subjektivizëm.

<sup>344</sup> Shih [http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns\\_2.htm](http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns_2.htm)

<sup>345</sup> [Swift, J. *A modest defence of punning*, te *A Modest Proposal and Other Writings*, London, 1716.] Cituar te [http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns\\_2.htm](http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns_2.htm)

<sup>346</sup> [Sheridan, Th. *The art of punning*, Dublin, 1719.] Cituar po aty.

<sup>347</sup> Po aty.

Megjithëse shumë njerëz i konsideruan ato si një formë e ulët krijimi, krijuesit e kalambureve bënë progres në shekullin e XIX. Çarls Lamp-i (Charles Lamp) deklaroi se ai “nuk njohu ndonjëherë ndonjë armik të kalamburit, i cili të ishte i panatyrshëm”. Dëshira e tij për të krijuar dhe përdorur kalambure ishte shumë e madhe. Ai mendonte se “kalamburet më të këqija janë më të mirat”. Ai i përkufizon kalamburet në këtë mënyrë: “Një lojë fjalësh nuk drejtohet nga ligjet që kushtëzojnë mendjen. Ajo është një pistoletë që shkrehet tek veshi; jo një pupël që ngacmon intelektin.”<sup>348</sup> Tomas Hud-i (Thomas Hood), sipas disa studiuesve, ishte “i fundit njeri i famshëm, që përdori kalambure”. Poezitë e tij ishin plot me të tilla. Ja si thumboi ai me një lojë fjalësh, kur një sipërmarrës i ofroi shërbimin e tij: “He is trying to *urn* a lively *Hood*” (Ai po përpiqet të fitojë / të kapë një njeri të shkathët). Në këtë fjali luhet me homofonet *urn* (fut në vazo) / *earn* (fitoj) dhe *Hood* (mbiemri i autorit) / *hood* (individualitet), të cilat janë homonime perfekte.<sup>349</sup>

#### 7.4.6. Krijimi dhe përdorimi i kalambureve është i justifikuar

Ndërsa G. K. Çestërton-i (G. K. Chesterton) e ka konsideruar kalamburin si një lloj arti perfekt, Oliver Uendëll Holms-i ishte i një mendimi krejtësisht të kundërt. Ai thekson se të godasësh krijuesin e kalambureve është e justifikuar vetëm nëse loja e fjalëve është e papëlqyeshme. Krijuesit e kalambureve janë si djemtë e papërmbajtur që vënë pengesa në shinat e trenit. Dredhia e tyre e vogël mund të mërzisë trenin e ngarkuar të bashkëbisedimit për shkak të një kritike goditëse.<sup>350</sup>

Kalamburi ka mbijetuar deri në ditët tona falë mendjeve të mëdha të Gruço Marks-it (Groucho Marx), Ogdën Nash-it (Ogden Nash), Dorothe Parkër-it (Dorothy Parker) dhe Xheims Thërbër-it (James Thurber). Ndërsa takonte T. S. Eliot-in (T. S. Eliot), G. Marks-i tha, “Unë zbulova se Eliot-i dhe unë kishim tri gjëra të përbashkëta: (1) një tërheqje për purot e mira; (2) macet dhe (3) një dobësi për të krijuar lojëra fjalësh – një dobësi të cilën jam përpjekur ta kapërcej për vite me rradhë”<sup>351</sup>.

#### 7.5. Homonimet si mjete stilistike në gjuhën shqipe dhe atë angleze

Në gjuhën shqipe, nuancat stilistike të homonimisë janë të ngjashme me ato të anglishtes, megjithatë dukuria nuk ndeshet shumë shpesh. Në letërsinë shqipe ajo është parë si burim shprehësie më rrallë.

Dukuria është më e shpeshtë në gjuhën angleze dhe si rrjedhim, loja me afrimin e homonimeve është mjaft e përhapur në letërsi, si në prozë ashtu edhe në poezi, në gjuhën e fëmijëve, gazetari, gjuhën kompjuterike, fjalëkryqe etj.

Në vazhdim, është trajtuar përdorimi stilistikor i homonimisë në secilën prej gjuhëve.

<sup>348</sup> Lamb, Ch. *That the worst puns are the best*, te *The last essays of Elia*, 1833.

<sup>349</sup> Shih [http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns\\_3.htm](http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns_3.htm)

<sup>350</sup> [Holmes, O. W. *The autocrat of the breakfast-table* (Kryesori në tavolinën e mëngjesit), London, 1858.] Cituar te [http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns\\_3.htm](http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns_3.htm)

<sup>351</sup> Augarde, T. *Puns the lowest form of wit*.  
[http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns\\_2.htm](http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns_2.htm)

Po ndalemi fillimisht tek përdorimi i homonimeve si mjete stilistikore në **gjuhën shqipe** për të vazhduar më pas, paralelisht me gjuhën angleze.

Nuancat stilistikore të homonimisë në **gjuhën shqipe** janë të ngjashme me ato të anglishtes për nga vlerat e tyre, vetëm se këto të fundit janë shumë më të shpeshta në përdorim. Ashtu si në gjuhën angleze edhe në shqip homonimia ndeshet në të folurin e përditshëm, në letërsi (prozë dhe poezi), gjuhën e fëmijëve, lojërat e fjalëve, gazetari etj.

Me vlerat stilistikore të homonimisë në gjuhën shqipe është marrë kryesisht gjuhëtari Xhevat Lloshi.<sup>352</sup> Edhe studiues të tjerë si: Jani Thomai e Rami Memushaj, e kanë prekur këtë çështje.

Loja me afrimin e homonimeve është ndeshur shpesh në letërsi. Shkrimtarë humoristë janë mbështetur tek homonimet dhe i kanë shfrytëzuar ato për të ndërtuar lojra fjalësh, thënie me dy kuptime, shaka që mund t'i marrësh edhe kështu edhe ashtu. Megjithatë, në letërsinë shqipe, homonimia është parë rrallë si burim shprehësie. Nga folklori kemi një gjëzë të tillë për breshkën:

Kudo *vete*,  
shtëpinë me *vete*;

ndonjë lojë fjalësh, si: *Pashë nje pashë më një mjekër shtatë pashë të gjatë*; rastin e një shprehje humoristike: *Qe si qe, u bë si ka*, si dhe ndonjë këngë, si:

Testembeli qesh e *lot*,  
Ç'ke nuse që qan me *lot*?

Kjo e fundit këndohet ndryshe edhe si:

Trëndafili qesh e *lot*, qesh e *lot*  
Çke nuse që qan me *lot*, qan me *lot*?<sup>353</sup>

Folklori shqiptar është i pasur me elementë të së qeshurës. Gjuha me larminë e saj, me elasticitetin dhe përshtatshmërinë e saj, me kuptimet e nënkuptimet, me figurat etj. është një mjet i dorës së parë për të krijuar komiken. Për këtë arsye ka raste ku shfrytëzohen homonimet, të cilat bëhen shkas i një keqkuptimi komik apo i një përgjigjeje me thumb. P.sh.,

---

<sup>352</sup> Lloshi, Xh. *Rreth disa shfaqeve të ndërlikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, I, Mihal Duri, Tiranë, 1972.

Lloshi, Xh. *Stilistika dhe Pragmatika*, Botimet Toena, Tiranë, 1999.

<sup>353</sup> Lloshi, Xh. *Stilistika dhe Pragmatika*, Botimet Toena, Tiranë, 1999, f. 94.

I thanë njërit

- Kur erdhe?
- Nesër dy ditë.
- Po nga je ti?
- Nga shtëpia ime.
- Ku e ke shtëpinë?
- Në mes të oborrit dhe me derë nga lesa.
- Opo, qënke *i trashë* ti!
- Ohu, të shikosh vëllanë tim ti, ta çash bëhen tre sa unë!<sup>354</sup>

Di vetë shkojnë misafirë me ni ven. I zoti i shpëjs për darkë u çoi me granë bukë e bathë. Mas bathëve u vu *fli* (një lloj pite). Si bonë shumë muhabet, erth vakti me ra me fletë. U strukën. Njoni prej miqve fli nuk kishte granë kurrë. I thotë shoqit t'vet kur bejnë me fletë:

-More, qejo heja e mrame qish e pat emnin? Se s'kam granë asnjë herë çasi senit!

- *Fli!* - i thotë shoqi.

-More, qish me *fletë*? S'a to m'marrë gjumi pa i mcue emnin!<sup>355</sup>

A.Z. Çajupi e ka njohur homoniminë, me sa duket nën ndikimin e modeleve të gjuhës frënge:

Dhe në sis' e *kisha*

Kur erdha nga *kisha*. (“14 vjeç dhëndër”)

Tekdo që *vete*,

Thotë me *vete*. (“Dhelpira dhe një shtat”)

Rastësisht afrimi i homonimeve del edhe te shkrimtarë të tjerë, p.sh., te Lazgush Poradeci:

Ku shfren me *komb* e liga

Ku ndeshet *kombi* i ngritur krejt. (“Mbi ta”)<sup>356</sup>

<sup>354</sup> Shih <http://www.balkanweb.com/forumi/index.php?topic=1468.0%3Bwap2>

<sup>355</sup> Po aty.

<sup>356</sup> Lloshi, Xh. *Stilistika dhe Pragmatika*, Botimet Toena, Tiranë, 1999, f. 94.

Kur homonimia ose paronimia ndërtohen qëllimisht me disa fjalë, atëherë kemi **kalambur**.

Në gjuhën e folur shqipe njihen shakatë: *Ka liqeni rosa, ka liqeni rika.*, e cila merret edhe: *Kali, qeni, rosa; kali, qeni, rika.*, ose përngjashmëria me greqishten: *Ti the lis, posa q'e pe ra*. Këtu kemi të bëjmë me njësi të ndryshme leksikore që kanë përmbajtje të ndryshme, por tingëllim të njëjtë dhe për këtë shpesh sjellin edhe keqkuptime në ligjërime. Kjo shihet edhe në shembullin,

Elbasani: Tash ik pagu ke merimanga të ma bje kerrin ktu, unë po pres qe aty  
*n'kaqif*.

Herkuli: Ej *nuk ka fiq* anej, katunarët i ke kënej.<sup>357</sup>

Kalamburin e ndeshim në poezi te Naim Frashëri, përsëri nën ndikimin e gjuhës frënge:

Moj po me ç'sy e me ç'faqe

Më qasësh e më çfaqe? (“E zonj’ e fatit”).<sup>358</sup>

Krijimi i homonimeve gjatë përdorimit të fjalës në forma artistike dhe figurative, në mirëkuptim me normën letrare, është një mënyrë që shfrytëzohet në letërsinë shqipe. Shumë autorë luajnë me homoniminë për të krijuar humor, si edhe për të depërtuar në psikologjinë dhe gjendjen shpirtërore të personazheve. Ky përdorim preferohet sidomos nga autorë të gjinive satirike–humoristike, të cilët i përdorin homonimet për të krijuar keqkuptime dhe situata, të cilat sjellin humor.

Për shembull, Qamil Buxheli në romanin “Karriera e zotit Maksut”<sup>359</sup> e përdor homoniminë kur zyrtari vendor i jep fshatarëve fotografinë e kryeministrit dhe i porositi ata që ta *varin* atë në mur. Fshatarët duke përdorur një ironi të hapur i përgjigjen: “*Do ta varim, zoti nënprefekt, do ta varim.*” Sigurisht që zyrtari vendor e kishte fjalën për të varur fotografinë në mur, por duke dashur të krijojë një motiv klasor, autori i jep fjalës *do ta varim* një ngjyrim tjetër *do ta çojmë në litar*. Brenda këtij konteksti, fjala *var* del në të paktën dy kuptime të ndryshme, ku përbërësi i kuptimit figurativ sjell një homonim, bazuar te norma letrare.

Shkrimtari Jakov Xoxe në romanin e tij “Lumi i vdekur”<sup>360</sup> ofron një pasurim sasior në leksik. Ai luan me homoniminë, p.sh., emri i fshatit *Trokth* është i njëjtë në tingëllim me *trok*, sepse ai është një fshat i varfër dhe me toka të djerra.

- “Fshati *Trokth*? ... - u çudit beu. – mos ke ndërmend të nxjerrësh kripë nga shëllira e tij,

se kashtë a zhukë s’ka fije ai, *trok*, si ja thonë dhe emrin ...”<sup>361</sup>

<sup>357</sup> Portokalli, Skaleta 12.11.

<sup>358</sup> Lloshi, Xh. *Stilistika dhe Pragmatika*, Botimet Toena, Tiranë, 1999, f. 94.

<sup>359</sup> Buxheli, Q. *Karriera e zotit Maksut*, Mësonjëtorja, Tiranë, 2005. f. 80.

<sup>360</sup> Xoxe, J. *Lumi i vdekur*, Botimet Encikolopedike, Tiranë, 2002.

<sup>361</sup> Po aty f. 18.

Ose

- “E, o Kozi, ka të drejtë papu. Ditën e së premtës së zezë s’ngre *zogu* fole, andaj ky *Zogu* ynë fluturoi të gjejë fole gjetkë ... - se kush qesëndisi nga pleqtë.”<sup>362</sup>

Në këtë shembull fjala e përgjithshme *zog* del në të njëjtin kontekst me emrin e përveçëm të mbretit *Zog*, ku qesëndiset largimi i tij nga Shqipëria. Ky rast quhet ndryshe edhe kapitonimi. Kapitonimi kemi kur një emër i përveçëm është homonim me një fjalë të përgjithshme.

Pranëvënia e kuptimeve ose e homonimive është në thelb një ngatërrim i qëllimshëm, prandaj më shpesh del për humor, si p.sh., *Gruaja juaj ka një thesar të pasur eksperience, - më tha. - A, të lutem, veç me thesarët mos më ngatërro, - i thashë unë gjithë nerva. - Edhe në qoftë se ka pasur ndonjë thesar tek i ati, tek unë nuk ka sjellë asgjë.* (Hosteni, 1980).

Homonimet në gjuhën shqipe duke pasur tingëllim të njëjtë, nganjëherë, ndonëse rrallë, sjellin keqkuptime në ligjërime dhe errësojnë qartësinë e fjalës. P.sh., fjala *hapa* mund të merrej sipas rastit me dy kuptime: “*Unë hapa derën dhe u sula të përqafoja të gjithë shokët.*” (Let. art.)// “*Ora ra dymbëdhjetë dhe ajo nuk i ndjeu fare ca hapa të lehtë që po i afroreshin.*” (Let. art.).

Megjithatë, vështirësitë që krijohen në ligjërime nga përdorimi i homonimeve nuk janë aq të dendura sa në anglisht dhe nuk pengojnë marrëveshjen ndërmjet bashkëbiseduesve. Në raste shumë të rralla, në gjuhën shqip jemi të detyruar të shtojmë në ligjërimin tonë fjalë e shpjegime plotësuese. Në përgjithësi, është konteksti ose situata e dhënë ku del qartë se me ç’kuptim përdoret kjo apo ajo fjalë. P.sh., “S’pret shpata, por *pret* dora e fuqishme e Skënderbeut” (Let. art.) // “Muji i *pret* me dorë në zemër...” (Let. art.), “Një *re* e lehtë, qumështore, iu afrua majës së malit e pastaj u shkoq.” (Let. art.) // “Dalina e vogël dëgjonte me vëmendje kur mësuesja po shpjegonte notën *re*.” (Let.art.) // “Udhëtimin e bëmë në një kohë të keqe, me *re* e mjegull.” (Let.art.), “*Malli, malli* për ty më solli këtu.” (Let.art.) // “*Malli* që ke ngarkuar është shumë i mirë.” (Let.art.), “- E, mor baba, e *poqe* atë dhëndrin? – E *poqa*, moj bijë, po të kërkojnë motrat edhe ty” (Kr. Pop.) // “Ndezi zjarr, *poqi* peshkun si mundi dhe e hëngri gjysmë të pjekur e gjysmë të papjekur” (Let. art.), “*Barin*, që ia bleva, as që e vuri në gojë. Më lehtë bën gjëlpërat ai” (Let. art.) // “Druvarët presin dru, bujqit mbjellin e korrin, kositin *barin* e rreshkur, vënë haje për bagëtinë” (Let. art.)<sup>363</sup>.

Shmangia e homonimisë, që u përmend në kapitujt e mësipërm, kur sjell vështirësi komunikimi dëshkohet nga zëvendësimi i *arrë* me *kaçkë* në krahinat juglindore, ku nuk dallohet [ r ] nga [ rr ], ose nga zëvendësimi i *pyll* me *orman* në krahinat jugperëndimore, ku kjo e dyta do të tingëllonte keq. Vështirësi të tilla ndeshen edhe sot në shqipen e shkruar, p.sh., fjalia “Bonaparti *do* të lozë rolin e bamirësit.” - merret si koha e ardhme, kurse autori kërkon të thotë se ai *dëshiron* të

<sup>362</sup> Po aty f. 396.

<sup>363</sup> Thomai, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 52.



lozë këtë rol. Për këtë arsye shkruhet: “Bonapardi *don* të lozë rolin e bamirësit.” Madje ndonjëherë vihen theksa mbi fjalë për të shmangur ngatërrimin, si p.sh., “U transportuan nga larg 2500 metra kub *dhé dhe* mbi 800 metra kub plehra.”<sup>364</sup>

Ndërsa në gazetarinë e sotme është e parapëlqyer loja me homonimet për shkak të së papriturës që jep në tituj, p.sh., “Plan *masash*, pa u këshilluar me *masat*”<sup>365</sup>; “Teta *rend* pas *rendit*”<sup>366</sup>; “Pse na merr malli për ‘*verën*’ në dimër (homonimi e pashmangshme)”<sup>367</sup>. Homonimet bëjnë sidomos përshtypje, kur njëra është fjalë e panjohur.

Përdorimin e homonimisë për arsye humori e ndeshim edhe te spektakli “Portokalli”. Po citojmë një shembull:

Zana: (Fedrit dhe Elsës) Kopshti jonë është projekt *pilot* amerikan ...

Fedri: Qyqja! Do ma çojnë djalin në luftë!

Zana: No, no! *Pilot* ... dmth., eksperimental, këtu aplikohen metodat amerikane të edukimit.<sup>368</sup>

Dihet që një prej burimeve të homonimisë në gjuhën shqipe është huazimi. Pikërisht, në lojën e mësipërme të fjalëve, fjala e huazuar keqkuptohet me fjalën ekzistuese të leksikut të shqipes.

Lindja e homonimeve mund të ndodhë edhe kur e njëjta fjalë por, e përdorur në struktura të ngurtësuar, si shprehje frazeologjike, largohet shumë nga kuptimi i saj fillestar. Për shembull,

Stela: Po zysh! Një çiklist niset nga pika A dhe ndalon në pikën B duke kaluar nga pika C ... Në cilën nga *pikat*, shpejtësia e tij e çastit është më e madhe! Varet zyshe, varet se ku *i bie pika!*<sup>369</sup>

\* \* \*

Homonimet janë të kudondodhura në **anglishten** e folur dhe të shkruar, por homofonet janë më të prekshmet.

Fakti që fjalët me kuptime krejtësisht të ndryshme mund të shqiptohen njësoj është shfrytëzuar shpesh në letërsinë angleze, ku përdorimi i kalambureve ka një histori të gjatë. Aty gjejmë kalambure klasike, të krijuara nga heronj të periudhës anglo - saksonë, deri në poemat e periudhës së mesjetës. Kjo prirje vazhdoi edhe më pas në dramën e periudhës së rilindjes dhe në letërsinë artistike pas kësaj periudhe. Kalamburet e kësaj kohe janë të rezervuara dhe të mprehta. Ato kanë vlera të

<sup>364</sup> [Zëri i Popullit, 1980.]

Cituar sipas Lloshi, Xh. *Stilistika dhe Pragmatika*, Botimet Toena, Tiranë, 1999, f. 95.

<sup>365</sup> [Zëri i Popullit, 1990.] Cituar po aty.

<sup>366</sup> [Koha Jonë, 1998] Cituar po aty.

<sup>367</sup> [Dr. Anna Kove, Galaktika Poetike “Atunis”, 25 Janar 2014.] Cituar po aty.

<sup>368</sup> Portokalli: Skaleta 9.13, 2010 – 2011.

<sup>369</sup> Portokalli”: Skaleta 12.11, 2010 – 2011.

ndryshme poetike, si për shembull, ndihmojnë për të ndërtuar temën, karakterizojnë, së bashku, personazhe të klasave të larta dhe të ulëta, krijojnë imazhe të pasura, shkaktojnë të qeshura etj.

Kalamburet jo-humoristike ishin dhe janë një mjet standard retorik dhe poetik në letërsinë angleze. Kalamburet dhe format e tjera të lojës së fjalëve janë përdorur nga shumë shkrimtarë të famshëm, si Aleksandër Poup-i (Alexander Pope), Xheims Xhois-i (James Joyce), Vladimir Nabëkov-i (Vladimir Nabokov), Robert Blok-i (Robert Bloch), Luis Kerël (Lewis Carroll), Xhon Dan-i (John Donne) dhe Uilliam Shekspir-i, i cili thuhet të ketë përdorur 3000 kalambure në veprat e tij.<sup>370</sup>

Shekspir-i është dalluar, gjithashtu, për lojën e tij me kalambure jo shumë serioze, çka bëri që Samuel Xhonson-i (1709-1784)<sup>371</sup> të ankohej në këtë mënyrë: “Për Shekspir-in një kalambur është si vaporët janë për udhëtarët! Kalamburi e ndjek shkrimtarin në të gjitha aventurat, por është e sigurt, kjo ndodh për ta nxjerrë atë nga rruga e tij dhe për ta zhytur në baltë. Kalamburi ushtron fuqi negative mbi mendjen e tij dhe magjepsjet e tij janë të pazëvendësueshme.”<sup>372</sup> Johnson-i i referohet kalamburit si “forma më e ulët e humorit”.

Në poemën “Një himn Zotit” nga Xhon Dan-i<sup>373</sup>, martuar me An Mor-in (Ann More), vihet re prania e shpeshtë e kalamburit: “*son/sun*” (diell/bir) në rreshtin e dytë të cituar dhe dy kalambure të përbëra “*Donne/done*” (mbiemri i autorit /e bërë) dhe “*More/more*” (mbiemri i bashkëshortes /më shumë). Të trija rastet janë homofone. Paqartësitë shërbejnë për të paraqitur disa kuptime të mundshme në këto vargje.

“When Thou hast *done*, Thou hast not done / For I have *more*.  
That at my depth Thy *Son* / Shall shine as he shines now, and heretofore  
And having *done* that, Thou hast *done*; / I fear no *more*.”<sup>374</sup>

Në mënyrë të ngjashme, Uilliam Shekspir-i në *Sonnet 135*, luan me kuptimet e emrit dhe foljes *will* dhe me shkurtime të emrit të tij, *Will*. Kjo ndodh, jo më pak se 13 herë.<sup>375</sup>

Shkrimtari i njohur anglez Bernard Shau (Bernard Shaw) e shfrytëzon shpesh homofoninë në veprat e tij letrare (në prozë) duke realizuar lojra tërheqëse fjalësh. Te “*Pygmalion*”<sup>376</sup> ai luan shpesh me fjalët për të shprehur qartë idetë, karakterizuar personazhet dhe për të krijuar efekte të veçanta të lexuesi. Më konkretisht, te “*Pygmalion*” (*Pigmelia*), profesori i fonetikës Z. Higin (Mr. Higgins) ironizon shpesh nxënësen e tij, Eliza Dolitëll (Eliza Doolittle) për pasaktësi në shqiptimin dhe të kuptuarit e fjalëve. Ai i drejtohet asaj “*You do little*” (Ti bën pak), ndërsa ajo e kupton për mbiemrin e saj “*You Dolittle*” (Ju Dolittle). Nëna i drejtohet Elizës “*Yes, my dear*” (Po, e dashura ime) dhe ajo e merr për “*Yes, my deer*” (Po, dreri im). Shembuj të tjerë në vepër janë: *all ready* (të gjithë gati) / *already* (pothuajse); *your*

<sup>370</sup> Shih <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>

<sup>371</sup> Johnson, Samuel 1709-1784, shkrimtar anglez i cili njihet si Dr. Johnson. Ai ka sjellë kontribute të çmuara në letërsinë angleze si poet, eseist, moralist, kritik letrar, biograf, botues dhe leksikograf. [http://en.wikipedia.org/wiki/Samuel\\_Johnson](http://en.wikipedia.org/wiki/Samuel_Johnson)

<sup>372</sup> Johnson, S. *Preface to Shakespeare*, London, 1765.

<sup>373</sup> Donne, J. *A hymn to God the Father*.

<sup>374</sup> Shih <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>

<sup>375</sup> [www.sit.wisc.edu/~spkraus1/catalyst/reading/shakespeare2.shtml](http://www.sit.wisc.edu/~spkraus1/catalyst/reading/shakespeare2.shtml)

<sup>376</sup> Shaw, B. *Pygmalion*, New York, 1916.

(juaji) / *you're* (ju jeni), *its* (i, e tij/saj) / *it's* (ky/kjo është); *knew* (e dija) / *new* (e re / i ri); *their* (e tyre) / *there* (atje) / *they're* (ata/ato janë) etj.

Xhorxh Bernard Show luan shpesh me këtë mjet stilistikor në veprat e tij. Ja një shembull tjetër nga vepra e tij "*Augustus Does His Bit*":

THE CLERK. Are you *engaged*? [His manner is strangely softened.]

(Ju jeni i *fejuar*/i *zënë* për momentin?)

AUGUSTUS. What business is that of yours? However, if you will take the trouble to read the society papers for this week, you will see I am *engaged* to the Honorable Lucy Pophan, youngest daughter of ....

(Ç'të duhet ty kjo gjë? Megjithatë, nëse do të kishe mundësi të lexoje gazetat e kësaj jave, do të mësoje se unë jam *fejuar* me të nderuarën Lucy Pophan, vajzën e vogël të ....)

THE CLERK. That ain't what I mean. Can you *see* a female?

(Nuk doja të thoja këtë gjë. A mund të *shikosh* një *femër* /takosh një femër?)

AUGUSTUS. Of course I can *see* a female as easily as a male. Do you suppose I'm blind?

(Sigurisht që mund të shikoj një femër aq lehtë sa mund të shikoj një mashkull. Ti mendon se jam i verbër?)

THE CLERK. You don't seem to follow me, somehow. There's a female downstairs: what you might call a lady. She wants to know can you *see* her if I let her up.

(Ti nuk po më ndjek. Është një femër poshtë, të cilën ti mund t'a quash zonjë. Ajo dëshiron të dijë nëse mund ta *shihni*/takoni sot)

AUGUSTUS. Oh, you mean am I disengaged. Tell the lady I have just received news of the greatest importance which will occupy my entire attention for the rest of the day, and that she must write for an appointment.<sup>377</sup>

(Oh, ju doni të thoni nëse jam i lirë / kam kohë të lirë. I thoni zonjës se sapo kam marrë një lajm me rëndësi mjaft të madhe çka do të kërkojë të gjithë vëmendjen time për pjesën tjetër të ditës, dhe që ajo duhet të shkruajë për të lënë një takim.)

Homonimet *engaged*<sub>I</sub> (i fejuar) / *engaged*<sub>II</sub> (i zënë me punë) dhe *see*<sub>I</sub> (shikoj) / *see*<sub>II</sub> (takoj) krijojnë lojëra fjalësh që janë shumë të dukshme për një vëzhgues të kujdesshëm.

Gjithashtu, homofonet ndeshen shpesh në vargjet e fëmijëve: "A *sailor went to sea, sea, sea, to see what he could see, see, see.*" (Një marinar shkoi në det, det, det, të shihte çfarë ai mund të shihte, shihte, shihte.) Vargje dhe shaka të tilla kryejnë një

<sup>377</sup> [Shaw, G. B. *Augustus does his bit*, 1916, <http://www.gutenberg.org/files/3487/3487-h/3487-h.htm> ]  
Cituar sipas Stefanllari, I. *A Course in English Lexicology*, GEER, Tiranë, 2011, f.102.

funksion të rëndësishëm duke i ndihmuar fëmijët të jenë të qartë për fjalë të ngjashme në formë ose shqiptim. Kjo është ana më serioze e homofoneve.

Homofonet ndeshen edhe në tituj të ndryshëm, si p.sh., “Grizzly - The *bear facts*” (e përhimtë - fakte të *pastra* / fakte për *arinjtë*) është emërtimi i një dokumentari të BBC - së. Në përgjithësi, ato janë përdorur në mënyrë krijuese, por shpesh mund të çojnë në paqartësi në anglishten e folur. Kur dëgjon vazhdimisht të shqiptohet në radio ose televizor titulli i këngës së Mudi Bluz (Moody Blues) “Nights in White Satin” (Netë në mëndafsh të bardhë), ajo tingëllon si “Knights in White Satin” (*Kalorës në mëndafsh të bardhë*).

Për një përdorues të zakonshëm të gjuhës, homofonet krijojnë gjithmonë probleme në të shkruar, gjë që nuk ndodh në ligjërim me to. Homofonet janë një arsye e shpesh të gabimeve në të shkruar. Për shembull, çiftet e mëposhtme të fjalëve shpesh na bëjnë të dyshojmë nëse është njëra fjalë apo tjetra që ne duhet të shkruajmë.

|                                   |   |
|-----------------------------------|---|
| <i>stationary</i> (e palëvizshme) | <i>stationery</i> (artikull, letër shkrimi) |
| <i>discreet</i> (i matur)         | <i>discrete</i> (i veçantë, i dallueshëm)   |
| <i>elicit</i> (nxjerrë)           | <i>illicit</i> (i paligjshëm)               |
| <i>canvas</i> (kanavacë, pikturë) | <i>canvass</i> (diskutoj)                   |
| <i>breech</i> (të ndenjurat)      | <i>breach</i> (shkelje)                     |
| <i>compliment</i> (kompliment)    | <i>complement</i> (plotësues)               |
| <i>dessert</i> (ëmbëlsirë)        | <i>desert</i> (shkretëtirë)                 |

Një harresë e vogël mund të ndikojë që një përdorues i anglishtes të gabojë edhe me çifte fjalësh që kanë dënduri përdorimi, si *affect* (ndikon) / *effect* (efekt); *course* (kurs) / *coarse* (e ashpër); *die* (vdes) / *dye* (lyej); *break* (thyej) / *brake* (frena). Në raste të tilla ndoshta dhe një kontroll - gjërmëzimi elektronik nuk do të ishte në gjendje të ndihmonte.

Për sa u përket homografeve, ato janë të njëjta në formën e shkruar dhe paraqesin të tjera probleme për përdoruesit e anglishtes. Gjërmëzimi i tyre nuk mund të ngatërrohet asnjëherë. Ashtu si homofonet, homografet përdoren në lojëra fjalësh për të krijuar situata të paqarta. Zakonisht, këto janë lojëra fjalësh më të sofistikuara dhe funksionojnë si në të shkruar edhe në të folur. P.sh., “Time *flies like* a bird. Fruit *flies like* banana” (Koha fluron si një zog. Mizat e frutave pëlqejnë bananet.) Përqëndrohemi te çiftet e homografeve: *flies* (folje) / *flies* (insekt) dhe *like* (parafjalë që shpreh ngjashmëri) / *like* (folje).

Homografet, gjithashtu, krijojnë paqartësi. Rasti më i përditshëm është ai i titujve të gazetave. Për shembull, titujt e mëposhtëm tregojnë qartë forcën e homografeve për të krijuar paqartësi.

Drunk gets nine months in *violin* case. (I dehuri qëndroi nëntë muaj në kutinë e *violinës*. / I dehuri qëndroi nëntë muaj në qelinë e *dhunës*.)

Red tape holds up *new* bridge. (Burokratët ngrenë ura të *reja*. / Burokratët i *njohin* urat lidhëse.)

Reagan wins on budget, but more *lies* ahead. (Regan fiton në buxhet, por më shumë *gënjeshta* përpara. / Regan fiton në buxhet por më shumë *shtrihet* përpara.)<sup>378</sup>

Dihet domosdoshmëria e gazetarisë për të përdorur një stil konciz, prandaj në rastin konkret, homografia është parë si një efekt anësor negativ. Megjithatë, ajo është një mjet i pazëvendësueshëm për të tërhequr vëmendjen e lexuesit dhe për qëllime krijuese.

Hartimi i fjalëkryqeve është një tjetër shembull i përdorimit në jetën e përditshme të fjalëve që janë të njëjta në të shkruar, por krejtësisht të ndryshme në kuptim. Të qenurit, plotësisht i ndërgjegjshëm për numrin e madh të homografeve në gjuhën angleze përbën një avantazh të jashtëzakonshëm në zgjidhjen e fjalëkryqeve. Formula më e zakonshme është ajo e paraqitjes së një çelësi dy-pjesësh, përgjigjja e të cilit është një çift homografik. P.sh., në një fjalëkryq çelësi është *motionless* (i palëvizshëm), *even now* (akoma). Nën ndikimin e homonimisë ne menjëherë përgjigjemi *still* (i palëvizshëm / akoma).

Fjalëkryqet kanë vlerë praktike në të mësuarin e gjuhës angleze si për vendasit ashtu edhe për të huajt.

Duke e përdorur anglishten vazhdimisht, familiarizohemi me forcën e homografisë për të nxitur keqkuptimin. P.sh., në qoftë se ne shkruajmë “I can’t bear children” (Unë nuk mund të duroj dot fëmijë. / Unë nuk mund të mbart dot fëmijë.), si do mund të kuptohemi duke u nisur vetëm nga ky informacion? Ndoshta duke qënë ballë për ballë mund të ndihmoheshit nga faktorë jashtëgjuhësorë. Pra, folësit e anglishtes ndeshen me homografinë në komunikimin e tyre të përditshëm.

Në gjuhën angleze, homografet ndeshen edhe në gjuhësinë kompjuterike (Natural Language Processing). Fusha (Word-Sense Disambiguation) e qartësimi të kuptimit të fjalës i dedikohet zhvillimit të mjeteve software, të cilat do të ndihmojnë kompjuterat në identifikimin e kuptimit aktual, konkret të fjalës. Kur ne lexojmë fjalinë “They couldn’t play cricket because they didn’t have a bat” (Ata nuk mund të luajnë kriket / gjinkalla sepse ata nuk kanë shkop.), sigurisht që e para gjë që na vjen në mendje është *sporti kriket* dhe jo *gjitari i vigël me krahë (gjinkalla)*. Kjo çështje krijon një pengesë të vërtetë për shkencëtarët që merren me pjesën software të përkthimit, sepse është më se e sigurt se homografet e një gjuhe nuk do të pasqyrohen si homografe në një gjuhë tjetër. Një përkthyes, i cili do të përpiquej të përkthente fjalinë e mësipërme, padyshim që do të ndeshte në vështirësi.

Fjalitë e mëposhtme janë disa shembuj më tepër mbi homografet dhe tregojnë qartë një prej arsyeve pse anglishtja është e vështirë për t’u mësuar.

- We must *polish* the *Polish* furniture. (Ne duhet t’i japim *shkëlqim* mobiljes *polake*.)
- The dump was so full that it had to *refuse* more *refuse*. (Koshi ishte aq plot sa nuk mund të mbante më *mbeturina*.)

---

<sup>378</sup>Për më shumë tituj të tillë gazetash në gjuhën angleze shih:  
<http://www.kaos2000.net/archives/backpages/newheadlines.html>

- He could *lead* if he would get the *lead* out. (Ai mund të drejtonte në qoftë se do ta nxirrte *plumbin*.)
- The soldier decided to *desert* his *dessert* in the *desert*. (Ushtari vendosi të linte *ëmbëlsirën* e tij në *shkretëtirë*.)
- Since there is no time like the *present*, he thought it was time to *present* the present. (Meqënëse *tani* nuk kishte më kohë, ai vendosi të tregonte *dhuratën*.)
- I did not *object* to the *object*. (Unë nuk e kundërshtoj *objektin*.)

## 7.6. Llojet e kalambureve (Tipologji)

Vihet re që kalamburet janë të llojeve të ndryshme, si: homografike, homofonike, homonimike, të përbëra, kalamburet e quajtura “Tom Suifti” (Tom Swifty) etj. Krijimi i tyre shpesh bëhet për humor, por gjithashtu, edhe për të krijuar situata më serioze.

Kalamburet klasifikohen si më poshtë:

**7.6.1. Kalamburi homografik** shfrytëzon fjalë, të cilat shkruhen njësoj (homografe), por që kanë kuptime dhe shqiptim të ndryshëm. Për shkak të natyrës së tyre, ato bazohen më tepër te forma e shkruar se sa te shqiptimi, ndryshe nga kalamburet homofonike. Ato, gjithashtu njihen si kalambure heteronimike. Sjellim një shembull në gjuhë shqipe:

Heshtja ime

*Ari* prej *ari*.<sup>379</sup>

Loja e fjalëve ndërtohet mbi homografet e gjuhës shqipe: *ari* “emër kafshe” / *ari* “em. flori”.

Në gjuhën angleze në rastin e fjalisë “A dog having puppies on the sidewalk is considered to be *littering*”<sup>380</sup> (Një qen që ka lëshuar këlyshet në trotuar quhet ndotje), kemi një kalambur të vërtetë homografik, sepse *is littering* “qeni është duke lindur këlyshet” dhe, gjithashtu, *is littering*, “është duke lëshuar mbeturina jo në vendin e duhur në trotuar”.

**7.6.2. Kalamburi homofonik** është një lloj i zakonshëm, i cili përdor grupet e fjalëve që tingëllojnë ngjashmërisht (homofonet) por që nuk janë sinonime. Uoltër Redfern-i (Walter Redfern) shprehet për këtë grup: “Të luash me fjalët do të thotë t’i trajtosh homonimet si sinonime”.<sup>381</sup>

<sup>379</sup> Belliu, I. *Murgu i muzgut*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2005, f. 85.

<sup>380</sup> Shih <http://www.wisegeek.com/what-are-the-different-types-of-puns.htm>

<sup>381</sup> Redfern, W. *Puns*, Blackwell, London, 1984, f.86.

Homofonet, fjalë që përputhen vetëm në shqiptim janë të rralla në gjuhën shqipe. E kemi përmendur edhe më parë që ato vërehen kryesisht në ligjërimin dialektor. Për këtë arsye është e vështirë të gjesh një kalambur të këtij lloji.

Në gjuhën angleze shembujt janë të shumtë. Për shembull, në thënien e Xhorxh Karlin-it (George Carlin) “Atheism is a *non-prophet* institution”<sup>382</sup> (Ateizmi është një institucion *jo -profetik/jo-fitimprurës*) fjala *prophet* “profet” përdoret në vend të homofonit të saj *profit* “përfitim”, duke sjellë ndryshim në pjesën e fjalisë “institucion *jo-fitimprurës*”. Në mënyrë të ngjashme ndërtohet edhe shakaja e mëposhtme:

Question: Why do we still have troops in Germany?

Answer: To keep the Russians in *Czech*.<sup>383</sup>

(Pyetja: Pse kemi akoma trupa në Gjermani?)

Përgjigjja: Për t’i mbajtur rusët në *Çeki* /në kontroll)

Ajo ndërtohet mbi paqartësinë në shqiptim të homofoneve *check* “kontrolloj” dhe *Czech* “Çeki”.

Shpesh, kalamburet nuk janë domosdoshmërisht homofonike, por ato luajnë me fjalë që shqiptohen në mënyrë të ngjasme, jo identike. Për shembull,

“I think so, Brain, but if we give *peas* a chance, won’t the lima beans feel left out?”<sup>384</sup> (Unë kështu mendoj, Tru, por në qoftë se ne i japim *bizeles/paqes* një mundësi, a nuk do të ndiheshin farat e limonit të lëna pas dore?)

Në këtë shembull luhet me shqiptimin e ngjashëm por jo identik të fjalëve *peas* “bizele” dhe *peace* “paqe”.

Disa fjalë janë homofone vetëm në dialekte të caktuara. Ja disa shembuj kalamburesh që varen nga mënyra si shqiptohen fjalët në dialekte të ndryshme:

*Ceasar* salad / *scissor* salad (sallatë çezar / sallatë gërshërësh)

Customer: I’d like a *Ceasar* salad.

Italian waiter: Sir! Are you sure you want the *Scissor* salad? You’ll cut your mouth.

(Klienti: Do të dëshiroja një *sallatë çezar*.

Kamarieri italian: Zotëri! A jeni i sigurt që doni *sallatë me gërshërë*? Do të prisni gojën.)

<sup>382</sup> Shih [http://en.wikipedia.org/wiki/George\\_Carlin](http://en.wikipedia.org/wiki/George_Carlin)

<sup>383</sup> Shih <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>

<sup>384</sup> [Pinky and the Brain, Tv Series 1995 -1998.] Cituar po aty.

The *Nail River* / The *Nile River*

(Lumë gozhdësh / Lumi Nil)

Në gjuhën angleze kalamburet homofonike janë me të lehta për tu ndërtuar, sepse ato krijohen mbi fjalë që vetëm shqiptohen njësoj dhe jo te një fjalë e vetme polisemantike. Kalamburet homofonike janë ndërtuar për të përfituar nga kuptimet e të dyja termave, për shembull, fjalia e gjuhës angleze “Joey is crying because he got hit by a *bawl*/*ball*”<sup>385</sup> mund të nënkuptojë dy gjëra të ndryshme. (Xhoi është duke qarë sepse u godit nga *një top*) ose (Xhoi është duke qarë sepse atij *i qahej*).

**7.6.3. Kalamburi homonimik** është një tjetër lloj i zakonshëm, i cili shfrytëzon fjalë, që janë së bashku, homografe dhe homofone.

Në gjuhën shqipe mund të sjellim shumë shembuj. Për shembull, Ismail Kadare për të përshkruar Shqipërinë luan me homoformat *re* (folje) dhe *e re* (mbiemër).

Vetëm ti në grackë

Shqipëri nuk *re*

E vogla *vigane*

E moçmja *e re*.<sup>386</sup>

Edhe Fatos Arapi luan me homoformat *Tiranë* “kryeqyteti i Shqipërisë” dhe *tiranë* “të pamëshirshëm”.

Në *Tiranë*, ka vetëm *tiranë*.<sup>387</sup>

Ali Asllani, gjithashtu, ndërton një lojë fjalësh me homoformat *u vesh* (folje) dhe *vesh* (emër).

Sonte u bë nuse, dhe *u vesh*, u ngjesh

Edhe Hanks Halla diç i tha në *vesh*!<sup>388</sup>

Pohimi i gjuhës angleze “Being in politics is just like playing golf: you are trapped in one bad *lie* after another”<sup>389</sup> (Të merresh me politikë është si të luash golf:

<sup>385</sup> Shih <http://www.wisegeek.com/what-are-the-different-types-of-puns.htm>

<sup>386</sup> Kadare, I. *Koha*, Vëllim poetik, Tiranë, 1976, f.95.

<sup>387</sup> Arapi, F. *Eklipsi i ëndrrës*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002, 129.

<sup>388</sup> Asllani, A. *Hanks halla*, Botimet “Kristo Luarasi”, Tiranë 1942, f. 133.

<sup>389</sup> Shih <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>



ju jeni bllokuar nga një *gënjeshër* / *rehati* pas një tjetre.) Këtu luhet me homoformat *lie I* “gënjeshër” dhe *lie II* “të rrish shtrirë, rehat”.

Një kalambur homonimik mund të jetë, gjithashtu, polisemik, dmth., fjalët mund të jenë homonimike por, gjithashtu, të zotërojnë kuptime të përafërta, një kusht ky, i cili është shpesh subjektiv.

**7.6.4. Kalamburi i përbërë** është një shprehje që përmban dy ose më shumë kalambure. Për shembull, pohimi kompleks i Riçerd Weitli-t (Richard Whately) përfshin katër kalambure:

“Why can a man never starve in the Great Desert?

Because he can eat the *sand which* is there.

But what brought the sandwiches there?

Why, Noah sent *Ham*, and his descendants *mustered* and *bred*.”<sup>390</sup>

“Pse një burrë asnjëherë nuk vdes urije në shkretëtirë?

Sepse ai mund të hajë *rërën* / *sanduiçet që ndodhet/n* aty.

Po ç’hyjnë sanduiçet këtu?

Pse, Noah dërgoi *Ham/proshutën* dhe pasardhësit e tij *të mbledhur/mustardën* dhe *të edukuar/bukën*.”

Ky kalambur përfshin: *sand which is there* / *sandwiches there* “rëra që ndodhet aty/sanduiçet që ndodhen aty”, *Ham/ham* “emër njeriu / proshutë”, *mustered* / *mustard* “të organizuar / mustardë”, dhe *bred/bread* “i edukuar/ bukë”.

Edhe Dagllas Adams (Douglas Adams) në vargun e mëposhtëm, kombinon brenda një konteksti kalamburin homofonik me atë homografik.

You can *tune* a guidar, but you can’t *tuna* fish. Unless of course, you play *bass*.<sup>391</sup>

(Ti mund të *akordosh* një kitarë, por ti nuk mundesh një *peshk ton*. Dhe sigurisht në qoftë se ju nuk luani në /me *bas*.)

Kjo shprehje përdor cilësitë homofonike të *tune a* “akordoj një” dhe *tuna* “peshk ton”, po ashtu përdor kalamburin homografik të fjalës *bass*, tek i cili paqartësia ngrihet mbi formën e njëjtë të shkruar të *bass* [‘beis] instrument muzikor me tela dhe *bass* [’bæs] lloj peshku.

<sup>390</sup> [Tartakovsky, J. Pun for the ages, The New York Times, 28 March 2009.] Cituar po aty.

<sup>391</sup> Po aty.

**7.6.5.** Në rastin e **kalamburit të përsëritur**, aspekti i dytë i një kalamburi mbështetet në të kuptuarit e një elementi në aspektin e parë. Në gjuhën shqipe Naim Frashëri përsërit homonimet *parë* (folje) dhe *parë* (rrethanor) brenda një fjalie:

E kini *parë* më *parë*.<sup>392</sup>

Edhe Fan Noli përsërit homonimet *dhe* (lidhëzë) / *dhe* (folje) / ***dhe*** (emër) brenda të njëjtit kontekst.

Pasuri *dhe* liri *dhe* fuqi ti na *dhe*

Përmbi ***dhe***, përmbi fron, përmbi qiell u bekoftsh.<sup>393</sup>

Në pohimin e gjuhës angleze “ $\pi$  is only half a *pie*.”<sup>394</sup> ( $\pi$  është vetëm gjysma e një byreku)  $\pi$  është 180 gradë, gjysmë rrethi dhe një byrek është një rreth i plotë. *Pie* dhe shenja  $\pi$  shqiptohen njësoj në gjuhën angleze dhe si rrjedhim, ato krijojnë një kalambur të përsëritur.

Një shembull tjetër është “*Infinity* is not *in finity*.”<sup>395</sup> (Infinit nuk është fundi.) Edhe këtu luhet me përsëritjen e homofoneve *infinity* “një varg i pafund” dhe *in finity* “në fund”.

**7.6.6. Kalamburet vizuale** përdoren në shumë logo, emblema, shenja dalluese dhe simbole të tjera grafike, të cilat një ose më shumë aspekte të kalamburit zëvendësohen me një pamje.

Një lloj i veçantë i kalamburit visual ekziston në gjuhët, të cilat përdorin shkrimin jofonetik. Për shembull, në gjuhën kineze, një kalambur mund të bazohet në ngjashmërinë e formës së karakterit të shkruar, pavarësisht mungesës së plotë të ngjashmërisë fonetike të fjalëve që krijojnë këtë lojë.<sup>396</sup> Mark Ellvin-i (Mark Elvin)<sup>397</sup> e ka përshkruar se si kjo “formë e veçantë kineze e kalamburit visual përfshinte krahasimin e karaktereve të shkruara me objektet.”<sup>398</sup>

**7.6.7.** Në përgjithësi, **kalamburet humoristike** ndërtohen për të argëtuar atë që i krijon ato si dhe audiencën e tij duke luajtur me fjalorin dhe kontekstin. Ato i gjejnë

<sup>392</sup> Frashëri, N. *Vepra të zgjedhura*, Akademia e Shkencave e RPSSH, 1985, f.229.

<sup>393</sup> Noli, F. *Album*, Boston, Mass. 1966, f. 20.

<sup>394</sup> Shih <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>

<sup>395</sup> Po aty.

<sup>396</sup> [Attardo, S. *Linguistic Theories of Humour*, 1994, fq. 109; Gruyter, W. dhe Allenton, V. *L'écriture Chinoise*, Paris, 1970.] Cituar po aty.

<sup>397</sup> (John) Mark (Dutton) Elvin është Profesor i Merituar i Historisë Kineze në Universitetin Kombëtar Australian në Kambera, Australi. [http://en.wikipedia.org/wiki/Mark\\_Elvin](http://en.wikipedia.org/wiki/Mark_Elvin)

<sup>398</sup> [Elvin, M. *The Spectrum of Accessibility: Types of Humor and the Destinies of the Flowers in the Mornor*, fq. 113. Te Roger T. Ames (et al.): *Interpreting Culture through Translation: a Festschrift for D. C. Lau*. 1991, f. 101–118.] Cituar po aty.

në komedi, filma, libra e tregime humoristike. Lojërat gazmore që ndërtohen mbi lojërat e fjalëve janë, gjithashtu, një mjet që mësuesit e përdorin shpesh. Duke i mësuar lexuesit e rinj të luajnë me fjalët, ata shpresojnë t'ju nxisin atyre një vlerësim për leximin dhe fjalorin.<sup>399</sup> Për shembull,

Duket nga një herë zëri e lëndon,  
Frëngu rri i qetë ose do bërtasë  
Nusja e humbet dhe i *vete* pas,  
Frëngu e ngre zërin edhe sokëllin  
Nusja e lë perin edhe vërshëllin:  
Ai flet me *vete*, e flet përçart  
Nusja s'është në *vete*, bëhet më e zjarrtë!<sup>400</sup>

Këtu Ali Asllani krijon lojë fjalësh me homonimet *vete I* fol. dhe *vete II* përem. vetv.

**7.6.8.** Ndërsa **kalamburet serioze** letrare i japin një kuptim të thellë kontekstit. Krijimi i tyre në vepra të mëdha letrare është një punë e jashtëzakonshme e krijësve të tyre të përkushtuar. Në shembullin e mëposhtëm Petro Marko përdor stilistikisht homonimet *dhe I* lidh. dhe *dhe II* em. për të shprehur nota serioze.

“Hekurat do shkrijnë bashkë me zinxhirët *dhe* unë mund të shkrihem nën *dhe*.”<sup>401</sup>

Një nga kalamburet më të famshme dhe serioze të gjuhës angleze gjendet në rreshtin e parë të veprës së Uilliam Shekspir-it, “*Rikardi i III*”:

“Now is the winter of our discontent made glorious summer by this *son* of York”<sup>402</sup>  
(Tashmë dimri i pakënaqësisë sonë u bë një verë e lavdishme nga *biri /dielli* i Jorkut.”

Në këtë fjali shkrimtari i referohet Eduardit IV, birit të Dukës së Jorkut, fronin e të cilit Rikardi III sapo e ka marrë. Duke luajtur me homofonet *sun* “bir” dhe *sun* “diell”, autori i drejtohet së bashku, simbolit të *diellit* të veshur nga Eduardi IV, *biri* i Dukës së Jorkut dhe *diellit* që e ktheu dimrin e pakënaqësisë në një verë të lavdishme.

<sup>399</sup> Shih <http://www.wisegeek.com/what-are-the-different-types-of-puns.htm>

<sup>400</sup> Asllani, A. *Hanko halla, Botimet*” Kristo Luarasi”, Tiranë 1942, f. 120 – 121.

<sup>401</sup> Marko, P. *Nata e Ustikës*, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja, Tiranë, 1999, f. 232.

<sup>402</sup> Shih <http://www.wisegeek.com/what-are-the-different-types-of-puns.htm>

## 7.7. Përdorimi i kalamburit

### 7.7.1. Në komedi dhe në shaka

Kalamburet janë një burim i zakonshëm humori në krijimin e shakave dhe komedive. Ato përdoren që në fillim të një shfaqjeje dhe i japin kuptim humoristik një historie që të lë pa fjalë.

Kalamburet shpesh përdoren në titujt e parodive. Një parodi është një film muzikor, të cilit ndodh t'i vihet një titull që godet atë që ironizohet dhe kjo shpesh arrihet duke zëvendësuar disa nga fjalët, me të tjera që tingëllojnë njësoj ose duken të ngjashme. Për shembull, grupet *collegiate a capella*<sup>403</sup> shpesh emërtohen sipas kalambureve muzikore për të tërhequr fansat me anë të notave të humorit. Një titull i tillë komunikon se ajo që po vjen është një parodi dhe se çfarë do të vihet në lojë në këtë parodi, duke i bërë të panevojshme prezantime të tjera me karakter shpjegues.<sup>404</sup>

### 7.7.2. Në letërsi

Kalamburi është një formë popullore e lojës së fjalës të cilës cila një fjalë është zëvendësuar nga një fjalë e ngjashme, në të shumtën e rasteve për efekt humoristik. Kalamburi përkufizohet si lojë me tingujt e fjalëve për të arritur një qëllim të caktuar. Me fjalë të tjera, një kalambur mund:

- të na bëjë të qeshim
- të na bëjë të mendohemi
- të rrisë shkallën e qartësisë kur përpiqemi të hyjmë në kuptimin e një teksti
- të sjellë paqartësi

Shumë prej tyre krijohen me homofone (fjalë që shqiptohen njësoj).

Roli i lojës së fjalëve në letërsi shkon pas mijëra vjet më parë dhe përfshin shumë gjuhë të lashta dhe moderne. Disa njerëz e urrejnë atë si fenomen dhe si të tillë e përshkruajnë si “formën më të ulët të humorit”. Kalamburi në veprat letrare kontribuon në mënyrën si teksti mund të interpretohet dhe mpreh zgjuarsinë e personazheve e të autorëve të tyre. Shkrimtarë të mëdhenj si Uilliam Shekspir-i, Oskar Wajëld-i dhe Xheims Xhois-i i përdoren kalamburet në letërsi duke krijuar efekte të fuqishme. Ato përdoren për efekte komike, si një mënyrë për të fshehur një shaka, një fyerje, ose si pjesë e një strategjie më të gjerë të përdorimit kreativ të gjuhës.

Lojërat e fjalëve janë regjistruar në format më të hershme të gjuhës së shkruar, përfshi hieroglifet egjiptiane dhe shkrimin e Sumerëve të lashtë. Kjo tregon që loja e fjalëve është një formë arti shumë e vjetër.

<sup>403</sup> *Collegiate a cappella* (ose college a cappella) janë grupe kolegjii që këndojnë dhe performojnë pa instrumenta muzikorë, [http://en.wikipedia.org/wiki/Collegiate\\_a\\_cappella](http://en.wikipedia.org/wiki/Collegiate_a_cappella)

<sup>404</sup> Shih <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>

Jo të gjithëve ju pëlqente përdorimi i lojës së fjalëve. Në një libër mbi Shekspir-in, dijetari dhe shkrimtari i shekullit XVIII, Samuel Xhonsën ankohej për përdorimin e shpeshtë të lojës së fjalëve nga Bard-i. Një tjetër kritik i lojërave të fjalëve në letërsi ishte poeti laureat i shekullit XVII, Xhon Drajden-i (John Dryden), i cili është i pari që i quajti lojërat e fjalëve “forma më e ulët e mençurisë”. Ndërsa shkrimtari amerikan Ambroi Birs-i (Ambrose Bierce), i cili njihej për zgjuarsinë e tij thumbuese, pranoi se të zgjuarit tërhiqen për të krijuar lojëra fjalësh, ndërsa budallenjtë i synojnë ato.<sup>405</sup>

Megjithatë, përdorimi i lojërave të fjalëve në letërsi është mjaft i përhapur dhe përfshin disa nga mjeshtrit më të famshëm të fjalës në gjuhën angleze. Vladimir Nabokov-i, mjeshtër i letërsisë ruse dhe angleze, shpesh përdorte kalambure dhe lojëra të tjera fjalësh, duke i dhënë punës së tij nivelet më të thella të domethënies tekstuale. Kjo lloj dinakërie letrare u përdor nga shkrimtarë të mëvonshëm, si: Tomas Pinçën-i (Thomas Pynchon) dhe Alan Mor-i (Alan Moore). Ashtu si Nabokov-i edhe Xhejms Xhois-i pëlqente të krijonte fjalë të reja duke copëtuar dhe kombinuar fjalë ekzistuese dhe duke luajtur me ndërtimin dhe etimologjinë e tyre. Xhois-i e quante këtë praktikë “ngjeshje etimologjike”.<sup>406</sup>

Lojërat e fjalëve në poezi kanë një shumëllojshmëri përdorimesh dhe mund të jenë të pafundme. Ajo mund të përdoret thjesht për efekt komik ose mund të përcjellë një ndjesi të ironisë.

Shumë poetë anglezë të shekullit XVII, hulumtuan përdorimin e kalamburit për efekt ironie. Uilliam Shekspir-i është ndoshta krijuesi më i famshëm i lojërave të fjalëve në letërsinë angleze. Ai përdori brenda të njëjtës vepër kalambure të pahijshme, “të trasha” dhe serioze. Për shembull, Hamleti, personazhi i tij maniak, që i dashuron lojërat e fjalëve, i thotë Ofelias në një prej skenave: “Get thee to a nunnery!” (Shko në një *manastir / bordell*). Fjala ‘nunnery’ në këtë fjali mund të nënkuptojë ose “convent / manastir” ose kuptimin deri diku të vjetëruar “bordello, shtëpi publike”. Audiencia moderne mund të mos e kuptojë këtë lojë fjalësh, por publiku i kohës së Shekspir-it do të dëgjonte me vëmendje gjithë ironinë thumbuese të një rreshti të shkurtër, që shpreh zemërimin e Hamletit dhe dëshirën e fshehur për të goditur Ofelian. Brenda të njëjtës vepër gjejmë lojëra fjalësh që shpalosin temën e vdekjes dhe të seksualitetit, duke kundërshtuar idenë se kalamburet nuk mund të sjellin kuptim përtej thellësisë së lojës bazë të fjalëve.<sup>407</sup>

Në shkrimet moderne poetike lojërat e fjalëve përdoren me shpesh në formën poetike *limerick* “poemë me pesë vargje”. Poetja e fillimit të shekullit XX Kerëlain Uells-i (Carolyn Wells) shkroi një *limerick* që u mbyll me këtë varg:

“To tutor two tooters to toot.”

Ajo punoi me tingujt për të luajtur me çiftin homofonik *tutor* “të japësh mësim” dhe *toote* “dikush që luan një instrument muzikor”. Loja e fjalëve në një *limerick* nuk është aq e pafajshme sa duket. Autorët e kësaj kohe shpesh luajnë edhe me eufemizma të gjuhës angleze që lidhen me trupin dhe aktin seksual.<sup>408</sup>

<sup>405</sup> <http://www.wisegeek.com/what-is-the-role-of-puns-in-literature.htm>

<sup>406</sup> Po aty.

<sup>407</sup> <http://www.wisegeek.com/what-is-the-role-of-puns-in-poetry.htm>

<sup>408</sup> Po aty.

Në letërsinë moderne, që nga seritë e Xheims Bond-it (James Bond) deri tek librat e Heri Poter-it (Harry Potter), autorët e kanë përdorur kalamburin për të argëtuar lexuesit.

### 7.7.3. Në retorikë

Kalamburet mund të funksionojnë si mjete retorike, të cilat shërbejnë si instrumente bindëse të autorit ose folësit. Megjithëse kalamburet shpesh janë perceptuar si klishe<sup>409</sup>, nëse një kalambur përdoret në mënyrë të ndërgjegjshme "... ai mund të jetë një mjet i efektshëm komunikimi në një shumëllojshmëri situatash dhe formash<sup>410</sup>. Vështirësia më e madhe e përdorimit të kalamburit në këtë mënyrë është se kuptimi i tij mund të interpretohet në mënyra të ndryshme sipas nivelit të audiencës dhe mesazhit që transmetohet<sup>411</sup>.

Për shembull, fjalimi i Xhon Kenedi-t (John Kennedy) në qershor të vitit 1963 në Republikën e atëhershme Federale të Gjermanisë, dy vjet pasi u ngrit muri i Berlinit, konsiderohet një fjalim frymëzues për popullin e Berlinit Perëndimor, i cili shpresonte për një Gjermani të bashkuar. Studiuesit mendojnë se Kenedi krijonte kalambure të paqëllimta. Ja një kalambur i përdorur prej tij në këtë fjalim: *Ich bin ein Berliner*. Qëllimi i shprehjes ishte të nënkuptonte "Unë jam një qytetar i Berlinit" por ndodhi që shprehja u keqpërkthye për humor si: "Unë jam një *petull me xhelatinë*", ku fjala *Berliner* është emri i një ushqimi të zakonshëm që përdorej në mëngjes në Berlinin e atyre viteve<sup>412</sup>. Ky shembull tregon lirshmërinë e një kalamburi të paqëllimtë ndërsa qëllimi i përdorimit të shprehjes është akoma i diskutueshëm.<sup>413</sup>

### 7.7.4. Në emërtime

Kalamburet, në përgjithësi, tërheqin vëmendjen dhe fiksohen në kujtesë. Për këtë arsye ato përdoren në tituj, emra vendesh / personazhesh / organizatash, reklama dhe slogane<sup>414</sup>.

Shumë lojëra fjalësh janë përfshirë në emërtime produktesh ose shërbimesh të njohura. Lojëra të tilla fjalësh jo vetëm që tërheqin vëmendjen e publikut por edhe ndriçojnë emrin e firmës. Në posterat reklamë ato shërbejnë njëkohësisht edhe për arsye estetike, duke sjellë humor dhe lënë mbresë në kujtesë.

---

<sup>409</sup> klishe (cliché ose cliché) është një shprehje, ide ose element i një pune artistike, i cili është përdorur aq shumë sa e ka humbur kuptimin e tij të originalit dhe madje deri në atë pikë sa është bërë irritues ose i rëndomtë, pa harruar që kohë më parë ajo konsiderohej e re dhe kuptimplotë, <http://en.wikipedia.org/wiki/Cliché>

<sup>410</sup> [Junker, D. *In defense of puns: How to use them effectively*, Public Relations Tactics, Shkurt 2013, f. 18.] Cituar te <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>

<sup>411</sup> [Djafarova, E. *Why do advertisers use puns? A linguistic perspective*, *Journal of Advertising Research*, Qershor 2008, f. 267 – 275.] Cituar po aty.

<sup>412</sup> [Lehmann-Haupt, Ch. *Books of the times, te The New York Times*, 27 Shatator 2013.] Cituar po aty.

<sup>413</sup> [Eichhoff, J. *'Ich bin ein Berliner'*, te *A History and a Linguistic Clarification*", Monatshefte, Pranverë 1993, f. 71-80.] Cituar po aty.

<sup>414</sup> [*The art and science of the advertising slogan*, Adslogans.co.uk., 20 Dhjetor 2011.] Cituar te <http://leo.aichi-u.ac.jp/~goken/bulletin/pdfs/No16/03AbassF.pdf>

Shumë emra restorantesh dhe dyqanesh përdorin kalamburin homofonik. Në gjuhën e përditshme angleze, emrat e dyqaneve janë rasti më i spikatur i homofoneve. Një numër i madh dyqanesh ku shitet peshk dhe patate të skuqura kanë mbi dyert e tyre të shkruar, p.sh., *Nice Plaice* “Peshk i mirë / Vend i mirë”; *The frying Plaice* “Peshk i skuqur / Vend i skuqur”; *Fish Plaice* “Peshk / Vendi i peshkut” etj. Në këta shembuj luhet me homofonet *plaice* “lloj peshku” dhe *place* “vend”. E njëjta prirje për të luajtur me fjalët shihet në emrat e dyqaneve të rrobaqepësve, p.sh., *Sew Fantastic* “Qep shkëlqyeshëm” / “Duket fantastike”; *Sew and Sew* “Qep e qep” / “Shiko e shiko”; *Sew Amazing* “Qep shumë mirë” / “Duket një mbrekulli” etj. Në këta shembuj përdoren homofonet *sew* “qep” dhe *saw* “shikoj”. Dyqane mobiljesh emërtohen, gjithashtu, duke përdorur homofone, si p.sh., *Home Suite Home* “Shtëpi e ëmbla shtëpi” / Një suite si shtëpi”; *The suite shop* “Dyqani i ëmbël” / “Dyqani suite”; *Suite dreams* “Ëndrrat e suitës” / “Gjumë të ëmbël” etj. Këto emërtime ndërtohen me homofonet *suite* “suite” dhe *sweet* “i, e ëmbël”. Emri i dyqanit të mishit *Meat at the corner* mund të nënkuptojë “Mish te cepi” ose “Takohe mi te cepi”, ku luhet me homofonet *meat* “mish” dhe *meet* “takoj”. Ndërsa emërtimi i flokëtores *Curl up and die* mund të kuptohet në dy mënyra “Dridhu dhe lyeju” ose “Dridhu dhe vdis”, ku shfrytëzohen homofonet *die* “vdes” dhe *dye* “lyej flokët”.

Po ashtu edhe në tituj librash e filmash përdoret homonimia dhe vlerat e saj stilistikore. Për shembull, si titull filmi sjellim rastin e dramës amerikane (1997) *Good Will Hunting* ku Will Hunting (Will Hunting) është emri i një personazhi të saj, një punëtor 20 vjeçar nga Bostoni jugor dhe gjeni i panjohur.<sup>415</sup> Në qoftë se e përkthejmë në shqip, titulli do të ishte *Will Hunting-u i mirë*. Por pa e njohur kontekstin, titulli mund të merrej në dy kuptime të tjera: *Willi i mirë ka dalë për gjah* ose *Dëshira e mirë për të dalë për gjah*.

Emra personazhesh po ashtu sjellin lojë fjalësh, siç janë: *Ash Ketchum*<sup>416</sup>, emri i të cilit është shkurtim i emrit në japonisht *Satoshi* dhe mbiemri i krijuar nga motoja e tij në gjuhën angleze “Gotta catch ‘em all” (do t’i kap të gjithë), kurse *Goku*<sup>417</sup> është personazhi kryesor në mediatikën *Dragon Ball*. Ai mund t’i referohet personazhit kryesor në mediatikën *Majmuni tajfun*; numërorit në japonisht 10<sup>48</sup>; titullit të një romani nga shkrimtari japonez Shimaki Kensaku etj.

Të dy janë protagonistë të serive të animuara *Pokémon* dhe *Dragonball*, që njihen për përfshirjen e një kuptimi të dytë në emrat e shumë prej personazheve të tyre. Në rastin e fjalës *Pokémon*, ajo ka disa kuptime që ndodh të krijojnë paqartësi, si: program mediatik japonez bazuar në një serial krijesash të mbledhura; serial lojërash për video; lojë me letra bazuar në lojrat për video; serial i animuar bazuar në lojëra për video dhe një kulturë e të rinjve në Kili.<sup>418</sup>

*Dragonball*, gjithashtu, karakterizohet nga paqartësia për shkak të kuptimeve të saj, si: program mediatik japonez; listë vëllimesh manga; serial i parë, i dytë, i tretë televiziv i animuar; listë filmash; listë lojërash për video; listë fonogramesh dhe një skicë mikro-kontrolluese.<sup>419</sup>

<sup>415</sup> [Shih [http://en.wikipedia.org/wiki/Good\\_Will\\_Hunting](http://en.wikipedia.org/wiki/Good_Will_Hunting)] Cituar te <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>

<sup>416</sup> [Shih [http://en.wikipedia.org/wiki/Ash\\_Ketchum](http://en.wikipedia.org/wiki/Ash_Ketchum)] Cituar po aty.

<sup>417</sup> [Shih [http://en.wikipedia.org/wiki/Goku\\_\(disambiguation\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Goku_(disambiguation))] Cituar po aty.

<sup>418</sup> Shih [http://en.wikipedia.org/wiki/Pokémon\\_\(disambiguation\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Pokémon_(disambiguation))

<sup>419</sup> Shih [http://en.wikipedia.org/wiki/Dragon\\_Ball\\_\(disambiguation\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Dragon_Ball_(disambiguation))

### 7.7.5. Përdorime konfuze dhe alternative

Kalamburi dhe teknika të tjera letrare siç është, për shembull, *double entendre*<sup>420</sup> (teknikë letrare që lidhet me dykuptueshmërinë e qëllimshme, ku një shprehje e artikuluar është krijuar për t'u kuptuar në dy mënyra) ndryshojnë pak nga njëra-tjetra. Zakonisht një prej tyre është shumë i dukshëm, ndërsa tjetri është më delikat. Kalamburi është thjesht një lojë e thjeshtë fjalësh për efekte komike ose reteorike, kurse një *double entendre* hedh dritë mbi një kuptim të dytë i cili nuk është i përfshirë në vetë shprehjen ose pohimin.

Ndërsa të dyja shfrytëzojnë përdorimin e qëllimshëm të kuptimeve të dyfishta, *kalamburet* mund të ndodhë të jenë *double entendre* dhe anasjelltas.<sup>421</sup>

Kalamburet mund të përdoren si një mjet i kujtesës për të rritur shkallën e të kuptuarit në një mjedis edukativ. Duke u përdorur mençurisht, kalamburet forcojnë përmbajtjen dhe ndihmojnë në ruajtjen e materialit.

### 7.8. Lloje të ndryshme lojërash ndërtuar mbi kalambure homonimike

Bazuar në lojën e fjalëve dhe kuptimet e dyfishta, lojërat me kalambure mund të jenë aktivitete të këndshme dhe që të angazhojnë. Mësuesit mund t'i përdorin lojërat me kalambur në klasë për të ndihmuar studentët të familjarizohen me përkufizimet e shumëfishta dhe gjuhën, në përgjithësi. Fëmijët dhe të rriturit në të njëjtën mënyrë mund të luajnë lojëra me kalambur në shtëpi, festa, udhëtimet e gjata me makinë dhe kudo tjetër virtualisht. Ekzistojnë lloje të ndryshme lojërash që bazohen te kalamburi (loja e fjalëve), si për shembull, lojëra me hamendësim, konkurse dhe lojërat “Rreth-e-Rrotull” (ku lojtarët i lënë rradhën njëri-tjetrit). Kur luhen në mënyrën e dukur, këto lojëra me kalambur çojnë në një të qeshur të madhe nga pjesëmarrësit e saj.

Disa lojëra me kalambur mund të përfshijnë shaka dhe gjëagjeza. Në këto lloj lojërash, një prej lojëtarëve mendon një gjeagjizë, përgjigja e së cilës përfshin një lojë fjalësh dhe për këtë pyetet pjesa tjetër e grupit. Lojtari i parë, i cili gjen përgjigjen e saktë, i kalon rradha për të pyetur me një gjeagjizë. Për shembull, një lojtar mund të pyesë në gjuhën angleze “How does the moon cut his hair” (Si i pret hëna flokët e saj?). Lojtarët duhet të mendojnë për një përgjigje të saktë “*Eclipse it*” (Duke eklipsuar). Kjo përgjigje ndërtohet mbi ngjashmërinë në shqiptim midis *eclipse* “bën eklips” dhe *he clips it* “ai ja kap me kapëse”.

Në rastin e grupeve konkurruese, lojërat me kalambur mund të përfshijnë një konkurs që të përfundojë me kalamburin më të mirë. Zakonisht, një person (në rolin e gjyqtarit) caktohet të zgjedhë një temë në mënyrë rastësore. Individëve ose grupeve të përfshira ju jepet një kohë e caktuar të mendojnë një lojë të zgjuar fjalësh. Gjyqtari atëherë do të lexojë ato që ka pranuar dhe do të vendosë për fituesin, bazuar në origjinalitetin e krijimit, humorin dhe ndonjë faktor tjetër. Për shembull, nëse tema është “Kafshët shtëpiake”, një prej skuadrave do të shkruante “The dog that gave birth on the side of the road was fined for *littering*.” (Qeni, i cili lindi në anë të rrugës, u

<sup>420</sup> Shih [http://en.wikipedia.org/wiki/Double\\_entendre](http://en.wikipedia.org/wiki/Double_entendre)

<sup>421</sup> Shih <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>



gjobua për hedhje mbeturinash / lëshim këlyshësh). Në këtë fjali luhet me përkufizimin e shumëfishtë të fjalës së gjuhës angleze *litter* “mbeturina” dhe “një tufë këlyshësh të porsalindur”.

Disa lojëra me kalambur përfshijnë një “Rreth-e-Rrotull” midis dy lojtarëve ose midis një grupi të madh, ku lojtarët me rradhë shpikin lojëra fjalësh dhe përpiqen t’ia lënë rradhën njëri-tjetrit. Në këtë lloj loje me kalambur, njëri prej lojtarëve sugjeron një temë, si për shembull, “Exercise” (ushtrim). Lojtarit tjetër do t’i duhet të shpikë një lojë fjalësh në moment, si p.sh., “The man *-fired* his personal trainer because he wasn’t working out.” (Burri *shkarkoi/pushkatoi* trajnerin e tij personal sepse ai nuk po përpiquej.) Ky lojtar pastaj duhet të sjellë një temë për kalamburin e lojtarit tjetër, e kështu me rradhë. Këto lojëra me kalambur janë shumë interesante për udhëtime të gjata, sepse ato mund të vazhdojnë pa fund ose deri sa lojës ‘i mbaron benzina’.

## 7.9. Paronomasia dhe përdorimi i saj stilistikor

Paranomazia është një nga figurat e fjalisë ashtu si, antiteza, kalamburi etj. Në gjuhën shqipe ajo njihet edhe me termin “paronimi”.

Gjatë hulumtimit të homonimisë nga pikëpamje të ndryshme, ndodh që të përmendet termi “paronomazi” ose “paronimi”. Lind pyetja: Ç’është paronomasia dhe ku qëndron lidhja e saj me homoniminë? Fenomeni “paronomazi” ndeshet si në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Paronimet janë të ngjashme me homonimet ose më saktë qëndrojnë midis homofoneve dhe homografeve.

Dukuria e paranomazisë ndodh kur një fjalë zëvendësohet me një fjalë tjetër që ndryshon etimologjikisht nga e para, por që është e afërt dhe e ngjashme me të përsa i përket shqiptimit. Ngjashmëria tingullore e fjalëve sjell ngatërrim në gjuhën e folur si p.sh., *hap* dhe *kap*; *blazë-a* dhe *bluzë-a*; *historik-e* dhe *histerik-e* etj. ose në anglisht *accept* “pranoj” - *except* “përjashtoj” - *expect* “pres”; *dawn* “agim” - *down* “poshtë”; *making* “*duke bërë*” - *mocking* “*tallës*”; *sport* “*sport*” - *spot* “*njollë*”; *seep* “*depërtoj*” - *sweep* “*fshij*” - *sleep* “*fle*” etj.

Këto fjalë kanë afërsi tingëllimi me njëra-tjetrën, ndërsa kuptimet leksikore të tyre janë krejtësisht të ndryshme. Pra, në kategorinë e paranomazisë futen fjalët që kanë karakteristika semantike të ndryshme. Mjaft studiues të huaj shprehin të njëjtin mendim në punimet e tyre. Leksikografi anglez Çarls T. Oniëns-i (Charles T. Onions) e përshkruan paranomazinë si “lojë fjalësh”<sup>422</sup>. E. Elstër-i (E. Elster) e përkufizon paranomazinë “si krahasim fjalësh të veçanta ose fjalësh analoge përsa i përket tingëllimit, me rrënjë krejtësisht të ndryshme”<sup>423</sup>. Tek “Everymen’s Encyclopedia” thuhet se “shpesh fjala *paranomazi* është ekuivalente përsa i përket kuptimit të saj me fjalën *kalambur*”<sup>424</sup>.

Zakonisht si paronime shumë gjuhëtarë, në shqip, marrin fjalë të afërta në shqiptim, por me rrënjë të përbashkët, madje që i përkasin të njëjtës pjesë ligjërata. P.sh., *bishtak* “enë me bisht” dhe *bishtuk* “kandil i thjeshtë”; *kullore* “enë me vrima”

<sup>422</sup> Onions, C. T. *The Oxford Dictionary of English Language*, Oxford at the Clarendon Press, 1966, f. 653.

<sup>423</sup> Elster, E. *Prinzipien der literaturwissenschaft*, 2, Brand, Stilistik Halle, 1911, f. 203.

<sup>424</sup> Dent, J. M. *Everyman’s Encyclopedia*, V. 9, 1958, f. 492.

dhe *kullomë* “llum që bie nga një lëng në fund të enës” ,si edhe *ditar – ditor; egërsi – egërsirë; mishërim – mëshirim; afrojt – ofroj; simulant – stimulant; session – seksion – sezon etj.*

Fenomenin e paranomazisë e gjejmë më shumë në lojrat satirike dhe komike të fjalëve, që marrin emrin kalambure, ku loja me fjalë bazohet në lojën e kombinimeve të tingëllimit të tyre.

Siç vihet re, paranomazia kushtëzohet nga prania e detyruar e fjalëve me rrenjë të ndryshme leksikore me tingëllim të përafërt. Pra, paronomasia është afërsi fjalësh nga ana fonetike.

Paranomazia realizohet ose qëllimisht ose nga zëvendësimi rastësor, qoftë edhe i një tingulli ose i një rrokjeje me të tjera, që shpesh janë homofonike. Ka raste kur harmonia e fjalëve paronomazike lind nga pakujdesia e të folurit ose nga moskuptimi i fjalëve të përdorura, p.sh., “Aeroplani do të na çojë në *kontigjentin* tjetër” në vend të fjalës “*kontinent*”<sup>425</sup>.

Si një mjet i përsosur i të shprehurit artistik, paronomasia përdoret në parodi, komedi, përralla, fjalë të urta etj.

Gjatë përdorimit të paranomazisë vërehet një ndarje e mendimit, e cila reflektohet menjëherë në bisedë, shpesh me paramendim, me qëllim për të krijuar një situatë komike ose satirike. Sa më e thellë të jetë ndarja e mendimit, aq më qartë shfaqet paronomasia.

Ka edhe raste kur fenomeni i paranomazisë krijon pa qëllim fjalë që nuk kuptohen ose që shpëtojnë pa dashje kur ngatërrohet fjala në gojë. Arsyet e ngatërimit mund të jenë fonetike, morfologjike dhe gojore. Jo gjithmonë gjatë paranomazisë të dy fjalët dalin në shesh: fjala paralele shpesh nënkuptohet. Por pavarësisht kësaj, gjatë paranomazisë të dyja fjalët janë afër njëra-tjetrës.

\* \* \*

Paranomazia, ngjashmëria tingullore e fjalëve sjell përshtjellim në gjuhën e folur. Ajo vepron me dinamizëm në gjuhën e gjallë dhe me forcën e saj shprehëse përdoret me qëllime stilistikore për humor, lojëra fjalësh, përshtjellim të qëllimshëm etj. Për shembull, Ismail Kadare shkruan:

- Më ka rrëmbyer *romanin*, - u përgjigja unë.

- Po pse, për një copë *koromane* ngrite mëhallën në këmbë, o i paudhë... Po pse, për një *kroman* apo *toroman* a shejtan vjen e na bën gjullurdi!”<sup>426</sup>

Në anglisht e gjejmë të përdorur nga Eduard Forset-i (Edward Forsett):

<sup>425</sup> Kornelja, S. Beatrice, K. *Paronimet në gjuhën e sotme shqipe*, te *Studime Filologjike*, Tiranë, 1992, f. 99.

<sup>426</sup> Kadare, I. *Koha e shkrimeve*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1986, f. 56.

- As I am being mocked, I am not *mocking* or *making* fun of our grave professors”.<sup>427</sup>

(Unë po vihem në lojë, por ama nuk po vë aspak në lojë apo të bëj humor me profesorët tanë seriozë”.

Luis Kerëll-i e përdor disa herë paroniminë për të shkaktuar dykuptimësi në veprën “Liza në Botën e Çudirave”. Për të përshkruar profesionin e mësuesit, autori L. Kerëll-i luan me paroniminë *tortoise* “breshkë” dhe *taught us* “na mësoi” që tingëllojnë njëllot.

“Why did you call him *Tortoise*, if he wasn’t one?” Alice asked.

“We called him *Tortoise* because he *taught us*,” said the mock Turtle angrily: ‘really you are very dull!’<sup>428</sup>

(Kapitulli IX. *The Mock Turtle’s story*, f. 43)

“Of course not,” said the Mock Turtle: “why, if a fish came to ME, and told me he was going a jorney, I should say “With what *purpose*?”

“Don’t you mean “*purpose*”?” said Alice.

“I mean what I say,” the Mock Turtle replied in an offended tone.<sup>429</sup>

(Kapitulli X. *The Lobster Quadrille*, f. 48)

Në këto fjali paronimia qëndron te tingëllimi i njëjtë i fjalëve *porpoise* “delfin” dhe *purpose* “qëllim”, ku Breshka e Rreme nuk e pranon kuptimin sipas Lizës, por siç do ajo vetë.

## 7.10. Shembuj homonimesh në vepra të letërsisë shqipe

Autorët e mëposhtëm janë renditur në mënyrë kronologjike

### PASHKO VASA

#### “Vepra letrare”<sup>430</sup>

Se ra shqypnia, me faqe n’**dhe**. f. 336.

**dhe** vesh atë trajtë t’mbuluar. f. 349.

<sup>427</sup> Forsett, E. *Pedantius*, 1851.

<http://www.philological.bham.ac.uk/forsett/>

<sup>428</sup> Carroll, L. *Alice’s Adventure in Wonderland*, June 2008, f. 43.

<sup>429</sup> Po aty f.48.

<sup>430</sup> Vasa, P. *Vepra letrare I*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1987.

Kush **pa** fëmijë krejt mbetet në këtë **dhe**. f. 391.  
... **dhe pa** se në tokë një ëngjëll kishte nisur. f. 391.

Besën që ti më **dhe**. f. 386.  
Ndoshta **dhe** në thelb të zemrës. f. 387.

**Linda** për skllavëri. f. 372.  
**Linda** po e linte këtë botë mizore. f. 392.

Atij që bën **ballë** zhigun e vdekjes. f. 362.  
Ajo atë **ballë** me trëndafil pajisur. f. 392.

Plot njëzet **hëna** më parë. f. 385.  
Dhe **hëna** përmbi kodër zu të dalë. f. 306.

Kjo zemër te ti **vete**. f. 360.  
Më pushtoi një flakë dhe më bëri për **vete**. f. 360.

Ajo e **pa** sepse ulur te bregu në heshtje qëndronte. f. 344.  
Të fshehtë **pa** lidhur mes qiellit dhe dheut. f. 351.  
Nëpër gjithë rruzullin erdha pa u **parë**. f. 352.  
Ato ëndërrime më **parë** për ty qenë përjetim. f. 307.

Mos shikoni **kisha** e xhamia... f. 309.  
Të **kisha** ndjenja, mendje dhe jetë. f. 365.

### NAIM FRASHËRI “Vepra të zgjedhura”<sup>431</sup>

Nënë një hije nën një **ah**. f. 41.  
**Ah**, të kish mësuar të mirat! f. 51.

Hapen: lajthi, dushk, **ah**, qarr. f. 74.  
**Ah**, ah im më. f. 68.

Duke qeshur **ha**, ha, ha. f. 75.  
**Ha** që të rrosh e mos rro që të hash. f. 82.

Ndaj **ati** nuk e vlen mirësia. f. 64.  
Një mbrëma e dëgjuanë i **ati** dh’ e ëma që thirri. f. 79.

I shoqi sheh **kanë**, lopën, viçnë, demnë, kalën, pelën. f. 79.  
Duke këputur nga çmagu, që se **kanë** vartur mirë. f. 79.

---

<sup>431</sup> Frashëri, N. *Vepra të zgjedhura*, Akademia e Shkencave e RPSSH, 1985.

Bujkun e zgjuan me natë edhe vë përpara **qetë**. f. 80.  
Mundohetë punëtori, po në zëmërzët **të qetë**. f. 83.

**Bariu** vë tufën përpara, vasha përkëdhel sheleknë. f. 79.  
Del ku hapet trëndafilu dhe **bari** është gjithë vesë. f. 81.

Gjë e gjallë na **vesh**, na mbath dhe na ushqen e na xbavit. f. 73.  
Mirretë **vesh** njeriu i lik, njihetë njeriu i mirë. f. 82.  
I kanë ngrirë të mjerit **vesh** ‘e goj’ e këmb’ e dorë. f. 84.

Një **pret** e qep, një merr e ep, një mbath, një shikon mullinë. f. 83.  
I **pret** me kraharor hapur e i përcjell të gëzuar. f. 83.

O! Është mbuluar në **dhe** vashëza fytyrëhënë. f. 85.  
Të këput shpirtinë plaka, kur zë **dhe** nëmëron e qan. f. 85.

Det i p’an’ i mirësisë, q’emrin tënt s’ë **zë** dot ngoje. f. 87.  
Kalliut bukë, mizës pjesë, zogut ngrënie, **zë** bilbilit. f. 87.

Ç’ka në **dhe** e nëpër qiej. f. 98  
**Dhe** të sosur s’ka gjëkundi. f. 98.

Kafshën, farën, shoknë, bukën, trajstënë, lakrorë, **qenë**. f. 81.  
Që nga kreji kshu ka **qenë**. f. 100.

I ra **verës**, e buçiti. f. 127.  
O **ver’**, o ditëz e mirë? f. 127.  
Edhe kështu **ver’** e vapë. f. 127.

**Ah**, e shkreta seç na gënjen! f. 119.  
**Ahu**, me krye përpetë. f. 105.

Vini **veshn’** edhe dëgjoni. f. 142.  
S’e marr dot **vesh**. f. 144.

Për **atë** s’ka vend gjëkundi. f. 156.  
Një mëmë e një **atë** kanë. f. 103.  
E kini **parë** më **parë**. f. 229.

Pastaj vuri **re** të parët. f. 263.  
Hapësira është e mbushur me **re**. f. 263.

Më nuk ‘ua dëgjoi **zënë**. f. 277.  
Udh’ e dyer ishin **zënë**. f. 279.

Dhe **pa** vëlla e **pa** atë.  
**Pa** venthit e uruar. f. 280.  
**Pa**, tek po vinte, Hasanë. f. 281.

Si **dhe** Toka, si **dhe** Hëna, ish etër. f. 357.

Dhe u shfaq pastaj ky **dhe** që vuri korë. f. 357.

Asnjë zë tani mbi **dhe** më nuk dëgjon. f. 359.

Vjen nga qielli **dhe** nuk bëhet mik pa druajtje. f. 359.

Sa përleshje përmbi **dhe** që ti ke parë. f. 364.

Nga yt gjysh, që dritën merr ti **dhe** stolitë. f. 365.

Që të varfrit përmbi **bar** t'i shoh të shtrirë. f. 372.

Nëpër boka, ja, thëllëza po **baret**. f. 373.

Mizë janë **dhe** njeriu, dhe ky **dhe**. f. 371.

Me q'u vure si mëkëmbës te ky **dhe**. f. 378.

Pra, këtu kërko **dhe** gaz edhe hare. f. 378.

**Zë** m'i ëmbëlë nga mjalti. f. 427.

Po **zë** dhen' e ahafinjet. f. 427.

S'pash' edhe s'kam për të parë. f. 427.

Thirri Ali **Pashë** burri. f. 303.

Gjithë trima e të **parë**. f. 302.

Sy me sy s'e kishin **parë**. f. 321.

Je m'i miri nga çdo gjë që ka ky **dhe**. f. 380.

Pra, këtu kërko **dhe** gaz edhe hare. f. 378.

## MIT'HAT FRASHËRI

### “Hi dhe shpuzë”<sup>432</sup>

Në është vërtet se zemra jote s'rreh kurrë për mua ashtu si ke dashur të më duash, në është vërtet se fytyra ime nuk **zë** asnjë vend në ëndërrimet e tua, pse, o e bukura ime, kur më sheh ngadalëson çapnë, pse më lëshon vështrimin e atij syri të shkruar tënt?  
f. 23.

Folmë, mik se dua të dëgjoj **zë** njeriu, dua të ndjej veten gjallë: folmë a do të mbajë shumë ky zi? f. 31.

Nuk e di ti që çdo gjë mi këtë **dhe** ka një funt? f. 25.

Më pyete pse të dua **dhe** unë qesha. f. 25.

Më ngjalle nevojën e dashurisë, më **dhe** gjithë të dhemburat, gjithë ndjenjat e saj.  
f.31.

Vështrimi yt është si një shtizë në dorë të një djali që **lot** me një zok. f. 24.

Ahere kur bota mbytesh me **lot**, ne ishim të gëzuar ahere, kur bota mbuloresh me ujë të ftohtë, ne kishim të nxehtë në zemër. f. 30.

---

<sup>432</sup> Frashëri, M. *Hi dhe shpuzë*, Shtypshkronja “Mbrodhësia”, Sofje, 1915.

Edhe i **pa** t'ecurit e saj, shtati i gjatë edhe kaq i bukur që po i valonte duke u mërguar. f. 33.

Dëgjo, dua që syri yt të jetë i qetë dhe **pa** re, si nat' e verës, nata që lajmon mëngjes e ëmbël. f. 34.

Të katër shokët u përqafojnë shqiptarisht, shtrënguan duart. Po dukeshin se ishin bërë vëllezër sado që pesë ditë më **parë** as e kishin **parë** shoku shoknë. f. 74.

Ç'është ky **bari** që po vjen duke nxituar pa frymë? f. 77.

Atje mbi një shtres prej **bari** ishte shtrirë dhe Gjoku. f. 85.

Plaku **më** tha: - Kanë rrojtur; tani **më** s'janë. f. 82.

Shiko ata që po unjen poshtë, sa janë të kënaqur dhe të fatshëm: se ata janë të **pasur**, kanë të holla, tha Meçeja. f. 70

Nga ç'kishte **pasur** në jetë tani vetëm ky djalë po i mbetet. f. 86.

Sulua me shtat të vogël dhe me pak mustaqe, kish gjashtë vjet që punonte në **ara** dhe në kopshte të Stambollit si gjithë shokët e tij nga Mati. f. 71.

Zoti të ndjeftë, vëlla, tha prifti duke shënjuar. Pastaj mori nga muri një kryq, një kryq prej dru **arre** të moçme, mbetur në këtë shtëpi prej pleqve. f. 89.

## **FAIK KONICA**

### **Katër përrallat e Zullulandit**<sup>433</sup>

Kur afrohet njeriu vë re menjëherë se kjo shtëpi, ndonëse e unjur dhe e vogël, ndoshta me tri oda vetëm ose të shumtët me katër - ndryshon nga gjithë shtëpitë e tjera të vendit nga bukuria e vijave, nga gjerësia elegante e derës, nga forma e shkafët e penxhereve - sicilido nga të cilat ka njëzet xhama të vegjël, të lidhur me metal **dhe** veçan nga shtëpia e mbuluar me qeramidha të bardha të shkruara me **dhe** me kujdes, kuptohet se është një shtëpi e mejtuar prej një arkitekti - artist për një myshtëri - poet. f. 39.

**Vera** punonte si koriste në një nga theatrat e mbedha të Petërsburgut. f. 41.

**Vera** e vërtetë del vetëm në Francë, dhe në ca vende të Gjermanisë anës lumit Ren. f. 49.

Hesht melon, se unë s'ta **ha** kokën. f. 64.

**Ha-ha.** Zylfikar aga - bëri Dr. Gjilpëra. f. 103.

Është një shtytje e fuqishme e natyrës, jo një **zë** i perëndishëm. f.42

E pastërvitur, pa fjalë do të ish; po ca njerëz, veçan gratë, lindin me një hollësi prej natyre që **zë** vendin e diturisë dhe e **zë** me shkëlqim. f.110.

Thosh me **vete**... f.42.

---

<sup>433</sup> Konica, F. *Katër përrallat e Zullulandit*, Shtëpia Botuese "Mësonjëtorja e Parë", Tiranë, 1999.

Javën që vjen nisem për Itali, ku do të **vete** për punën e shtëpisë që dua të godit në Tiranë. f.117.

**FAN NOLI**  
“Album”<sup>434</sup>

Pasuri **dhe** liri, dhe fuqi ti na **dhe**  
Përmbi **dhe**, përmbi fron, përmbi qiell u bekoftsh. f. 20.

**ALI ASLLANI**  
“Hanko halla”<sup>435</sup>

Dhe i lumtë goja kush e tha më **parë**  
Xhan e shpirt o burrë, xhan e shpirt o zjarr! f. 109.  
E ku qënka **parë**, e ku është dëgjuar  
Që të hapi femra gji e kraharuer  
Dhe të shkoj’ përpara, burri t’i vej’ prapa  
Ky pa hedhur çapën, femra heth tri çapa? f. 115.

Ruana Zot nga fjala, zgjatet edhe zgjatet  
Sa me **pash’** njeriu s’ka sesi të matet! f. 129.  
Kur i **pash’** të parat, desh më zuri frika  
Kur i pash’ të dytat... deh iu rëntë pika! f. 129.

Me një **mes** të hollë gati për t’u thyer. f. 120.  
Mu në **mes** të reve hëna në të dukur  
Mu në mes të reve si hën’ e si yll  
Ose si një xhinde fshehur në një pyll! f. 121.

Tym e **re** e mjegull dhe në mes të saj  
Ç’quan një drit’ kandili terur e pa vaj. f. 118.  
Si e **re** që është nus’ e hallës  
Derdhet mu si vala, vala i ngjan valës  
Po sado të derdhet mu si val’ e detit  
Nonjë dëm s’i bëhet detit e kismetit. f.125.

Sonte u bë nuse, dhe u **vesh**, u ngjesh  
Edhe Hanko Halla diç i tha në **vesh!** f. 133.

Nusja ja arriti dhe në shkall’ mbi **krye**  
Mbi **krye** të saja një çyrek u thye! f. 135.

Dit’e **hën’** mëngjes, ngritur që me vesë  
Nisur e stolisur, unjur syt’ e zesë. f. 137.  
Ti moj **hën’** e bukur, hën’ e mira hënë

<sup>434</sup> Noli, F. *Album*, Boston, Mass. 1966.

<sup>435</sup> Asllani, A. *Hanko halla*, Botimet” Kristo Luarasi”, Tiranë 1942.



Motr' e vendit tënë që shëtiti në qieje  
Rreth e rrotull yje, rreth e rrotull djeje! f. 138.

U! Më mart' të keqen dhe m'u bëft' kurban  
Far' e fis i tia an' e mban' ku jan'! f. 111.

Me këto receta, me këto gënjeshttra  
U helmua gjaku, u helmua eshttra. f. 115.

Mbytur nëpër halle si një frenk mylis  
Me një pallto kashte hedhur mbi kurris,  
Dhe një palo shapkë, me një pal' shallvare  
Dhe më keq akoma që nuk **vete** fare. f. 116.

Gjith' këto gjynahe nuk i lan as deti,  
Duket që afroji koha kijameti.  
Thënka dhe qitabi: rob i kësaj jete  
Dale me ngadalë nuk do jet' në **vete**. f. 117.

Djali mu si flutur flakës u lëshua  
E kush u martua edhe s' u gëzua?  
Si të mos gëzohet sidomos i riu  
E çfarë gazi tjetër ka në **jet'** njeriu? f. 136.  
Nus' e kësaj kohe tjetër zanat s' paska  
A do marr kalemin që të bëj' laraska  
A do zër të shkruajë ose do dëgjojë  
Një kuti të vogël që na flet me gojë.  
Një kuti të vogël që mos qoft' të **jet'**  
Është një frenk i marrë, çirret e bërtet! f. 120.

Duket nga një herë zëri e lëndon,  
Frëngu rri i qetë ose do bërtasë  
Nusja e humbet dhe i **vete** pas,  
Frëngu e ngrë zërin edhe sokëllin  
Nusja e lë perin edhe vërshëllin:  
Ai flet me **vete**, e flet përçartë  
Nusja s' është në **vete**, bëhet më e zjarrtë! f. 120 - 121.

Atë nat' - thot halla - bëri **zë** pa kohë  
Na u prish edhe moti, bëri shi e llohë. f. 24.  
Shikoni e shikoni valën që valon  
Se sa shumë gjëmon, se sa pak gjykon  
Me re e me erë **zë** e guduliset  
Tundet e lëkundet dhe nga shtrati niset. f. 25.

Hallë në ke **të holla** mbetur a kursyer  
Lëri në një bankë, vendi më i vyer! f. 124.  
Me shami Stambolli majë kokës lidhur  
Gati për të rarë, gati për të zgjidhur:  
Me linja **të holla**, me mëngë të gjera  
Derdhur përmbi supe, derdhur përmbi llëra! f. 131.

Mir' për na të parët s'mbeti fjal' e vend  
**Brez'** i ri vall' ç'pati që u prish nga mend? f. 115.  
Me linja të holla rrahur në tezgjah  
dhe **brez'** i bukur varet në një krah:  
Disa me fustane, hedhur dhe një xhokë  
Dhe gjynah mos qoftë, pa shami në kokë! f. 131.

Gjalp' e **vaj** i tyrej derdhej si përrua  
Katër teste qypa kishin në katua. f.112.  
Në të dy shtëpirat vallja po vjen rrotull  
Do gëzojë dhe Zoti kur gëzon një popull  
Pra në thelp të dimrit koha u bë **vaj**  
Defi edhe qejfi flakërin në Maj. f. 132.

Hoxha u bë prift, prifti u tërbua  
Dhe gjynah mos qoftë, bëhen mish e **thua!** f. 117.  
Çorba, mish i pjekur, bakllavaja tri  
Byrek e qoftera dhe një kabuni  
Një pilaf të bardhë me piper të zi  
Tet' a nënt' të tjera dhe që **thua** ti  
Nonjë teste gjellra... e ç'i do më shumë?  
Më mir' pak e sak, sa shum' e për lum. f. 133.

Me një her' do thyhet **mez'** i holl' i vajzës  
Shkon për **mes** të rrethit, rrethit të unazës. f. 128.  
Para **mez'** i natës erdhi çast i lumtë  
Nata u bë dit' nga qirinjt' e shumtë. f. 136.

## LASGUSH PORADECI

### "Poezi"<sup>436</sup>

Dergjej Perëndimi më të vagëlluar  
Kur më **pa** së fshehta syri yt i shkruar. f. 55.  
E gjesh më mbyti e më mbete mjerë  
**Pa** m'i shtire sytë për të tretën herë. f. 56.

Pa fillon me **zë** të dredhur  
Motra së kënduari. f. 65.  
Shoq i vet, nga malli i ri  
Më me zjarr **zë** përvëlohet. f. 98.

Një degë të ulur sipër **ti(j)** f. 86.  
Ja zgjati si një dorë.  
**Ti** eja që me natë ndaj tumb e varrit t'im  
Pa dalë zbardhëllimi vrapo si vetëtim. f. 92.

Na rritej malli posi det

---

<sup>436</sup> Poradeci, L. *Poezi*, Botimet "Onufri", Tiranë, 1999.

Posi një det që vjen me **valë**. f. 71.  
Prej mosgjëje zunë fill  
Plot jetë e mall të **valë**. f. 97.

### **PETRO MARKO** “Qyteti i fundit”<sup>437</sup>

... atij çasti të mallkuar që babi na **zë** me nënën. f. 3.  
... dhe grupe-grupe bisedonin me **zë** të ulët. f. 3.

Me **vete**: “Nga zëri më duket i ri...” f. 7.  
**Vete** e mbron një kriminel, vetëm se është italian. f. 309.

**Ha-ha-ha!** f. 9.  
**Ha**, derr i pangopur. f. 32.

Unë s’e besova, po **hapa** derën dhe si i çmendur... f. 283.  
U ngrit dhe me kokën daulle bëri ca **hapa** tutje... f. 282.

**Dhe**, megjithatë, mekaniku kënaqej... f. 199.  
... dëshirën time që nuk munda ta plotësoja mbi **dhe**, se isha i varfër... f. 199.

**Po, po!** Më kujtohet! f. 56.  
**Po** ta lemë këtë histori. f. 56.

### “Nata e Ustikës”<sup>438</sup>

Hekurat do shkrijnë bashkë me zinxhirët **dhe** unë mund të shkrihem nën **dhe**. f. 232.

U morët **vesh?** f. 30.  
**Vesh** më vesh. f. 154.  
Rënkimet e ulurimat e dhomës pranë mbërrinin në **veshët** e mi. f. 11.  
... e po në këto çaste, dëgjova atë **zë**, atë thirrje, gjersa të vdes, do ta dëgjoj. f. 21.  
I ngjitej malit të Çikës në behar, ulej nëpër honet ku bora **zë** borën, e çante me sëpatë.  
f. 25.

S’qëndron gjë mbi këtë **dhe**. f. 17.  
Po ... **dhe** sado që thell’ e fshehtë. f. 20.

M’u përgjigj me atë **zë** si të erës kur **lot** me degët e plepit. f. 6.  
Këndonte me **lot** në sy atëhere kur vareshin në vinçin e vaborit. f. 55.

A **do** gjë? f. 8.

---

<sup>437</sup> Marko, P. *Qyteti i fundit*, Shtëpia Botuese “Omsca”, Tiranë, 2000.

<sup>438</sup> Marko, P. *Nata e Ustikës*, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, Tiranë, 1999.

Ne nuk e dimë ku **do** të na shpien. f. 10.

Natën tjetër u **çuam** më shumë ushqime. f. 9.

Të gjithë u **çuam** dhe e mbajtën se nisi t'i binte derës. f. 250.

**Para** fiton mjaft. f. 10.

Kur vdiste ndonjë i burgosur dhe e nxirrnin në oborr që ta merrte karroja e bashkisë që mbledh plehrat, **para** se ta hidhnin në karron e bashkisë ky Dali Minxha shkonte dhe me një gozhdë i shponte syrin të vdekurit për të parë se mos bënte kastile... f. 16.

Ta **pret** mendja, xha Frrok. f. 23.

Ç'**pret**? – Asgjë! f. 233.

E vura **re** se vuante, vuante shumë për gjendjen e re që u qe krijuar në burg! f. 25.

U gdhiva si mbi **re**. f. 269.

Sa e bukur! Sa e **re**! f. 343.

Të pija pak ujë se mu **tha** gjuha. f. 26.

Ju e dini italishten - më **tha** marshalli. f. 27.

Unë fërkova **kyçet** e duarve që më ishin mpirë. f. 27.

Dëgjova **kyçin** e derës. f. 32.

Njeriu i **mund** bishat. f. 33.

Po ti si nuk **munde** të kapje ndonjë stacion? f. 184.

Sytë herë i mbaja të mbyllur, herë i çelja dhe s'merrja **vesh** si dhe mbi kë qëndroja.

Në djall të **vesh** se më dërrmove... f. 40.

Sa m'i kishte mustaqet! **Vesh** më vesh! f. 11.

Herë i afroheshim dritares, herë uleshim, herë shtriheshim, herë flisnim, herë pushonim e pushonim e pastaj përsëri pyesnim njëri-tjetrin, mbanim **vesh**... f. 291.

Uleshim e këpusnim ndonjë **vesh** rrushi. f. 332.

Çela sytë dhe po të mos kisha parë Gjigandin nuk do ta kisha marrë **vesh** se ku isha. f. 33.

**Vija** re muret e njollosura me gjakun tonë. f. 56.

Unë **vija** nga jeta monotone e qelive. f. 100.

Dorëzuam teshat tona. Na dhanë uniformat e burgut. Ato cohë me **vija** të trasha që poshtë-lart e që lart-poshtë. f. 75.

E de ç'lajme na **bie**? f. 66.

Mor po sikur po i **bie** të fikët! f. 66.

Që larg **nisi** të dukej ishulli. f. 83.

Po ku e gjetën këtë **nisi** për ne! Nisi e thatë si gërnxh i shkretë. f. 83.

Më ishin **mpirë** këmbët siç më ishin **mpirë** shpirti dhe shikimi. f. 84.

Thuaji të **vijë** brenda! f. 94.

Dhëmballa i kishte mbetur atij për të ndrequr. Të tjerat i kishte në **vijë**. f. 96.

S'të ka **hije** të flasësh ashtu. f. 60.  
Dielli na përvëlonte. Sheshi ynë s'kishte asnjë **hije**. f. 107.

Po unë ç'hyja në këtë **mes**! f. 119.  
Unë e ndieja veten mirë se isha në **mes** dhe falenderoja ata që na lidhën. f. 51.

**Ballë** për ballë kameronit tonë banonin tre italianë. f. 123.  
Kur i vura dorën në **ballë** ai i hapi sytë. f. 125.

Keni një shok të sëmurë **rëndë**, ë? f. 129.  
Unë nuk desha t'ju ngacmoja plagën e **rëndë** po ja që më ka marrë malli për vendin tim. f.159.

Si shumë ma ke lëshuar atë **gjuhë**... f. 139.  
Pastaj e kishe pyetur sesa **gjuhë** dinte. f. 127.

Iu afrova murit ku ishin **ngjitur** shumë lajmërimë dhe urdhëra të shkruara me makinë dhe të nënshkruar nga drejtori. f. 147.  
Lajmi i krijimit të Partisë e gjeti në burg në qelinë **ngjitur** me mua. f. 115.

Vura re se ai që shiste lajthitë ishte skelet. I djegur në fytyrë. I thatë **dhe** i gjatë sa një druganë. Tjetri, i mbushur dukej si gjigand.

Më **dhe** tetë!  
Të dhashë dhjetë! f. 163.  
Po i zbresin... po i futin në **dhe**. f. 178.

A e pe? Krimi u **krye**! f. 165.  
Marshi funebër herën e parë u dëgjua si shumë larg. E pastaj, pak nga pak u përhap gjer në **krye**, gjer te Bexheti dhe Kadriu që mbanin kurorën. f. 174.

Ajo shprehje thoshte: "Sa i mirë që je... Po mos më **nga**." f. 186.  
Të heshtur zbritëm **nga** ajo pllakë - gërxxh. f. 187.

**Vura** librin nën sqetull. f. 192.  
**Vura** re se u pre në fytyrë! f. 92.

Fajtori jam unë. Se unë e **bija** në shtëpi atë maskalcon... f. 198.  
Don Çuçoja e përkëdheli me dorën e tij duke i thënë " **bija** ime". f. 210.

Na u **thanë** zorrët. f. 213.  
Nuk **thanë** asnjë fjalë. f. 81.

**Pres** lirimin me orë e pres, tha. f. 216.  
Gërshetat i ke shumë të gjata!  
Do t'i **pres** se më pengojnë shumë... f. 187.

Agimi i zyrtë e i lagur **pa** siluetat e një tabori oficerësh të hynin në oborr. Dhe ne nga dritaret e kaushit **pa** dritë, i shikonim të drejtoheshin nga sheshi i ngushtë, ku trekëmbëshi ngrihej me hijen e tij të tmerrshme. f. 278.

Kam dëgjuar se në luftën aeronovale marina italiane ka pësuar dëme të mëdha...Dhe ku **pa**?! Në ujërat tona, në brigjet tona! f. 293.

**Vete** unë! - tha vajza e një partizani që ishte aty se u kishte shpënë bukë. f. 230.  
Është në **vete** ky apo ka luajtur? f. 234.

Të çmendurit ... na morrën më **qafë**! f. 236.  
Zora, duke hedhur pas flokët e saj të zinj me një të tundur të kokës zgjati **qafën** e saj të gjatë dhe pyeti... f. 128.

Ç'është? - pyeti italianin me një këmbë.  
**Zi** e madhe! - u përgjigj ai f. 238.  
Ja edhe fundi, fundi i **zi**! f. 266.

Këta janë bisha kushedi, mund të hedhin në **erë** Ustikën. f. 28.  
**Erë** nuk frynte fare. f. 201.  
Shumë herë i merrja **erë**, po ajo copë e rëndë dhe e njomë ishte pa erë e pa shije. f. 214.

Ishte një goxha **ka**, sa një mal. f. 304.  
**Ka** pak vajza. Pak gra dhe disa fëmijë. f. 7.

Kosta kishte një dem të zi, si **ari**... f. 304.  
I erdhën katërqind franga **ari** dhe tha se nuk i pëlqente të jetonte më këtu me ne. f. 154.

Për një çast, u ngrit në të katër anët e sheshit një **mori** zërash të ngatërruar. f. 306.  
Iku. E **mori** nata. f. 22.

Natën e kaluam **buzë** lumit. f. 336.  
E përqafova. E putha në **buzë**. f. 351.

Unë e Sonja si çdo natë bëjnë folenë tonë me **bar** të thatë dhe me degë. f. 336.  
Në **Bari** vinin njëri pas tjetrit të plagosurit nga Shqipëria. f. 355.

Shumë herë e kisha lutur të qëndronte me **Dorën**, se ajo be bënte për kokën e Sonjës. f. 345.

Natën e mirë! – tha ajo dhe **dorën** që ia mbaja në dorën time e tërhoqi me përtim. f. 6.

Më vinte plasje që nuk po dëgjoja asgjë për të **qenë**. f. 160.  
Unë kodosh kam **qenë**, po spiun s'bëhem kurrë! f. 194.

M'u duk sikur gjithë ata që më përcollën **deri** në derë të sallës, ishin aty pranë meje. f. 28.  
Dhe kjo është fatkeqësia se po arriti Hitleri të zaptojë pusët e vajgurit, na mori lumi të gjithë... Se qymyrin e siguroi **derri**. f. 12.1

### “Poezia shqipe”<sup>439</sup>

Po... dhe sado që thell’ e fshehtë. f. 20.

Po! Heshtja jote na ka bindur. f. 25.

Dëgjo! Gjëmon sot këng’ e re. f. 25.

dhe jo të dehen si në re. f. 28.

Se ç’hypi lart përmbi re. f. 20.

të ëndërrës së re pa fat. f. 21.

që ti pret o vash e re. f. 47.

ku mbi re shkrep vetëtima. f. 51.

Ku deti qesh dit’ edhe natë. f. 90.

Dje un qesh në vëndin tim i huaj. f. 207.

Dhe jetës t’i japim gëzim. f. 126.

punosh mbi dhe. f. 126.

### FATOS ARAPI

#### “Eklipsi i ëndërrës”<sup>440</sup>

Në Tiranë ka vetëm tiranë. f.129.

Rrëzoi sy e qëpallë në dhe. f.127.

As ti nuk ma dhe dorën të ngrihem. f.128.

Një grusht dhe mbi varr. f. 81.

As gjyshi më njeh dhe as unë e njoh. f. 83.

Unë kështu qeshë brumosur. f. 53.

Qaj e qesh në një lot. f. 108.

Dhe ti do të thuash: - Tani,

jo unë - lufta. f. 192.

Tani unë jam i lirë. f. 235.

Trishtimi më braktisi i fundit

Dhe unë u munda. f. 27.

Në kaq pak Tiranë

Si mund të mbetesh kujtim,

Si mund të kthehesh në mall. f. 122.

Të gjithë po heshin nga një grusht dhe. f. 81.

Në fushën e errët të gjakut

---

<sup>439</sup> Marko, P. *Poezia shqipe*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1973.

<sup>440</sup> Arapi, F. *Eklipsi i ëndërrës*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002.

Mbijnë **dhe** ecin ullinjtë. f. 68.

Unë jam ajo kokrrizë  
Që shkon e s'di ku **vete**  
Që humb e prapë s'tretet  
Që rron veç jo për **vete**. f. 92.

Lojë e hapësirave  
Që mbyllën të gjitha në **buzët** e tua  
Kur ti vetë qenke në **buzë** të jetës  
Frymë e mërmërimës së tyre. f. 101.

Në sytë ëndërr dhe s'jemi **parë**  
Unë gjysmëvdekur, ti gjysmëgjallë. f. 103.  
Ai donte t'i lajmëronte më **parë**  
Foletë e zogjve. f. 123

Ky qiell i prillit, **pa** ty është i vjetër f. 108.  
Te këndi i qelqtë – vetmia  
Më **pa** dhe lëvizi... f. 127.

Fytyrat janë **po** ato. f. 126.  
Mirë sot, **po** si durohet pa ty nesër? f. 109.  
Ja vlen një kafe të dy  
Sot **po**... f.127.

Ti ...  
Ç'do **t'i** bëje **ti** lundrës së tij të stërmoçme? f. 206.

E sapo del prej **kishe**, anatemën e papës  
E mban në dorë si qeleshën e bardhë. f. 199.  
**Kishe** qenë një trim i pashoq  
Vogëlushi im. f. 208.

**Gryka** e Matit rrëmben  
Rënkimin e fundmë të turqve  
Të arbërve e thëthin Tumemishti f. 200.  
Ti je vetëm një peshk dhe në **grykë**  
E ke grepin që ta tërheqin ndershmerinë tënde. f. 227.

Dashurinë që drejt meje po vjen  
Do ta puth në **buzë**, në ballë. f. 19.  
**Buzë** mbrëmjes i menduar f. 167.

Një gjethe akoma e gjelbër akacie  
M'u **var** në majë të penës. f. 133.  
Por unë e di  
Ka vetëm një **varr** për tiranët - liria. f.128.

Ke për të **parë** po s'gënjeva karontin. f. 104.



Thyenin këmbët, rrokulliseshin  
Që të vinin sa më **parë** tek unë. f. 29.

Te kryet e **tu** tri trëndafilë të bardhë. f. 85.  
Po ta dinin, ndofta po **t'u** lutesha  
Mu në mesin e këngës së tyre... f. 84.

### “Gloria Victis”<sup>441</sup>

Kërcen **akrepi** i orës drejt tjetrit, f. 46.  
Lakminë **akrep** të pushtetit dhe gabojmë. f. 46.

### SOTIR LASHOVA

#### “Gomari që desh të bëhej mbret”<sup>442</sup>

Sa më parë të **verë** dorë,  
Të zhdukë kanale e hidrivorë. f. 59.  
Një gushëkuq shend e **verë**  
I tha korbit pendësterrë. f. 23.  
I thave shakujt e **verës**  
Ngre dolli për fitore. f. 21.

Vështrimin ngulur nga dera  
Priti aty sa erdhi **vera**. f. 6.  
E ndoqën pas lulet e tjera,  
Në lulishte i vaposi **vera**. f. 46.

Na ka prishur punë  
Në çdo koriye ku **vete**  
Shpendët i bën për **vete**. f. 25.  
Një lider më merr me **vete**  
Ngado që **vete**. f. 38.

Por natën tek thumbonte një **ka** në hendek  
Zukati mushkonja barkfryrë kacek. f. 27.  
Për mua **ka** kuptim liria  
Që plotëson tekat e mia. f. 33  
Me keqardhje **pata** tha:  
Zonja domate, këtë hata,  
A ka ndonjë që e ndreq? f. 75.  
Lashë lekët që **pata** e atë pak shëndet,  
Këmba këtu mos më shkeltë kurrë. f. 84.

U ndihmon **Zoti** dhe bota... f. 16.  
Zotrote Sanço dhe ti im **zot**

<sup>441</sup> Arapi, F. *Gloria Victis*, Botimet “Neraida”, 1997.

<sup>442</sup> Lashova, S.; Grillo, O. K. *Gomari që desh të bëhej mbret, Fabula dhe epigram*, Tiranë, 1997.

Vitin s' do ta ngrysn dot. f. 21.  
S' pranon tjetër kurrsesi,  
Veç t' i thonë “**Zoti ari**” f. 28.

Oreksi më shtohet një **çikë** në drekë,  
Dy kofshë viçi boll i kam, biftekë. f. 30.  
Macja i jep **çik** nga dera:  
Ç' ke, o qen, që leh për hera? f. 47.

Kur binte tërmet më parë,  
Ortek ose stuhi nga **reja**,  
Na bënin banesa të **reja**. f. 49.

Në një ish-pyll me drurë të prerë, u foli ujku që printe në **ballë**. f. 9.  
**Ballë** stuhive si kështjellë,  
Mbrojti tokën nga e gërryera. f. 62.

Tani më **qafë** askush s' do të na bjerë  
E meritonim me kohë këtë ligj. f. 9.  
Në një çark i mbylli së toku,  
Në **qafë** e këmbë pranga u vuri. f. 7.

Dallëndyshja në Qafë të Qarrit  
S' e përmbajti dot të qarit. f. 45.  
S' i ndal dot mullinj të e **erës**? f. 21.  
I paska marrë koka **erë**. f. 55.

Ky i ka gjethet e gjera,  
Aty ku je të grin **era**. f. 72.  
**Era** sillte që nga larg  
Dimrin me ngricë e acar. f. 39.

Zioshi tjerr fjalën tërkuzë:  
Lërmë të të puth në **buzë**. f. 31.  
**Buzë** përroit e një ledh,  
Shtatin lart plepi e hedh. f. 32.  
Kur flet zgërdhesh **buzë** e faqe,  
Dhe thurr lavde për lirinë. f. 33.

Si **lumë** më burojnë paratë,  
Bjeri kavallit se i bie mirë. f. 31.  
**Lumi** lë shtratin e vjetër,  
Nis e çan një udhë tjetër. f. 34.

Shihni si lëviz  
Po vallëzon me **bisht**. f. 54.  
Lufta për paqe tymnajë zhgënjimi,  
Aurorë kometë, rrenë me **bisht**. f. 86.  
I rëndon **bishti** dhe jo sqepari  
S' i peshon kalliri, por kashta. f. 87.

Edhe zotrote e ke vënë **re**  
S'ka patur fare as shi, as **re**. f. 75.

Mbi llumin e një kanali,  
I bëri përshtypje një **pate**. f.75.  
Me druajtje hyri në fshat  
Palle me sa fuqi që **pate**. f.78.

## ISMAIL KADARE

“Koha”<sup>443</sup>

Partia ime ti ma **dhe**. f. 9.  
Më madhështoren përmbi **dhe**. f. 9.

Si yjet janë vërtet dashuritë,  
Kërkojnë hapësira të mëdha e po aq **mund**. f. 6.  
Perandori **mund** të bëjë hara - kiri. f. 48.

Unë **qesh** me perënditë hindjane  
Me perënditë greke qesh. f. 11.  
Tek **qeshë** i humbur tek kërkoja  
Të kapem tek diçka e gjallë. f. 29.

Ja qielli **gri** i lartë, mes tij një bubullimë  
Si e plagosur ikën, një shpellë të gjejë për të vdekur. f. 12.  
Për një breg u vra,  
U **gri** për një shesh. f. 92.

Ky mbi kalë është xhaxhi Don Kishoti,  
Vërtet i **marrë**. f. 50.  
Meqënëse tani për tani ke moshën  
Me ta për t'u **marrë**. f. 51.

Dorën e zbetë  
Mbi ballë **ta** vuri. f. 39.  
Më duket se njëfarësoj  
Mund të merresh me **ta**. f. 51.

Vetëm ti në grackë  
Shqipëri nuk **re**  
E vogla vigane  
E moçmja e **re**. f. 95.

Si një **bari** me katër krraba në duar. f. 73.  
Aty këtu mbi djerinë një shushurimë **bari**  
Ca shkëmbinj me gurmaze të shqyer. f. 44.

---

<sup>443</sup> Kadare, I. *Koha*, Tiranë, 1976.

### “Ftesë në studio”<sup>444</sup>

Ç’letra, më muarë të **hap**? f. 6.  
Me **hap** të lehtë ajo kapërceu pragun. f. 63.

Si duket s’ka më të pavdekshëm mbi **dhe**. f.16.  
Ecin **dhe** të lumtur tani janë krejt. f. 16.

Më kujtohet, gazetat **hapa** në mëngjes. f. 53.  
Ja Pushkini **hapat** i ndal. f. 7.

Faleminderit **Patë** për aq sa bëre për ne. f. 10.  
... dhe **patë** se koha e Mesjetës ... f. 10.

### “E penguaga”<sup>445</sup>

... që kishte qenë e palëvizshme, si gjithë ata që janë nën **dhe**. f. 127.  
I përsëriste me vete, pastaj tundi kryet **dhe** tha: f. 128.

### “Pa formë është qielli”<sup>446</sup>

**Ti** mjegullat, unë retë  
Do **t’i** dërgojmë njëri-tjetrit.  
Në **rimë** të një balade  
Kanë ngecur diku. f. 23. (“Koha”)  
E dita vjen. Rrjedh prapë jeta  
Dhe ne të dy si dhe më parë  
Të ftohtë **rrimë** e të pamposhtur  
Si dy qytete mesjetarë. (“Pa formë është qielli”)

### REXHEP QOSJA

#### “Vdekja më vjen prej syve të tillë”<sup>447</sup>

Në **prag** të mbrëmjes, kur mëllenjat tulaten, dielli i afrohet perëndimit dhe rrezet e tij  
i kthen pingul shpellës së Harapit. f. 6.  
Hajroja i Likës, me njëren këmbë mbi **prag** dhe me një kilogram mish në duar priste  
mëngjesin përjashta. f. 158.

<sup>444</sup> Kadare, I. *Ftesë në studio*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.

<sup>445</sup> Kadare, I. *E penguaga*, Botimet “Onufri”, 2009.

<sup>446</sup> Kadare, I. *Pa formë është qielli*, Botimet “Onufri”, 2005.

<sup>447</sup> Qosja, R. *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, Prishtinë, 1974.

Dikur, moti në kohën e babagjyshit tim, kur kishte shumë zotërinj të **pasur**, një arap i zi ia kishte vjedhur thesarin gruas së zotërisë dhe e kishte fshehur në atë shpellë - thoshte plaku i dytë. f. 8.

Dhe ai kishte vendosur ta pushtonte shpellën prej anës së sipërme, sepse prej tri anëve të tjera nuk kishin **pasur** sukses. f. 10.

Kur i ishte afruar shpellës në tre pashë njeriu, kallajxhiu kishte rrëshqitur si thes me **para** dhe kishte rënë poshtë. f. 10.

**Para** se të bënte krimin që e kishte bërë Fazliu, ishte nxirë si ura e fikur. f. 49.

Nuk e dinte sa kohë kishte kaluar qysh se kishte dalë përtej shtëpisë, por shihte se terri i dendur i asaj nate vjeshtore kishte filluar të dobësohej para rrezeve të **para** të agut. f. 67.

Edhe në qoftë se përvishnin llërët dhe bënin një palë shkallë aq të gjata nuk ishte e sigurt se do të mund të qëndronin shkallët thikë përpjetë pa u kthyer **pas** me të gjithë ata që do të ngjiteshin në to. f. 11.

Ka hyrë në punë **pas** shumë kërkimesh poshtë e lart dhe zyrë më zyrë në fabrikën e konservave në një qytet gati shtatë orë larg nënës së vet. f. 69.

Shumica prej tyre kishin shfaqur qejfin të lidheshin vetë me ata shokë, të lëshoheshin vetë në shpellën e Harapit, ta nxirrnin vetë në dritë thesarin e saj dhe pastaj t'u përmendej emri vit për vit dhe **brez pas brezi**. f. 12.

Thonë se mjeshtri që e kishte ndërtuar kështjellën ishte një plak i thinjur që i arrinte mjekra deri në **brez**. f. 146.

Nuk e kuptoj si po pasurohen disa njerëz, ku i marrin të gjitha ato **të holla**. f. 177.

Në mëngjes zgjohesh i zbehtë. Shikohesh në pasqyrë: në të dy faqet vëren dy vija **të holla**, dëshmi e natës së kaluar mes shtazëve. f. 145.

Kur kthehej, **krye** disa ditësh na dukej disi e qetësuar, por jashtëzakonisht e lodhur, e raskapitur, se përkundej rrugës varavingo duke i matur apo numëruar kokulur hapat e ngadalshëm që bënte. f. 22.

Kur ia del në **krye** fshin duart, habitesh përse të dalin dhjetë proshka më shumë se herën e kaluar. f. 132.

I nderë shpirtërisht, merrte rrugët, bridhte poshtë e përpjetë për t'u ndalur në kafenetë "Khajami", "Gajret" apo "Afërdita" tek do të gjente ndonjë baksëz që ishte **zënë** me gruan. f. 32.

Kishte menduar, pastaj për arsytet e këtij zgjimi të papritur dhe i kishte parë të lidhura rreth një brengje që kishte **zënë** t'i mundonte. f. 54.

Donin të vazhdonin tutje, por tamam në atë çast i **zoti** i shtëpisë i ishte drejtuar papagallit thuase po i drejtohej ndonjë profeti. f. 35.

Ditët e kaluara në mes katër muresh, dhoma e zbrazët e nënës, shtëpia e pushtuar prej pluhurit dhe minjve, Rudina e arratisur **Zoti** e di ku, i jepte të drejtë të bëjë çka të dojë me vetveten. f. 112.

Prandaj një ditë si rastësi e kishte gërrithur me veturë gruan e fqinjit dhe prej kësaj ajo kishte qitur shumë gjak, dy muaj s'kishte ardhur në vete dhe **mend** kishte vdekur. f. 145.

Njeriu shpesh shikon dhe nuk sheh, sepse si i thonë një fjale, nuk sheh me sy por me **mend**. f. 95.

Coka e di se Leci është një rrobaqepës, një grua me pantallona, që **pret** e qep edhe fustane, po të del prej kujt s'e **pret**. f. 56.

Macula i Dushes i lyen flokët me brilantinë dhe **vaj** të arrës. f. 56.

Ia kisha plasur **vajit** dhe nuk e kam as sot të qartë pse pikërisht mua më dhembet Trashja aq shumë. f. 59.

Atëherë të shikosh në **xhami** mos ka hyrë të lutet se është bërë besimtare, e shkreta. f. 59.

Përfashta bie një shi i imët si kokrrat e orizit, që **xhamit** të dritares përgjysmë të çelur, lëshohen me vrap poshtë, duke lënë pas vija të holla, të errëta. f. 71.

Atij në mes të qilimit, afër sixhades, Afitabja e mbledhur kruspull duarpaluar me kuranin në gji, të zbkuruar prej përvuajturiisë dhe lotëve që pikonin mbi **faqet** e librit të shenjtë. f. 60.

Ia lëmonte **faqet** me duart e nxehta, kurse ajo rrinte si të ishte prej balte. f. 63.

Afrimi me të shoqen Kadën, që **qe** nëntë vjet thotë, s'i ka bërë dy ditë të bardha me vjehrrën, ia ka kthyer shpinën përgjithmonë shtëpisë e Vajazanit.

Lëshoje dëgjojësen, **qe** ku jam! (ja ku jam) f. 74.

**Dora** e shtrënguar, e ngrirë prej dhembjes, papandehur ishte çliruar dhe prej saj në dyshtemenë e kuqe kishte rënë thika e ngopur me dhembjen e gishtave të tij. f. 68.

Të gjitha të tjerat janë të **dorës** së dytë, mik e vlen barra qiranë të mbyllet njeriu në rrjetën e vetmisë me vjet dhe të merret me çikërima. f. 74.

Dhe, derisa fajësoj herë pikat e shiut, **erën**, ullukun dhe dritaren, herë penën, gishtat e fletoren e herë veshët e mi, fërshëllima tërhiqet ngadalë, sikur largohet në drejtimin tim të kundërt dhe ia lëshon vendin një zëri të çjerrë. f. 71.

Ajo ishte nëna e mëkatit dhe e pasioneve më të errëta, që turbullojnë mendjen, përhapin **erën** e helmit, të barutit dhe të gjakut të vëllait. f. 62.

Çohet, drejtohet, **hap** gojën e madhe si të ishte zgjuar prej gjumit, e ngre bishtin e gjatë e të zi dhe e mbështjell rreth trupit... f. 79.

Kur dilte me të shoqen, gjithmonë ecte një **hap** përpara. f. 139.

Shpendi ishte zënë me **Dashin** për një kilogram mish: i ka kërkuar mish viçi, ai i ka dhënë mish **dashi**. f. 84.

Kisha menduar fët e fët të kërcej prej kalit por më kishte shkrepur se do të mund të **bija** ose në tela ose fare afër atyre dhe të digjesha ose të thyeja qafën prej rënies.

f. 92.

Hë, e **bija** e Rakipit të Agës, a i ke prekur edhe sot sytë me spec të kuq? f. 224.

Dreqi e **martë!** f. 100.

E ëma i kishte thënë se kishte lindur ditën e **martë**. f. 48.

Karshi xhamisë së Madhe, takoj Binakun e Kusarajve që më sheh dhe si gjithmonë më përshëndet prej së largu e kur afrohet mbasi e mbush hapësirën me një **gaz** që dredh ajrin, më zë ngrykë, më tund, më thotë ca fjalë që i thuhën vetëm mikut të dashur. f. 107.

Dhe berberët, rrobaqepësit, furtarët, farkëtarët, kasapët, këpucarët, qoftexhinjtë, qylaxhinjtë e samarxhinjtë e qytetit mbyllnin dyqanet dhe nëpër dritaret e tyre përcillnin me **gaz** në buzë shtrëngatën e çuar. f. 23.

Te shitorja e madhe e librave kur kaloj rrallë, pres të ma ngjesë për dore ajo çupëlina e pafajshme, me sy të humbur dhe **zë** të dridhur. f. 128.

Natën, shpesh më **zë** ankthi, më kaplojnë djersë të ftohta, më del gjumi kohë e pa kohë, shoh ëndrra të këqija. f. 128.

Themelet i kishte jashtëzakonisht të forta, të thella, të futura shtatë **pashë** nën dhe. f. 146.

Kur **pashë** Remzie Berishën, mendimet m'u sollën nëpër kokë. f. 156.

Muret i kishte të trasha, prej gurësh të murrme e të mëdhenj, të sjellë prej do bjeshkësh të afërme që i quajnë të mallkuara, ndoshta pse nëpër gurore, thepat, hejzat dhe përlinat e tyre në çdo kohë të pranverës, **verës** e vjeshtës, dëgjohet një ku-ku-ku. f. 146.

Pas bodrumit të **verës**, ku ruhej vera e treqind vjetëve, dhomës së ekzekutimeve, ku ishte vendosur karamanjolla, bodrumit të armëve, ku ruhej baruti që do të ndizej po ta ndizte kush qiriun qoftë edhe në ndonjë prej kthinave më të skajshme. f. 147.

Shkrimtar i **lirë** ishte. f. 153

Hajroja i Likës dehej çdo të dytën ditë me raki të **lirë**. f. 158.

Në mund të themi se edhe disa prej njerëzve që kanë kryer fakultetin, por që nuk janë dashamirës të librit qoftë pse nuk janë mësuar me kohë të lexojnë, qoftë edhe pse kohën e **lirë** e kalojnë me më qejf, me punë të tjera më të lehta. f. 161.

E kishin shikimin aq të **prerë**, të fortë sa edhe s'mund të përmblihdeshë t'ua dalloje ngjyrën. f. 168.

Kam kaluar nëpër tehun e briskët, por nuk jam **prerë** me të dhe kurrë nuk ua kam kthyer të tjerëve. f. 172.

E para ishte e gjatë, thatime, me lëkurën e ngjitur në kockat e faqeve dhe e mbuluar prej do flokësh të **rrallë** e të thinjur që lyheshin në tepen e saj. f. 169.

I urtë, **rrallë** ja dëgjon fjalën, këqyr hallet e veta. f. 17.

Po kurrë nuk kam menduar se do t'ua shoh **sherrin** shkrimeve të mia. Duke bërë mirë, njeriu ndonjëherë gjen **sherrin**. f. 173.

Kurrë nuk **shkel** në dërrasë të kalbur. f. 176.

Mbasi nuk mund të mendoj dhe të shkruaj, marr të lexoj. I kaloj faqet, më duket **shkel** e **shko** mbase pse nuk jam shumë i interesuar që t'i kuptoj. f. 72.

Mund ta shihje vetëm një herë në muaj të gëzuar dhe në rastet e tilla nuk pushonte goja; fliste pa ndërprereje, i përshëndeste ata që i njihte dhe ata që s'i njihte, u bëntë komplimente grave, e çlironte dorën dhe u porosiste **kafe** të gjithë nëpunësve. f. 183.

Është prej kristali, por prej kristali të posaçëm dhe të ngjyrosur bojë **kafe**: ta ka ënda ta shohësh me sy. f. 186.

Tani është vështirë të gjesh **mall** të mirë, i prodhojnë sendet e bukura, i lyejnë dhe i lustrjnë përjashta por nuk rrojnë aspak. f. 185.

Kur i përsëriste me imagjinatë çastet e lumturisë me të, e kujtonte me **mall** dhe dhembje. f. 220.

Mos mendon se të presin urimet, bekimet, falenderimet, mirënjohjet e atyre që u ke ecur pas si **hije**? f. 202.

Sa **hije** i ka kjo pelerinë alegorike! Le ta mbajë si dëshmi të famës që ka fituar, si dëshmi të dashurisë që lexuesit ia kanë dhuruar dhe si dëshmi të gjenialitetit që mendojnë se e ka treguar në veprat e tij. f. 268.

Më qepen sytë në setrën e tij bojë hiri të arnuar, me jakë të përlyer, si ta kishte futur në pezhgve, në këmishën e kuqe fringo të re dhe në kravatën e **zezë** që s'i përgjigjet aspak setrës dhe këmishës. f. 206.

Kur, çka të shohësh, i ishte zgjidhur gjuha, fliste si avokat, si ajo anglezja avokate që e quajnë tigër në lëkurën e gruas dhe m'i ngarkon njëqind e një të **zeza**. f. 174.

Rreth orës shtatë, shtojë shumë numri i tyre, **ziheshin** të gjitha karriget. f. 218.

Qytetarët ndonjëherë **ziheshin** mesveti se cili do ta tërheqë pajtonin. f. 248.

Më kujtohen edhe emra të tjerë të cilët tani s'kam kohë t'i përmend këtu, se më **zihet** fryma dhe më terratisen sytë e ballit. f. 126.

Kishte shikuar djathtas dhe majtas, përpara dhe mbrapa dhe kishte pikasur një vashë zeshkane, me vetulla të holla, me qerpikë të gjatë e të zez, që lëshonin njëfarë ngjyre të kuqe, që krijonte vazhda nëpër **faqet** e saj të mbufatura. Në **faqen** 416 ja kishte vrarë syrin titulli i romanit "Juda i ngjallur", të cilin Xhezairi e kishte botuar dy vjet më vonë në të njëjtën shtëpi botuese të Vajazanit. f. 256.

Ishin të ndërgjegjshëm, fare të ndërgjegjshëm se nuk mund të ketë **jetë** pa pyetje. f. 257.

Thoshte se çdo njeri është i dhënë pas diçkaje dhe shtonte turravrap se sa më e rëndësishme të **jetë** ajo "diçka", aq më e çmuar është jeta e njeriut. f. 29.

Bekuar qofsh, **ati** ynë që je në qiell, që më shpëtove prej kësaj sëmundjeje fatale! f. 263.

E ku mund të jetë allahile?

Mos ka shkuar tek i **ati**? - e kishte ngushëlluar. f. 59.

Nuk e dinte sa kohë kishte kaluar qyshse kishte dalë prej shtëpisë, por shihte se terri i dendur i asaj nate vjeshtore kishte filluar të tërhiqej, të rrafshohej. Të dobëdohej **para** rrezeve të **para** të zbehta të agut që i kishte sjellë fatkeqësinë. f. 67.

Mos **më** kthe **më**, të lutem baba! f. 55.

Trashja hante **vetëm** dhe nuk përbënte ndonjëfarë grupi të tretë, të cilit i duhej shërbyer si dy të tjerëve. **Vetëm** kur kishte fasule, apo lakra pa mish edhe Trashës i çohet si edhe të tjerëve, sado në enë dhe në lugë të tjera. f. 20.

Pastaj ishte **çar**, kishte nisur të sillej marramendas rreth thesit si të ishin mallkimi dhe urimi i saj në të dhe në fund, na i kishte gozhuar sytë e saj, tani se di, të



përgjakur apo të përлотur! E kishim kuptuar shikimin e saj lutës, ia kishim vënë thesin në shpinë dhe për çudi ajo e kishte **çuar** në mulli. f. 21.

Kishim përhapur fjalën për vdekjen apo vrasjen e Trashës; kishin dalë do burra të papunë **dhe** e kishin futur në **dhe** pranë asaj kodre të vogël, të gjelbëruar ku kishte varrosur mëkatin e gjakut të vet. f. 25.

Mbas punës në dyqanin e tij përfundi shtëpisë që e lodhte, e kapiste, se i duhej të çohet dhe të ulej aq herë gjatë ditës, t'i **priste** dhe t'i përcillte myshterinjtë gjithnjë me fjalë të ëmbla. f. 53.

Për herë të parë dora e tij që aq shkathët përdorte gërshërët, gjilpërën dhe vizoren, kishte mbetur pezull, e shtangur, e mandej ishte shtrënguar si rreth thikës së madhe, me të cilën ai gjithmonë, ia **priste** bukën asaj. f. 55.

Me të kryer të kësaj pune të vështirë që kërkonte një koncentrim të madh dhe mjaft **mund** fizik, kishin dalë anash dhe e kishin shikuar tërë shend e verë monumentin e kolegut të tyre të ndjerë. f. 268.

Pleqtë mendonin se do të **mund** të blinin ilace të shtrenjta që të shëronin sëmundjet e tyre të rënda dhe ta zgjasnin jetën e tyre edhe disa vjet. f. 6.

## MUSA VYSHKA

“Mos m’a grisni abetaren”<sup>448</sup>

Dy muaj **para** se të mbaronte shkolla, ai na thirri ne të dyjave. f. 9.

Po pate **para** tepër, paguaji! f. 45.

## SKËNDER RUSI

“Korçës një fjalë dashurie”<sup>449</sup>

Se **ti** gjithmonë seç bën ca gjëra  
Që çmendurira **t’i** kam quajtur. f. 23.

Ato s’ishin net  
Ishin veç dritare  
**Era** që i hapte ishte kënga. f. 45.  
E dashur **Era!** f. 111.

Ne jemi mbrëmja që **po** ikën. f. 7.

**Po**, ikën ato netë, u tretën. f. 401.

Kush të **pa** e desh të ikte. f. 49.

**Pa** fjetur dhe Korçën e linim. f. 39.

Ndaj ca **i marrë** dhe unë mundem, Kajros t’i jem dukur. f. 24.

Në ardhhtë vdekja të na **marrë**. f. 74.

<sup>448</sup> Vyshka, M. *Mos m’a grisni abetaren*, “Erik”, Tiranë, 2001.

<sup>449</sup> Rusi, S. *Korçës një fjalë dashurie*, Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2010.

**FERIT LAMAJ**  
“Në kopshtin zoologjik”<sup>450</sup>

Kopshti ynë numër **tetë**  
Gjith ditën ish në festë. f. 3.  
**Teta** jonë edukatore  
Na mëson dhe punëdore. f. 7.

U hodh Beni: Në cirk unë  
**Qeshë** me babin një të shtunë. f. 4.  
**Qeshëm**, qeshëm shend e gaz:  
“Po ato janë në kafaz. f. 3.

Milingona, moj e mirë,  
Nuk të **ha** s’është egërsirë. f. 13.  
Hi, hi, hi e **ha, ha, ha**  
Oh, ç’gënjeshtër të mëdha! f. 9.

Edhe frikë s’ka aspak,  
Pa zë mblidhet rrumbullak. f.15.  
Do t’i **zë** peshqit në det  
Dhe me grep, edhe me rrjetë. f. 21.  
Ç’**zë** të ëmbël ka ai:  
Ci, ci, ci e ci, ci, ci... f. 22.

**ILIR BELLIU**  
“Murgu i muzgut”<sup>451</sup>

Heshtja ime  
*ari* prej *ari*. f. 85.

**7.11. Shembuj homonimesh në vepra të letërsisë së huaj të përkthyer në shqip**

**XHAKOMO LEOPARDI**  
“Këngë”<sup>452</sup>

Po ndjenja **dhe** fuqia e talentit **dhe** e dorës. f. 23.  
Nga koha e jetës sate në këtë **dhe**. f. 27.

O **atë**, po s’ndjeve zemërim. f. 27.  
Mbi **atë** det dëborë të tmerrshme. f. 28.

<sup>450</sup> Lamaj, F. *Në kopshtin zoologjik*, Shtëpia Botuese “Rozafa”, Tiranë, 1996.

<sup>451</sup> Belliu, I. *Murgu i muzgut*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2005.

<sup>452</sup> Leopardi, Xh. *Këngë*, Botimet “Argeta LMG”, Tiranë, 2007.

Si **re** vallë dhe kur? f.18.  
Të bëjmë të shkrepë një shkëndijë në **re**. f. 24.  
Të bëjë një të **re** njeri s'mendon. f. 189.

S'thotë dot: O **dhe** i lindjes. f. 19.  
Po ta kthej jetën që ma **dhe** një ditë. f. 19.

Ju **nyje** mbinjerëzore. f. 106.  
Po vdekja më në fund e theu **nyjen**. f. 86.

Më pak e bukur do të **qe** e ngjashme. f. 92.  
Po **qe** se e tillë si ti shoh në mendime. f. 93.

Elvira ime, akoma jam në këtë **dhe**. f. 89.  
Kam vdekur **dhe** më pe për herë të fundit. f. 78

## HENRIK HAJNE

### Poema "Gjermania një përrallë dimri", Lirika I<sup>453</sup>

Mbi **dhe** na rritet grurë plot. f. 23.  
**Dhe** bëja unë dy-tri hapa tutje. f. 46.

Më erdhi në **vesh** një gurgullimë. f. 38.  
Si **veshin** me të bardha, por të kuqe. f. 41.

## ALEKSANDËR S. PUSHKIN

### "Eugjen Onjegini"<sup>454</sup>

Më qan me **lotë** shpirt' i ngratë. f. 68.  
Dridhet e pret e s'**lot** nga vendi. f. 72.

## NIKOLAS SPARKS

### "Ëngjëlli mbrojtës"<sup>455</sup>

**Po** ... më dhemb. f. 30.  
**Po** pyesja me vete nëse do të pëlqente të vije me mua. f. 30.

Ema më ka rrëfyer se i ka pëlqyer që në çastin e **parë** që të ka **parë**. f. 38.  
Të tefonova më **parë**, por nuk ishte. f. 38.

Po atëherë pse ajo përshtypje e turbullt se Rikardi kishte kapërcyer një kufi të trishtuar, **pa** i kërkuar më parë leje? f. 45.  
Duke vështuar përreth, **pa** një kacavidë dhe mendoi se ndoshta me të do të kishte mundur ta ngrinte. f. 35.

<sup>453</sup> Hajne, H. *Poema "Gjermania një përrallë dimri, Lirika I*, Tiranë, 2007.

<sup>454</sup> Pushkin, A. S. *Eugjen Onjegini*, Botimet "Argeta LMG", Tiranë, 2001.

<sup>455</sup> Sparks, N. *Ëngjëlli mbrojtës*, Botimet "Bota Shqiptare", Tiranë, 2005.

Rikardi u kthye dhe e peshoi me vëmendje, **para** se të kthehej përsëri nga ana tjetër. f. 63.

Je pa **para**. f. 61.

## HONORE DE BALZAK

### “Iluzionet e humbura”<sup>456</sup>

Kur e **pa** të birin, të heshtur përpara kësaj liste inventari, plaku Seshar u shqetësua, sepse i pëlqente më tepër që i biri të hahej me të se sa të pranonte pa thënë asnjë fjalë. f. 29.

Ky kostum prej borgjezi ku spikatte punëtori, u shkante aq për shtat veseve dhe zakoneve të tij, dhe shprehte aq mirë jetën e tij, sa ky bablok dukej sikur kishte lindur i veshur, se, **pa** rroba as që mund ta përfytyroje, po ashtu si nuk mund ta përfytyrojmë qepën pa lëvore. f. 23.

Ariu Parvëni pa shkollë e krejt i paditur, e përbuzte shumë diturinë, megjithatë e dërgoi të birin në Paris për të mësuar mjeshtrinë e lartë tipografike, por e porositi me aq këmbëngulje atë që të fitonte sa më shumë **para** në atë qytet.... f. 22.

Më 1821, në ditët e **para** të muajit maj, Davidi dhe Lysjeni rrinin pranë dritares nga ana e oborrit. f. 40.

**Ti** je përtac dhe s’do të bëhesh i pasur. f. 31.

Gjersa David Seshari **t’i** paguante të tridhjetë mijë prangat, të ardhurat do të ndaheshin në mes. f. 31.

**Po** ne kemi shkronja të bukura, të përshtatshme për këtë vepër. f. 44.

**Po**, zotëri - u përgjigj kryepunëtori. f. 44.

## GUSTAV FLOBER

### “Zonja Bavari”<sup>457</sup>

Natën, kur poshtë dritareve të saj kalonin me qerre peshkshitësit duke kënduar “Marzhonelën”, ajo zgjohej nga gjumi **dhe**, si dëgjonte zhurmën e rrotave të hekurta që, në të dalë të fshatit, shuhej përnjëherë mbi **dhe**, thoshte me vete ... f. 60.

## LEON TOLSTOI

### “Ana Karenina”<sup>458</sup>

**Po**, ke të drejtë... - tha Stepan Arkadici duke qeshur me gëzim. f. 69.

Sikur të kishte dëgjuar fjalët që kishin thënë prindërit e vajzës atë mbrëmje, sikur të mendonte edhe ai ashtu siç mendonte edhe familja dhe të mësonte se Kitit do të

<sup>456</sup> Balzak, H.D. *Iluzionet e humbura*, Botimet “Ombra GVG”, 2005.

<sup>457</sup> Flober, G. *Zonja Bavari*, Botimet “Argeta LMG”, Tiranë, 2009.

<sup>458</sup> Tolstoi, L. *Ana Karenina, Vëllimi I*, Shtëpia Botuese “Kokona”, 2006.

pikëllohëj **po** të mos martohej me të, ai do të habitej shumë dhe nuk do ta besonte këtë gjë. f. 66.

Fjalët e guvernantes e sollën në **vete** dhe atë çast iu kujtua nëna dhe takimi që do të kishte me të. f. 71.

“Ç’më gjeti...” - tha me **vete** Kiti dhe atë çast sikur ngriu në vend. f. 55.

Të **vete** a të mos **vete**. f. 12.

Hodhi një sy nga pasqyra dhe u lemeris kur **pa** sa e zbehtë qe në fytyrë. f. 55.

Nuk mund të ndodhte ndryshe - tha ai **pa** e vështruar. f. 57.

I vëllai kishte marrë hua ca **të holla** për të. f. 3.

Shkoi në fshat për të rregulluar shtëpinë me ato shije **të holla** që kishte. f. 4.

Ndjenja e xhelozisë e pushtoi si atë natë, një natë më **parë**. f. 11.

Kur i kishte **parë** bashkë. f. 11.

Dhëndri kishte arritur në **kishë**. f. 16.

Më mirë ta **kishë** veshur me kohë. f. 16.

Kjo është gjëja më e mirë që **mund** të bënte. f. 381.

Kuptoj dhe dua t’u shërbej me **mund** tha ai. f. 388.

Si **i marrë** kishte vrapuar në bankën e stacionit. f. 389.

Nuk kini **marrë** ndonjë telegram pas atij që erdhi dje? f. 389.

Jo baba, ai është shumë i mirë dhe Kostja **e do** shumë. f. 390.

Sikur t’a njihje **do** të më kishte njohur edhe mua. f. 391.

Më fort nga të gjithë fliste djali i ri **i gjatë**. f. 383.

Kishin zëvendësuar besimet e tij **gjatë** kohës së periudhës midis moshave 20 - 30 vjet. f. 394.

Duhet t’i jap hua ca **të holla**. f. 392.

Dukej sikur i kishin lidhur penjëra **të holla** tek kyçi. f. 392.

Ca **re** të ulëta dhe të zeza ishin përpara resë së madhe. f. 421.

Nën hijen e dendur të një plepisteje **të re**. f. 413.

Do të **vija** vetëm një kusht. f. 419.

Duhet të hyjnë në një legjition të veçantë te **vija** e parë dhe të hidhen në sulm. f. 423.

Ose thashë me **vete** se më kishte topitur mendjen. f. 416.

**Vete** andej-këndej me djalë. f. 412.

Ç’mendon **ti**? f. 417.

**T’i** jap edhe ca djalit. f. 417.

E, si **vete**? f. 22.

Nuk kuptonte pse e ndiente veten të penduar: që e kishte bërë për **vetë** Levinin apo që s'kishte pranuar të bëhej gruaja e tij. f. 64.

Jo - u përgjigj Levini, pasi u mendua një copë herë - duhet të **vetë** edhe në disa vende. f. 24.

Akulli është shumë i mirë, mbathini patinat. - Nuk i kam me **vetë** - u përgjigj Levini. f. 34.

Shko, po të duash, por të këshilloj të mos **vesh**. f. 32.

Por princesha nuk merrte **vesh** prej askujt se si duhej martuar vajza tani. f. 52.

Duhej të përpiquej të mposhte këtë frikë, duke bërë këtë arsyetim: meqë **rreth** saj silleshin gjithfarë njerëzish, edhe ai mund të vinte atje e të rrëshqiste me patina. f. 33.

Atë ditë jave dhe në atë kohë të ditës, në sheshin e patinazhit mblidheshin njerëzit e një **rrethi**, që e njihnin mirë njëri-tjetrin. f. 34.

Në këtë **rreth** ishin ndërtuar nëntë pengesa: lumi, një ledh i madh prej dy arshinësh mu përpara tribunës, një hendek i thatë, një hendek me ujë, një faqe kodrine. f. 224.

## **FREDERIK STENDAL**

### **“E kuqja dhe e zeza”<sup>459</sup>**

**Po, po** të mos pranoj, do të përbuzë vetveten më pas. f. 309.

Ajo është marrë **vesh** me të vëllanë për të luajtur me mirëbesimin tim. f. 282.

Të **vesh** veten në rrezik, kjo e lartëson shpirtin dhe e shpëton nga mërzia, ku adhuresit e mi të ngratë duken se janë zhytur, dhe kjo mërzitje është ngjitëse. f. 284.

Në mbrëmjen e ditës së tretë kërshëria zotëroi mbi qëllimin për të **parë** gjithçka, përpara se të paraqitej tek abati Pirar. f. 217.

Ultrarujalistët do të pushtohen gjithnjë nga zilia për t'u bërë **parë** ose fisnikë të Dhomës. f. 214.

Ai u prek pak, kur **pa** prej së largu për herë të parë Parisin. f. 216.

Ti dashke të jetosh në fshat, **pa** i plotësuar dëshirat e fqinjëve, pa dëgjuar bile as thashethemet e tyre. f. 215.

E dini sa para **kisha**? f. 220.

Froni, **kisha**, fisnikëria mund të përmbysen nesër, zotërinj, në qoftë se nuk do të krijoni në çdo departament një repart prej pesëqind vetash besnikë, them besnikë, jo vetëm me tërë trimërinë franceze, por edhe me qëndresën spanjolle. f. 351.

Për një pendë **dhe**, ai i dha Sorelit katër, nja pesëqind çapa më poshtë mbi brigjet e Duit **dhe** megjithëse ky vend ishte shumë më i përshtatshëm, për tregëtinë e tij të dhogave prej bredhi, prapëseprapë, kur kuptoi të fshehtëni që fqinji i tij ishte i paduruar dhe e brente mania e pronarit, xha Soreli, siç e quanin qëkurse ishte bërë i pasur, gjeti marifetin t'i xhvatë një shumë prej gjashtë mijë frangash. f. 9.

<sup>459</sup> Stendal, F. *E kuqja dhe e zeza*, Shtëpia Botuese “Dituria”, 1997.

### “E kuqja dhe e zeza”<sup>460</sup>

I propozoi ta linte **zotin** Dë Renal. f.128.

Falenderonte **Zotin** jo që ja fali, por që ishin pranë tij. f.128.

Zhylljeni që **s’e** ndiente veten mirë. f. 130.

Filloj të mendojë **se** nga ana tjetër kishte varfanjakë. f. 130.

I vinte mirë të dërdëlliste me **ta**. f. 133.

Dë Renal nuk do **ta** priste mirë këtë histori. f. 134.

Në të kthyerat **e para** do të mësoj të fshehtë. f. 139.

Kjo shishe me verë që pini kushton kaq **para**. f. 132.

Kur u nisa nga këtu nëntë ditë më **parë**. f. 141.

Duke **parë** zonjën Dë Renal. f. 141.

Në **jetë** s’më kishin rënë në dorë kurrë kaq para. f. 142.

Po të **jetë** gruaja nuk e përmend dot shtëpinë. f. 132.

Perëndia është e drejtë, unë s’**qeshë** e zonja t’i jap fund mëkatit. f. 146.

Abati Pirar **qeshë** nën buzë. f. 160.

E mora **vesh** i tha ajo e gëzuar. f. 152.

Të **vesh** prapë petkat e mia të zeza. f. 154.

Sikur do ta fuste shtatë pashë nën **dhe**. f. 170.

Për botën **dhe** për salltanetet e saj. f. 174.

Ishte baras me **të holla** që u jepnin atyre që u binin këmbanave. f. 190.

Buzët e tij **të holla** sajnin një gjysëmrrrethi mbi dhëmbët e tij të dala. f. 190.

Ai **zë** një apartament në katin e dytë. f. 196.

Fituesi me një **zë** si të zvarritur tha se shtëpia i mbeti zotit Dë Sen Zhiro. f.146.

### XHANI RODARI

#### “Libri i gabimeve”<sup>461</sup>

Dhe ndërkaq dërdëlliste me **vete**: “I marrë! Nuk jam gjë tjetër veçse një i marrë.”f. 12.

**Vete** dhe gjurmoj gabimet te foljet... f. 12.

Shërbyesja punonte pa pushuar duke mprehur majat e lapsave se profesori harxhonte një **mori** lapsash. f. 56.

<sup>460</sup> Stendal, F. *E kuqja dhe e zeza*, Shtëpia Botuese “Dituria”, 2004.

<sup>461</sup> Rodani, Xh. *Libri i gabimeve*, Prishtinë, 2004.

Desha të them - **mori** guxim e foli shërbyesja, - se nxënësi Bolati është munduar të bëjë një aluzion... f. 56.

Nga një pikëpamje, **po**. **Po** ta vështrosh mirë... f. 56.

Dhe tani, i gjori **bari**, hante bar si bagëti. f. 61.

Tenda e madhe bojë **bari** dhe karrocet e vogla shumëngjyrëshe që e rrethonin, ishin për të e gjithë bota. f. 139.

**Bari** i fushës nuk është rritur aq sa të korret. f. 20.

Pastaj njëri prej tyre u kollit si për të **marrë** guxim dhe tha. f. 11.

I **marrë!** Nuk jam gjë tjetër veçse një i marrë. f. 12.

Shtëpia u shemb e u mbështoll në një **re** pluhuri. f. 26.

Duke qenë se nuk kishte pothuaj fare përvojë lundrimi, nuk e vuri **re** menjëherë këtë gabim. f. 15.

Sot nuk është me **hënë** të mirë. f. 20.

Shpiku një makinë për të shkuar në **Hënë**, një tren që harxhonte energji sa një kokërr orizi për çdo 1000 km, këpucë që nuk griseshin kurrë. f. 41.

Ju shkoni në djall

T'ju vijë **mendja** vërdallë. f. 29.

S'di ç'të të them e marr me **mend**. f. 64.

Profesor Gramatikusi **mend** qau nga mallëngjimi. f. 71.

Udhëve do të bares

Krenare, serbes

Gjithë hare e **gaz**

Sekretin pas. f. 117.

**Gazit** të vjetër hidrogjen

Shpejt ndjesë kërkoji f. 19.

Me **gaz** të madh e presin

Me fjalë e premtime f. 65.

Po kur mbërrin te jazi i shteri gjithë **gazi**. f. 118.

Të gjitha bombat me "H"

Nga **toka** jonë t'i fshijmë. f. 19.

Hiquni mënjane, në doni të mos digjeni i gjallë dhe ju **tok** me këtë shtrigë. f. 73.

Enriku i trishtëm ka **qenë** fatkeq qysh në lindje. f. 75.

Dhe një **qen** pa kokë

Kjo është për çudi

Se qysh mund të lehë

S'e merr vesh njeri. f. 23.

Profesor Gramatikusi një ditë

I doli një vajzë në **pritë**. f. 13.

**Priti** sa i kaloi marramendja dhe nisi të thërrasë. f. 80.



Jam gati t'i **fal** cilitdo, po një mungesë të tillë respekti për vendin e tij nuk ia fal dot. f. 56.

Si tha këto, portieri më **fali** një përkulje tjetër dhe u zhduk. f. 86.

Po deshe që të ngjitesh lart

Në **jetë** dhe në art. f. 20.

Po me siguri do të **jetë**

Njëzet pashë plot. f. 108.

Megjithkëtë, **Zoti** Projeti, duke folur për të birin, thoshte shpesh: - Është djalë i **zoti**, po ç'ë do është ëndërrimtar i madh. f. 130.

Pulat e gjetën një **herë** dhelprën të shtrirë në mes të oborrit. f. 134.

Nga arka e së ëmës merrte **herë** një mantel të kuq, herë një togë të qëndisur, herë një brez të stolisur me gurë të çmuar e një vello mëndafshi. f. 146.

Mirëpo e shpunë te një mjek i gabuar, që nuk ishte në gjendje të shërojë as një **mi** nga frika e maceve. f. 77.

Miq të **mi!** f. 80.

Ishte nota e dytë e shkallës muzikore, banonte pikërisht nën një vijëzë dhe kishte përsipër një "**mi**" me një kororë të madhe në kokë. f. 99.

Veç **para** se të përgjigjesh, mendohu një grimë. f. 103.

Po cili është ai budalla që vete e blen me **para** qeren, atë sëmundje të pështirë? f. 69.

Për të arrirë sa më **parë**

Në atë zabel për të **parë**. f. 106.

Kur të dojë atë e **hap**. f. 95.

I ngrirë si stap

S'bënte dot asnjë **hap**. f. 119.

Gabimin ju e keni në kokë, sepse ende nuk e keni kuptuar se nuk çalon gomari nga **veshi**. f. 102.

Në vrimat e hundës, nëpër **veshë**

Nga mjekra në sup kish tjerë një urrë. f. 125.

S'po të marr **vesh**. f. 127.

I **veshi** dorashka të tejdukshme. f. 145.

Të humbësh një biletë mund të jetë diçka më e keqe sesa t'u ndërrosh vendet dy shkronjave e, në vend të "i-së" të **vesh** një "u." f. 17.

## **XHON LUKA KARAXHALE**

**"Një letër e humbur"**<sup>462</sup>

Turp për qytetin tonë t'i hyjë **data** nga një njeri! f. 11.

Do t'jua provoj me **data** historike që çdo popull ka nga një '64 të tijën. f. 75.

---

<sup>462</sup> Karaxhale, J. L. *Një letër e humbur*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1977.

Të marr një sy gjumë, se **qeshë** këputur fare nga zjarri. f. 16.  
Kacavenku **qesh**. f. 66.

Mos dashke të mbaj erë gaz? f. 66.  
Heq lemezë dhe ia plas **gazit**. f. 65.

Sonte më ra në **vesh**, se dhaskejtë e Kaçavenkut me të tërë zhganin do të bëkan skandal. f. 25.

Të luftojmë: zotrote do të **vesh** kandidaturën, e dimë, unë shpall se do të vë timen....  
luftë elektorale . f. 82.

## 7.12. Shembuj homonimesh në vepra të letërsisë angleze

### 7.12.1. Shembuj homonimesh në veprën “Romeo dhe Zhulieta” nga Uilliam Shekspir-i

Kalamburi përdoret kur ne duam të luajmë me fjalët të cilat mund të shqiptohen ngjashmërisht, por kanë kuptime të ndryshme dhe përdoren për të sjellë nuanca humori. Vepra “*Romeo dhe Zhulieta*” (“*Romeo and Juliet*”<sup>463</sup>) e U. Shekspir-it në letërsinë angleze është një rast i spikatur ku shembuj të ndryshëm të lojës humoristike me fjalët kanë gjetur përdorim të gjerë.

Askush nuk e vë në dyshim mjeshtërinë dhe mprehtësinë e Shekspir-it. Ai ndryshoi gjithë faqen e gjuhës angleze. I njohur për përdorimin e lojës me fjalë, në të gjithë krijimtarinë e tij numërohen rreth 3000 figura të tilla shprehëse. Shekspir-i është një krijues brilant i lojës së fjalëve dhe i përdor ato në veprat e tij për qëllime të ndryshme.

Një prej shumë veprave të shkruara prej tij, nga më të famshmet, e cila u bë sinonim i historive të dashurisë është “Romeo dhe Zhulieta”. Shekspir-i edhe në mes të një historie tragjike dashurie, ja del mbanë të mbajë gjallë humorin e sjellë në formën e lojës së fjalëve.

Në vepër ndeshim personazhe, të cilët shprehin humor në mënyra të ndryshme.

Nuk është e çuditshme që në përgjithësi, të rinjtë janë ata, të cilët luajnë me fjalët. Tragjedia hapet me një skenë të ndërtuar mbi lojë fjalësh. Personazhi Markucio (Markutio) përdor dendur dhe qëllimisht lojën e fjalëve, ndërsa Gregori (Gregory) dhe Sempsen (Sempson) përdorin shpesh një lojë fjalësh të drejtpërdrejtë (të papërpunuar). Infermierja tenton të na sjellë humor duke përdorur, gjithashtu, lojë fjalësh dhe duke përsëritur pohime që ajo i ka përmendur edhe më parë. Piter-i (Peter), gjithashtu, përdor lojëra të mprehta fjalësh në momente të papërshtatshme. Këto personazhe të ndryshme i janë shtuar përsosmërisht veprës, duke ndriçuar atmosferën dhe duke i veshur veprës ngjyra të realitetit.

Loja e fjalëve ndihmonte të hidhte dritë mbi një skenë tragjike ose në kohë, ja dilte mbanë të mahniste audiencën kur krijonte situatë ose ndjenjë, që një personazh përpiqej të shprehte.

---

<sup>463</sup> Shakespeare, W. *Romeo and Juliet*, Washington Square Press, 1992.

Shumë prej këtyre kalambureve kanë në qendër homoniminë. Po sjellim disa shembuj të këtij lloji kalamburi.

### Pjesë të shkëputura nga diskutimi Romeo dhe Markucio

#### Ëndrrat

**Romeo:** And we mean well in going to this mask, but 'tis no wit to go.

**Markutio:** Why, may one ask?

**Romeo:** I dreamt a dream tonight.

**Markutio:** And so did I.

**Romeo:** Well, what was yours?

**Markutio:** That dreamers often *lie*

**Romeo:** In bed asleep, while they do dream things true.

(Akti I, Skena IV)

Personazhi Markucio ndërton një lojë fjalësh që bazohet te homonimet perfekte *lie* “gënjej” / *lie* “shtrihem”. Pra duke i treguar njëri-tjetrit për ëndrrat që kanë parë, Markucio shprehet që këta ëndërrimtarë shpesh *gënjejnë* ose *shtrihen*. Shprehja mund të merret edhe kështu, edhe ashtu.

#### Vallëzimi

**Romeo:** Give me a torch: I am not for this ambling;  
Being but *heavy*, I will bear the *light*.

(Akti I, Skena IV)

Këtu luhet me fjalët *light* “e lehtë”, që është e kundërta e *heavy* “e rëndë” / “e trishtuar”, ndërkohë që Romeo i referohet, gjithashtu, *light* “dritës në pishtar” / “e lehtë”.

**Markutio:** Nay, gentle Romeo, we must have you dance.

**Romeo:** Not I, believe me. You have dancing shoes  
With nimble *soles*. I have a *soul* of lead  
So stakes me to the ground I cannot move.

(Akti I, Skena IV)

Loja e fjalëve ngrihet mbi homofonet *soles* “thembra e këmbës, shuall” / *soul* “shpirt”. Kur personazhi Markucio i kërkon Romeo-s të kërcejë, Romeo refuzon duke

i thënë Markucio-s, që ai është i shkathët për të kërcyer me ‘nimble soles’. Romeo ka përdorur fjalën *sole* kur i referohet këpucëve të Markucio-s dhe më pas krijon lojë fjalësh duke ju referuar shpirtit të tij *soul*.

## Dashuria

**Markutio:** You are a lover; borrow Cupid’s wings,  
And *soar* with them above a common bound.

**Romeo:** I am too *sore* enpierced with his shaft  
To *soar* with his feathers, and so bound,  
I cannot bound a pitch above dull woe:  
Under love’s heavy burden do I sink.

(Akti I, Skena IV)

Markutio i thotë Romeo-s : “Ti je një dashnor; merr krahë dhe fluto shumë lart.”

Loja e fjalëve në këtë situatë ndërtohet me homofonet *soar* “fluturo” dhe *sore* “i lënduar”.

## Lojë fjalësh midis personazheve Gregori dhe Sempson

**Sempson:** Gregory, o’ my word, we’ll not carry coals

**Gregory:** No, for then we should be *colliers*

**Sempson:** I mean, an (if) we be in *choler*, we’ll draw

**Gregory:** Ay, while you live, draw your neck out o’ the *collar*

(Akti I, Skena I)

Tragjedia “Romeo dhe Zhulieta” fillon me një lojë fjalësh të trefishtë ndërtuar me homofonet *collier* “shitës qymyri”, e cila tingëllon si *choler* “zemërim” dhe *collar* “jakë, qafore”.

**Watchman:** We see the *ground* whereon these woes do lie,  
But the true *ground* of all these piteous woes  
We can not without circumstances descry.

(Akti V, Skena III)

“Ne e kuptojmë shkakun e kësaj dhimbjeje,  
Por na duhet të kërkojmë për të zbuluar gjithë ngjarjen.”

Ky pohim është vënë në gojën e dëshmitarit të parë okular, menjëherë pas vetvrasjes së Zhuliet-ës (Juliet). Loja e fjalëve krijohet me fjalët *ground* “toka ku janë shtrirë të dy trupat” dhe *ground* “arsye ose rrethanat që çuan drejt kësaj vdekjeje”.

Kulmi i lojës së fjalëve arrihet me një humor të hollë të Markucio-s në Aktin III, kur ai kupton që është plagosur rëndë. Ai ndalon papritur humorin dhe shpjegon:

**Markutio:** “... ask for me to-morrow, and you shall find me a *grave* man.”

Fjala *grave* “serioz” në këtë kontekst përdoret për ta çuar lexuesin drejt vdekjes së shpejtë të personazhit dhe nënkupton “vdes”.

**Markutio:** Consort? What, dost thou make us minstrels? An thou make minstrels of us, look to hear nothing but *discords*. Here’s my fiddlestick. Here’s that shall make you dance. Zounds, “consort”!

“Prisni?” Kush mendoni ju se jemi ne, muzikantë të një bande? Nëse ju dukemi si muzikantë, mos prisni të dëgjoni gjë tjetër përveç zhurmës (duke prekur tehun e shpatës së tij). Ky është harku im i violinës. Unë do ta përdor atë që t’ju bëj të kërceni. Pastaj më thoni: “Prisni”.

Këto janë fjalët e Markucio-s, ndërsa ai luan me fjalën *discords*<sub>I</sub> “zhurmë nga një instrument i paakorduar” ose *discords*<sub>II</sub> “mosmarrëveshje”.

Kjo vepër e U. Shekspir-it është shkruar e bazuar në periudhën elisabetiane. Publiku i asaj kohe i pëlqente shumë lojëra të tilla fjalësh. Imagjinoni një vendngjarje tek “Romeo dhe Zhuljeta”, ku kalamburi është përdorur gjerësisht para një audience të etur për të, që përpiqet të thithë çfarë thuhet përkundrejt çfarë nënkuptohet. Kjo manifeston qartë bukurinë e gjuhës angleze.

Shekspir-i përdor edhe shumë forma të tjera të humorit në veprat e tij, ndërsa ai synon të befasojë lexuesin e tij dhe ta prijë atë drejt diçkaje të papritur, duke manipuluar gjuhën, duke krijuar lojëra fjalësh, duke rimuar poezi dhe duke ndërtuar metafora, krahasime e figura të tjera letrare.

### 7.12.2. Shembuj homonimesh në veprën “Hamleti” nga Uilliam Shekspir-i<sup>464</sup>

Tragjedia e Hamlet-it, Princit të Danimarkës, është vepra më e gjatë e Shakespeare-it dhe nga më të fuqishmet dhe më me influencë në lëtersinë angleze. Ngjarjet zhvillohen në Mbretërinë e Danimarkës. Ashtu si në veprën e lartpërmendur, edhe këtu Shekspir-i sjell humor brenda një tragjedie, duke përdorur shpeshherë lojën e fjalëve. Disa prej këtyre lojëra fjalësh janë krijuar me homonime. Duke qënë se kalamburi është një formë e dhunshme e gjuhës, Hamlet-i e përdor atë si armën e tij të

<sup>464</sup> Shakespeare, W. *Hamlet (Hamleti)*, 1599.  
<http://www.feedbooks.com>

parë dhe si mënyrë për t'u mbrojtur. Ai i drejtohet me lojën e tij të fjalëve pothuajse çdo personazhi, duke krijuar një lojë gjuhësore sulmi dhe kundërsulmi në gjykatën daneze. Nga ana tjetër, paqartësia e lojës së fjalëve i jep mundësi Hamlet-it t'i shmanget dhënies së një përgjigjeje të saktë.

Po sjellim disa shembuj të spikatur të veprës:

In what partuculat thought to work I know not;  
But in the gross and scope of my opinion,  
This bodes some strange *eruption* to our *state*.

(*Hamleti*, Akti I, Skena I, f. 9.)

Duke përdorur një fjalë polisemantike dhe një homonimike, përshkruhet situata e nderë që është krijuar pas vrasjes së pabesë të mbretit Hamlet. Me lojën e fjalëve, të krijuar nga kuptimet e fjalës polisemantike *eruption* “shpërthim i dhunshëm” dhe homonimeve *state<sub>I</sub>* - “shtet”, mbretëri në këtë rast, shumë mirë mund të kemi një lexim tjetër që vjen po nga kuptimet e tyre, ku *eruption* është “shpërthim puçrash në trup” dhe *state<sub>II</sub>* - “gjendje shëndetsore”.

O, that this too too solid flesh would melt  
Thaw and resolve itself into dew!  
Or that the Everlasting had not *fix'd*  
His *canon* 'gainst self-slaughter! O God! God!

(*Hamleti*, Akti I, Skena II, f.18.)

Nisur nga çfarë mbreti Klaudus kishte thënë më parë, Hamlet-i i përgjigjet përsëri, duke shfrytëzuar dykuptimësinë e krijuar nga një fjalë polisemantike *fixed* - “1. e përcaktuar, e vendosur, 2.e fiksuar në një pozicion” dhe homonimeve *cannon<sub>I</sub>* - “kanun, ligje të pashkruara” dhe *cannon<sub>II</sub>* - “top artilerie”. Mbreti Klaudus kishte folur disa çaste më parë lidhur me topat e vendosura në kështjellë. Kjo fjalë shfrytëzohet nga Hamlet-i për t'ju referuar këtyre ligjeve të pashkruara e të përcaktuara më parë lidhur me vrasjen e të tjerëve për pushtet.

HAMLET

Not so, my lord, I am too much in the *sun*.

(*Hamleti*, Akti I, Skena II, f. 67.)

Kjo është përgjigjja që Hamlet-i i jep pyetjes së Mbretit “How is it that the clouds still hang on you?” (Si ka mundësi që retë akoma janë mbi ty?) Me përgjigjen e tij Hamlet-i nënkupton që Mbreti e ka quajtur atë disa herë *son* “bir”. Si rrjedhim, loja e fjalëve qëndron tek homofonet *sun* “diell” dhe *son* “bir”.

HAMLET: Words, words, words  
 LORD POLONIUS: What is the *matter*, my lord?  
 HAMLET: Between who?  
 LORD POLONIUS I mean, the *matter* that you read, my lord.<sup>465</sup>  
 (*Hamleti*, Akti II, Skena II, f. 64.)

Kjo është një nga citimet më të njohura të Shekspir-it, ku loja e fjalëve krijohet me ndihmën e homonimit *matter*<sub>I</sub> “përmbajtje” dhe *matter*<sub>II</sub> “shkaku i zënies”.

OPHELIA: You are *keen*, my lord, you are keen.  
 (*Hamleti*, Akti III, Skena II, f.100.)

Me anë të mbiemrit *keen* Ofelia (Ophelia) përshkruan Hamlet-in, duke përshkruar dy tipare të tij: nga njëra anë *keen*<sub>I</sub> “i zgjuar, i mprehtë” dhe nga ana tjetër *keen*<sub>II</sub> “i zjarrtë”.

Blasting his wholesome brother. Have you eyes?  
 Could you on this fair mountain leave to feed,  
 And batten on this *moor*? Ha! Have you eyes?<sup>466</sup>  
 (*Hamleti*, Akti III, Skena IV, f.120 – 121.)

Me këto fjalë Hamlet-i i drejtohet së ëmës për t’i hapur sytë lidhur me burrin e ri që ajo ka zgjedhur. Edhe në këtë rast Shekspir-i përdor forcën e lojës së fjalëve me anë të një forme të vetme *moor*<sub>I</sub> “kënetë, tokë e djerrë” dhe *moor*<sub>II</sub> “njeri i zi, me ngjyrë” në kontrast me mbretin e parë që ishte *fair mountain*. Pra, *moor*<sub>I</sub> “kënetë, toka e djerrë” vihet përballë *mountain* “malit”, i cili është *fair*<sub>I</sub> “bjond” ose *fair*<sub>II</sub> “i drejtë”.

Mother, good night. Indeed this counsellor  
 Is now most still, most secret and most *grave*,  
 Who was in life a foolish prating knave.  
 (*Hamleti*, Akti III, Skena IV, f. 126.)

Në këtë kontekst loja e fjalëve krijohet me homonimet *grave*<sub>I</sub> “varr” dhe *grave*<sub>II</sub> “njeri i rëndë, serioz”. Shekspir-i i përshtat shumë mirë të dy kuptimet brenda

<sup>465</sup> Shakespeare, W. *Hamlet*, 1599.

<http://www.feedbooks.com>

<sup>466</sup> Po aty

të njëjtit kontekst. Pas vrasjes së Polonius-it, të dyja njësitë leksikore me kuptimet e tyre përkatëse i përshtaten kontekstit.

HAMLET

Thou dost *lie* in't, to be in't and say it is thine

Tis for the dead, not for the *quick*; therefore thou *liest*.<sup>467</sup>

(*Hamleti*, Akti V, Skena I, f. 169.)

Mjeshtëria e shkrimtarit në këtë situatë është shumë e dukshme. Ai përdor këto homonime në të njëjtin kontekst, ku të dy kuptimet janë krejtësisht të kundërta me njëri-tjetrin. Kuptimet e fjalëve *quick*<sub>I</sub> “i gjallë” dhe *quick*<sub>II</sub> “i paduruar, i nxituar” dhe *lie*<sub>I</sub> “gënjej” dhe *lie*<sub>II</sub> “shtrihem” përkojnë më së miri me njëri-tjetrin.

### 7.12.3. Shembuj homonimesh në veprën “Liza në botën e çudirave” nga Luis Kerëll (Lewis Carroll)<sup>468</sup>

Luis Kerëll është një shkrimtar që përdor me shumë mjeshtëri lojën e fjalëve në veprën “Liza në Botën e Çudirave”. Vepra vjen në formën e lojës, ashtu siç është edhe aventura e Lizës në këtë botë. Emrat e vendeve, emrat e personazheve, emrat e lëndëve si dhe mosrespektimi i rregullave gjuhësore janë në përputhje me atë botë aq të ndryshme nga bota reale. Po sjellim disa raste të lojës së fjalëve, që përdor autori ndërtuar mbi homoniminë.

“Mine is a long *tale*”, said the Mouse, turning to Alice, and sighing. “It is a long *tail*, certainly,” looking down with wonder at the Mouse’s tail; “but why do you call it sad?” And she kept on puzzling about it while the Mouse was speaking, so that her idea of the tale was something like this:

“Fury said to

a mouse, that

he met in the house, ‘Let

us both go

law: I

will prosecute you.

Come, I’ll

take no denial; We

must have

a trial:

For really

this morning I’ve

<sup>467</sup> Po aty

<sup>468</sup> Carroll, L. *Alice’s Adventure in Wonderland (Liza në botën e çudirave)*, June 2008.

<http://www.gutenberg.org/files/11/11-pdf.pdf>



nothing  
 to do.”  
 Said the  
 mouse to  
 the cur,  
 ‘Such a trial,  
 dear Sir, with  
 no jury  
 or judge  
 would  
 be wasting our  
 breath.’  
 I’ll be  
 judge  
 I’ll be  
 Jury, ‘  
 Said cunning  
 Old  
 Fury:  
 “I’ll  
 try  
 the  
 whole  
 cause,  
 and  
 condemn  
 you to  
 death.”

(Kapitulli III, *The Mouse’s tale*)

Në këtë mënyrë Luis Kerëll kupton gabimet e padëshiruara të Lizës, për shkak të homonimisë së fjalëve *tale*<sub>I</sub> “përrallë” dhe *tail*<sub>II</sub> “bisht”, ndërkohë që para lexuesit shfaqet strofa në formën e bishtit të Miut *mouse’s tail*. Loja e fjalëve këtu krijohet bazuar në këto dy homophone të gjuhës angleze: *tale*<sub>I</sub> em. “tregim” dhe *tail*<sub>II</sub> em. “bishti i kafshës”.

“And how many hours a day did you do *lessons*?” said Alice, in a hurry to change the subject.

“Ten hours the first day,” said the Mock Turtle: “nine the next and so on.”  
 “What a curious plan!” exclaimed Alice.

“That’s the reason they’re called *lessons*,” the Gryphon remarked: “because they *lessen* from day to day.”<sup>469</sup>

(Kapitulli IX. *The Mock Turtle’s Story*, f. 45.)

---

<sup>469</sup> Caroll, L. *Alice’s Adventure in Wonderland*.  
<http://www.gutenberg.org/files/11/11-pdf.pdf>

Homofonet *lesson<sub>I</sub>* “mësim” dhe *lessen<sub>II</sub>* “zvogëlohen” dalin në të njëjtin situatë, me dy kuptime të ndryshme, ku jepet edhe arsyeja pse ato quhen “*mësime*”, sepse “*zvogëlohen*” çdo ditë.

“You promised to tell me your history, you know,” said Alice, “and why it is you hate - C and -D,” she added in a whisper, half afraid that it would be offered again.

“Mine is a long and a sad *tale!*” said Alice, turning to Alice, and sighing.

“It is a long *tail*, certainly,” said Alice, looking down with wonder at the Mouse’s *tail*; “but why do you call it sad?” And she kept on puzzling about it while the Mouse was speaking, so that her idea of the tale was something like this: ...

(Kapitulli III. *A Causus-Race and a Long tale*, f. 12.)

Keqkuptimi që ndodh midis Lizës dhe Miut vjen si rezultat i përdorimit të dy homofoneve *tale<sub>I</sub>* “përrallë” dhe *tail<sub>II</sub>* “bisht”. Kur Miu thotë që historia ime është një “rrefënjë” e gjatë dhe e trishtuar, Liza e keqkupton, duke i parë bishtin e çuditur; pra, pse “bishti” i tij ishte i trishtuar, kurse ... ai ishte i gjatë, kjo gjë dihej.

“You are not attending!” said the Mouse to Alice severely. “What are you thinking of?”

“I beg your pardon,” said Alice very humbly: “you had got to the fifth bend, I think?”

“I had *NOT!*” cried the Mouse, sharply and very angrily.

“A *knot!*” said Alice, always ready to make herself useful, and looking anxiously about her. “Oh, do not let me to undo it!”

(Kapitulli III. *A Causus-Race and a Long tale*, f. 13.)

Homonimet e anglishtes *knot* “nyje” dhe *not* “pjesëz mohuese” nuk sjellin një situatë qesharake në keqkuptimet ndërmjet Lizës dhe Miut, i cili e mohon gjendjen e tij jo të mirë mendore, kurse Liza kujton se bishti i tij është ngatërruar dhe është lidhur duke formuar një nyjë.

“Just think of what work it would make with the day and night! You see the earth takes twenty-four hours to turn round on its *axis* ”

“Talking of *axes*,” said the Duchess, “chop off her head!”

(Kapitulli VI. *Pig and Pepper*, f. 26.)

Përdorimi i homonimeve *axis* “bosht” dhe *axes* “shumësi i ax” “sëpatë” shkakton keqkuptim. Biseda ndryshon rrjedhën e saj. Ndërsa më parë ishin duke folur për rrotullimin e tokës rreth boshtit të saj, më pas flitet për prerjen e kokës me sëpatë.

“Boots and shoes under the sea” the Gryphon went on in a deep voice, “are done with a whiting. Now you know.”

“And what are they made of?” Alice asked in a great curiosity.

“*Soles* and *eels*, of course,” the Gryphon replied rather impatiently: “any shrimp could have told you that.”

(Kapitulli X. *The Lobster Quadrille*, f. 48.)

Edhe në këtë shembull dykuptimësia e krijuar nga përdorimi i homonimisë është e përkryer. Duke folur për këpucët dhe çizmet që gjenden në det, autori përdor homoniminë dhe paroniminë për të luajtur me fjalët. Dihet që këpucët bëhen nga *sole*<sub>I</sub> “shuall” dhe *heels* “taka”, por meqënëse jemi në det, atëherë ato fare mirë mund të jenë *sole*<sub>II</sub> “shojzë deti” dhe *eels* “ngjala”.

“You can draw water out of a *water-well*,” said the Hatter; “so I should think you could draw treacle out of a *treacle-well* – eh, stupid?”

“But they were IN the *well*,” Alice said to the Dormouse, not choosing to notice this last remark.

“Of course they were”, said the Dormouse; “*well* in.”

(Kapitulli VII. *A Mad Tea-Party*, f. 33 – 34.)

Në këtë dialog biseda bëhet rreth një pusi *well*<sub>I</sub> me shurupin e melasës. Përderisa ekziston një pus uji *water-well*, pse të mos ketë edhe një pus me melasë. Ndërkohë që Liza flet për ata që ndodheshin brenda në pus, Miu Gjumash e pranon me një siguri të plotë, duke e përforcuar se ata ishin plotësisht *well*<sub>II</sub> ndajf. “mirë” atje brenda.

Now, Dinah, tell me the truth: did you ever eat a bat?” when suddenly, thump! thump! Down she came upon a heap of sticks and dry leaves, and the *fall* was over.

(Kapitulli I. *Down the Rabbit-Hole*, f. 4.)

Rrëzimi i Lizës përkon edhe me natyrën e mbushur me gjethe të thata dhe shkarpa drurësh të rrëzuar nga vjeshta. Këto dy kuptime jepen me homonimet *fall*<sub>I</sub> “rënie” dhe *fall*<sub>II</sub> “vjeshtë”.

“Of course it is,” said the Duchess, who seemed ready to agree to everything that Alice said; ‘there’s a large mustard-*mine* near here. And the moral of that is – “The more there is of *mine*, the less there is of yours.”

(Kapitulli IX. *The Mock Turtle’s Story*, f. 41.)

Dukësja flet për “minierën” e mustardës *mine*<sub>I</sub> dhe njëkohësisht ajo nxjerr një konkluzion lidhur me të. Sa më shumë të ketë ajo për veten e saj *mine*<sub>II</sub> “e imja”, aq më pak do të mbetet për të tjerët.

“When we were little.” the Mock Turtle went on at last, more calmly, though still sobbing a little now and then, “we went to *school* in the sea. The master was an old Turtle – we used to call him Tortoise”

(Kapitulli IX. *The Mock Turtle’s Story*, f. 43.)

Brenda këtij konteksti, kuptimet e homonimeve *school<sub>I</sub>* “shkollë” dhe *school<sub>II</sub>* “grup peshqish të një lloji” dalin në harmoni të plotë. Breshka e Rreme tregon për shkollën ku ajo shkonte kur ishte e vogël. Shkolla ishte nën det dhe krijesat e tij ishin të grupuara sipas llojit të tyre.

## PËRFUNDIME

Në këtë punim, në përpjekje të vazhdueshme për të arritur në përfundime sa më të drejta e në analiza raportesh të pranëvëna sa më natyrshme, na u desh të kalonim përmes situatash, veçantish e ngjashmërisht, që disa herë dukeshin të qarta e shumë herë të tjera të fshehura mes shtresime kohërash, kulturash dhe drejtimesh semiologjike e gjuhësore. Në këtë tekst të endur muaj pas muaji, u synua të hidhej dritë mbi marrëdhënie të cituara edhe më përpara nga studime kritike semiologjike e gjuhësore. Këto raporte autorësh e kulturash të ndryshme leksikore, përtej vështirësive e dyshimeve të vazhdueshme që ofronin, na ushqyen edhe me një kënaqësi të madhe, të tillë që mund ta ofrojë vetëm semiologjia, leksikologjia dhe të shijuarit e studimeve të mëdha në plan krahasues. Por, përtej kënaqësisë duhet thënë se ishte edhe një përgjegjësi jo e vogël t'u afroshesh emrave të këtyre autorëve të mëdhenj në lidhje me dukurinë e shenjës gjuhësore dhe atë të homonimisë.

Duke u nisur nga çështjet e parashtruara në **pjesën e parë** të punimit, arrijmë në këto përfundime:

- Çfarë është semiologjia? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje mjafton të sjellim ndërmend përvojën e përditshme të secilit prej nesh. Nëse do të kërkojmë kuptimin në ndonjë fjalor çfarëdo të termit *semiotikë*, do të mësojmë se kjo vjen nga fjala greke *semeion* “shenjë” dhe *semeiotikos* “që lidhet me shenjat”. Nëse me shenjë kuptojmë diçka që shpreh ose na sjell ndërmend diçka tjetër, atëherë mund të themi se e gjithë jeta jonë lëviz brenda shenjave. Semiologjia ka një histori të gjatë, rrënjët e së cilës shkojnë thellë në antikitetin grek. Në kohë më të vonshme, nevoja për të përvijuar linjat e një disipline të vërtetë e të mirëfilltë shkencore me këtë emër, është bërë më e fortë në gjysmën e dytë të shekullit XIX, nga një filozof i drejtimit pragmatik, amerikan, Çarls Sandërs Pirs dhe në fillimet e shekullit XX nga gjuhëtari zviceran Ferdinand de Sossyr në veprën e tij “*Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*”.
- Vetitë e *shenjës së mirëfilltë* mund të cilësojnë një klasë ngjarjesh të prodhuara nga qeniet e gjalla, njerëzore ose lloje të tjera gjallesash, duke shtuar, të gjitha sistemet e krijuara nga njeriu me qëllim të veçantë përmbushjen e një funksioni komunikativ (sinjalistika e tipeve të ndryshme, sistemet e alarmit, programet e shkrimit në kompjuter etj.) është e zakonshme të përdoret termi *qëllimshmëri* për të karakterizuar shenjat e mirëfillta dhe të vërteta, të realizuara sipas rregullave të parashikuara nga një *kod* në bazë të korrespondencave të qartësuar mes shprehjes dhe përmbajtjes.
- Semiologjia është teoria e *shenjave gjuhësore* dhe *jogjuhësore*, si dhe e proceseve shenjuese. Në këtë mënyrë ajo është e interesuar për:
  - lidhjen midis shenjave të ndryshme (sintaksë);*
  - lidhjen midis shenjës dhe kuptimit të saj (semantikë);*
  - lidhjen midis shenjës dhe përdoruesit të saj (pragmatikë).*
- *Linguistika* ose *shkenca mbi gjuhën* shihet si pjesë përbërëse e shkencës mbi shenjat. Nëse këtë tezë e marrim në kuptimin më të gjerë të saj, arrijmë në

përfundimin se semiologjia i zgjeron kompetencat e saj shkencore dhe metodologjike dhe se gjuhësia dhe zbatimi i saj është pjesë e semiologjisë.

- Ka tri modele kryesore, të cilat japin një shpjegim të hollësishëm të formimit të një shenje (gjuhësore). Këto janë modelet e Ferdinand de Saussure-it, Çarls Sandërs Pirs-it dhe Karl Buhler-it.
- Dy modelet më të përhapura mbi shenjat gjuhësore janë ato të gjuhëtarit Ferdinand de Saussure dhe filozofit amerikan Çarls Sandërs Pirs. Të dy kanë koncepte shumë të ndryshme mbi atë se çfarë tregon një shenjë. Saussure-i beson se shenja gjuhësore nuk është shoqërimi midis një objekti dhe një emri, por lidhja midis një koncepti dhe një strukture tingujsh, ku struktura e tingujve nuk është një tingull aktual dhe as fizik. Ai beson se struktura tingullore është përshtypja psikologjike e dëgjuesit për një tingull dhe si ai perceptohet nga shqisat. Saussure-i beson se natyra arbitrare e shenjës bën të qartë parimin e parë të gjuhës.<sup>470</sup> Më pas, Çarls Hokit e klasifikoi arbitraritetin si çelës të *tiparit të projektimit* të gjuhës.<sup>471</sup> Në kundërshtim me këtë, Pirs-i besonte se shenjat janë mjeti ynë i vetëm i të menduarit. Shenjat mund të marrin formën e imazheve, fjalëve, aromave, objekteve ose veprimeve, por, në fakt, atyre u mungon kuptimi i trashëguar dhe ato bëhen shenja vetëm kur ato pajisen me një kuptim. Pirs-i pohon se asgjë nuk përbën një shenjë nëse nuk interpretohet si e tillë dhe nuk shenjon diçka.<sup>472</sup> Arsyeja pse një shenjë ekziston është të mbartë një kuptim. Ndërsa modeli Organon i gjuhës (sipas greqishtes *organon* “vegël”) i formuluar nga psikologu gjerman Karl Buhler, përkufizon funksionet komunikuese sipas të cilave mund të përshkruhet komunikimi gjuhësor.
- Mendohet se nuk ka një model të përsosur të shenjës (gjuhësore), kështu që është shumë e vështirë për të vendosur se cili prej tyre është më i miri. Rekomandohet që për çdo shenjë gjuhësore, funksionin e saj dhe madje dhe “aktin e të folurit”, fillimisht duhet menduar rreth çdo modeli në vetvete dhe pastaj të përpiqemi të gjejmë modelin që i përshtatet më mirë situatës së dhënë. Nëse do veprime ndryshe, kjo do të çonte në një situatë kaotike. Vëmë re se çdo model ofron një shumëllojshmëri teorish dhe mundësish.
- Çdo shenjë gjuhësore, nga natyra e saj, ka karakter spontan. *Spontaniteti* shpreh rastësi, *arbitraritet* dhe mungesë natyrshmërie/rregullsie në formim. Gjuha dhe shenjat janë formuar pikërisht në këtë mënyrë. Askush nuk i ka shpikur shenjat gjuhësore dhe askush nuk ka rënë dakord mbi kuptimin e fjalëve të formuara.
- Me *asimetri* të shenjës gjuhësore kuptohet mungesa e një lidhjeje midis kuptimit dhe formës. Një formë mund të shprehë shumë kuptime dhe një kuptim mund të shprehet nga shumë forma. Kjo asimetri e lidhjeve midis formës dhe kuptimit shfaqet te homonimia, sinonimia, polisemia, dykuptimësia dhe komplikime të ndryshme semantike në nivelin sintagmatik.<sup>473</sup>

<sup>470</sup> Po aty. f. 59.

<sup>471</sup> Hockett, Ch. F. *Animal “Languages” and Human Languages*, te Spuhler, J. N. *The Evolution of Man’s Capacity for Culture*, Detroit, MI, Wayne State University press, 1965, f. 32 – 39.

<sup>472</sup> Peirce, Ch. S. *Collected Writings* (Vëllimi II), Cambridge, MA, Harvard University Press, 1931, f. 58.

<sup>473</sup> <http://studopedia.org/6-11674.html>

- Duke pasur parasysh interesin e semiologjisë mbi semantikën duhet kuptuar edhe lidhja e tyre në komunikimin e kuptimit. Të dyja fushat ndajnë një interes të përbashkët në lidhje me kuptimin e shenjave. Xhon Sturrek-u<sup>474</sup> thekson se ndërsa semantika fokusohet në dimensionet denotative (kuptimi i parë i fjalës) të kuptimit të fjalëve, semiologjia ofron një ide më të gjerë të kuptimit duke u fokusuar në dimensione denotative dhe konotative (kuptimi figurativ) të shenjave.

Në **pjesën e dytë** të punimit objekt i hulumtimit tonë është bërë dukuria gjuhësore (semantike) e homonimisë.

Nga analiza e çështjeve të homonimisë në gjuhën shqipe dhe angleze, u arrit në përfundimet e mëposhtme:

- Çështja e homonimisë në të dyja gjuhët sot është shumë aktuale.
- Ngrihen një sërë pyetjesh për fushën e homonimisë, por më i rëndësishmi është problemi i dallimit të fjalëve homonimike nga ato polisemantike.
- Mjaft gjuhëtarë janë marrë me problemin e homonimisë në të dyja gjuhët, në të shkuarën dhe në të tashmen. Në veçanti, Jani Thomai dhe Xhevat Lloshi ishin ndër të parët, që hulumtuan çështjen e homonimisë në gjuhën shqipe.
- Në lëmin e studimeve gjuhësore homonima zë një vend të rëndësishëm. Ajo trajtohet teorikisht dhe qasjet me karakter praktik janë të pashmangshme. Studimet e kohëve të fundit lidhen më teknologjinë e informacionit dhe përpunimin e të dhënave nga korpuset elektronike, me qëllim që të shmangin sa më tepër gabimet gjatë marrjes së informacionit.
- Një studim i thelluar i materialit mbi metodën krahasuese, vendos ballë për ballë dukurinë leksikore në gjuhën shqipe dhe atë angleze, në aspekte rëndësore të studimit, përdorimit dhe zhvillimit të tij. Kjo përbën edhe qëllimin e kësaj teme.
- Homonimia, tingëllimi ose forma grafike e njëjtë (ose të dyja së bashku) e njërive të ndryshme leksikore, zë një vend të veçantë në të dy gjuhët.
- Arsyeja kryesore e lindjes së saj është se gjuha ndryshon, lëviz, zhvillohet në të gjitha pjesët e sistemit të saj.
- Vihet re që prania e homonimeve në gjuhë është rezultat i shumë faktorëve të brendshëm gjuhësorë, që mund të veprojnë së bashku ose në lidhje me njëri-tjetrin. Prania e homonimeve në secilën prej dy gjuhëve lidhet me veçori karakteristike të tyre. Në gjuhën shqipe shumica e homonimeve janë krijuar si rrjedhojë e shpërbërjes së polisemisë. Shqipja është një gjuhë mjaft flektive, në të cilën tema rrallë përputhet me rrënjën, ndërsa homonime që krijohen nga përputhja rastësore e formave, ndodhin akoma më rrallë.

---

<sup>474</sup> Sturrock, J. *Structuralism and science: From Levi Strauss to Derrida*, Oxford University Press, 1979, f. 48.

Në gjuhën angleze struktura rrokjesore e fjalëve është një nga faktorët më të rëndësishëm të pranisë së homonimeve. Këtu mbizotërojnë fjalët njërrrokëshe dhe si rrjedhim, ka shumë homonime të tilla. Theksojmë, gjithashtu, që shumica e fjalëve në gjuhën angleze kanë një polisemi shumë të zhvilluar, që çon në zhvillimin e kuptimeve të cilat gradualisht ndodh të shkëputen nga kuptimi qendror.

- Nga vëzhgimet mbi homonimet në gjuhën shqipe dhe atë angleze, del se ato kanë lindur nga fjalëformimi, përputhja fonetike, huazimi i fjalëve të ndryshme, nga dialektet, e së fundi, në raste të veçanta, homonimia lind për shkak të largimit të madh të kuptimeve të po asaj fjale, dmth, për shkak të zbërthimit të polisemisë.
- Kalimi nga polisemia në homonimi shpreh zhvillime të thella semantike në gjuhë dhe veprime ndërmjet elementit të qëndrueshëm dhe të lëvizshëm në semantikë. Për këtë arsye, homonimia shpesh quhet edhe shkalla më e lartë e polisemisë.
- Pra, shprehje e lëvizjeve në gjuhë është, si lindja e homonimeve me rrugë të ndryshme, ashtu edhe çdo ndryshim në kuptimet, të cilat mund të çojnë, gjithashtu, deri në homonimi. Këto ndryshime, të çdo lloji qofshin: ngushtime, zgjerime, përskajime, humbje etj., përbëjnë zhvillim të gjuhëve, pasi janë shprehje e prirjeve të tyre për t'u përsosur, për ekonomizimin dhe fuqizimin e mjeteve të tyre, për diferencime relevante etj.
- Që këtë del veçoria specifike e homonimisë. Ajo nuk është një rregull, një ligj, një marrëdhënie e lidhje e nevojshme në sistemin e gjuhës, *ajo është vetëm një rezultat, një pasojë* e veprimit të rregullave e ligjeve të tjera të gjuhës, që vetëm rrallëherë bëhet *shkak* ndryshimesh.<sup>475</sup>
- Lindja e homonimeve mbetet edhe sot një proces i gjallë, sepse gjuha është në lëvizje të pandërprerë. Duke krahasuar numrin aktual të homonimeve me rezultate të mëparshme, vihet re se në gjuhën angleze, ajo ka marrë një zhvillim shumë më të madh se në atë shqipe. Karakteri njërrrokësh i kësaj gjuhe indoevropiane përbën, përveç të tjerash, arsyen kryesore të këtij zhvillimi.
- Rastet që u përmendën gjatë temës mbi ndikimin e homonimisë në gjuhë përfshijnë vetëm pak nga ajo, që mund të vërehet në të dyja gjuhët. Studimi i gjeografisë së fjalës do të plotësonte njohuritë tona mbi ndikimin e vërtetë të homonimisë për të dyja gjuhët. Megjithatë, numri i këtyre shfaqjeve nuk është i madh, duke marrë parasysh numrin e madh të homonimeve në këto gjuhë, sidomos në anglisht. Pra, një gjuhë vetëm në raste të rralla reagon ndaj homonimeve.
- Në të dyja gjuhët dukuria klasifikohet nga këndvështrime të ndryshme si: rruga e formimit, shkalla e përputhjes etj. Tipat më tradicionalë në të dyja gjuhët janë homografet dhe homofonet. Homofonet janë të shumta në anglisht dhe në të kundërt të rralla në shqip. E rëndësishme është të përmendet se perceptimi i

<sup>475</sup> Lloshi, Xh. *Rreth disa shfaqjeve të ndërlikimit të homonimisë në gjuhën shqipe, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, Mihal Duri, Tiranë, 1972, f. 233.



ngjashmërisë midis fjalësh është subjektiv dhe shpesh mund të ndryshojë nga personi në person. Në rastin e homofoneve, thekset lokale të fjalëve mund t'i krijojnë ose kundërshtojnë ato. Duke analizuar klasifikime homonimesh në të dyja gjuhët, vëmë re se studiues të ndryshëm bazohen në kritere të ndryshme. Si rrjedhim, klasifikimet janë të llojeve të ndryshme.

Duke krahasuar klasifikime të homonimeve në të dyja gjuhët arrijmë në këto përfundime:

- a. Përputhje të plotë klasifikimi gjejmë vetëm në rastin e homonimeve perfekte/homoformave, homofoneve dhe homografeve.
  - b. Vëmë re ngjashmëri klasifikimi në këto raste:
    - Homonimet leksikore dhe homonimet leksiko - gramatikore ekzistojnë në të dyja gjuhët.
    - Homonimet e pjesëve të ligjeratës ekzistojnë, gjithashtu, në të dyja gjuhët.
    - Si në gjuhën shqipe edhe në atë angleze përmenden homonimet e plota leksikore dhe homonimet e pjesëshme leksikore.
  - c. Vëmë re ndryshime në klasifikim në këto raste:
    - Klasifikimi i Xhon Lajëns-it është i veçantë dhe i hollësishëm. Tiparet dalluese të homonimeve vlerësohen njëherazi. Nuk ka një të tillë në gjuhën shqipe.
    - Në gjuhën shqipe nuk përmenden homonimet gramatikore.
    - Në gjuhën angleze nuk përmendet klasifikim i homonimeve sipas burimeve të tyre.
    - Në gjuhën angleze nuk ekziston klasifikimi i mirëfilltë i homonimeve me lidhje etimologjike dhe jo-etimologjike, megjithëse aty – këtu përmendet diçka shkarazi.
- Karakteri shumëfunktional i një gjuhe çon drejt shumëkuptimësisë të fjalëve. Nëse kuptime të ndryshme të fjalës lidhen nga ana sistematike, atëherë lind pyetja si këto kuptime janë prejardhur nga njëra-tjetra dhe si duhet të organizohen për të pasqyruar rregullsinë e tyre në kuptimin denotativ? Përgjigjen e kësaj pyetjeje e gjejmë në kapitullin e tretë të temës, ku bëhen përpjekje për të identifikuar tiparet dalluese midis fjalëve polisemantike dhe homonimike të një gjuhe. Një përgjigje e saktë e kësaj pyetjeje çon në kapërximin e problemeve të paqartësisë të kuptimit të fjalëve.
  - Këto fjalë, që shqiptohen njësoj dhe ndonjëherë edhe shkruhen njësoj, dmth, homonimet, duhen njohur jo vetëm për formim teorik, por edhe praktik. Në situata të veçanta brenda gjuhës, ato krijojnë vështirësi për t'i dalluar e përdorur në ligjërim. Numri i tyre në rritje çon pa dyshim drejt paqartësisë. Megjithatë, rrallë ndodh që paqartësi të kësaj natyre të ndikojnë te kuptimi. Kjo, sepse në dinamikën e gjuhës së gjallë dhe veçanërisht në ligjërimin letrar, homonimia merr vlera shprehëse stilistikore për të ndërtuar lojra fjalësh ose kalambure. Prania e tyre në një titull gazete, reklamë, prozë, poezi, fjalëkryq etj. tërheq vëmendjen dhe ngjall interes tek lexuesi dhe dëgjuesi. Si të tilla, ato jo gjithmonë përbëjnë një fushë problematike. Shumica e tyre janë një burim i vërtetë humori me anë të lojës së fjalëve. Zhvillimi i teknologjisë ka sjellë përdorimin e tyre në internet.

Shpeshherë homonimia duket se e vështirëson kuptimin e përmbajtjes së një thënieje, siç ndodh kur nuk njihet gjuha apo në situata të caktuara ligjërimi.

Si rrjedhim, homonimet përftojnë mjete stilistikore. Prania e tyre në stile të ndryshme e bën gjuhën tërheqëse, interesante, të gjallë, plot nota humorit për dëgjuesin ose lexuesin.

Në ligjërimin e zakonshëm, homonimia nuk bie në sy, madje janë gjuhëtarët, që e tregojnë si dukuri, përndryshe folësit e zakonshëm nuk e njohin aspak.

Në gjuhën shqipe nuancat stilistikore janë të ngjashme me ato të anglishtes, megjithatë dukuria nuk ndeshet shumë shpesh. Në letërsinë shqipe homonima rrallë është parë si burim shprehësie. Në gjuhën angleze, ajo është një dukuri e shpeshtë dhe loja me afrimin e homonimeve është mjaft e përhapur në letërsi dhe në prozë, ashtu edhe në poezi, në gjuhën e fëmijëve, gazetari, gjuhën kompjuterike, fjalëkryqe, reklama, gjuhën e përditshme etj. Shembujt e dhënë janë të shumtë në të dyja gjuhët.

- Ndërsa në gjuhën angleze janë hartuar shumë fjalorë homonimikë, para leksikografëve të shqipes shtrohej vazhdimisht detyra e hartimit të një fjalori të veçantë homonimik, i cili do shërbente si mbështetje për punimet e ardhshme leksikografike. Kjo nevojë në rritje, nxiti disa leksikografë të gjuhës shqipe të punojnë dhe të sjellin vitet e fundit përpara lexuesve disa fjalorë të tillë homonimikë.
- Një fjalor i qartë dhe i lehtë në përdorim kërkon që homonimet të paraqiten njësoj, sipas kriterëve të caktuara më parë. Zakonisht, fjalorët i paraqitin homonimet nën fjalë tituj të veçanta, pra si fjalë të ndryshme. Megjithatë, kjo nuk përbën një kriter të domosdoshëm.  
Homonimia në praktikën leksikografike ka qënë shpesh një burim problemor. Duke vëzhguar homoniminë në praktikën leksikografike shqipe dhe atë angleze, vihet re se shumë prej problemeve janë të ngjashme, por secila gjuhë ka edhe veçoritë e saj në këtë drejtim. Pikat e mëposhtme janë të përbashkëta në trajtimin e dukurisë leksikore në fjalor për të dyja gjuhët.
  - Kërkesa themelore që shtrohet para çdo fjalori është të arrihet një paraqitje sa të jetë e mundur më e drejtë dhe sa më e përpiktë nga ana shkencore e sistemit leksikor të gjuhës, për periudhën, të cilës i përket fjalori, në dritën e një çështjeje të ngushtë, siç është homonimia.
  - Problem i formës themelore, formës përfaqësuese të fjalës në fjalor, ka gjetur zgjidhje të ndryshme sipas autorëve të ndryshëm dhe si rezultat, kjo sjell luhajtje të mëdha të numrit të homonimeve në një gjuhë.
  - Vështirësia më e madhe në të dyja gjuhët, del në sistemin e dhënies së homonimeve, në mënyrën grafike të dallimit të tyre nga kuptimet e një fjale të vetme. Çështja është se brenda të njëjtit fjalor shpesh, nuk ruhet i njëjti parim.
  - Që këtë del si kërkesë për çdo fjalor në të dyja gjuhët, që homonimet të pasqyrohen sipas një parimi të vetëm, të caktuar që më parë dhe të dallohen nga ana grafike në mënyrë të njëjtë. Vendin e parë nga renditja, është e mira ta zërë fjala homonime, që është më e përdorur / më e përhapur.
  - Vendosija e një kriteri universal të dallimit homonimi – polisemi, përbën një problem tjetër të përbashkët në leksikografinë e të dyja gjuhëve. Homonimet që dalin nga zbërthimi i polisemisë kanë patur vështirësi paraqitjeje në fjalor sepse

në disa raste nuk mund të caktohet me përpikmëri nëse kemi një fjalë me dy kuptime a dy fjalë me kuptime të ndryshme.

- Është detyra e leksikografit të përcaktojë kufijtë e çdo fjale, dmth, të diferencojë homonimet dhe të vendosë në çdo rast nëse kuptimet e ndryshme i përkasin të njëjtës fjalë polisemantike apo duhen trajtuar si fjalë të veçanta me të njëjtën formë.
- Me shtimin e fjalëve nga një fjalor në tjetrin është rritur edhe numri i homonimeve.
- Nga studimi i thelluar i materialit shohim se homonimia dhe çështjet e saj më thelbësore janë pothuaj të njëjta për të dyja gjuhët. Ngjashmëria në trajtimin e tyre vihet re në pjesën dërmuese të temës. Veçantitë zënë një vend të konsiderueshëm, për më tepër kur bëhet fjalë për dy gjuhë indoevropiane që u përkasin degëve të ndryshme të kësaj familjeje të madhe, shqipja e një dege të veçantë dhe anglishtja e degës gjermanike. Zhvillimi i kësaj dukurie gjuhësore, sidomos në gjuhën angleze përbën zhvillim të gjuhëve dhe është shprehje e prirjeve të tyre për t'u përsosur.
- Çështja e homonimisë akoma pret për analiza dhe hulumtime të mëtejshme për të dyja gjuhët.

Si përfundim mund të themi se homonima nuk është një rregull, një ligj, një marrëdhënie e lidhje e nevojshme në sistemin e gjuhës, ajo është vetëm një rezultat, një pasojë e veprimit të rregullave e ligjeve të tjera të gjuhës, që vetëm rrallëherë bëhet shkak ndryshimesh.

Punimi i kësaj teme ishte një përvojë interesante, jo vetëm sepse ndriçoi disa dukuri të caktuara të semiologjisë dhe semantikës, por edhe sepse zgjoi interesin për të kërkuar më tepër mbi to në të ardhmen.

### **Perspektivat e punimit**

Shpresojmë që ky punim të ketë vlerë për studentë dhe pedagogë të të dyja gjuhëve, shqipe dhe angleze. Gjithashtu, shpresojmë që punimi të zërë një vend të merituar midis punimeve kushtuar çështjes së shenjës gjuhësore dhe asaj të homonimisë.

## REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA

### Literatura shkencore (artikuj dhe libra të botuar)

**Agolli, E.** *Vështrim përmasës i disa fushave leksiokore të anglishtes dhe të shqipes dhe problem të përvetësimit të leksikut në shkollë*, Tiranë, 1989.

**Allan, K.** *Natural Language Semantics*, Blackwell, Oxford, 2001.

**Arnold, I.** *The English Word*, Publishing House “High School”, Moscow, 1986.

**Atichison, J.** *Teach Yourself Linguistics*, London: Hodder and Stoughton, 1993.

**Attardo, S.** *Linguistic Theories of Humour*, Berlin; New York: Mouton de Gruyter, 1994.

**Bezhani, H.** *Cikël leksionesh për kursin e Gjuhësisë së Përgjithshme*, Tiranë, 1962.

**Brown, D. M.; Hall, J. W.** *The Cambridge History of Japan: Ancient Japan*, Cambridge University Press, 1993.

**Burton-Roberts, N.** *Meaning, semantics and semiotics*, te **Capone, A.** *Perspectives on Philosophy and Pragmatics*, Newcastle, UK: Newcastle University, 2011.

**Carrol, L.** *Alice through the looking glass*, Macmillan, 1871.

**Catford, C. J.** *A Linguistic Theory of Translation*, Oxford University Press, 1965.

**Chandler, D.** 2002, *Semiotics for Beginners*, London, Routledge, 2002.

**Chomsky, N; Mukherji, N; Patnaik, B; Agnihotri, R.** *The architecture of language*, New Delhi: Oxford University Press, 2000.

**Cruise, A. D.** *Polysemy and related phenomena from a cognitive linguistic viewpoint*, te *Computational Lexical Semantics*. Studies in NLP Cambridge University Press, 1995.

**Crystal, D.** *The Cambridge Encyclopedia of the English Language*, Cambridge University Press, 1995.

**Çabej, E.** *Studime Gjuhësore I*, Rilindja, Prishtinë, 1976.

**Çabej, E.** *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, I, N. 4, Tiranë, 1960.

**Çabej, E.** *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, II, Tiranë, 1982.

**Çabej, E.** *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, te *Bul. Un. Sht. Të Tiranës S. Shk. Shoq.* 1962.

**Danien E. C.; Sharer, R. J.** *New theories on the ancient Maya*, University of Pennsylvania, University Museum of Archeology and Anthropology, UPenn Museum of Archeology, 1992.

**Dent, J. M.** *Everyman's Encyclopedia*, V. 9, London, 1958.

**Djafarova, E.** “Why do Advertisers use puns? A linguistic perspective”, *Journal of Advertising Research*, June 2008.

- Doherty**, M. J. *Children's difficulty in learning homonyms*, Cambridge University Press, 2004.
- Eichhoff**, J. 'Ich bin ein Berliner', *A History and a Linguistic Clarification*, Monatshefte, Spring 1993.
- Elster**, E. *Prinzipien der Literaturwissenschaft*, 2, Brand II - Stilistik Halle, 1911.
- Elvin**, M. "The Spectrum of Accessibility: Types of Humor", *The Destinies of the flowers in the Mirror*. Te **Roger T. Ames** (et al.): *Interpreting Culture through Translation: a Festschrift for D. C. Lau.*, The Chinese University Press, Hong Kong, 1991.
- Fromkin**, V.; **Rodman**, R.; **Hyams**, N. *An Introduction to Language*, 7<sup>th</sup> ed. USA: Heinle, a part of Thomson Corporation, 2003.
- Geerartes**, D. *Theories of Lexical Semantics*, Oxford University Press, 2010.
- Gomez**, C. M. "A functional description of semantic relationships", *Language design* 4, 2002.
- Gramley**, S.; **Pätzold**, K. *A Survey of Modern English*, London: Routledge, 1992.
- Gruyter**, W.; **V. Allenton**, V. *L'écriture Chinoise*, Paris, 1970.
- Hartmann**, R.; **Stork**, F. C. *Dictionary of Language and Linguistics*, London: Applied Science Publishers Limited, 1976.
- Herbst**, Th. *English Linguistics: A Coursebook for Students of English*, Germany, 2010.
- Harris**, R. *The language machine*, Duckworth, London, 1987.
- Harris**, R. *Language, Saussure and Wittgenstein: How to play games with words*, London: Routledge, 1988.
- Hockett**, Ch. F. *Animal "Languages" and Human Languages*, te **Spuhler**, J. N. *The Evolution of Man's Capacity for Culture*, Detroit, MI, Wayne State University press, 1965.
- Jackson**, H.; **Amvela**, Z. E. *Words, Meaning and Vocabulary, An Introduction to Modern Lexicology, 2-nd Edition*, Athenaeum Press, London, 2007.
- Jakobson**, R. *Closing statement: linguistics and poetics*, te Sebeck, T. *Style in Language*, 1960.
- Jashari**, A. *Gjuhësi e zbatuar, I* (tekst për studentë), KOTTI, Korçë, 2003.
- Johnson**, S. *Preface to Shakespeare*, London, 1765.
- Junker**, D. "In defense of puns: How to use them effectively", *Public Relations Tactics*, February 2013.
- Katz**, J. J. *Semantic Theory*, New York: Harper and Row, 1972.
- Karcevskiy**, S. O. *On the asymmetric dualism of the linguistic sign*, "Travaux du Cercle linguistique de Prague", I, 1929.
- Kastovsky**, D. *Wortbildung und Semantik*, 1982 te **Lipka**, L. *English Lexicology, Lexical structure, word semantics and word-formation*, Gunter Narr Verlag Tübingen: Narr. 2002.

- Koleci, F. & Turano, G.** *Hyrje në Sintaksën Gjenerative të Shqipes*, shblu, Tiranë, 2011.
- Kornelja, S.; Beatrice, K.** “Paronimet në gjuhën e sotme shqipe”, *Studime Filologjike*, Tiranë, 1992.
- Kostallari, A.** “Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme”, *BShSh*, VI, Tiranë, 1955.
- Kostallari, A.** “Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme”, te *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vëllimi II, Tiranë, 1972.
- Kostallari, A.** “Parimet themelore për hartimin e ‘Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe’”, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vëllimi II, Tiranë 1972.
- Kreidler, Ch.W.** *Introducing English Semantics*, Routledge, London, 1998.
- Langer, S.** *Philosophy in a New Key*, Harvard University Press, 1951.
- Lamb, Ch.** “That the worst puns are the best”, *The last essays of Elia*, J.M. Dent and co., 1903.
- Leech, G.** *Semantics*, Penguin, London, 1976.
- Leech, G.** *Semantics. The study of Meaning 2<sup>nd</sup> ed.*, Penguin Books, London, 1981.
- Lehmann-Haupt, Ch.** “Books of the times”, *The New York Times*, New York, September 27<sup>th</sup>, 2013.
- Lèvi-Strauss, C.**, *Structural Anthropology*, Harmondsworth, Penguin, 1972.
- Lewis, D.** *General semantics*, Davidson & Harman, eds., 1972.
- Liddell. H.G.; Scott, R.** *A Greek-English Lexicon*, Oxford University Press, 1819.
- Lipka, L.** *English Lexicology, Lexical structure, Word semantics and Word-formation*, Gunter Narr Verlag Tubigen, 2002.
- Lloshi, Xh.** *Stilistika dhe Pragmatika*, Botimet Toena, Tiranë, 1999.
- Lloshi, Xh.** “Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe”, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vëllimi I, Tiranë, 1972.
- Lloshi, Xh.** “Rreth disa shfaqeve të ndërlimitit të homonimisë në gjuhën shqipe”, *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, Mihal Duri, Tiranë, 1972.
- Lyons, J.** *Semantics 1*, Cambridge University Press, 1977.
- Lyons, J.** *Semantics 2*, Cambridge University Press, 1977.
- Lyons, J.** *Introduction to theoretical linguistics*, Cambridge University Press, 1968.
- Lyons, J.** *Linguistics semantics: An Introduction*, Cambridge University Press, 1995.
- Lyons, J.** *Structural semantics*, Oxford: Basil Blackwell, 1972.
- Memisha, V.** *Studime për fjalën shqipe*, Botart, Tiranë, 2011.
- Memushaj, R.** *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004.
- Memushaj, R.** *Gjuhësia Gjenerative*, SHBLU, Tiranë, 2008.

- Moravcsik**, J. M. *Metaphor; creative understanding and the generative lexicon*, te **Bouillon**, P dhe **Busa**, F. (eds.) *The Language of Word Meaning*, CUP, Cambridge, 2001.
- Morris**, Ch. W. *Writings on the general theory of signs*, The Hague, Mouton, 1971.
- Nesfield**, J. C. *English Grammar Past and Present*, London, 1946.
- Newhouse**, D. *The encyclopedia of homonyms 'sound-alikes'*, Newhouse Press, USA, 1977.
- Newmark**, P. *A textbook of Translation*, Prentice Hall, 1988.
- Nida**, A. E. *Contexts in translating*, John Benjamin Publishing Company, 2001.
- Peirce**, Ch. S. *Collected Writings*, Cambridge, MA, Harvard University Press, 1831.
- Pustejovsky**, J. "The generative lexicon", *Computational Linguistics*, 17(4), 1991.
- Rainers**, L. *Stilkunst. Win Lehbruch deutscher Prosa*, 3, Aulf. München, 1950.
- Redfern**, W. *Puns*, Blackwell, London, 1984.
- Robson**, E. *Mathematics in ancient Iraq: a social history*, Princeton University Press, 2000.
- Saussure**, F. de. *Course in General Linguistics*, London, Duckworth, 1983.
- Saussure**, F. de. *Kursi i Gjuhësisë së Përgjithshme*, Prishtinë: Rilindja, Redaksija e Botimeve, 1977.
- Stefanllari**, I. *A Course in English Lexicology*, GEER, Tiranë, 2011.
- Sturrock**, J. *Structuralism and science: From Levi Strauss to Derrida*, Oxford University Press, 1979.
- Svensén**, B. *A Handbook of Lexicography: The Theory and Practice of Dictionary-Making*. Cambridge: Cambridge University Press, 2009.
- Richards**, I. A. *The Philosophy of Retic*, London, Oxford University Press, 1932.
- Richards**, J.C.; **Schmidt**, R. *Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics*, Essex, England: Pearson Education Limited, 2002.
- Rrokaj**, Sh. *Strukturalizmi semantik*, Shtëpia Botuese Shtypshkronja, Tiranë, 2007.
- Rrokaj**, Sh. *Hyrje në Gjuhësinë e Përgjithshme*, SHBLU, Tiranë, 2005.
- Tartakovsky**, J. *Pun for the Ages*, The New York Times, 2009.
- Thomai**, J. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1989.
- Thomai**, J. *Tiparet themelore të derivacionit semantik në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, 3, Tiranë, 1981.
- Thomai**, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë, 1974.
- Thomai**, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, UT, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Tiranë, 1984.
- Thomai**, J. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, shblu, Tiranë, 1999.
- Thomai**, J. *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Botimet EDFa, 2009.
- Thomai**, J. S. *Leksikologjia shqipe (për shkollat e larta)*, Tiranë, 1961.

- Todd**, L. *An Introduction to Linguistics*, Longman York Press, Essex, 1987.
- Waley**, A. *Three ways of thought in ancient China*, Stanford University Press, 1982.
- Watkins**, F. C.; **Dillingham**, W. B.; **Hiers**, J. *Practical English Handbook*, 11<sup>th</sup> ed. Boston: Houghton Mifflin Company, 2001.
- Yule**, G. *The Study of Language: An Introduction*, CUP, Cambridge, 1985.
- Yule**, G. *The Study of Language*, 3<sup>rd</sup> ed. Cambridge: Cambridge University Press, 2006.
- Zabalbeascoa**, P. *Dubbing and the non-verbal dimension of translation*, te Poyatos, F. *Non-verbal communication and translation: New perspectives and challenges in literature, interpretation and the media*, Amsterdam, 1997
- Zgusta**, L. *Manual of Lexicography*. The Hague/Paris: Mouton, 1971.

### **Literatura shkencore (artikuj dhe libra te paraqitur ne internet)**

- <file:///C:/Users/user/Downloads/301-1027-1-PB.pdf>
- <http://corpus.byu.edu/bnc/?c=bnc&q=22675971>
- <http://dictionary.reference.com/browse/pun>
- [http://en.wikipedia.org/wiki/Ash\\_Ketchum](http://en.wikipedia.org/wiki/Ash_Ketchum)
- <http://en.wikipedia.org/wiki/Caligula>
- <http://en.wikipedia.org/wiki/Cliché>
- [http://en.wikipedia.org/wiki/Collegiate\\_a\\_cappella](http://en.wikipedia.org/wiki/Collegiate_a_cappella)
- [http://en.wikipedia.org/wiki/Double\\_entendre](http://en.wikipedia.org/wiki/Double_entendre)
- [http://en.wikipedia.org/wiki/Dragon\\_Ball\\_\(disambiguation\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Dragon_Ball_(disambiguation))
- [http://en.wikipedia.org/wiki/Goku\\_\(disambiguation\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Goku_(disambiguation))
- [http://en.wikipedia.org/wiki/Good\\_Will\\_Hunting](http://en.wikipedia.org/wiki/Good_Will_Hunting)
- [http://en.wikipedia.org/wiki/Mark\\_Elvin](http://en.wikipedia.org/wiki/Mark_Elvin)
- [http://en.wikipedia.org/wiki/Pokémon\\_\(disambiguation\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Pokémon_(disambiguation))
- <http://en.wikipedia.org/wiki/Pun>
- <http://grammar.about.com/od/pq/g/punterm.htm>
- <http://leo.aichi-u.ac.jp/~goken/bulletin/pdfs/No16/03AbassF.pdf>
- <http://people.ucalgary.ca/~rseiler/semiolog.htm>
- <http://philosophy.tamu.edu/~rasmith/Courses/Ancient/predication.html>
- [http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns\\_2.htm](http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns_2.htm)
- [http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns\\_3.htm](http://puzzles.about.com/od/wordloverssites/a/puns_3.htm)
- <http://sharedsymbolicstorage.blogspot.com/2008/06/karl-bhlerbuhlerbuehler-on-evolution-of.html>
- [http://shkenca.org/pdf/gjuhe/homonimia\\_ne\\_fgjssh.pdf](http://shkenca.org/pdf/gjuhe/homonimia_ne_fgjssh.pdf)



<http://studentbank.ru/view.php?id=32196>

<http://studopedia.org/6-11674.html>

<http://unix.cc.cc.wmich.edu/~cooneys/poems/donne.hymn.html>

<http://www.aber.ac.uk/media/Documents/S4B/sem02.html>

[http://www.atilf.fr/IMG/pdf/verbum/Verbum\\_XXXI\\_1-2\\_1\\_4\\_Halawa.pdf](http://www.atilf.fr/IMG/pdf/verbum/Verbum_XXXI_1-2_1_4_Halawa.pdf)

<http://www.balkanweb.com/forumi/index.php?topic=1468.3Bwap2>

[http://www.calvin.edu/academic/philosophy/virtuallibrary/articles/smith\\_james/Betw072701.pdf](http://www.calvin.edu/academic/philosophy/virtuallibrary/articles/smith_james/Betw072701.pdf)

<http://www.ello.uos.de/field.php/Semantics/TheLinguisticsign>

<http://www.fjalori.shkenca.org/>

<http://www.grin.com/en/e-book/71829/linguistic-sign-theories>

[http://www.indiana.edu/~slavicgf/e103/assignments/Chandler\\_ch1\\_pt2.pdf](http://www.indiana.edu/~slavicgf/e103/assignments/Chandler_ch1_pt2.pdf)

<http://www.myboe.org/portal/default/Resources/Viewer/ResourceViewer?action=2&resid=13873>

[http://www.nytimes.com/2009/03/28/opinion/28Tartakovsky.html?\\_r=0](http://www.nytimes.com/2009/03/28/opinion/28Tartakovsky.html?_r=0)

<http://www.poetryfoundation.org/bio/john-dryden>

[http://www.rusnauka.com/15\\_NPN\\_2013/Philologia/7\\_135961.doc.htm](http://www.rusnauka.com/15_NPN_2013/Philologia/7_135961.doc.htm)

[http://www.semioticsigns.com/articlesofinterest/2007\\_09\\_20/handbook.pdf](http://www.semioticsigns.com/articlesofinterest/2007_09_20/handbook.pdf)

<http://www.thefreedictionary.com/pun>

<http://www.wisegeek.com/what-are-the-different-types-of-puns.htm>

<http://www.wisegeek.com/what-is-the-role-of-puns-in-literature.htm>

<http://www.wisegeek.com/what-is-the-role-of-puns-in-poetry.htm>

<http://yukari-h.livejournal.com/37896.html>

[www.Britannica.com](http://www.Britannica.com)

[www.English-for-students.com/Homonyms-B.html#chitika\\_close\\_button](http://www.English-for-students.com/Homonyms-B.html#chitika_close_button)

[www.sit.wisc.edu/~spkraus1/catalyst/reading/shakespeare2.shtml](http://www.sit.wisc.edu/~spkraus1/catalyst/reading/shakespeare2.shtml)

<http://stud24.ru/historical-figures/phonetic-coincidence-and-semantic-differentiation/204337-597644-page4.html>

**Barthes**, R. *Elements of Semiology*, 1964.  
<https://www.marxists.org/reference/subject/philosophy/works/fr/barthes.htm>

**Dash**, N. S. *Polysemy and Homonymy*  
[http://www.cfilt.iitb.ac.in/wordnet/webhwn/IndoWordnetPapers/08\\_iwn\\_PolysemyandHomonymy.pdf](http://www.cfilt.iitb.ac.in/wordnet/webhwn/IndoWordnetPapers/08_iwn_PolysemyandHomonymy.pdf)

*Humorous Homonym Sentences*  
<http://www.hse.k12.in.us/staff/rvanlandingham/Documents/Vocabulary/Humorous%20Homonym%20Worksheet.pdf>

**Kleiber, G.** *Problèmes de sémantique. La polysémie en questions*, Presses Universitaires du Septentrion te Pierre Frath, *Polysemy, homonymy and reference*, 1999.

<http://u2.u-strasbg.fr/spiral/Equipe/Pierre/Articles/AMB-ART.RTF>

**Nichols, D.** “*Watt is a homonym*”, MED Magazine, November 2<sup>nd</sup>, 2002.

<http://www.macmillandictionaries.com/MED-Magazine/November2002/02-language-interference-homonym.htm>

*On the linguistic sign asymmetry*

[http://www.rusnauka.com/15\\_NPN\\_2013/Philologia/7\\_135961.doc.htm](http://www.rusnauka.com/15_NPN_2013/Philologia/7_135961.doc.htm)

*Polysemy, homonymy and reference*, Departamenti Informatik i Shkencave Humane, Universiteti i Oksfordit, 1999. [http://u2.u-](http://u2.u-strasbg.fr/spiral/Equipe/Pierre/Articles/AMB-ART.RTF)

[strasbg.fr/spiral/Equipe/Pierre/Articles/AMB-ART.RTF](http://u2.u-strasbg.fr/spiral/Equipe/Pierre/Articles/AMB-ART.RTF)

**Riggs, W.F.** *Homonyms, Heteronyms and Allonyms*.

[www.webdata.soc.hawaii.edu/fredr/welcome.htm](http://www.webdata.soc.hawaii.edu/fredr/welcome.htm)

**Shields, Ch.** *Aristotle*, The Stanford Encyclopedia of Philosophy, Edward N. Zalta (ed.), 2012.

<http://plato.stanford.edu/archives/sum2012/entries/aristotle>

Wikipedia, Homonymy, 2010, f.2.

[en.wikipedia.org/wiki/User:Homograph](http://en.wikipedia.org/wiki/User:Homograph)

### **Vepra leksikografike (fjalorë shpjegues të gjuhës shqipe dhe asaj angleze, lista homonimesh etj.)**

*American Heritage Dictionary*, Second College edition, Houghton Mifflin Company, 1985.

*Collins English Dictionary – Complete and Unabridged*, Harper Collins Publishers, 1991, 1994, 1998, 2000, 2003. <http://www.thefreedictionary.com/homonym>

*The Concise Oxford Dictionary*, 12-th ed., Oxford University Press, 2011.

**Cooper, A.** *Homonyms list*, 1996.

<http://www.cooper.com/alan/homonym.html>

**Burke, R. R.** *Dictionary of Homonyms and Homophones*, Rogers Reference. Australia, 2000.

<http://rogersreference.com/>

**Finifter, T.** *Homonym / Homophone Page*.

<http://www.taupecat.com/personal/homophones>

*Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954.

*Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

*Fjalor i shqipes së sotme*, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Tiranë, 1984.

*Fjalor i Shqipes së Sotme*, Botimi i dytë, TOENA, Tiranë, 2002.

*Fjalor me Shprehje të Huazuara në Gjuhën Shqipe*, DUDAJ, Tiranë, 2007.

*Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.

**Hornby, S. A.** *Oxford Advanced Learner's Dictionary of Current English*, New Edition, Oxford University Press, 1974.

**Hornby, A. S.** *Oxford Advanced Learner's Dictionary*, Oxford University Press, 2000.

**Hornby, S. A.** *Oxford Advanced Learner's Dictionary*, International Student's Edition, Oxford University Press, 2000.

**Inglot Bey, A. F.** *A dictionary of English homonyms: pronouncing and explanatory*, Paternoster House, London, 1899.

<http://archive.org/stream/dictionaryofengl00beyauoft#page/124/mode/2up>

**Jashari, A.** *Fjalor me Shprehje të Huazuara në Gjuhën Shqipe*, DUDAJ, Tiranë, 2007.

*Kemerman English Multilingual Dictionary*, K Dictionaries Ltd, 2006 – 2013.

<http://kdictionaries.com/index.html#>

**Kostallarit, A.; Koci, R.; Skendi, Dh.** *Fjalor i shkurtër shqip – rusisht*, Shtëpia botonjës shtetërore e fjalorëve të huaj dhe nacionalë, Moskë, 1951.

**Kristoforidhi, K.** *Fjalori shqip – greqisht*, Tiranë, 1961.

**Kryeziu, B; Jashari, A.** *Fjalor i homonimeve të gjuhës shqipe*, Shkëndija, Prishtinë, 2008.

**Leoti, A.** *Fjalor shqip – italisht*, Romë, 1937.

**Man, S.** *A historical Albanian – English dictionary*, London, 1948.

**Meyer, G.** *Fjalor Etimologjik i Gjuhës Shqipe – 1891*, Botimet Çabej, Tiranë, 2007.

**Onions, C. T.** *The Oxford Dictionary of English Language*, Oxford at the Clarendon Press, 1966.

**Presson, L.** *A dictionary of Homophones*, Barron's Educational Series, USA, 1997.

**Rothwell, D.** *Dictionary of Homonyms*, Wordsworth Reference, Great Britain, 2007.

[www.wordsworth-editions.com](http://www.wordsworth-editions.com)

*Scholastic Pocket Dictionary of Synonyms, Antonyms, Homonyms*, Scholastic Reference Inc., July 1<sup>st</sup> 2012.

**Scott; Foresman, Thorndike Barnhart - Advanced Dictionary**, Illinois, USA, 1973.

**Spahiu, A.** *Fjalori i Sotëm i Gjuhës Shqipe*.

[http://shkenca.org/pdf/gjuhe/homonimia\\_ne\\_fgjssh.pdf](http://shkenca.org/pdf/gjuhe/homonimia_ne_fgjssh.pdf).

**Suber ; Thorpe** *An English homophone dictionary*.

<http://legacy.earlham.edu/~peters/writing/homofone.htm>

*The American Heritage Dictionary of the English Language*, Botimi IV, Houghton Mifflin Company, 2000.

<http://www.thefreedictionary.com/homonym>

*The Concise Oxford Dictionary*, Oxford University Press (Fjalor i vjetër i gjuhës angleze)

*Webster's College Dictionary*. 2010 K Dictionaries Ltd. Copyright 2005, 1997, 1991. Random House Kememan, Inc.

<http://www.thefreedictionary.com/pun>

*Webster's New College Dictionary*, Houghton Mifflin Company, Boston – New York, 1995.

WordNet 3.0, Farlex clipart collection, Princeton University, Farlex Inc. 2003-2012.

<http://www.thefreedictionary.com/homonym>

**Zengolewicz, K.** *Homonyms. When you need to write the right words*, Lexington, USA, 2011. [www.kathyzengolewicz.com](http://www.kathyzengolewicz.com)

## Literatura artistike

**Arapi, F.** *Eklipsi i ëndrrës*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2002.

**Arapi, F.** *Gloria Victis*, Botimet “Neraida”, 1997.

**Asllani, A.** *Hanko halla*, Botimet “Kristo Luarasi”, Tiranë 1942.

**Balzak, H.D.** *Iluzionet e humbura*, Botimet “Ombra GVG”, 2005.

**Belliu, I.** *Murgu i muzgut*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2005.

**Buxheli, Q.** *Karriera e zotit Maksut*, Mësonjëtorja, Tiranë, 2005.

**Çajupi, A. Z.** *14 vjeç dhëndër*, Shqipëri, 1930.

**Carroll, L.** *Alice's Adventure in Wonderland (Liza në botën e çudirave)*, June 2008.

<http://www.gutenberg.org/files/11/11-pdf.pdf>

**Flober, G.** *Zonja Bavari*, Botimet “Argeta LMG”, Tiranë, 2009.

**Frashëri, M.** *Hi dhe shpuzë*, Shtypshkronja “Mbrodhësia”, Sofje, 1915.

**Frashëri, N.** *Vepra të zgjedhura*, Akademia e Shkencave e RPSSH, 1985.

**Forsett, E.** *Pedantius*, 1851.

<http://www.philological.bham.ac.uk/forsett/>

**Hajne, H.** *Poema “Gjermania një përrallë dimri, Lirika I*, Tiranë, 2007.

**Kadare, I.** *E penguaga*, Botimet “Onufri”, 2009.

**Kadare, I.** *Ftesë në studio*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.

**Kadare, I.** *Koha*, Tiranë, 1976.

**Kadare, I.** *Koha e shkrimeve*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1986.

**Kadare, I.** *Pa formë është qielli*, Botimet “Onufri”, 2005.

- Karaxhale**, J. L. *Një letër e humbur*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977.
- Konica**, F. *Katër përrallat e Zullulandit*, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja e Parë”, Tiranë, 1999.
- Lamaj**, F. *Në kopshtin zoologjik*, Shtëpia Botuese “Rozafa”, Tiranë, 1996.
- Lashova**, S.; **Grillo**, O. K. *Gomari që desh të bëhej mbret, Fabula dhe epigram*, Tiranë, 1997.
- Leopardi**, Xh. *Këngë*, Botimet “Argeta LMG”, Tiranë, 2007.
- Marko**, P. *Nata e Ustikës*, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, Tiranë, 1999.
- Marko**, P. *Qyteti i fundit*, Shtëpia Botuese “Omsca”, Tiranë, 2000.
- Marko**, P. *Poezia shqipe*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1973.
- Noli**, F. *Album*, Boston, Mass. 1966.
- Poradeci**, L. *Poezi*, Botimet “Onufri”, Tiranë, 1999.
- Pushkin**, A. S. *Eugjen Onjegini*, Botimet “Argeta LMG”, Tiranë, 2001.
- Qosja**, R. *Vdekja më vjen prej syve të tillë*, Prishtinë, 1974.
- Rodani**, Xh. *Libri i gabimeve*, Prishtinë, 2004.
- Rusi**, S. *Korçës një fjalë dashurie*, Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2010.
- Shakespeare**, W. *Hamlet (Hamleti)*, 1599.
- <http://www.feedbooks.com>
- Shakespeare**, W. *Romeo dhe Zhulieta (Romeo and Juliet)*, Washington Square Press, 1992.
- Shaw**, B. *Pygmalion*, New York, 1916.
- Skaleta nga shfaqja “*Portokalli*”, 2011 – 2012.
- Sparks**, N. *Ëngjëlli mbrojtës*, Botimet “Bota Shqiptare”, Tiranë, 2005.
- Stendal**, F. *E kuqja dhe e zeza*, Shtëpia Botuese “Dituria”, 1997.
- Stendal**, F. *E kuqja dhe e zeza*, Shtëpia Botuese “Dituria”, 2004.
- Tolstoi**, L. *Ana Karenina, Vëllimi I*, Shtëpia Botuese “Kokona”, 2006.
- Vasa**, P. *Vepra letrare I*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1987.
- Vyshka**, M. *Mos m’a grisni abetaren*, “Erik”, Tiranë, 2001.
- Xoxe**, J. *Lumi i vdekur*, Botimet Encikolopedike, Tiranë, 2002.

## SHKURTIME

- anat. - term në anatomi
- ang. - anglishtja
- ang. vjet. - anglishtja e periudhës së vjetër
- ang. mes. - anglishtja e periudhës së mesme
- ang. mod. - anglishtja e periudhës moderne
- bot. - term në botanikë
- det. - term në detari
- dipl. - term në diplomaci
- dmth. - domethënë
- em. - emër
- etj. - e të tjera
- fol. - folje
- f. - faqe
- f. - emër i gjinisë femërore
- fig. - figura
- frëngj. - frëngjishtja
- frëngj. vjet. - frëngjishtja e vjetër
- ital. - italishtja
- jokal. - folje jokalmtare
- kal. - folje kalimtare
- krah. - krahinore
- lat. - latinisht
- lidh. - lidhëz
- m. - emër i gjinisë mashkullore
- mb. - mbiemër
- n. - noun (ang. emër)
- num. - numëror
- ndajf. - ndajfolje
- parafj. - parafjalë
- përem. vetv. - përemër vetvetor
- p.sh. - për shembull
- sh. - numri shumë
- tek. - term i teknikës

v. - verb (ang. folje)

vjet. - kuptim i vjetër i fjalës

zool. - term i zoologjisë

## Abstrakt

Një studim teorik në fushën e Semiologjisë e ndërthurur me Gjuhësinë karakterizon pjesën e parë të studimit. Shenja gjuhësore, tri modelet kryesore të saj, tipare, si: arbitrariteti dhe asimetria, realizojnë një shpjegim të hollësishëm të formimit të një shenje.

Duke pasur parasysh interesin e Semiologjisë për Semantikën kuptohet edhe lidhja e tyre në komunikimin e kuptimit. Të dyja fushat kanë një interes të përbashkët në lidhje me kuptimin e shenjave.

Pjesa e dytë e studimit trajton dukurinë gjuhësore të homonimisë duke nxjerrë në pah universalitetin e saj në gjuhën shqipe dhe angleze. Trajtimi teorik hedh dritë mbi prejardhjen e fjalës *homonimi*, shkaqet dhe burimet e lindjes së homonimeve në të dyja gjuhët, klasifikimet e tyre, ndikimin e homonimisë në gjuhë dhe kundërveprimin e gjuhës për t'a shmangur atë. Dallimi teorik midis homonimisë dhe polisemisë krijon një problem që, gjithashtu, ka tërhequr vëmendjen e shumë gjuhëtarëve.

Shfrytëzimi i fjalorëve bashkëkohorë nga të dyja gjuhët argumenton trajtimin e homonimeve në praktikën leksikografike dhe parimet që duhet të ndjekë një leksikograf në paraqitjen e tyre. Homonimet përftojnë mjete stilistikore dhe prania e tyre në stile të ndryshme e bën gjuhën tërheqëse, interesante, të gjallë, plot nota humori për lexuesin ose dëgjuesin.

**Fjalët kyçe:** *semiologji, gjuhësi, semantikë, shenjë, model, homonim, gjuha shqipe, gjuha angleze, klasifikim, polisemi, leksikografi, mjet stilistikor, lojë fjalësh.*

## Abstract

A theoretical study in the field of Semiology combined with Linguistics makes the first part of the work. The linguistic sign, its three main models, features, like: arbitrariness and asymmetry, bring a detailed explanation of the formation of a sign.

Considering the interest of Semiology on Semantics, we understand their connection to the communication of meaning. Both fields share a common interest about the meaning of signs.

Second part of the study focuses on the linguistic phenomenon of homonymy highlighting its universality both in English and Albanian languages. The theoretical approach depicts the origin of the word *homonymy*, the causes and sources of homonyms development in both languages, their classifications, the impact of homonymy in the language and the reaction of language against it. The theoretical difference between homonymy and polysemy raises a problem that has attracted the attention of many linguists.

The work with contemporary dictionaries of both languages, argues the use of homonyms in the lexicography of both languages and the principles that guide a lexicographer during their presentation. Homonyms are stylistic means and their application in various styles makes the language attractive, interesting, vital and full of humor for the reader or listener.

**Key words:** *semiology, linguistics, semantics, sign, model, homonymy, Albanian language, English language, classification, polysemy, lexicography, stylistic means, pun.*